

**Edukata Islame**  
*Revistë shkencore, kulturore islame tremujore*  
Viti XLI nr. 100 / 2012

**Edukata Islame**  
**Revistë shkencore, kulturore islame tremujore**  
Viti XLI nr. 100 - 2012

*Botues:*  
**Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës**  
*Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84*  
*Tel & fax: 038 / 224-024*  
e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

*Kryeredaktor:*  
**Mr. Qemajl Morina**  
qemajlmorina@hotmail.com

*Redaksia:*  
Akad. Pajazit Nushi, Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti,  
Nexhat Ibrahimi, Hajrullah Hoxha dhe Dr. Xhabir Hamiti.

*Sekretar i redaksisë:*  
**Hajrullah Hoxha**

*Lektor:*  
Bislim Berisha

*Korrektor:*  
Skender Rashiti

*Realizimi:* **Shtëpia Botuese** 

*Redaktor teknik &  
Operator kompjuterik:*  
Nuhi Simnica

Tirazhi: 600

# **Edukata Islame**

**Revistë shkencore, kulturore islame tremujore**  
**Viti XLI nr. 100 / 2012**

**Prishtinë**  
**2012**

## EDITORIALI

*Qemajl Morina*

## ME RASTIN E NUMRIT TË 100-TË JUBILAR

**Mulla Sherif ef. Ahmeti, kryeredaktor i parë**

*Të dashur lexues,*

Numri që keni në duar është numri i 100-të jubilar i revistës “Edukata Islame”, ndërkohë që është viti i dyzet e një i daljes së saj. Pra, mund të themi se kemi dy jubile të revistës më të vjetër islame jo vetëm në Kosovë, por pothuajse në të gjitha trojet shqiptare dhe në diasporë. Numri i 100-të jubilar i kësaj reviste po përkon edhe me 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë, gjë që këtë numër jubilar e bën edhe më madhështor.

Revista “Edukata Islame” për herë të parë filloi të dalë në vitin 1971, si organ i Shoqatës së Ulemave, për të vazhduar deri në (nr.61-62), të vitit 1997. Ndërsa prej numrit 63-64 të vitit 1998 e deri më sot del si Organ i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës.

Iniciator i kësaj nisme dhe kryeredaktor i parë, ishte Mulla Sherif ef. Ahmeti, myderriz i shumë brezave, që kaluan nëpër duart e tij në Medresenë “Aluaddin” të Prishtinës. Ai nuk ngurroi, që për numrin e parë të revistës të kërkojë ndihmën edhe të nxënësve të medresesë, që edhe ata të kontribuojnë me shkrime. Andaj, falë iniciativës së tij, m’u dha rasti, që shkrimin e parë ta botoj në numrin e parë të revistës

“Edukata Islame”. Andaj, për mua si dhe për shumë të tjerë ky jubile do të thotë një nismë në botën e shkrimeve, që është një ngjarje kumore në jetën e njeriut.

Nëse kryeredaktori është përgjegjësi kryesor për mirëvajtjen e një gazete apo reviste, atëherë, me rastin e revistës “Edukata Islame”, kjo meritë, për themelimin dhe zhvillimin e saj i takon kryeredaktorit të parë të saj, Mulla Sherif ef. Ahmetit, i cili me meritë mban edhe stazhin më të gjatë të kryeredaktorit. Ai kreu këtë detyrë prej numrit të parë të revistës deri në numrin 49, prej vitit 1971 deri në vitin 1987. Do të thotë se për 16 vjet ishte në krye të saj. Për ç’gjë vërtet, ai edhe meriton atributin e doajenit të publicistikës islame të gjuhës shqipe në Kosovë. Por, me këtë rast vlen të theksohet se kontributi i tij ishte shumë i gjerë edhe në lëmenjtë tjerë të jetës islame. Ai ishte myderriz nga duart e të cilit dolën me qindra nxënës nga të gjitha trojet shqiptare, si nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Shqipëria dhe diaspora. Ai u bë i njohur me përkthimin e kuptimeve të Kur’anit të Madhërisëm me komentim në gjuhën shqipe, i cili u ribotua disa herë, në miliona ekzemplarë dhe mund të konsiderohet libri me tirazhin më të madh në gjuhën shqipe deri më tani.

Andaj, kur ne sot, pas një periudhe kohore, prej katër dekadave i bëjmë një vështrim dhe vlerësim, në radhë të parë ajo i takon iniciatorit të kësaj nisme, i cili pati kurajën të marrë një hap të tillë të guximshëm.

## Rrugëtimi i “Edukatës Islame”

Kryeredaktori i dytë i revistës “Edukata Islame”, ishte Hajrullah ef. Hoxha, i cili ishte në krye të saj, prej numrit 50-54, prej vitit 1988-1990.

Edhe pse, si kryeredaktor pati një stazh të shkurtër, ai vazhdimisht ishte një shtyllë e kësaj reviste, krah i djathtë i të gjithë kryeredaktorëve. Ai edhe sot e kësaj dite, edhe pas pensionimit, është anëtar i redaksisë dhe në vazhdimësi është prezent me shkrime në faqet e saj.

Kryeredaktori i tretë, ishte Resul ef. Rexhepi, i cili udhëhoqi atë prej numrit 55 deri 64, prej vitit 1992-1998. Gjatë mandatit të cilit, “Edukata Islame” u pasurua mjaft si në aspektin përmbajtësor, por edhe ndryshoi formatin e saj, duke hyrë në mesin e revistave islame bashkëkohore.

Pas një pauze prej tre vjetësh, me iniciativën e përgjegjësit të atëhershëm për shtyp dhe veprimtari botuese, në njërin nga mbledhjet e Kryesisë së Bashkësisë Islame, në vitin 2001, u shqyrtua fati i mëtu-tjeshëm i saj. Pas një diskutimi objektiv dhe të gjithanshëm, për shkak të rolit të saj në afirmimin e jetës islame, jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë, rëndësisë së saj, u vendos të vazhdojë botimi saj. Me atë rast u caktua edhe redaksia e re. Dhe prej asaj kohe revista “Edukata Islame” vazhdoi daljen e saj deri në ditët tona, duke arritur kë-shtu numrin e saj jubilar të 100-të.

Në rrugëtimin e saj të gjatë, “Edukata Islame”, përjetoi natyrisht rritjen e saj si në aspektin kualitativ, por edhe atë kuantitativ. Nëse numri i parë i saj numëronte 59 faqe, numri i fundit arrin në 388 faqe. Kjo tregon rritjen dhe zhvillimin e revistës “Edukata Islame” në këto dyzet vjetët nëpër, të cilat ajo kaloi, duke kaluar nëpër periudha të ndryshme kohore.

Nëse temat e shtjelluara, në numrat e parë të saj dukshin modeste, tani ajo në përmbajtjen e saj ka tema me tematikë të ndryshme, të një spektri të gjerë. Mirëpo, kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se është arritur maksimumi.

Me gjithë vështirësitë dhe sfidat, me të cilat u ballafaqua “Edukata Islame” gjatë periudhës së kaluar, ajo arriti jo vetëm të mbijetojë, por edhe të trasojë rrugën e saj duke tubuar rreth vetes një numër të konsiderueshëm dashamirësh të fjalës së shkruar islame në gjuhën shqipe. Ajo ishte tribunë e shprehjes së mendimit islam. Prandaj, sot me plot të drejtë mund të thuhet se “Edukata Islame” gjatë periudhës së kaluar ishte histori e gjallë e kulturës sonë islame. Ajo është kronikë e zhvillimit të jetës sonë materiale e shpirtërore. Për këtë arsye, secili hulumtues dhe studiues i zhvillimit të jetës islame në Kosovë dhe në

trojet tjera shqiptare e ka vështirë ta bëjë atë pa iu referuar “Edukatës Islame”.

Revista “Edukata Islame” kontribuoi që fjala e shkruar islame në Kosovë, të mos mbetet monopol vetëm i saj, por me kalimin e kohës filluan të shihnin dritën edhe revista tjera. Kështu, në vitin 1986, nisi të botohej revista e përmuajshme “Dituria Islame”, organ i kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovë, pastaj revista, “Nur el-Kuran”, organ i shoqatës së nxënësve të Medresesë së Mesme “Alaudin”, kurse me hapjen e fakultetit të studimeve Islame, revista “Zgjimi Islam”, organ i Unionit të Studentëve të FSI-së, pastaj “Buletini”, revistë e Fakultetit të Studimeve Islame, si dhe një sërë botimesh të veçanta, qoftë në kuadër të shoqatës së Ulemave apo të Kryesisë së Bashkësisë Islame.

E sotmja dhe e ardhmja nuk mund të ndërtohen pa u mbështetur në të kaluarën. “Edukata Islame” e pa dritën dhe rriten e saj në kohërat më të vështira. Atëherë, kur komunizmi ishte në kulmin e fuqisë së tij. Megjithatë, ajo mbijetoi, falë vullnetit dhe përpjekjeve të atyre besimtarëve të përkorë dhe idealistëve të Islamit, brenda Bashkësisë Islame dhe jashtë saj, të cilët kishin besim të plotë, se fjala e shkruar islame në gjuhën shqipe, me gjithë peripecitë e shumta do të triumfojë. Por, vetëm duhej durim dhe angazhim i pareshtur. Dhe koha e vërtetoi se ata patën të drejtë.

### **Rrita dhe zhvillimi i “Edukatës Islame”**

Të nderuar lexues,

Tash më mbetet të flas për periudhën më të re, por edhe më të vështirë të revistës “Edukata Islame”, që fillon me numrin 65, të vitit 2001, kur pata nderin, por edhe përgjegjësinë që të jem në krye të revistës me të cilën kisha filluar rrugëtimin tim të shkrimeve të para. Është shumë vështirë që njeriu të flasë për vetveten apo punën e vet, për këtë, besoj se ju do ta keni fjalën si vrojtues dhe lexues, si dhe brezat që do të vijnë më vonë. Por, një gjë duhet ta them, se ishte fati i mirë i imi, por edhe i revistës, që ne patëm një redaksi të konsoliduar mirë, emra të njohur të pendës, të profileve të ndryshme, të cilët nuk

prituan asnjë herë që temat e parashtruara për botim t'i lexojnë, t'i analizojnë mirë para se ato të botohen. Po ashtu, pas botimit, në çdo mbledhje të redaksisë është bërë një analizë e temave të botuara dhe është dhënë vlerësimi i merituar me qëllim që lëshimet eventuale të mos përsëriten në numrat vijues.

Besoj se përvoja e “Edukatës Islame” ne hapjen e saj jashtë kornizave të Bashkësisë Islame, është treguar shumë i suksesshëm dhe duhet të zgjerohet edhe në segmente tjera të Bashkësisë Islame. Redaksia në përbërjen e saj ka akademikë, profesorë universiteti, të cilët me përvojën e tyre të gjatë i dhanë një gjallëri dhe shpirt të ri revistës, si në aspektin përmbajtësor dhe atë estetik, për ç’gjë unë u jam mirënjohës për punë dhe kontributin e dhënë në pasurimin dhe begatimin e saj.

Ajo që vlen të theksohet, se redaksia është përpjekur, aq sa ka pasur mundësi të bëjë freskimin e revistës me tema dhe rubrika të reja nga reportoari i tematikës islame.

Secila revistë apo gazetë për të rritur numrin e lexuesve, duhet të hulumtojë për bashkëpunëtorë të rinj dhe penda të reja, të cilët e pasurojnë atë me ide dhe tema të reja. Në këtë aspekt, jemi angazhuar edhe ne, duke botuar kohë pas kohe pjesë të temave të diplomave të studentëve tanë, me qëllim që atyre t’u ofrohet mundësi për paraqitje dhe një lloj stimulimi që ata të vazhdojnë në këtë drejtim.

Prej rubrikave të reja jemi përpjekur që kohë pas kohe të kemi recensione, kronika të ngjarjeve kulturore, simpoziumeve apo konferencave shkencore si dhe shënime bibliografike.

Ne qendër të vëmendjes së revistës ka qenë trashëgimia jonë kulturore shpirtërore dhe materiale në periudha të ndryshme të historisë sonë, si dhe portretet e figurave tona fetare dhe kombëtare në të gjitha trojet shqiptare.

Sa u përket planeve të redaksisë në të ardhmen, ne besojmë se po jetojmë në shekullin e specializimeve të ngushta, andaj është koha që kjo të ndodhë edhe me shtypin islam në kuadër të Bashkësisë Islame. Besoj, se “Edukata Islame” duhet të profilizohet në një revistë më tepër edukativo-arsimore me karakter pedagogjik, në veçanti kur ne

kemi dy institucione të specializuara në këtë aspekt: Fakultetin e Studimeve Islame dhe Medresenë e Mesme “Alauddin” në Prishtinë.

Ne shpresojmë se me pavarësimin e Kosovës, në një të afërme të afërt do të realizohet edhe kërkesa jonë e kamotshme për inkorporimin e lëndës së edukatës fetare në shkolla publike. Andaj, kjo kërkon një revistë të specializuar, që do të merrej me këto çështje. Këtë mision mund ta kryejë “Edukata Islame” në ndërkohë do të themelohej ndonjë revistë tjetër, e cila do të merrej me çështje teologjike islame, apo pse edhe të mos ketë më shumë se një revistë që do të merrej me aspektet e caktuara të profileve të ngushta të shkencave islame, siç është lëmi i hadithit, tefsirit, jurisprudencës islame etj.

Puna në një revistë është punë e përbashkët ekipore, ku marrin pjesë një numër faktorësh, prej përgatitjes e deri te arritja e saj te lexuesi është një hallkë zingjirorë, e cila nëse nuk funksionon si duhet mund të shfaqen defekte. Andaj, me këtë rast falënderoj të gjithë, duke filluar prej autorëve të punimeve, apo bashkëpunëtorëve, redaksinë, stafin e deri te distribuesit si dhe lexuesit tanë.

Dhe në fund, më lejoni t’u përkujtoj fjalën e Allahut të madhërisëm në fillim të kaptinës “El-Kalem”, ku thotë: **“Nun, betohem në penën dhe në atë që shkruajnë”.**

Njerëzit vdesin, ngjarjet harrohen, objektet, sado të mëdha qofshin ato, i shkatërron dhembja i kohës. Mbetet vetëm fjala e shkruar dëshmi e kontributit dhe përpjekjeve të njeriut për kryerjen e misionit të tij në këtë botë kalimtare.

Revistës “Edukata Islame” i uroj që të festojë edhe shumë jubile, duke shërbyer si një fanar i pashuar për myslimanët e të gjitha gjeneratave.

Qemajl Morina

**ON THE OCCASION OF THE PUBLICATION  
OF THE 100<sup>TH</sup> EDITION OF THE  
“EDUKATA ISLAME” MAGAZINE**

(Summary)

**Mullah Sherif ef. Ahmeti, first editor-in-chief**

Dear readers,

The current number marks a special anniversary – the publication of the 100<sup>th</sup> edition of the “Edukata Islame” Magazine. Its publication started 41 years ago. “Edukata Islame” is the oldest magazine of its kind not only in Kosova but throughout the territories inhabited by Albanians. Its 100<sup>th</sup> edition coincides with the 100<sup>th</sup> anniversary of the independence of Albania, which makes this occasion even more significant.

“Edukata Islame” was first published in 1971, as an official publication of the Ulemma Association. Its publication continued until 1997. Starting from 1998 it is the official publication of the Board of the Islamic Community of Kosova.

كمال مورينا

بمناسبة صدور عدد ١٠٠

(خلاصة البحث)

ملا شريف أفندي أحمدى أول رئيس تحرير

القراء الاعزاء ،

العدد الذى بين ايديكم هو العدد ١٠٠ لمجلتكم الغراء "التربية الاسلامية" فى حين بلوغها عامها الواحد أربعين من عمرها المديد من بداية صدورها . اذن يمكن القول بان هناك مناسبتان لا قدم مجلة اسلامية ليس فى كوسوفا وحدها بل فى كل الاراضى الالبانية والمهجر . العدد ١٠٠ الذهبى للمجلة ويتزامن أيضا مع الذكرى ال ١٠٠ لاستقلال ألبانيا، الأمر الذى يجعل هذه الذكرى أكثر روعة و عظمة .

بدأت مجلة "التربية الإسلامية" لأول مرة فى الظهور فى عام ١٩٧١، باعتبارها مجلة تابعة لهيئة لرابطة العلماء حتى العدد ٦١-٦٢ لسنة ١٩٩٧ فى حين أن ابتدا من عدد ٦٣-٦٤ لسنة ١٩٩٨ يبدأ صدورها كمجلة تابعة لمشيخة الجماعة الإسلامية فى كوسوفو.

## JURISPRUDENCË

**Mr. Ejup Haziri**

### **MARRËVESHJET E KOSOVËS DHE PAQJA E HUDEJBIJES** (studim krahasimtar mes marrëveshjeve laike dhe islame)

#### **Hyrje**

Njeriu si krijesa më e përsosur në këtë gjithësi, ka një prirje të jashtëzakonshme për të krijuar konflikte, lakminë e tij e ngop vetëm dheu, ajo lakmi e shpie atë në armiqësi ndaj të tjerëve, nga një lakmi e krijuar kalon në një konflikt të hapur, e nga konflikti i hapur vjen deri te lufta. Kështu është bërë lufta një traditë natyrore në mjedisin njerëzor, e cila përsëritet në çdo kohë dhe vend. Prandaj, ndodhin problemet dhe luftërat mes njerëzve në mbarë botën, pa përjashtim.<sup>1</sup>

Luftërat janë të vjetra, që nga njerëzit e parë, nga tronditja vrastare e bijve të Ademit, kur njeri deshi të mbizotërojë ndaj tjetrit, prandaj, vrasja dhe mbytja në këtë jetë u bë një gjë mjaft e njohur dhe e ndër-lidhur (ngushtë) me njeriun.<sup>2</sup>

Lufta e ka shoqëruar njerëzimin që prej krijimit të tij, ajo është rritur dhe zhvilluar me njerëzimin që nga faza e krijimit, rritjes dhe zhvillimit. Ajo është një dukuri njerëzore e vazhdueshme, saqë as mendja e as urtësia nuk ishin në gjendje ta eliminojnë atë, ngase shkaqet dhe motivet ndryshojnë, rigjenerohen me evoluimin e jetës, dhe kanë një vazhdë të ripërtëritjes.

Lufta, nuk ka dyshim, se është një gjë e urryer, ngase për shkak të saj ndodhin gjëra që nga vrasja, shkatërrimi, gjakderdhja, prishja e rendit, shkatërrimi dhe shumë tjera, që janë tendenca për efekte negative.

Por, marrëveshjet dhe traktatet ndalin luftërat, krijojnë paqe, sjellin siguri e stabilitet, kurdo që këto marrëveshje kryhen në pajtueshmëri me konditat e parapara të marrëveshjeve dhe me pajtimin e palëve kontraktuese. Por, kur ato bëhen padrejtësisht pa përfillur vullnetin dhe pajtimin e palëve kontraktuese, atëherë krijohen probleme e sfida të mëdha që lufta është e pashmangshme, si rrjedhojë e një marrëveshjeje të padrejtë.

Ndaj, është shumë me rëndësi që marrëveshjet të kryhen me pajtimin e plotë të palëve kontraktuese, e jo me imponim e mohim të plotë të të drejtave themelore.

Në këtë punim të shkurtër do të hedhim një vështrim mbi marrëveshjet e Kosovës apo ato që kanë të bëjnë me to, gjegjësisht disa që janë me kryesore, duke filluar nga ajo e Shen Stefanit e duke mbaruar me marrëveshjet e reja që u arritën gjatë këtij viti.

Do t'i prekim vetëm disa elemente të atyre marrëveshjeve, andaj nuk do të flasim gjerësisht se çfarë përmbajnë ato, me përjashtim të përmendjes së ndonjë elementi, për shkak se është e pamundur që brenda një punimi siç është ky të arrihet trajtimi i të gjithave. Ndërsa në pjesën e dytë do të flasim për periudhat në të cilat kalon marrëveshja, si dhe do të marrim shembullin e mirënjohur të marrëveshjes së Hudejbijes.

<sup>1</sup> Hadixhe Ebuetele, *El-Islamu vel-ilakatud-devlijeh fis-silmi vel-harbi: dirasetun muka-renetun*, Dar el-Mearif, pa vit botimi, Kajro-Egjypt, fq. 176.

<sup>2</sup> Dhafir El-Kasimij, *El-Xhihadi vel-hukuk ed-devlijeh el-ameh fil-islam*, bot. i I-rë, Dar el-Ilm lil Melajine, 1982, Bejrut-Liban, fq. 116.

## MARRËVESHJET E KOSOVËS NË RETROSPEKTIVË

Kosova përgjatë historisë së saj ka arritur marrëveshje të ndryshme, që shumica e tyre ishin në dëm të saj, duke filluar që nga ato të hershmet e deri këto në muajt që lam pas.

Që nga marrëveshja e armëpushimit të Shën Stefanit, ku ndonëse çështja shqiptare nuk ishte përmendur, por që kishte krijuar një situatë disfavorëse për shqiptarët, ngase me këtë marrëveshje, Perandoria Osmane humbte 80% nga territoret e Ballkanit, ndaj kjo ndikoi që Serbia dhe Mali i Zi të nisin fushatën e tyre të egër të gllabërimit dhe uzurpimit të tokave shqiptare.<sup>3</sup>

Pas Marrëveshjes së Shën Stefanit, erdhi Traktati i Berlinit,<sup>4</sup> i cili pranonte kërkesat e shteteve, por vetëm Fuqitë e Mëdha mund të vendosnin. Edhe në këtë marrëveshje, copëtimet e tokave shqiptare nuk kishin të ndalur, megjithëse ishte më e mirë se ajo paraprake.<sup>5</sup>

Më pas erdhi Konferenca e Londrës, ku prej çështjeve kryesore ishte çështjen shqiptare. Në këtë Konferencë u arrit pajtimi mes Shteteve të Mëdha që tokat shqiptare të ndaheshin mes fituesve, si dhe Kosova përfundimisht u shkëput nga Shqipëria, pasi që ishte pjesë e saj, e toka e saj u nda mes Serbisë dhe Malit të Zi.

Ajo që vlen të theksohet këtu, është fakti se në këto marrëveshje dhe traktate, mungonin elementet thelbësore që e bënë të fuqishme dhe të aplikueshme një marrëveshje, si:

<sup>3</sup> Vlen të theksohet se Sulltani AbdulHamidi i dytë ishte kundër kësaj marrëveshje që tokat shqiptare t'u jepeshin serbëve, grekëve dhe malazezve, ngase ky sulltan kishte një simpati të madhe ndaj shqiptarëve. Ai thoshte se Perandoria Osmane mbahet dhe ruhet nga shqiptarët..." Ky sulltan e kishte inkurajuar Lidhjen e Prizrenit që të ngriheshin kundër këtij vendimi.

<sup>4</sup> Erdhi si pasojë e pakënaqësisë së shumë shteteve nga Marrëveshja e Shën Stefanit, e cila favorizonte Rusinë, e ndaj së cilës frikësoheshin shumë shtete.

<sup>5</sup> Shih për copëtimet e tokave shqiptare: *Historia e Popullit Shqiptar*, Prishtinë, 1996, fq. 155; Jusuf Bajraktari & Arber Salihu, *Historia e përgjithshme*, fq. 58.

## E para: Moslejimi i të shprehurit

Shqiptarët, ndonëse vendi i tyre dhe ata ishin autoktonë, atyre nuk iu lejua që të shpreheshin lirshëm dhe të flisnin për çështjen e tyre, ndaj ky element i bën këto marrëveshje e traktate të padrejta, ngase ato u realizuan pa pëlqimin e dy palëve, dhe njëherësh kjo bën edhe divergjencën mes popujve dhe religjioneve, duke ua dhënë jomyslimanëve tokat e mysli-manëve. E kjo nuk ka të komentohet ndryshe vetëm se ata çështjen shqiptare e shihnin si një pikë të zezë për shkak të përkatësisë Islame të shqiptarëve.

Ne në historinë Islame kemi shembuj të shumtë e të panumërt për marrëveshje e traktate ndërmjet mysli-manëve dhe jomysli-manëve, e padyshim që Pakti i Hudejbijes<sup>6</sup> është shembulli më i mirë, e që është kryer pa imponim, por me pajtim të ndërsjellë të të dy palëve kontraktuese, që me gjithë urrejtjen, ata zhvilluan bisedime e negociata dhe u shprehën lirshëm. Marrëveshjet që kryhen me imponim dhe pa pëlqim të dyanshëm, lënë pasojë afatgjata dhe krijojnë probleme të ndryshme që rezultojnë edhe në luftëra. E shembulli ynë është një pasqyrim i këtij realiteti të hidhur.

## E dyta: Mosliria ndaj besimit dhe mendimit

Secilën marrëveshje që e shqyrtojmë ishte në dëm të mysli-manëve dhe në dobi të besimeve tjera, për shkak se mysli-manët në këto troje ishin të paktë në numër dhe të pafuqishëm, ndonëse sa ishin nën Perandorinë Osmane ishin të fuqishëm dhe luanin rol. Andaj, në këto marrëveshje sikurse bota joislame u hakmorr ndaj pakicës Islame dhe sikurse ia arritën qëllimit të përqeshjes me mysli-manë, ndonëse bota Islame që nga fillimi ka dëshmuar për një praktikë krejtësisht tjetër, ku pasqyrohet toleranca e mirëfilltë në marrëveshje e traktate mes mysli-manëve dhe jomysli-manëve, e për këtë shembulli më i mirë është Karta e Medinës, ku i Dërguari i Allahut i ftoi të gjitha palët; mysli-

<sup>6</sup> Do të flasim më vonë për Marrëveshjen (Paktin) e Hudejbijes.



manët, çifutët dhe të tjerët, që të bashkëjetonin në paqe e harmoni, duke iu siguruar secilit praktikimi i besimit të tij lirshëm, mbrojtja e vendeve religjioze, liria e të shprehurit, liria e pronës private dhe shumë çështje tjera.<sup>7</sup> Ndonëse kjo kartë, ishte kushtetuta e parë e shkruar në këtë frymë, ajo përmbante 51 nene, ku njëzet e gjashtë flisnin për të drejtat dhe përgjegjësitë e komuniteteve tjera (joislame).

Kemi marrëveshje të shumta, e që njëra ndër to që është shumë e njohur është Pakti i Omerit drejtuar popullit të Palestinës<sup>8</sup>: “Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirbërësit. Kjo është siguri të cilën shërbëtori i Allahut ‘Omeri’, komandant i besimtarëve, garanton siguri për popullin e Palestinës. Ai iu jep atyre një garanci sigurie për veten e tyre, pronat dhe kishat e tyre, për të sëmuret dhe të shëndetshmit në këtë qytet, gjithashtu një garanci për të gjitha ritualet që i përkasin fesë së tyre. Kishat e tyre nuk do të banohen nga myslimanët dhe nuk do të shkatërrohen. As ata, as toka në të cilën qëndrojnë, as pronat e tyre assesi nuk do të dëmtohen. Banorët e Palestinës nuk do të detyrohen me forcë të konvertohen. Ata duhet ta paguajnë taksën sikurse e paguajnë atë edhe popujt të qyteteve tjera, dhe banorët e Palestinës duhet t’i dëbojnë bizantinët dhe grabitësit nga ky qytet...”<sup>9</sup>

### E treta: Marrëveshje imponuese

Në këto marrëveshje dhe traktate, imponimi ishte prezent dhe shtetet e mëdha dhe të fuqishme përdornin atë si mjet ndaj shteteve të vogla dhe të pafuqishme, duke bërë që ato të përfitojnë.

Islami e refuzon një veprim të tillë, duke qenë kategorik kundër imponimit dhe kundër marrëveshjeve që bëhen dhunshëm, pa vullnetin dhe pëlqimin e të dy palëve, qoftë me përdorimin e armëve apo ndonjë kërcënim tjetër.

<sup>7</sup> Subhi Mahmesani, *El-Kanun vel ilakat ed-Devlijeh fil Islam*, bot. i II-te, dar el-ilm lil Melajine, Bejrut-Liban, 1982, fq. 140.

<sup>8</sup> Kjo kishte ndodhur në vitin e 15-të hixhri, apo 636 miladi.

<sup>9</sup> Al-Tabari, *The History of al-Tabari*, trans. Y.Friedmann, Albany: SUNY Press, 1985, vol. XII, p.191.

Në Islam, shembulli më sublim për marrëveshje është ai i Hudejbijes, kur i Dërguari i Allahut bënte marrëveshje me Suhejl ibn Amrin, e ky i fundit nëse nuk pajtohej me ndonjë prej kushteve të marrëveshjes, atëherë refuzonte dhe nuk pranonte, në mënyrë që marrëveshja mes tyre të jetë në bazë të vullnetit e pajtimit, e jo me imponim e forcë.

Islami në asnjë mënyrë nuk e afirmon e as që e pranon parimin e imponimit, e çdo kontratë që bëhet pa ofertë dhe pranim e trajton si kontratë të pavlefshme.<sup>10</sup> Ndërsa kontratat dhe marrëveshjet që arrihen nën presion dhe imponim apo edhe nën cytjen e armëve dhe luftërave, konsiderohen marrëveshje që mund të bëhen të pavlefshme, ngase një popull nuk mund të flejë gjithnjë mbi padrejtësi, e ditët ndërrohen, i ligu një ditë forcohet, i shtypuri fiton lirinë, e ai që ka të drejtë e kërkon drejtësinë, e kështu edhe fillon betejë e re derisa të kthehet e vërteta tek ata që u takon dhe drejtësia te kërkuesit e saj.<sup>11</sup>

### E katërta: Marrëveshja pa praninë e udhëheqësit

Të gjitha marrëveshjet janë kryer pa prezencën e përgjegjësit të Kosovës, madje as që kishin lejuar që të prezentonte dikush nga Kosova e lëre më të fliste për këtë të drejtë, e për shtetet tjera, sado të vogla që ishin ato, kishin të drejtën e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të tyre dhe të flisnin haptazi për interesat dhe kërkesat e tyre.

Islami inkurajon që edhe nëse marrëveshja ka të bëjë mes një shteti dhe një province, të bëhet me përfaqësuesit e tyre, e jo me të tjerët, që nuk përfaqësojnë askënd.

Këto marrëveshje që në thelbin e tyre sillnin padrejtësi të mëdha, do të shkaktonin trazira, probleme, por edhe luftëra që do të pësojnë njerëz të pafajshëm.

Pas këtyre marrëveshjeve mizore, radha erdhi te Marrëveshja e Rambujesë, ku një draft-marrëveshje ishte përgatitur nga amerikanët

<sup>10</sup> Mahmud Ibrahim ed-dik, *el-Muahadat fish-Sheriatil islamijeh vel kanun ed-devlij el-am*, bot. i II-të, el-Mektebetul Vetanijetu, 1418h-1997m, fq 176.

<sup>11</sup> Vepër e cituar, fq. 195.

dhe evropianët, ndërsa për palët në konflikt mbetej miratimi apo refuzimi. Pas një hapësire kohore të gjatë, më në fund delegacioni kosovar e pranoi, përderisa ai serb refuzoi, ndaj kjo i dha shkak që NATO të niste fushatën e saj bombarduese.

Në këtë marrëveshje parashihej që Kosova të ishte në kuadër të Jugosllavisë, por jashtë Serbisë<sup>12</sup>, e kësaj të fundit i lejohej që të kishte 12000 ushtarë dhe 3000 policë brenda territorit të Kosovës. Kufijtë parashiheshin të monitoroheshin nga forcat serbe, por të mbeteshin të pandryshueshëm. Kjo marrëveshje kishte disa nene që nuk favorizonin çështjen shqiptare e as që sinjalizonin për një pavarësi nga Serbia, por e rëndësishme ishte fakti që çështjen kosovare e bënte si çështje globale që duhet të zgjidhet.

Nëse ia hedhim një analizë të shkurtër kësaj marrëveshjeje të rëndësishme, mund të konstatojmë se kjo hapi një derë të re për çështjen tonë dhe ishte në interes tonë të përgjithshëm, ndaj do të ndalemi në tre aspekte të kësaj marrëveshjeje:

### **E para: Ishte në interes të popullit tonë**

Për herë të parë, ndoshta në historinë shqiptare, një marrëveshje e tillë, e projektuar nga vendet që dikur bënë pazarllëqe me tokat shqiptare, ishte në interesin shqiptar, edhe nëse interesi ishte i pjesshëm, ngase jo e tëra ishte në favorin tonë, por pjesërisht ishte në interesin tonë të përgjithshëm.

Prej kushteve të marrëveshjeve në Islam është edhe interesi, ngase nuk paramendohet një marrëveshje në Islam që nuk sjell dobi dhe interes.

<sup>12</sup> Ndonëse në këtë kohë çështjet jugosllave i drejtonte Serbia, ngase kishte mbetur vetëm ajo dhe Mali i Zi në kuadër të Jugosllavisë, ngase shtetet tjera ishin bërë të pavarura, ndaj në një farë forme kjo pikë kishte shpjegim të dyanshëm.

### **E dyta: Ndërmjetësit me qëndrim të drejtë**

Në këtë marrëveshje, ndërmjetësit-siç kemi potencuar sipër ishin amerikanët dhe evropianët, kishin qëndrim të drejtë, e kjo ndoshta ndodhte për herë të parë në raport me Kosovën, madje ata u futën në luftë edhe me serbët, për Kosovën. Ndaj, qëndrimi i tyre ishte i drejtë, për dallim nga e kaluara, kur në marrëveshjet e hershme shqiptarët i quanin si “mbeturina e turqve” për shkak ishin të dominuar nga aspekti religjioz, por që kësaj here kishin qëndrim krejtësisht të kundërt.

Kjo marrëveshje mund të cilësohej e drejtë deri në një masë, pasi që synonte të pajtonte dy popuj, e pala e tretë që ishin ndërmjetësues, kishin hartuar marrëveshjen në bazë të realitetit në Kosovë, ndaj ata ishin neutral, e neutraliteti e bën këtë marrëveshje të rëndësishme, kur dihet se edhe në Islam lejohen marrëveshje të tilla të inicuar dhe të përgatitura nga pala e tretë, e cila ka për qëllim pajtimin e dy popujve, por që kjo palë duhet të jetë krejtësisht neutrale. E rëndësishme është që marrëveshja të jetë e drejtë. Në historinë Islame nuk raportohet për asnjë marrëveshje apo traktat që të jetë bërë me imponim.

### **E treta: Marrëveshja me pajtim**

Nëse shikojmë rrjedhën dhe ecurinë e marrëveshjes, kuptojmë se ajo ishte e gatshme, ku delegacionet mund të pajtoheshin rreth saj apo ta refuzonin atë, por që pala e tretë nuk kishte detyruar asnjërin delegacion që ta pranojnë atë. Pra, dy delegacionet kishin të drejtën e pranimi apo të mospranimi. Kushdo që pajtohej mund ta nënshkruante atë, e ai që nuk pajtohej mund të mos nënshkruante atë, por që nenet e kësaj marrëveshje ishin të pandryshueshme, ngase po të lihej kjo si alternativë, atëherë dy delegacionet nuk do të pajtoheshin asnjëherë.<sup>13</sup>

<sup>13</sup> Ndonëse në praktikë, disa nene të kësaj marrëveshjeje u ndryshuan pas ankesave nga delegacioni serb dhe shqiptar.

Me fjalë të përgjithshme mund të them se kjo marrëveshje plotëson kushtet dhe kriteret e nevojshme që duhet të plotësohen në marrëveshje, e që është pajtimi, dobia e disa tjera.

Pas kësaj marrëveshje, u arrit një marrëveshje tjetër, ajo e Kumanovës, për ndërprerjen e luftës, e që kësaj radhe u bë pa prezencën e udhëheqësisë kosovare dhe pa prezencën e udhëheqësve të UÇK-së, por që marrëveshja u arrit vetëm mes gjeneralëve serbë dhe atyre të NATO-s. Pra, mungonte pëlqimi i palës shqiptare, madje as që ishte konsultuar ajo palë, ndonëse ishte çështja thelbësore për interesin e vendit dhe popullit. Edhe në të Drejtën Ndërkombëtare nuk parashihet një marrëveshje e tillë, por që është praktikuar edhe në disa vende tjera, ku shtetet e fuqishme kishin bërë marrëveshje të tilla, ku shtetet e pafuqishme nuk ishin pyetur fare.

Një çështje tjetër që ndërlidhet me këtë marrëveshje është edhe fakti se interesi i kësaj marrëveshje ishte i kufizuar, ndërsa kishte edhe dëme të mëdha, si çmilitarizimi i UÇK-së, që kishte dobësuar tejmas faktorin ushtarak dhe politik, e që kishte ngjallur reagime të mëdha, e që kjo marrëveshje ishte kryer pa prezencën e UÇK-së. Një marrëveshje e tillë nuk mund të konsiderohet e pranueshme sipas kushteve dhe kriterëve të marrëveshjeve në Islam, ngase mungojnë kriteret thelbësore.

Rrjedhat pastaj kishin marrë një karakter tjetër, e pas disa viteve, filluan negociatat e reja në Vjenë, që vazhduan për kohë të gjatë, por pa sukses, e kjo e detyroi Martti Ahtisarin të shpallë përfundimin e negociatave dhe të fillojë hartimin e një plani gjithëpërfshirës për situatën përfundimtare në Kosovë.

Ai hartoi Planin e tij, të cilin e pranoi Kosova por jo edhe Serbia, por që në fakt ishte kundër interesave të shqiptarëve dhe myslimanëve kosovarë. Ndaj do të ndalemi këtu te plani i tij për të hedhur një vështrim nga disa pikëpamje:

## E para: Injorimi ndaj fesë zyrtare

Plani Gjithëpërfshirës i Ahtisarit e bën Kosovën një shtet pa fe zyrtare dhe neutral ndaj çështjeve të besimit: “Kosova nuk ka fe zyrtare dhe që do të jetë e paanshme në çështjet e orientimeve fetare” (An. I, 1.4). Zakonisht, në shumicën e vendeve, qofshin ato evropiane apo vende tjera, shteti megjithëse është i ndarë nga feja, ka një fe zyrtare, si për shembull Norvegjia, ndonëse është ndarë feja nga shteti, mirëpo fe zyrtare e saj është protestantizmi. Po kështu qëndron edhe me shtetet tjera evropiane, pa marrë parasysh ndarjen e fesë së tyre nga shteti.

I çuditshëm është fakti se një injorim i tillë i bëhet shumicës e që janë myslimanët, ku përqindja e tyre arrin në 96%<sup>14</sup> dhe një refuzim i tillë është tejet e papranueshëm dhe kundër ligjeve e të drejtave njerëzore. Pas kësaj, Bashkësia Islame e Kosovës kishte dalë me disa vërejtje rreth Planit të Ahtisarit, ku në reagim thuhej: “...Në pakon e Presidentit Ahtisari, ndër të tjera, thuhet se “Kosova nuk ka fe zyrtare dhe që do të jetë e paanshme në çështjet e orientimeve fetare” (An. I, 1.4). Një trajtim i këtillë i fesë, cila do qoftë ajo, na duket i padrejtë dhe mund të shkaktojë reagime në mesin e besimtarëve. Në të vërtetë, një qasje e këtillë na rikujton të kaluarën e hidhur të sistemit monist – ateist, kur feja jo vetëm që ishte anashkaluar por edhe ishte luftuar nga regjimi i atëhershëm. Nuk duhet harruar se një numër i konsideruar i vendeve evropiane, ku feja është e ndarë nga shteti, megjithatë feja zyrtare figuron në kushtetutat e tyre. Gjithashtu, duhet theksuar se ne asnjëherë nuk kemi pretenduar dhe as tani nuk pretendojmë që ne si shumicë absolute të privilegjohejmë ose që formulimi të bëhet në dëm të bashkësive të tjera tradicionale të vendit. Nga ana tjetër, nuk

<sup>14</sup> Duke u bazuar në statistikat e fundit të të dhënave preliminare të dala nga regjistrimi i fundit i popullsisë, ku në Kosovë jetojnë 1.8 milion banorë. Nga ta, 96 për qind janë myslimanë, 2.2 për qind katolikë dhe 1.5 për qind ortodoksë. Këto janë të dhënat preliminare të dala nga regjistrimi i fundit i popullsisë. Rreth 93 për qind e banorëve janë shqiptarë, 1.5 për qind janë serbë-pa përfshirë veriun, boshnjakë 1.6, turq 1.1... Më shumë se një milion e gjysmë të qytetarëve të Kosovës janë myslimanë. Kjo ka dalë nga regjistrimi i popullsisë në Prill të vitit që shkoi. Shih:

<http://www.botasot.info/def.php?category=3&id=154702>

duhet harruar, gjithashtu, se çdo përpjekje për imponimin e një multi-etniteti apo multireligjioziteti artificial mund të prodhojë efekte negative për shoqërinë kosovare...”<sup>15</sup>

Po të shikojmë secilën marrëveshje apo traktat gjatë kohës së të Dërguarit të Allahut, do të gjejmë se ato janë shembuj sublimë që flasin për tolerancën ndaj jomyslimanëve, duke ua miratuar fenë e tyre dhe duke ua mbrojtur të drejtën e besimit dhe aplikimit në jetën e përditshme. E, kjo mund të vërtetohet edhe në marrëveshjen mes tij dhe çifutëve të Medinës, ku mes tjerash thuhej: “...jomyslimanëve u takon aplikimi i besimit dhe pasuria e tyre, ata nuk do të imponohen të kalojnë në fenë Islame, e as që do t’u merret pasuria e tyre...”

### **E dyta: Injorimi i trashëgimisë Islame dhe njohja e trashëgimisë ortodokse**

Çështja tjetër, që në thelb, është mjaft injoruese dhe diskriminuese ndaj shumicës absolute, e që ka të bëjë me trashëgiminë Islame, ku në Aneksin V të Planit Gjithpërfshirës, përmendet vetëm trashëgimia ortodokse, por jo ajo Islame. Madje të gjitha nenet e Planit në Aneksin e theksuar, i dedikohet mbrojtjes së trashëgimisë së Kishës Ortodokse Serbe, kur dihet mirë se Kisha Ortodokse Serbe, i kishte dhënë përkrahje të jashtëzakonshme regjimit të Millosheviqit dhe terrorit të tij, e në anën tjetër, shqiptarët përgjatë historisë së tyre, ishin ata që kishin mbrojtur e ruajtur monumentet e tilla. Një trajtim i tillë, është në kundërshtim me vlerat e çmuara që i ka Kosova dhe është kundër interesave të shqiptarëve, ngase trashëgimia Islame është shumëherë më e madhe se sa ajo serbe, por në anën tjetër mungon edhe përmendja e trashëgimisë katolike shqiptare.

Ahtisari me veprimin e tij e mohoi trashëgiminë Islame që nga koha e Osmanëve e deri në ditët tona, e që për çdo çast ka qenë dominante në vendin tonë përgjatë gjashtë shekujve. Ndërsa trashëgimia serbe, shumica e saj është ndërtuar dhunshëm dhe gjatë kohës së fund-

<sup>15</sup> “Kushtetuta e ardhme e Kosovës të njohë fetë tradicionale.” Dituria Islame, viti XIX, nr.199, shkurt 2007, fq. 4.

it, për të proklamuar rrejshëm para botës se Kosova është toka e tyre apo djepi i kulturës së tyre. Shumica e kishave dhe manastireve janë ndërtuar gjatë shekullit të kaluar, kur ne ishim të okupuar nga Serbia.

### **E treta: Pabarazia mes besimeve dhe privilegjet e veçanta ortodokse**

Plani Gjithpërfshirës diskriminon besimet fetare, ngase nuk parashihet barazi për të gjitha ato besime, për faktin se çmon dhe përkrah besimin ortodoks, duke i dhënë privilegje të veçanta, që pothuajse nuk ndodh në asnjë vend të botës. Kështu sa për ilustrim, një numër i zgjedhur i manastireve dhe kishave ortodokse serbe, sikurse edhe objektet fetare e historike serbe, gezojnë mbrojtje të veçantë përmes përcaktimit të “Zonave të mbrojtura”.<sup>16</sup> Për ironi, hartuesi i Planit, nuk kishte caktuar “Zona mbrojtëse” ndaj objekteve Islame në vendet që popullohen me serbë.

Gjithashtu ky plan parashihet që “Kosova duhet t’i ofrojë Kishës Ortodokse të Serbisë privilegje doganore dhe tatimore”,<sup>17</sup> ndërsa mungon një tretman i njëjtë edhe për bashkësinë Islame dhe atë Katolike. Pra, Kosova duhet t’i ofrojë privilegje Kishës serbe, e cila e kishte përkrahur diktatorin e Ballkanit, për vrasje, dhunim, keqtrajtim, spastrim etnik...etj., ndaj popullatës shqiptare. Kurse pas luftës, kësaj kishë që kishte përkrahur terrorin, i jepën privilegje të ndryshme, në vend se të ndëshkohet për veprimet e bëra.

Serbët kishin shkatërruar 218 xhamia gjatë luftës së fundit, e disa xhami ishin shumë të vjetra e të një rëndësie të veçantë, sikurse që ishte “Xhamia Ramadanije”, e cila daton nga viti 1470, ndërsa kishin shkatërruar edhe objekte tjera të trashëgimisë Islame nga e kaluara osmane.<sup>18</sup>

<sup>16</sup> Aneksi V, neni 4, alineja 4.1.

<sup>17</sup> Aneksi V, neni 2, alineja 2.2.

<sup>18</sup> Mehmet Ibrahimil, ‘Eski Yugoslavyya –I’, Günümüz Dünyasında Müslüman Azinliklar, s.165-166; Shih Muhamed Aruci, ‘Kosova (1912-2002)’ Periudha postosmane, Dituria Islame, nr. 150, Janar 2003, fq. 77-80.

Historikisht shqiptarët nuk kishin shkatërruar asnjë kishë serbe gjatë historisë, por ata i kishin ruajtur ato objekte, madje edhe atëherë kur serbët nuk ishin në vendet e kultit të tyre.

Ky plan, në tërësinë e tij, nuk përmend qoftë edhe një herë të vetme emrin xhami apo monumente historike islame, e as trashëgiminë fetare e kulturore Islame, ndërsa në anën tjetër përmend kishat, sinagogat dhe monumentet historike të kishës ortodokse serbe në shtatëdhjetë vende.<sup>19</sup>

### **E katërta: Plani, kundër interesave të myslimanëve**

Ky plan në tërësi është i dëmshëm për myslimanët, përderisa nuk përmend objektet fetare islame, madje edhe mohon prezencën e Islamit dhe myslimanëve, të cilët përbëjnë 96% të popullatës. Nga ana tjetër, i jep rëndësi të madhe një komuniteti destruktiv që ka zhvilluar katër luftëra brenda një dekade, dhe që ka kryer krime të ndryshme, e që nga këto privilegje, pësimin më të madh do ta pësojnë shqiptarët, të cilët, përkundër që janë vendës, nuk janë të barabartë me pakicën e vendosur në këto troje.

Ky plan, është diskriminues, i dëmshëm për shqiptarët dhe në dobi të serbëve, e kjo e bën ndërmjetësuesin të anshëm, e jo neutral. Ndonëse lejohet që ndërmjetësi të mundohet t'i afrojë palët, sikurse që kishte bërë ndërmjetësi i njohur mes myslimanëve dhe kurejshitëve, Halis ibn Zijadi, i cili ishte munduar t'i afronte palët rreth një marrëveshje, por duke qenë ai neutral, e jo i anshëm.<sup>20</sup>

Sidoqoftë, edhe Republika e Kosovës u shpall duke u bazuar në këtë plan, si dhe të gjitha ecuritë e mëtutjeshme ndodhën sipas këtij plani të projektuar dhe të subkordinuar nga Ahtisari.

Mirëpo, për ironi të madhe, ky plan nuk solli fundin e negociatave, sikurse që nuk solli edhe pavarësinë e shumëpritur dhe integritetin

e shumëpërfolur të Kosovës, ngase u krijuan enklavat serbe në pjesë të ndryshme që sfiduan dhe vazhdojnë ta sfidojnë shtetin e ri të Kosovës. E tëra kjo erdhi, si pasojë e privilegjeve të mëdha që morën serbët me këtë plan.

Tash së fundi janë zhvilluar disa runde negociatash në Bruksel, ku nën presionin e Bashkimit Evropian, Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për menaxhimin e përbashkët të kufijve. Kjo marrëveshje ishte komentuar ndryshe nga pala serbe dhe krejtësisht ndryshe nga pala kosovare. Serbia e kishte komentuar marrëveshjen si “vendkalime” që nuk nënkupton assesi dy shtete të ndara, dhe e cila është në përputhje me Kushtetutën e Serbisë, ndërsa Edita Tahiri kishte potencuar se marrëveshja është në pajtim të plotë me ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e ajo ka të bëjë me menaxhimin e kufijve. Ndërsa BE në një komunikatë nuk përmendi fjalën “kufi”, por vetëm “vendkalime”

Luajtja me terme është mjaft e rrezikshme dhe komentimi i secilës palë ndryshe nga pala tjetër, nënkupton se diçka po fshihet nga këto marrëveshje, por ekziston frika e reklamimit të së vërtetës.

Pas kësaj u arritën edhe marrëveshje të reja, si kjo e fundit që ka të bëjë me përfaqësimin rajonal të Kosovës me fusnotë. Në këtë kuptim Kosova\* është i vetmi emërtim që do të shfrytëzohet në kuadër të bashkëpunimit rajonal.

Fusnota që do të zbatohet krahas yllthit do të jetë: „Ky emërtim nuk ndikon në qëndrimin për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të KB-së dhe me mendimin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës”

Kosova\* merr pjesë e pavarur dhe flet në emër të vet në të gjitha tubimet rajonale. Kur të arrihen marrëveshje të reja ose nënshkrime, përfaqësuesi i Kosova\* do të nënshkruhet nën emërtimet e përshkruara në nenet 2. dhe 3.

<sup>19</sup> Ndonëse numri i tyre në krahasim me ato islame është i vogël, e shumica e tyre janë ndërtuar në kohët e fundit për qëllime politike, e assesi fetare.

<sup>20</sup> Mahmud Ibrahim ed-dik, *el-Muahadat fish-Sheriatil islamijeh vel kanun ed-devlij el-am*, fq 272-273.

## KONKLUZION RRETH MARRËVESHJEVE

Marrëveshjet e fundit janë bërë mollë sherri mes palëve negociuese dhe spektrit politik në Kosovë e Serbi, ku secili spektër akuzon qeverinë përkatëse për këto marrëveshje. Pa u fokusuar në këto marrëveshje, duhet të themi se këto marrëveshje ishin një rast i veçantë në historinë e marrëveshjeve dhe traktateve, duke pasur parasysh mënyrën e dialogimit, presionin ndërkombëtar, jotransparencën, fshehjen e tyre nga publiku dhe masa e gjerë, komentimin e secilës palë ndryshe, si dhe ajo që është kruciale në çdo marrëveshje; aprovimi dhe ratifikimi i marrëveshjeve, mirëpo këtu mungon aprovimi dhe ratifikimi i këtyre marrëveshjeve në kuvend, ndonëse është kërkuar një gjë e tillë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh të gjitha këto elemente, mund të konstatohet se këso marrëveshjes, jo që nuk janë ndërkombëtare, por janë më tepër një lojë që shtetet tjera e orkestrojnë për të zvarritur proceset e mëdha në këtë vend. Vetë fakti që shumica e tyre nuk bëhen publike dhe komentohen tri lloje; ndryshe nga Brukseli, ndryshe nga Prishtina e krejtësisht ndryshe nga Beogradi, jep të kupton se mungon transparenca dhe sinjeriteti, ndërsa me të nënshkruar secila palë konfirmon ngadhënjimin e saj dhe superioritetin ndaj palës tjetër. Pra, këto marrëveshje përmbajnë dykuptimësi dhe këso marrëveshje ka pasur edhe në të kaluarën, e zakonisht këso marrëveshje me dykuptimësi janë përdorur nga shtetet e fuqishme për pajtimin e dy shteteve të vogla që mes tyre ka pasur konflikt, ku për të shuar urrejtjen dhe për të paraqitur secilën palë fituese, nene të shumta kanë përmbajtur elementin e dykuptimësisë, që rezulton të jetë mjaft i dëmshëm në destabilizimin edhe njëherë të atij vendi.

Këto marrëveshje nuk i plotësojnë kriteret që kërkohen në një marrëveshje, andaj janë marrëveshje ku bëhen eksperimente të ndryshme, ndoshta për herë të parë provojnë te ne, sikurse që ishte përfaqësimi i Kosovës në nisma rajonale, ku Kosova duhet të përfaqësohet me fusnotë (Kosova\*).

Tani do të paraqesim mënyrën se si arrihet deri te një marrëveshje, duke filluar nga procedurat paraprijëse të marrëveshjeve, gjegjësisht etapat e ndryshme që kalon procesi kontraktues, deri te nënshkrimi mes palëve kontraktuese. E në fund do ta paraqesim Marrëveshjen e Hudejbijes, si një shembull ideal, ndonëse është arritur para 14 shekujsh, por që mbetet një marrëveshje shumë e rëndësishme.

## PROCEDURAT PARAPRIJËSE TË MARRËVESHJEVE

Kur themi procedurat paraprijëse të marrëveshjeve, kemi për qëllim ato gjera apo procedura që i paraprijnë ratifikimit të marrëveshjes, apo fazat dhe etapat e ndryshme që kalon procesi kontraktues e që rezulton në fund me ratifikim dhe nënshkrim të atij akti mes palëve kontraktuese.

Këto që njihen në të drejtën Islame si '*Procedurat paraprijëse të traktatit-Mukaddimat el-Muahadat*', nuk kanë ndonjë ndryshim me të drejtën ndërkombëtare, përpos në disa formalitete të caktuara, të cilat nuk bien ndesh fare me Islamin.

Andaj, në vijim kur do të cekem etapat nëpër të cilat kalon marrëveshja nuk do të bëjmë dallim mes të drejtës islame dhe të drejtës ndërkombëtare laike, ngase nuk ka ndonjë kontradiktë që vlen të përmendet, përpos në disa formalitete që ndryshuan në kohet moderne me ndryshimin e rrethanave.

Etapat nëpër të cilat kalon një traktat apo marrëveshje janë këto:

1. Negociatat dhe bisedimet
2. Aprovimi dhe ratifikimi
3. Nënshkrimi dhe autentifikimi i akteve ratifikuese

### 1- Negociatat dhe bisedimet

Negociatat konsiderohen faza e parë dhe më e rëndësishmja mes shteteve për të identifikuar çështjet që do të diskutohen dhe bisedohen për lidhjen e ndonjë traktati, gjithnjë duke diskutuar rreth dispozitave për të cilat pritet një dakord i rënë mes palëve, gjegjësisht shteteve.

Dhe kjo fazë e lidhjes dypalëshe për marrëveshje-traktate private plotësohet nëpërmjet përfaqësuesve shtetërorë në mënyrë të veçantë, ndërsa për traktatet publike mund të bëhen edhe nëpërmjet konferencave të thirrura nga shtetet të cilat pjesëmarrjen e tyre e shfrytëzojnë për diskutim të ndonjë traktati a marrëveshje, dhe nga ai diskutim i tyre në baze të një projekti, vjen deri te përgatitja e një komisioni të veçantë, që shtetet e interesuara pajtohen rreth përbërjes dhe formulimit të traktatit.<sup>21</sup>

Pra, hapi i parë që merr shteti pasi të ketë vendosur të zhvillojë bisedime me një apo më shumë shtete për lidhjen e ndonjë marrëveshjeje (traktati) ndërkombëtar është emërimi i personit (i negociatorit) për bisedime. Personi i tillë duhet të jetë i autorizuar qoftë në bazë të funksionit që ushtron ose t'i jepen autorizime të nevojshme nga të cilat shihet qartë statusi i tij si përfaqësues zyrtar për të biseduar dhe përfunduar një marrëveshje ndërkombëtare.<sup>22</sup>

Nëse i kthehemi historisë Islame, gjejmë se myslimanët nuk kanë bërë ndonjë marrëveshje me të tjerët e që të mos i ketë shoqëruar procesi negociator para lidhjes së marrëveshjes, e pa dyshim që marrëveshja e paqes së Hudejbijes - mes Profetit në njërën anë dhe Kurejshëve mekkas në anën tjetër - është shembulli më i mirë se si ishte kryer procesi negociator para marrëveshjes së arritur.

Negociatat në paktin e Hudejbijes ishin së pari përmes ndërmjetësuesve, ku ndërmjetësues i parë ishte caktuar Budejl ibn Vereka, ishte udhëheqës i delegacionit nga Huzaah, e që qëllimi i tij ishte ndërmjetësimi për zbutjen e tensioneve ndërmjet myslimanëve dhe kurejshitëve. Fjalimin e tij si ndërmjetës e filloi me këto fjalë: *“Unë e lash Ka’b ibn Luejje, pranë të cilit janë tubuar el-ehabish”<sup>23</sup> kundër teje, një turmë e mbledhur dhe gjigante, ata do të luftojnë ty dhe do të pengojnë*

<sup>21</sup> Alij Sadik Ebu Hejfi, *El-Kanun ed-Devlij el-Am*, bot. i XII-te, En-Nashir el-Mearif, Aleksandri-Egjipt, 1975m, fq. 529.

<sup>22</sup> Zejnullah Gruda, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*, fq. 258.

<sup>23</sup> El-Ehabish (njëjës: Uhbush) janë disa fise që lidhën aleancë me kurejshitët (fisat Benu Mustalik, Benu Hevn ibn Huzejme ibn Mudrike, Benu Harith ibn Abd Menat ibn Kenane). Thuhet se vendi ku ata lidhën aleancë ishte kodra e cila quhej el-Habesh, po ka mendime që është quajtur për faktin se ata të gjithë u tubuan në aleancë.

*nga shtëpia (Qabeja).*”<sup>24</sup> Ndërsa, përgjigja e Profetit që kjo me plot maturi dhe sinqeritet: *“Ne s’kemi ardhur për ta luftuar askënd, por kemi ardhur për të kryer Umren...e nëse dëshirojnë lidhim paqe dhe le të na lënë të lirë.”* Budejli u kthye dhe iu tregoi atyre tërë atë që kishte propozuar Profeti, mirëpo kurejshët nuk pranuan këtë ndërmjetësim.<sup>25</sup>

Pas kësaj, radha i erdhi ndërmjetësit të dyte Urvetu ibn Mes’ud Thekafiu<sup>26</sup>, i cili i këshilloi kurejshët që të mbanin një qëndrim të drejtë, e më pas edhe të tretit Mikriz ibn Hafs, e ky i fundit ishte i njohur për dinakëri, tradhti, mashtrim dhe dredhi. Kurejshët e dërguan këtë për shkak të dinakërisë dhe dredhisë së tij që t’i mbrojë ata në negociatat me të Dërguarin e Allahut. Posa e pa i Dërguari i Allahut, tha: *“Ky është një njeri mashtrues.”*<sup>27</sup>

Negociatat vazhduan me ndërmjetësuesin e katërt, ai ishte Hulejs ibn Zebban, të cilin Profeti [paqja e Zotit qoftë mbi të] e njihte si një person që i jep rëndësi të posaçme vendit të shenjtë, dhe se kur ky ndërmjetësues pa kurbanin për fljijim pranë të Dërguarit të Allahut dhe kur kuptoi se qëllimi i tij ishte ta bënte Umren dhe të sillej rreth Qabes, e ndryshoi mendimin e tij, të cilin ia kishin turbulluar kurejshët, e me pas tha: *“Madhëria i qoftë Zotit, nuk duhet që këta persona të pengojnë nga shtëpia e shenjtë”*, heshti pak e pastaj tha: *“U shkatërruan kurejshët pasha Zotin e Qabes, këta njerëz kanë ardhur për Umre.”* Ndërsa Profeti [paqja e Zotit qoftë mbi të] ia ktheu: *“Ashtu është o vëlla i bijve të Kenanit.”*<sup>28</sup>

<sup>24</sup> Ibni Kajim el-Xhevziye, *Zadul Mead fi Hedji Hajril Ibad*, bot. i XXVI-të, Muessesetur-Risaletu, Bejrut-Liban, 1412h-1992m, vol. III, fq. 288-289.

<sup>25</sup> Ibn Xherir Et-Taberi, *Te’rihu-t-Taberij*, bot. i II-të, Dar el-Kutub el-Ilmijetu, Bejrut-Liban, 1408h/1988m, vol.II, fq. 118.

<sup>26</sup> Vinte nga fisi i njohur Thekif, ishte nga udhëheqësit e tyre më të rëndësishëm, luajti rol të rëndësishëm në paktin e Hudejbijes, pranoi Islamin në vitin e nëntë hixhriq dhe u bë një mysliman i devotshëm, mirëpo kur shkoi të thërras popullin e tij në Islam, ata e mbytën, dhe kur lajmi i mbytjes së tij shkoi te Profeti, ky i fundit deklaroi: *“Shembulli i i Urvetu ibn Mes’ud-it është sikurse shembulli i atij që përmendet në Jasin, ftoi popullin e tij në thirrje për Allah, por ata e mbytën atë.”*

<sup>27</sup> Ibn Xherir Et-Taberi, *Te’rihu-t-Taberij*, vol.II, fq. 120.

<sup>28</sup> Ali ibn Burhan Dihani el-Halebij, *Siretul Halebijetu*, vol.II, fq. 137.

Ai u kthye te kurejshët, i bindur në veten e tij se sjelljet e kurejshëve janë të pa drejta dhe të pajustificuara në raport me myslimanët, kur shkoi tek ata, u tha atyre: *“Unë kam parë diçka që nuk lejohet kundërshtimi e as pengimi i tij, kam parë kurbanat para tyre, të kushtuar e të lidhur në vendet e tyre, e njerëzit u ishin përllyer rrobat dhe trupit (nga gjurmët e udhëtimit). Pasha Zotin nuk kemi bërë aleancë për këtë që ju t’i pengoni nga shtëpia e Zotit ata që kanë ardhur për nderim ndaj vendit të shenjtë të tyre (qabes), dhe për ta kryer një të drejtë të tyre.”*<sup>29</sup>

Zemërimi i kaploi kurejshët posa dëgjuan fjalët e tij që ishin një argument i fuqishëm në anën e Profetit [paqja e Zotit qoftë mbi të], andaj edhe i thanë kështu: *“Ulu, se me të vërtetë je një beduin, nuk ke fare dituri.”*<sup>30</sup>

Pas kësaj, negociatat nga ana e myslimanëve ndryshuan mënyrën, koncepti i tyre ndryshoi nga ndërmjetësuesit te të dërguarit drejtpërdrejt. I Dërguari i Allahut dërgoi Othman ibn Affanin pasi Omer ibn Hattabi kërkoi ndjesë për arsye të caktuara. Othmani hyri në Mekke te kurejshët dhe ua paraqiti atyre mendimin e Profetit<sup>31</sup> [paqja e Zotit qoftë mbi të], mirëpo kurejshët ngulën këmbë në qëndrimin e tyre. Dhe derisa ai ndodhej në mesin e kurejshëve, dikush përhap lajmin se atë e kanë mbytur, dhe kjo i zemëroi pa masë myslimanët, andaj në mbështetje të tij, ata u tubuan te një pemë dhe dhanë betimin e tyre të njohur, e cila u njoh si Bej’atu Rridvan-Besëlidhja e Pajtimit (kënaqësisë).<sup>32</sup>

<sup>29</sup> Muhamed Ahmed Bashmil, *Sulhul Hudejbijeh*, bot. i III-të, dar el-Fikr, Bejrut-Liban, 1393h-1972, fq. 202.

<sup>30</sup> Muhamed el-Vakidi, *el-Megazi*, Kalkuta-Indi, 1855m, vell.II, fq. 600; Ibn Xherir Et-Taberi, *Te’rihu-t-Taberij*, vol.II, fq. 119.

<sup>31</sup> I Dërguari i Allahut para se ta dërgonte Othmanin, i tha atij: *“Tregoju atyre se ne nuk kemi ardhur për lufte, por kemi ardhur për ta kryer Umren, dhe thirrri ata në Islam...”* Shih për me tepër: Ibni Kajim el-Xhevziye, *Zadul Mead fi Hedji Hajril Ibad*, vol. III, fq. 290.

<sup>32</sup> Në lidhje me këtë besëlidhje i Plotfuqishmi zbriti këto fjalë: *“Vërtet, Allahu qe i kënaqur me besimtarët kur ata nën hijen e atij druri të zotoheshin ty dhe Ai e dinte se ç’kishin zemrat e tyre, andaj u dhuroi qetësimin dhe së shpejti i shpërbleu me një fitore (çlirimin e Hajberit).”* Kur’ani, El-Fet’h: 18.

I Dërguari i Allahut ftoi myslimanet që t’i jepnin besën për të luftuar kundër armiqve, aty dhanë besën se do të luftonin gjer në vdekje, u shtrënguan duart dhe Profeti tha: **“Kjo besëlidhje është për Othmanin.”** Mirëpo, sa mbaroi besëlidhja, erdhi Othmani dhe u demantua lajmi.

Më në fund, kurejshët lidhen paqe me myslimanët, duke e dërguar Suhejl ibn Amr-in negociator për bisedime dhe për lidhjen e paqes me të Dërguarin e Allahut.

Si përfundim të kësaj mund të themi se marrëveshjet nuk mund të marrin formën përfundimtare vetëm përmes negociatave.<sup>33</sup> Ato mund të zhvillohen drejtpërdrejt ose me shkrim. Bisedimet për çështje më të rëndësishme më së shpeshti zhvillohen me anë të shkresave, e cila gjë e eviton mundësinë e çfarëdo keqkuptimi.

Përfaqësuesit e shteteve para fillimit të bisedimeve marrin instruksione preliminare. Mirëpo, edhe më vonë, sa here është e domosdoshme, ata mund të kërkojnë instruksione të reja. Kjo bëhet sidomos para se ta nënshkruajnë tekstin final (definitiv) të marrëveshjes.<sup>34</sup>

## 2- Aprovimi dhe ratifikimi

Aprovimi dhe ratifikimi konsiderohen faza e dytë nëpër të cilën kalon akti i marrëveshjes (traktatit), dhe me këtë fazë vihet në konsideratë pëlqimi i shtetit, aprovimi i tij ndaj marrëveshjes në këto raste:

- Në qoftë se kushtet e marrëveshjes së aprovuar janë një mjet i shprehjes së pëlqimit.
- Nëse kjo është dëshmuar në një mënyrë që shtetet negociuese kishin rënë dakord me kërkesat e ratifikimit.
- Në qoftë se përfaqësuesi i emëruar i shtetit ka nënshkruar marrëveshjen me kusht aprovues.

<sup>33</sup> Mahmud Ibrahim ed-dik, *el-Muahadat fish-Sheriatil islamijeh vel kanun ed-devlij el-am*, fq. 133.

<sup>34</sup> Zejnullah Gruda, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*, fq. 258.



- Nëse shteti i caktuar ka si synim që të jetë nënshkrimi me kushtet aprovues i mëvonshëm nga dokumenti i plotë autorizues për përfaqësuesit e tyre, apo këtë e shpreh edhe gjatë negociatave.<sup>35</sup>

Akti i ratifikimit ndaj marrëveshjes të nënshkruar kompletohet nga përfaqësuesit e shtetit të caktuar sipas sistemeve të ndryshme kushtetuese të vendeve të ndryshme, p.sh., në Mbretërinë e Bashkuar,<sup>36</sup> ratifikimi i marrëveshjes-traktatit bëhet nga ekzekutivi, ndërsa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kjo arrihet nëpërmes presidentit të shtetit, ai ka rolin e ratifikimit të traktatit, mirëpo me pëlqimin dhe këshillat e senatit. E, në Francë, ratifikimin e traktatit e ekzekuton ekzekutivi, përpos traktateve të rëndësishme, të cilat duhen ekspozuar Asamblesë Kombëtare.

Në të drejtën Islame, ratifikimi i marrëveshjeve-traktateve duhet të miratohet nga imami në pushtet (halifja<sup>37</sup>), e ai është sunduesi më i lartë i shtetit, nëse kjo ishte kryer nga negociatorët, pas rënies dakord dhe nënshkrimit të saj ajo hyn në fuqi menjëherë. Edhe pse Islami i jep të drejtë absolute imamit (halifes) në ratifikimin e traktatit, kërkohet prej tij që të konsultohet me njerëz të aftë e ekspertë që i përkasin atyre fushave, e padyshim se institucioni i konsultimit në Islam është një sistem udhëzues, një obligim i detyrueshëm fetar, që nuk lejohet dalja, injorimi apo tejkalimi i tij. Allahu në lidhje me këtë thotë: **“...e konsultohu me ta në të gjitha çështjet...”**<sup>38</sup>

E kjo nënkupton se në çështjet e rëndësishme, sidomos në ato çështje që mungon teksti bazik nga ligji islam, atëherë konsultimi është çështje primare që nuk duhet anashkaluar, sidomos në çështjet që ndërlidhen me shtetin e që kanë pësuar ndryshime drastike që nga e kaluara e gjer në ditët e sotme të kohës moderne.

<sup>35</sup> Mahmud Ibrahim ed-dik, *el-Muahadat fish-Sheriatil islamijeh vel kanun ed-devlij el-am*, fq. 137.

<sup>36</sup> Përveç nëse traktati përfshinë një ndryshim në ligjin e vendit dhe ka nevojë për një miratim në Parlament.

<sup>37</sup> Prijësi suprem i komunitetit mysliman.

<sup>38</sup> Kur'ani, Ali Imran, 159.

Nëse kushtetutat (normat) e themeluara nga njerëzit e kanë kushtëzuar dhe kredituar kompetencën e guvernatorit në lidhje me çështje të caktuara, autoriteti i halifes (prijësit suprem të myslimanëve) dhe princave tjerë është i përcaktuar saktësisht në jurisprudencën islame, që nëse ndokush nga pushteti publik shkel ligjin islam, abuzon me pushtet, apo devijon nga interesi publik i komunitetit mysliman, qofte në lidhje me traktatet apo diçka tjetër, ai do të jetë i vetmi përgjegjës për veprimet e tij para Allahut nga njëra anë, dhe para ligjit dhe opinionit publik në anën tjetër.<sup>39</sup>

Kur jemi tek aprovimi dhe ratifikimi, duhet kujtuar edhe procedurat rrënjësore që kanë ndryshuar në komunitetin islam, përderisa në të kaluarën ekzistonte halifja<sup>40</sup> dhe ai ishte kompetent për ratifikim, ndërsa në periudhën e sotme, ku shtetet islame udhëhiqen në mënyrë krejtësisht tjetër, mund të themi se ratifikimin e traktateve e bën Ministria e Jashtme, gjegjësisht ministri i Jashtëm, por mund ta bëjë edhe ndonjë ministri përkatës apo ndonjë përfaqësues diplomatik, varësisht se me çfarë lidhet traktati, dhe në rast se traktatet janë dypalëshe. E nëse kemi të bëjmë me lidhjen e traktateve shumëpalëshe, bisedimet dhe përgatitjet bëhen në ndonjë konferencë ndërkombëtare, apo ndonjë kongres.<sup>41</sup>

<sup>39</sup> Fuad Muhamed En-Nadi, *Mebde' el-Meshru'ijetu ve Davabit Hudu' ed-Devleti lil Kanun fil Fikhl Islami*, fq. 324.

<sup>40</sup> Në botën islame miratimin, ratifikimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes e ka bërë Halifja që përfaqësonte mbarë myslimanët në periudhën mbas vdekjes së Profetit si dhe në disa periudha të mëvonshme, e në disa tjera përfaqësonte pjesën më të madhe të myslimanëve. Gjithashtu kjo formë ka qenë e përhapur edhe tek besimet tjera kjo gjë arrihej nëpërmjet udhëheqësit të tyre, p.sh. në Prusi këtë e bënte mbreti i tyre, në Rusi cari, në Austri perandori, e në vendet papnore, e bënte papa.

<sup>41</sup> Si p.sh. Liga Arabe, Liga Islame, apo edhe jashtë kontekstit islam, në konferencat ndërkombëtare që mbahen në Amerikë, Evropë dhe në vende tjera.

### 3- Nënshkrimi dhe autentifikimi i akteve ratifikuese

Nënshkrimi dhe autentifikimi i akteve ratifikuese konsiderohet faza e tretë nëpër të cilën kalon akti i traktatit.

Në të kaluarën traktatet janë bërë në mënyrë krejtësisht të fshehtë, nuk kishte ndonjë regjistrim të traktateve në ndonjë organ shtetëror, kjo nuk ishte kusht, deri në formimin e kombeve<sup>42</sup>, mirëpo nëse i referohemi historisë islame, gjejmë se nënshkrimi dhe autentifikimi i akteve ratifikuese kanë qenë pjesë përbërëse të traktateve apo besëlidhjeve. I Dërguari i Allahut nuk kishte lidhur pakt, traktat, besëlidhje apo marrëveshje, qoftë me armiq të tij, apo me ndonjë shtet fqinj me shtetin islam të Medinës, e të mos jetë ajo e nënshkruar, e dëshmuar nga Allahu, i Dërguari i Tij, dhe nga ata që ishin prezentë nga myslimanët, dhe kjo praktikon fjalën e Allahut, i Cili thotë: *“...Dhe mos përtori për ta shkruar atë dhe afatin e tij, i vogël qoftë ose i madh...”*<sup>43</sup> E nëse kjo urdhëresë është në veçanti për borxhin, atëherë për traktatin do të jetë edhe më e madhe dhe më sublime, ngase traktati është borxh që duhet realizuar, në mënyrë që çështjet dhe gjërat kontraktuese të mos jenë në ballafaqim me mohim, manipulim, lojë dhe fshehje e së vërtetës, e nënshkrimi dhe autentifikimi i akteve ratifikuese është menyra më e mirë dhe më e qartë për të mbizotëruar ruajtja dhe kujdesi ndaj traktateve nga të dyja palët.<sup>44</sup>

Pas nënshkrimit të traktatit, nga një kopje dergohet te secila palë kontraktuese e atij traktati, duke qenë si një dëshmi e gjallë e asaj marrëveshjeje nënshkrimi dhe dëshmitarët, e që i japin një vlerë sublime për të respektuar dhe zbatuar në përpikëri urdhrat dhe obligimet që dalin nga ai traktat i nënshkruar.

Negociatat përfundojnë rregullisht me redigjimin e tekstit përfundimtar të traktatit. Një tekst i tillë mund të nënshkruhet, të inko-

rporohet, apo edhe të refuzohet. Por, në momentin që nënshkruhet, marrëveshja apo traktati hyn në fuqi, dhe se palët kontraktuese obligohen në përmbajtjen dhe realizimin e traktatit.

Nënshkrimi është rregullisht akt shumë formal. Nënshkrimin e vënë më së shpeshti personat që kanë zhvilluar bisedime, punë që është fare e logjishme, sepse nënshkrimi është përfundimi formal i bisedimeve. Rendi i nënshkrimeve varet nga numri i palëve kontraktuese dhe gjuha e marrëveshjeve. Traktatin dypalësh, që lidhet në dy gjuhë të palëve i pari e nënshkruan secili përfaqësues tekstin në gjuhën e tij. Traktatet që lidhen vetëm në një gjuhë, ose traktatet shumëpalëshe nënshkruhen sipas rendit të alfabetit, ose sipas rendit kronologjik (marrëveshjet që nënshkruhen më vonë veç e veç nga shtetet). Në praktikë ka pasur raste që marrëveshjen ta nënshkruajnë më parë shtetet e mëdha e pastaj shtete të tjera.<sup>45</sup>

### PAQJA E HUDEJBIJES<sup>46</sup>

Marrja e paqes së Hudejbijes si shembull e model ka të bëjë më shumë me formën dhe procesin e zhvilluar që rezultoi në marrëveshje, ndaj do të fokusohemi në procesin që i parapriu kësaj marrëveshjeje, përmbajtja e marrëveshjes, skenat që u krijuan nga kjo marrëveshje dhe disa elemente tjera që kanë të bëjnë me këtë marrëveshje tejet të rëndësishme.

Procesit të Hudejbijes i kishte paraprirë vendosmeria e myslimanëve së bashku me të Dërguarin e Allahut që ta bëjnë Umren në Mekke. Kurejshët e Mekkes bllokuan iniciativën e myslimanëve që të hyjnë në Mekë, andaj në Hudejbije u ndalën dhe aty u zhvilluan negociatat e njohura të cilat rezultuan me paqen e arritur në të, e që u quajt me emrin Paqja e Hudejbijes.

<sup>42</sup> Kurse tani nuk ka ndonjë marrëveshje apo traktat të vlefshëm, vetëm nëse bëhet nënshkrimi dhe autentifikimi i traktatit nga palët kontraktuese.

<sup>43</sup> Kur'ani, El-Bekare, 282.

<sup>44</sup> Mahmud Ibrahim ed-dik, *el-Muahadat fish-Sheriatil islamijeh vel kanun ed-devlij el-am*, fq. 140.

<sup>45</sup> Zejnullah Gruda, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*, fq. 261.

<sup>46</sup> Kjo paqe ndërmjet myslimanëve dhe kurejshëve u arrit në muajin Shevval apo Dhul Ka'de të vitit të 6 hixhrij, apo Mars të vitit 628 miladij.

Kur u arrit marrëveshja në Hudejbije pas një raundi të gjatë të negociatave, u pranuan edhe kushtet e një armëpushimi të gjatë prej dhjetë vjetësh, dhe kjo marrëveshje përbëhej prej dhjetë nenesh:

1. Në emrin tënd o Allah.
2. Kjo është paqja e arritur mes Muhamedit të birit të Allahut dhe Suhejl ibn Amrit.
3. Kemi arritur paqe për ndërprerjen e luftës (armiqësisë) në afat prej dhjetë vjetësh. Gjatë kësaj periudhe sa zgjat armëpushimi, njerëzit do të jenë të lirë (të qarkullojnë lirshëm) dhe t'i shmangen njëritjetrit.
4. Ai i cili pranon Islamin nga kurejshët dhe ikën të Muhamedi, pa lejen paraprake të kryeparit të tij, duhet kthyer prapa në Mekke, ndërsa kush vjen nga myslimanët të kurejshët, gjegjësisht ikën nga i Dërguari i Allahut, ai nuk duhet kthyer prapa.
5. Nuk do ta cenojmë njëritjetrit në pasurinë dhe gjakun e tij, si dhe nuk do të ketë vjedhje e as mashtrime mes nesh.
6. Muhamedi së bashku me besimtarët, duhen të kthehen në Medinë pa hyrë fare në Mekke këtë vit.
7. Ata mund ta vizitojnë Qaben në vitin e ardhshëm dhe atë në afat prej tre ditësh. Ata nuk duhet të jenë të armatosur me armë të tjera, përveç shpatave në këllëf.
8. I Dërguari i Allahut të mos e pengojë askënd nga shokët e tij nëse ndokush eventualisht dëshiron të qëndrojë në Mekke.
9. Kushdo (prej fiseve) që dëshiron të hyjë në Pakt me Muhamedin apo t'i bashkohet atij, mund ta bëjë këtë me kusht që të respektojë këtë kontratë, gjithashtu kjo vlen edhe për ato fise që dëshirojnë të lidhin pakt me kurejshët dhe t'iu bashkohen atyre<sup>47</sup>. Çdo fis i tillë do të konsiderohet si pjesë e atij populli. Çdo armiqësi kundër aleatëve, do të konsiderohet si armiqësi ndaj palës që i takon.<sup>48</sup>

<sup>47</sup> Fisi i njohur Huzaah u bë aleat i Muhamedit dhe myslimanëve. Fisi Benu Beker u bë aleat i kurejshëve.

<sup>48</sup> Shih: Sahihul Buhari, libri i kushteve dhe libri i betejave; Sahihul Muslim, libri i xhihadit; Musnedi i imam Ahmedit, vol.IV, fq. 325; Siretu Ibni Hisham, vol.II, fq. 316 e tjetër; Zadul Mead, vol.I, fq. 382; Nektari i vulosur i xhenetit, fq. 391-392.

10. Për këtë paqe të arritur dëshmuan disa burra nga myslimanët dhe disa nga kurejshët.<sup>49</sup>

## VËSHTRIM RRETH MARRËVESHJES SË HUDEJBIJES

Këto kushte ishin të rënda për besimtarët, sidomos e dyta dhe e katërta, dhe kjo kishte shkaktuar pikëllim të madh dhe pakënaqësi të myslimanët, dhe ata në njëfarë forme u habitën nga i Dërguari i Allahut që pranoi kërkesat e kurejshëve, siç ata dëshiruan, andaj vëprimi i të Dërguarit të Allahut kishte ngjallur dyshim dhe pasiguri të besimtarët.

Mirëpo, duke i studiuar paragrafët e kontratës, qoftë për të kërkuar domethënien e tyre të thellë ose vetëm atë sipërfaqësor, pa kurrfarë dyshimi, arrijmë të konkludimi i rëndësishëm, se armëpushimi dhe kontrata në Hudejbije është fitorja e parë verbale e myslimanëve, për ç'gjë gjer atëherë kurejshët as që donin të dëgjonin, e lëre më t'i pranonin ata (myslimanët) për çfarëdo qoftë. Përkundrazi, ata dëshironin t'i shfarosnin myslimanët gjer në atë të fundit, dhe pritnin me padurim çastin e shkatërrimit të tyre. Ata mundoheshin me të gjitha forcat të futnin përçarje midis fesë islame dhe popullit, duke pasur parasysh se ishin të vetëdijshëm që Islami prej ditës më ditë merrte frerët e udhëheqjes shpirtërore dhe atë profane në mbarë Gadishullin Arabik.<sup>50</sup>

Me pranimin e kësaj marrëveshje, del në pah një fuqi e re, fuqia e myslimanëve, dhe se kurejshët tanimë ndodheshin para një sfide të re; nuk ishin në gjendje të përballeshin e të luftonin me myslimanët. Ajo që është me rëndësi të ceket këtu, është se paragrafi i nëntë i kontratës së Hudejbijes tregon se kurejshët kishin harruar udhëheqjen e

<sup>49</sup> Nga myslimanët dëshmuan: Ebu Bekr Es-Siddiku, Omer ibnul Hattabi, Abdurrahman ibn Avfi, Abdullah ibn Suhejl ibn Amr, Sa'd ibn ebi Vekkas dhe Mahmud ibn Musel-le-meh, ndërsa nga kurejshet dëshmuan: Mikrez ibn Hafs dhe Suhejl ibn Amr. Shih: Suhejli, *Rrevdul Enf*, vol.IV, fq. 53.

<sup>50</sup> Safijjurarrahman El-Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i Xhenetit*, fq. 395.

vet fetare dhe profane në Arabi, dhe se tani atyre asgjë e askush nuk u interesonte, sepse duhej të kujdeseshin për vetveten<sup>51</sup>

Kjo marrëveshje u arrit në kohën kur myslimanët ishin të fuqishëm –deri diku- e jo të dobët, kishin mundësi të mos pranonin kushtet e kurejshitëve, ngase edhe në numër nuk ishin të vogël, e që i Dërguari i Allahut në Hudejbije ishte njëri prej njëmijë e pesëqind personave<sup>52</sup>.<sup>53</sup> Mirëpo, i Dërguari i Allahut pranoi ato kushte me një butësi dhe me- nçuri të madhe, derisa ia arriti qëllimit që edhe Islami thërret në të, e që është mbrojtja e gjakut, mbizotërimi i paqes, shpresa që populli do të vetëdijësohet duke pranuar të vërtetën dhe dëgjuar fjalën e Zotit.<sup>54</sup>

Nuk duhet harruar faktin se suksesin që e arritën myslimanët nga kjo marrëveshje gjatë kohës së paqes, pas marrëveshjes, ai sukses kurrë nuk do të mund të arrihej me luftë, madje edhe atëherë kur fitorja ishte e qartë.

Për shkak të zemërgjerësisë së Islamit, myslimanët kanë arritur suksese të mëdha në fushën e përhapjes së fesë. Dhe, përderisa numri i myslimanëve para marrëveshjes së Hudejbijes ishte gjithsej 3.000, ushtria myslimane tani vetëm për dy vjet pas armëpushimit përbëhej prej 10.000 luftëtarësh (me rastin e çlirimit të Mekkes).<sup>55</sup>

Neni i katërt i Marrëveshjes së Hudejbijes ishte në disfavor të myslimanëve dhe në favor të plotë të kurejshitëve vështroar nga aspekti teorik, kurse po të vështrojmë nga aspekti praktik atëherë gati edhe na del e kundërta, ngase është e njohur që myslimani kurrë nuk do ta braktisë rrugën e Allahut dhe të Pejgamberit të Tij, e as që do të ikë prej mesit islamik, por vetëm nëse e lëshon fenë (renegon) haptazi apo

<sup>51</sup> Op. cit.: 395. Në këtë burim ceket paragrafi (neni) i tretë, kurse në radhitjen tonë është paragrafi i nëntë.

<sup>52</sup> Në disa transmetime tjera thuhet se numri i pjesëmarrësve ka qenë 1400, gjithashtu në disa vende thuhet se kanë qenë 1300. Në disa burime të njohura historike ku unë jam bazuar, përmendet shifra prej 1500.

<sup>53</sup> Shih: Ibni Kajjim el-Xhevziu, *Zadul Mead fi hedji Hajril ibad*, (me recenzure te Shuajb Arnautit dhe Abdul Kader Arnautit, vol.III, fq. 259; Abdullah ibn Shejh Muhamed ibn Abdul Vehhab, *Muhtesar Siretu-rr-Rresul*, bot.i I-rë, Vizaretu Shuun el-Islamijetu vel Evkaf...Arabia Saudite, 1418h, fq. 297.

<sup>54</sup> Ed-dik, *el-Muahadat fish-Sheriatil islamijeh vel kanun ed-devlij el-am*, fq. 269.

<sup>55</sup> Safijjurr Rahman El-Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i Xhennetit*, fq. 395-396.

fshehurazi, e nëse e lëshon fenë, atëherë myslimanët as që kanë nevojë për një të tillë. Largimi i tij nga shoqëria Islame do të ishte shumë më i vlefshëm sesa mbetja e tij.

Përkitazi me këtë ka menduar Resulullahu kur ka thënë: **“Ai që largohet prej nesh, atë Allahu e ka larguar.”**<sup>56</sup>

Nëse dikush prej banorëve të Mekes pranon Islamin, edhe pse i ndalohet shpërngulja në Medine, nuk i ndalohet shpërngulja në vende të tjera, ndërsa toka e Allahut është e gjerë. A mos, vallë, Abisinia nuk qe e gjerë për myslimanët, përderisa banorët e Medines as që kishin dëgjuar diç për Islamin? Resulullahu mu për këtë solucion ka menduar kur ka thënë: **“Kush prej tyre vjen te ne, Allahu për të do të bëjë lehtësim dhe zgjidhje.”**<sup>57</sup>

Mbrojtja e sovranitetit në këtë mënyrë, edhe pse paraqet një aspekt të fuqisë dhe të famës kurejshite, në realitet kjo rezulton nga shqetësimi i madh i tyre, nga pasiguria dhe nga frika e madhe për ekzistencën e tyre politeiste. Ata sikur e dinin se sot, më tepër se çdoherë tjetër, janë buzë greminës, pasi që nuk kanë zgjidhje tjetër, përveçse të pranojnë një mbrojtje të këtillë të sovranitetit.<sup>58</sup>

Megjithëse kjo marrëveshje nuk u mirëprit nga disa myslimanë, në anën tjetër Allahu proklamoi çlirimin e Mekes mu në kohën kur u arrit marrëveshja teksa i Dërguari i Allahut kthehej rrugës për në Medine, shpallja nga zonat më të larta qiellore solli fjalët përgëzuese për çlirimin e Mekes: **“Ne ty të dhamë (vendosëm për) një fitore të sigurt. Ash-tu që All-llahu (pas fitores) të liroi ty prej mëkateve (që t'i mbathën) të mëparshme dhe prej atyre të mëvonshme (kur njerëzit do ta pranojnë fenë islame dhe nuk do të jenë më mëkatarë) dhe ashtu të plotëson mirësinë e Vet ndaj teje e të orienton ty në rrugën e drejtë. Dhe që Allahu të ndihmon ty me një ndihmë të fortë.”**<sup>59</sup>

<sup>56</sup> Transmetohet në koleksionin e Muslimit, kaptina: *Armëpushimi në Hudejbije*, vol.II, fq. 105.

<sup>57</sup> Transmetohet në koleksionin e Muslimit, kaptina: *Armëpushimi në Hudejbije*, vol.II, fq. 105.

<sup>58</sup> Safijjurr Rahman El-Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i Xhennetit*, fq. 396-397.

<sup>59</sup> Kur'ani, El-Fet'h: 1-3.

Po ta studiojmë në detaje këtë marrëveshje të arritur, do të vijmë në konkludim, se:

E para: Parahyrja (parathënia) e traktatit islam fillonte me emrin e Zotit, përderisa në të drejtën ndërkombëtare ajo fillon sipas pajtimit të arritur të të dyja palëve. Dhe ajo që është për të shqyrtuar këtu, është fakti se traktatet në Islam mbështeten në Allahun, fillojnë me emrin e Tij, e që Ai është Vëzhguesi dhe Llogaritësi i tërë asaj që ndodhet në zemrat e njerëzve, dhe kjo u jep shenjtëri traktateve, duke mos lejuar manipulimin apo tradhtinë ndaj tyre, me që është filluar me emrin e Zotit.

E dyta: Pas parahyrjes të bëhet referimi (përmendja) e emrave të atyre që kanë lidhur traktatin, kjo është e njëjtë edhe në të drejtën ndërkombëtare.<sup>60</sup>

E treta: Referimi i motivit të traktatit, të ceket arsyeja e një traktati, ashtu siç edhe në fillim të traktatit të Hudejbijes u cek armëpushimi për arsyen e ndalimit të luftës mes tyre për dhjetë vjet, që të jenë njerëzit të lirë dhe të mos e pengojnë njëri-tjetrin. Gjithashtu kjo është e njëjtë edhe në të drejtën ndërkombëtare.

E katërta: Hyrja në boshtin e traktatit duke përmendur edhe kushtet. Edhe në traktatin e Hudejbijes i Dërguari i Allahut përmendi kushtet për të cilat ata kishin arritur pajtim, e që edhe në të drejtën ndërkombëtare është identike.

E pesta: Në traktatin e armëpushimit lejohet që imami (kryetari i shtetit islam) të kërkojë ai i pari për armëpushim me armiqtë nëse për këtë shih interes dhe dobi për myslimanët, e të mos pret që kërkesa të jetë përherë prej tyre.<sup>61</sup>

E gjashta: Marrëveshjen e Hudejbijes Allahu e quajti ‘çlirim’, edhe pse për myslimanët, sipërfaqësisht ajo dukej si ofendim dhe padrejtësi e madhe ndaj tyre, mirëpo i Dërguari i Allahut e kishte shikuar këtë marrëveshje me një largpamësi të madhe, duke parë nga ajo mirësi të mëdha, përderisa ai pajtohej me të gjitha kushtet që shtrënonin

kurejshitët. Nganjëherë ajo që duket e urrejtur në shikim të parë mund të jetë shumë e mirë dhe e dobishme, dhe këtë e vërteton edhe fjala hyjnore: “...**Por mund që ju ta urreni një send, e ai është shumë i dobishëm për ju...**”<sup>62</sup>

E shtata: Traktati mund të jetë i hapur për ata që dëshirojnë të inkuadrohen dhe të futen në të, madje për këtë nënvizon edhe e drejta ndërkombëtare, teksa lejohet që palët apo shtetet tjera të inkuadrohen në atë traktat. E, përderisa traktati i Hudejbijes që i hapur, fisi Huzaah hyri në aleancë me myslimanët, për dallim nga fisi Benu Bekër që u bë aleat i kurejshitëve.

E teta: Traktati duhet të nënshkruhet nga palët kontraktuese dhe të dëshmohej. Traktati i të Dërguarit të Allahut dhe dëshmia e tij është në rolin e aprovimit dhe ratifikimit që njihet në bazë të drejtës ndërkombëtare.<sup>63</sup>

E nënta: Lejohet ndërhyrja e një ndërmjetësuesi neutral, apo ndërhyrja e një pale për t’i afruar mendimet, ashtu siç bëri ndërmjetësuesi Hulejs ibn Zaban-i, teksa kurejshitët kërkuar prej tij që të jetë ndërmjetësues mes tyre e myslimanëve. Hulejsi ishte i mençur dhe largpamës, ishte i nderuar, dhe Profeti e njihte si një person që i jep rëndësi të posaçme vendit të shenjtë.

Edhe në të drejtën ndërkombëtare mund të lidhet një traktat me ndërmjetësimin e një personi të palës tjetër që nuk ka lidhje me shtetet në konflikt, apo me ndërmjetësimin e ndonjë shtetit neutral, i cili nuk është i kyçur në konflikt.<sup>64</sup>

E dhjeta: Traktatet në të drejtën Islame hyjnë në fuqi posa të arrihet pajtimi rreth kushteve, edhe në qoftë se nuk janë ratifikuar, ashtu siç ndodhi me Ebu Xhendel ibn Suhejl ibn Amr, të cilin i Dërguari i Allahut e riktheu mbrapa në bazë të marrëveshjes së arritur, e që neni i katërt i asaj marrëveshje e kthente atë mbrapa.

E njëmbëdhjeta: Traktatet duhet të shkruhen në dy kopje, dhe secila kopje i dorëzohet secilës palë. Kështu kishte ndodhur edhe në

<sup>62</sup> Kur’ani, El-Bekare: 216.

<sup>63</sup> Ed-dik, *el-Muahadat fish-Sheriatil islamijeh vel kanun ed-devlij el-am*, fq. 272.

<sup>64</sup> Muhamed Ahmed Bashmil, *Sulhul Hudejbijeh*, fq. 199-200.

<sup>60</sup> Ed-dik, *el-Muahadat fish-Sheriatil islamijeh vel kanun ed-devlij el-am*, fq. 271.

<sup>61</sup> Ibni Kajjim el-Xheviu, *Zadul Mead fi hedji Hajril ibad*, fq. 304.

Paqen e Hudejbijes, teksa u arrit marrëveshja, ajo u shkrua dhe iu dorëzua nga një kopje secilës palë.

E dymbëdhjeta: Konsultimi, e sidomos në çështjet e rëndësishme siç janë traktatet. Edhe i Dërguari i Allahut ishte konsultuar me Ummu Selemen në Paqen e Hudejbijes, dhe kjo e vërtetoi lejimin e konsultimit me një grua që është e mençur dhe largpamëse, edhe pse i Dërguari i Allahut ishte në pozicionin e profetisë, megjithatë ishte konsultuar.<sup>65</sup> Në Kur'an thuhet: **“...e konsultohu me ta në të gjitha çështjet...”**<sup>66</sup>

Kjo marrëveshje edhe pse është bërë para 14 shekujve, ajo është bazë për gjitha traktatet në Islam, madje edhe për ato ndërkombëtare, kur kihet parasysh kohën kur është bërë dhe në rrethanat që mbretëronin, por që sfidon edhe traktatet moderne, andaj ky traktat meriton një respekt të veçantë.<sup>67</sup>

## PËRFUNDIM

Ndonëse në këtë punim është folur për shumë marrëveshje, qasja e këtij punimi ka të bëjë më tepër me një elaborim sipërfaqësor sesa përmbajtësor. Dhe kjo vjen si pasojë e natyrës së punimit. Sigurisht se ia vlen më tepër të merremi me këtë çështje dhe ta trajtojmë atë sipas trajtimit të duhur e adekuat, por jam i bindur se edhe një trajtim sado i shkurtër si ky do të jetë i dobishëm dhe do të jetë një dritare e re për ata që dëshirojnë të merren e të shkruajnë për këtë problematikë, që na ka kushtuar rëndë gjatë këtyre dy shekujve, por që pasojat e këtyre marrëveshjeve do të jenë afatgjata dhe ato do të vërehen në secilën kohë kur do të na paraqiten probleme të ndryshme, sikurse po na paraqiten tani.

### Literatura e konsultuar:

- Alij Sadik Ebu Hejfi, *El-Kanun ed-Devlij el-Am*, bot. i XII-te, En-Nashir el-Mearif, Aleksandri-Egjipt.
- Zejnullah Gruda, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*.
- Ibni Kajim el-Xhevziye, *Zadul Mead fi Hedji Hajril Ibad*, bot. i XXVI-të, Muesseseturr-Rrisaletu, Bejrut-Liban, 1412h-1992m.
- Ibn Xherir Et-Taberi, *Te'rihu-t-Taberij*, bot. i II-të, Dar el-Kutub el-Ilmijetu, Bejrut-Liban, 1408h/1988m.
- Muhamed Ahmed Bashmil, *Sulhul Hudejbijeh*, bot. i III-të, dar el-Fikr, Bejrut-Liban, 1393h-1972.
- <sup>1</sup> Muhamed el-Vakidi, *el-Megazi*, Kalkuta-Indi, 1855m, vell.II, fq. 600; Ibn Xherir Et-Taberi, *Te'rihu-t-Taberij*.
- Ibni Kajjim el-Xhevziu, *Zadul Mead fi hedji Hajril ibad*, (me recenzurë të Shuajb Arnautit dhe Abdul Kader Arnautit
- Abdullah ibn Shejh Muhamed ibn Abdul Vehhab, *Muhtesar Siretu-rr-Rresul*, bot.i I-rë, Vizaretu Shuun el-Islamijetu vel Evkaf... Arabia Saudite.
- Hadixhe Ebuetele, *El-Islamu vel-ilakatud-devlijeh fis-silmi vel-harbi: dirasetun mukarennetun*, Dar el-Mearif, pa vit botimi, Kajro-Egjipt.
- Dhafir El-Kasimij, *El-Xhihadu vel-hukuk ed-devlijeh el-ameh fil-islam*, bot. i I-rë, Dar el-Ilm lil Melajine, 1982, Bejrut-Liban.
- Subhi Mahmesani, *El-Kanun vel ilakat ed-Devlijeh fil Islam*, bot. i II-te, dar el-ilm lil Melajine, Bejrut-Liban, 1982.
- Al-Tabari, *The History of al-Tabari*, trans. Y.Friedmann, Albany: SUNY Press, 1985.
- Mahmud Ibrahim ed-dik, *el-Muahadat fish-Sheriatil islamijeh vel kanun ed-devlij el-am*, bot. i II-të, el-Mektebetul Vetanijetu.
- Ejup Haziri, *Traktatet në të Drejtën Islame*. Boton Bashkësia Islame e Kosovës. 2010, Prishtinë.
- *Historia e Popullit Shqiptar*, Prishtinë, 1996
- Jusuf Bajraktari & Arber Salihu, *Historia e përgjithshme*.

### Burime tjera:

- Pakoja e Ahtisarit
- Dituria Islame
- Bota Sot

<sup>65</sup> Ed-dik, *el-Muahadat fish-Sheriatil islamijeh vel kanun ed-devlij el-am*, fq. 273.

<sup>66</sup> Kur'ani, Ali Imran: 159.

<sup>67</sup> Shih për këtë marrëveshje dhe marrëveshjet tjera librin tonë: Ejup Haziri, *Traktatet në të Drejtën Islame*. Boton Bashkësia Islame e Kosovës. 2010, Prishtinë.

Mr. Ejup Haziri

**KOSOVA AND  
THE PEACE TREATY OF HUDAIBIYA  
(Comparative study between secular and Islamic treaties)**

(Summary)

**Introduction**

Human beings are the most sophisticated creatures in the universe and are extremely inclined to conflict. Only death will stop them from being greedy. Greed makes humans become hostile to each other. Greed leads to conflict and conflicts lead to war. Thus, war has become something like a phenomenon. This is why we have wars throughout the world, without exception.

Wars date back to antiquity, since the conflict between Adam's sons, when one of them wanted to prevail over the other. Ever since, murder has become something familiar and intertwined with mankind.

أيوب حازيري

**اتفاقيات كوسوفو و صلح الحديبية  
(دراسة مقارنة بين الاتفاقيات العلمانية والإسلامية)  
(خلاصة البحث)**

مدخل

الانسان هو المخلوق الأكثر مثالية في هذا الكون، هناك نزعة مستمرة لخلق الصراع وأطماعه يشبعه التراب فقط . والجشع يؤدي به إلى العداء تجاه الآخرين، عن طريق خلق جشع يمضي الى صراع مفتوح، و من صراع مفتوح يأتي الى الحرب ، حتى أصبحت الحرب تقليدا في البيئة البشرية التي تتكرر في كل زمان ومكان. ولذلك، تحدث الحروب بين الناس في مختلف أنحاء العالم، دون استثناء. و الحروب قديمة منذ وجود الانسان الاول على الارض و بالتحديد من بني آدم، عندما اراد احدهما أن يسيطر على الآخر و منذ ذلك الحين اصبح القتل في هذه الدنيا شيئا معروفا و ذات صلة بالانسان .

## JURISPRUDENCË

*Arta Tahiri*

### E DREJTA E VETËVENDOSJES NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE, KOSOVA NË KORPUSIN E KËSAJ TË DREJTE

Në korpusin e së Drejtës Ndërkombëtare vetëvendosja është mbase nga ato parime që ka hapur më shumë debate lidhur me atë se **kujt** i takon e drejta e vetëvendosjes dhe **si** dhe **kur** mund të realizohet ajo.<sup>1</sup>

Në ditët e sotme, e drejta për vetëvendosje është një pjesë e pandarë dhe e padiskutueshme e së drejtës ndërkombëtare, e përfshirë gjithashtu në Kartën e OKB-së, në marrëveshjet ndërkombëtare të Gjenevës (16 dhjetor 1966), dhe në Deklaratën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së mbi Principet e së Drejtës Ndërkombëtare lidhur me Marrëdhëniet Miqësore dhe Bashkëpunimin (24 tetor, 1970).

Por më 22 janar 1917, pas Luftës së Parë Botërore, presidenti amerikan Wilson ishte ai i cili për herë të parë e futi në të Drejtën Ndërkombëtare të drejtën për vetëvendosje të popujve. Në një fjalim drejtuar Kongresit, ai deklaroi se nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme, në qoftë se nuk njihet kjo e drejtë. Në një mesazh dërguar Rusisë, më 9 qershor 1917, në të cilin bënte të ditur qëllimet e SHBA-së në

luftë, ai deklaroi se Shtetet e Bashkuara të Amerikës shkojnë në luftë “për liri, vetëqeverisje dhe zhvillim të lirë për të gjithë popujt në përgjithësi dhe çdo popuj në veçanti nuk duhet detyruar ose lënë me forcë nën një sovranitet që nuk dëshirojnë të jetojnë.”<sup>2</sup>

Në Deklaratën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, mbi principet e së Drejtës Ndërkombëtare lidhur me marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin, e drejta për vetëvendosje përfshinte “krijimin e një shteti sovran dhe të pavarur, asocim të lirë të çdo shteti të pavarur ose shpallje e ndonjë statusi tjetër politik me vullnet të lirë nga populli”. Këtu, shprehja “popull” nuk ishte më e kufizuar në kontekstin e kolonizimit të jashtëm.<sup>3</sup>

Prapa shembjes së regjimeve koloniale gjatë shekujve nëntëmbëdhjetë dhe njëzet, e drejta për vetëvendosjes ka qenë një forcë kryesore, e cila ka luajtur një rol të rëndësishëm në arenën ndërkombëtare.

Parimi i vetëvendosjes nënkupton që populli, i cili vështrohet si komb, duhet të ketë të drejtën për të formuar edhe një shtet dhe për të ushtruar sovranitetin e tij mbi problemet e veta. Vetëvendosja është një parim i pranuar gjerësisht në problemet ndërkombëtare të kohës së sotme.<sup>4</sup>

Vetëvendosja ka qenë dhe vazhdon të jetë synimi kryesor i shumë grupeve etnike, gjuhësore, fetare ose indigjene, të cilët marrin pjesë në konflikte ose kërkojnë këtë të drejtë në mënyrë më të moderuar dhe paqësore. E drejta për vetëvendosje radhitet si një ndër nocionet më të debatueshme në sferën e praktikës dhe teorisë politike. Zakonisht e drejta e vetëvendosjes është njohur si e drejta për çkonolizime të territoreve që nuk vetëqeverisen, si e drejta e grupeve të veçanta etnike për të vetëvendosur vetë statusin tyre politik, dhe si e drejta e popullsisë së një shteti për të zgjedhur qeverinë që dëshiron. Me një fjalë kjo nënkupton se e drejta e vetëvendosjes është një e drejtë që i përket

<sup>2</sup> Lee C. Buchheit, Shkëputja: Legjitimiteti i vetëvendosjes (1978) fq.63.

<sup>3</sup> United Nations General Assembly Resolution 2625 (XXV, 24 tetor, 1970).

<sup>4</sup> Joshua S. Golstein, Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Dituria, 2003 Tiranë, fq 45.

<sup>1</sup> Ana Lalaj, Kosova rruga e gjatë drejt vetëvendosjes, Mësonjëtorja e parë, 2000 Tiranë.



një popullsie, etnie, grupi që të vendosin në mënyrë të përbashkët pozicionin e tyre politik në mënyrë demokratike.

Nga kjo mund të shihet se parimi i vetëvendosjes shprehet në dy forma: e brendshme (opozitë kundër një diktature dhe pjesëmarrje e drejtë në qeverisje) dhe e jashtme (pavarësi ose shkëputje).<sup>5</sup> Duke u mbështetur në këto dy parime të vetëvendosjes do të shtjellohet dhe çështja e Kosovës si në rastin e parë në një vetëvendosje të brendshme kjo që përfaqëson periudhën nga 1918 me krijimin e MSKS, pastaj në 1944 me krijim e Federatës Jugosllave, që në të dy rastet pozicioni i Kosovës në qeverisje ishte jashtë këtyre kornizave dhe më pas në vitet 1990, me shpërbërjen e Jugosllavisë, ku të gjitha shtetet pjesëmarrëse të kësaj ish-Federate patën të drejtën e vetëvendosjes, me përjashtim të Kosovës dhe Vojvodinës.

Kështu që nga fillimi i shekullit njëzet, popullsisë etnike shqiptare të Kosovës i është mohuar çdo mundësi për të marrë pjesë konstruktivisht në qeverisje dhe i janë cenuar shumë të drejta ekonomike, sociale e kulturore brenda Jugosllavisë. Këta faktorë ndikuan shumë në vlerësimin dhe diskutimet mbi kërkesat për vetëvendosje të shqiptarëve të Kosovës.

Që nga fillimi i ekzistencës së Jugosllavisë së Titos e deri në vitet '90, shqiptarët nuk hoqën dorë nga kërkesa për të pasur republikën e tyre brenda Jugosllavisë, dhe populli i Kosovës të njihet si komb shtetëformues. Por, këto kërkesa nuk u morën parasysh bile ndodhi e kundërta e kësaj, Kosovës gjatë regjimit jugosllav iu dha vetëm një e drejtë autonomie si rajon si krahinë, siç ju dha Vojvodinës, gjithashtu Kosova kurrë nuk u konsiderua në këtë periudhë si komb por si kombësi, që do të thotë se vetëm kombet kishin të drejtën e shtetformimit, ndërsa kombësitë jo sepse ato ishin pjesë e një kombi, e në rastin konkret Kosova komb kishte Shqipërinë.

Por, situata u përkeqësua për të drejtën e vetëvendosjes së shqiptarëve të Kosovës. Në vitin 1992, Komuniteti Evropian, duke dashur

të evitojë ndërlikimet e mëtejshme, problemet dhe rreziqet që kërcënonin Ballkanin parapëlqeu të bënte një kërkesë formale për njohjen vetëm të gjashtë republikave federative të Jugosllavisë, duke mos përfshirë këtu dy provincat autonome (Kosova dhe Vojvodina).<sup>6</sup>

Duke injoruar zbatimin e kriterëve të tyre të njohjes ndaj një prej rajoneve më me probleme dhe më të shtypura të Jugosllavisë, pra, ndaj provincës së Kosovës (administratisht e ndodhur në Republikën e Serbisë), Komuniteti Evropian dhe Shtetet e Bashkuara nuk mundën të evitonin konfliktet e mëtejshme. Kjo tregon dhe faktin që konflikti dhe dhuna e ndezur në Kosovë në vitet 1998, ishte si pasojë e këtij gabimi, apo vendimi të quajmë, vendim i cili solli probleme si në aspektin rajonal gjithashtu kriza dhe problem edhe në aspekt ndërkombëtar.

Kështu që duke u mbështetur edhe në faktet e lartpërmendura qëllimi i këtij punimi është shqyrtimi nëse shqiptarët e Kosovës përbëjnë një grup të autorizuar, nga e drejta ndërkombëtare me vetëvendosje të rangut më të lartë, duke marrë këtu parasysh edhe të drejtat e grupeve të tjera brenda dhe rreth Kosovës.

Programi i politikës së jashtme të Serbisë për pushtimin dhe kolonizimin e viseve shqiptare u përpunua në “Naçertanie” (1844) të Ilia Garashaninit - politikan dhe më vonë kryeministër i Qeverisë së Mbretërisë së Serbisë. Përmbajtja e “Naçertanies” mbështetet në krijimin e të ashtuquajturës Serbi Jugore, me të cilën nënkuptohej Kosova e Maqedonia me tokat shqiptare të saj, por edhe Shqipëria Veriore, për të krijuar kështu të ashtuquajturën “Perandori të Car Dushanit”. “Naçertania” rrezatoi në shtetin serb, në organet dhe në institucionet e tij, sikurse edhe në aktivitetet e pushtetarëve të tij prej vitit të përpilimit të saj e deri në ditët tona. Në objektivat e “Naçertanies” kanë gjetur mbështetje sidomos politika e gjenocidit të pushtetit serb ndaj shqiptarëve. Format kryesore të politikës gjenocidale të pushtetit serb ishin dhe ngelën dëbimi i shqiptarëve nga trojet e veta dhe kolonizimi i këtyre trojeve me popullsi sllave.<sup>7</sup>

<sup>5</sup> Sami Repeshiti, Vetëvendosja dhe Statusi i tanishëm i Kosovës, në çështja e Kosovës: një problem historik dhe i tanishëm.

<sup>6</sup> M.Çelmeta, E drejta për vetëvendosje e shqiptarëve të Kosovës, Flesh, 2001.

<sup>7</sup> Jusuf Osmani, Kolonizimi serb i Kosovës, Prishtinë, 2000

Pas luftës së Dytë Botërore shqiptarëve të Kosovës u ishte premtuar se do të kishin të drejtën e vetëvendosjes, por siç shihet ajo as nuk u përmend dhe nuk u mor parasysh asnjë premtim.

Deri atëherë udhëheqësit e Partisë Komuniste të Jugosllavisë, nuk patën ngurrar të premtonin se pas çlirimit ata do të zbatonin me korrektësi parimin e të drejtës së vetëvendosjes deri në shkëputje, si për shqiptarët ashtu edhe për gjithë popujt tjerë në Jugosllavi. Por i njëjti lidërsip, pas luftës, parimin e të drejtës së vetëvendosjes deri në shkëputje e quajti “një parim abstrakt<sup>8</sup>, i cili s’mund të zbatohet në Kosovë, pasi do të zemëroheshin nacionalistët serbë dhe kështu do të humbnim shumë te populli serb”.

Me Kushtetutën e RFSJ të vitit 1974, Kosovës iu dha një autonomi në fushë të gjerë, por prapë, duke ngelur në varësi të Serbisë. Këtë herë, Kosova konsiderohej se kishte një autonomi të rangut më të lartë se Vojvodina (edhe kjo një provincë autonome), sepse ishte dhënë e drejta të merrte pjesë në qeverinë federale të qarkullueshme,<sup>9</sup> dhe me përfaqësues të zgjedhur në Parlamentin Federal.

Fakti është që Kosova, nëpërmjet Kushtetutës jugosllave të 1974, siguroi të gjithë autoritetin dhe prerogativat e nevojshme të një shteti: një Kushtetutë që garantonte një parlament, një qeveri, një organ drejtësie dhe administratë të pavarur. Sovraniteti i provincës buron nga “populli punonjës i Provincës” (dhe jo e dhënë nga Republika Serbe), dhe një entitet juridik, i cili kishte të drejtën të ushtronte “të drejtat e tij sovranë konform sistemit politik dhe socio-ekonomik të Jugosllavisë”.<sup>10</sup> Evolucion i autonomisë së Kosovës dëshmonte për një proces gradual për të arritur një status federal në ish-Jugosllavi.<sup>11</sup>

Me Kushtetutën e vitit ’74, Kosova ishte bërë një entitet legjitim i nivelit federativ, me potencialin që ushtronte shumicën apo dhe tërë kompetencat e një republike. Tash e tutje, ambicia politike e shqipta-

rëve të Kosovës do të përqendrohej te hapi i mëtejshëm, i natyrshëm Kosova Republikë.<sup>12</sup>

Të gjitha këto të drejta që iu dhanë shqiptarëve të Kosovës, nuk zgjatën dhe shumë, kështu me vdekjen e Titos, situata u përmbys dhe mund të themi se u kthye në gjendej e viteve ’50-’60 ku për shqiptarët e Kosovës ishte një nga periudhat më të errëta.

Nga të gjitha faktet dhe elementet e paraqitura në mënyrë të përmbledhur në këtë punim, shihet mjaft qartë rruga e gjatë, e vështirë dhe çështja shumë unike e shqiptarëve të Kosovës, për të drejtën e vetëvendosjes.

Kosova në Jugosllavi u aneksua kundër vullnetit të kosovarëve dhe duke u ndeshur me rezistencën e tyre, në vitet 1913, në 1918 dhe në 1923. Ky aneksim forcërisht u inkurajua nga Fuqitë e Mëdha, në mënyrë që këto të fundit të mund të zgjidhnin mosmarrëveshjet që kishin me njëra-tjetrën.

Pra, nga kjo shihet qartë se shqiptarët e Kosovës u sakrifikuan që në fillim në emër të ruajtjes së paqes në Evropë. Kështu, ky aneksim shkeli të drejtën e shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje dhe në të njëjtën kohë shkeli të drejtën ndërkombëtare.

Kur një shtet është i paafte ose i pavullnetshëm për të mbrojtur dhe respektuar të drejtat themelore të një populli, atëherë sovraniteti dhe integriteti i këtij shteti nuk mund të mbrohet nga e drejta ndërkombëtare.

<sup>8</sup> J.B.Tito, Çështja nacionale në Jugosllavi në dritën e luftës Nacionalçlirimtare, Proleter, 1942.

<sup>9</sup> Libal Kohl, Kosova: Nyja Gordiane e Ballkanit, 1992, fq 70-75.

<sup>10</sup> Kushtetuta e Provincës Socialiste Autonome të Kosovës 1974. Neni 1.

<sup>11</sup> Catharine Samary, Konfederatë ose shpërthim, 1999.

<sup>12</sup> Noel Malcolm, Një Histori e Shkurtër e Kosovës, Koha, Prishtinë, fq, 338.

Arta Tahiri

## THE RIGHT TO SELF-DETERMINATION IN INTERNATIONAL LAW KOSOVA IN THE CORPUS OF INTERNATIONAL LAW

### (Summary)

Within the corpus of International Law, the right to self-determination is probably among the principles, which have provoked most debate, concerning the fact who has the right to self-determination and when and how it can be applied.

Nowadays, the right to self-determination is an integral part of International Law, contained in the UN Charter, the Geneva Conventions, (16 December 1966), and the UN General Assembly Declaration of Principles of International Law concerning Friendly Relations and Cooperation Among States (24 October 1970).

آرتا طاهري

الحق في تقرير المصير في القانون الدولي، كوسوفو في صميم هذا

الحق

(خلاصة البحث)

في مجموعة القانون الدولي هو أن حق تقرير المصير من تلك المبادئ التي هي أكثر مناقشة و الانفتاحا فيما يتعلق بمن يحق له حق تقرير المصير، وكيف ومتى يمكن تحقيق ذلك. و في هذه الأيام، الحق في تقرير المصير هو جزء لا يتجزأ من القانون الدولي و لا يقبل الجدل، وأيضا في ميثاق الأمم المتحدة والمعاهدات الدولية في جنيف (١٦ ديسمبر ١٩٦٦)، والإعلان الصادر عن الجمعية العامة

للأمم المتحدة المتعلق بمبادئ القانون الدولي المتعلقة بالعلاقات الودية والتعاون  
(٢٤ أكتوبر، ١٩٧٠).

## Interesimi i Ebu Hanifes për hadithin dhe shkencat e hadithit

Ebu Hanife qysh në rini është interesuar për Kur'anin dhe Hadithin, sikurse edhe shumica e fëmijëve myslimanë të kohës së tij, por shkak i moshës së tij të re, transmetimet e tij të hadithit nuk janë pranuar.<sup>3</sup> Ai mësoi hadithin në Kufë, e më vonë në Basra. Por, mësimet i vazhdoi edhe në Medinë dhe Mekë.<sup>4</sup> Bashkëkohësit dhe nxënësit e tij e theksojnë interesimin e tij për hadith por dhe udhëtimet e tij në kërkim të hadithit në vende e shkolla të ndryshme. Këtë rast e pohon një transmetim të cilin e shënon Ibn Abd'ul-Berri, në të cilin Ebu Hanife thotë:

*“Kur në vitin 93 h. me babanë shkova në haxhillëk, kam pasur 16 vjet. Me këtë rast e kam parë një plak rreth të cilit qenë tubuar njerëzit. E kam pyetur babanë: Kush është ai plak? Është përgjigjur: Ai është Abdullah b. El-Haris b. Xhez'i, një nga as'habët e Pejgamberit s.a.v.s.! E kam pyetur sërish: Ç'mund të merret prej tij? Më ka thënë: “Hadithet të cilat i ka dëgjuar prej Pejgamberit s.a.v.s.! E kam lutur që të afrohem në mënyrë që të dëgjoj diç prej tij. Kur iu afrova, e kam dëgjuar se si thekson se Pejgamberi i Zotit s.a.v.s. ka thënë: Kush e kupton fenë, Allahu do t'ia plotësojë nevojat e tij dhe do ta furnizojë atë nga nuk e llogarit ai!”<sup>5</sup>*

Dijetarët mendojnë se Ebu Hanife kishte përzgjedhur rreth 40 mijë hadithe, e të cilat i kishte marrë nga dijetarë të shquar të Kufës, Irakut dhe vendeve të tjera. Kur dëgjonte se ndonjë muhaddith ka ardhur në Kufë për t'ua mësuar hadithin njerëzve, ai e dërgonte ndonjërin nga

### QASJE

*Nexhat Ibrahim*

## KONTRIBUTI I EBU HANIFES NË SHKENCËN E HADITHIT

### Hyrje

Kontributi i Imam Ebu Hanifes<sup>1</sup> në shkencën e hadithit dhe njohja e tij është e pamundur të shtrohet në një shkrim të shkurtër. Për këtë arsye, synimi ynë është që të përpiqemi në mënyrë sa më përmbledhëse t'i shtrojmë të dhënat më kryesore dhe të ndihmojmë në shpjegimin dhe qartësimin e disa çasteve kyç. Po ashtu, ky shkrim ka për synim ta provojë të vërtetën para të painformuarve, por edhe para kundërshtarëve dhe të përgënjeshtrojë fanatikët për paragjykimet e tyre lidhur me qëndrimin e Ebu Hanifes rreth hadithit dhe përdorimit të tij në shqyrtimin e çështjeve islame në akaid, fikh etj. Duhet pranuar se kohëve të fundit janë bërë disa shkrime lidhur me këtë temë nga kënde të ndryshme, andaj përpjekja jonë do të jetë që të kemi sa më pak përsëritje.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Imam Ebu Hanife - Nu'man ibn Thabiti (80-150 h./699-767), njëri ndër dijetarët dhe personalitetet më të mëdha që i ka pasur bota muslimane dhe bota në përgjithësi.

<sup>2</sup> Krahason: Muhammad bin Al-Hasan Ash-Shaybani, The Muwatta of Imam Muhammad, London, 1425/2004, fq. 29 e tutje, sidomos fq. 32.

<sup>3</sup> Sidomos Shkolla e Kufës ishte rigorozë në pranimin e haditheve nga njerëzit e rinj në moshë. Sipas: Al-lameh Shibli Nu'mani, Imam Abu Hanifa - zivoti i djelo, Zagreb, 1996, fq. 20.

<sup>4</sup> Al-lameh Shibli Nu'mani, po aty, fq. 35.

<sup>5</sup> Ibn Abdu'l-Berr, *Xhami'u bejani'l-ilm ve fadlih*, 1/45, *Daru-l-kitabi ilmijji*, Bejrut, pa vit botimi, sipas:

[http://www.ipf.unze.ba/fileadmin/user\\_upload/TEKSTOVI/ZBORNIAK\\_6\\_2\\_.pdf](http://www.ipf.unze.ba/fileadmin/user_upload/TEKSTOVI/ZBORNIAK_6_2_.pdf).

nxënësit për të dëgjuar se ç'fliste mbi hadithin, që të shihte se mos vallë ai posedon hadithe që ky nuk i ka e t'i merrte prej tij.<sup>6</sup>

Edhe Muhammed ibn El-Hasani pohon një gjë të tillë thotë:

“E kam dëgjuar Ebu Jusufin duke thënë: “Me Ebu Hanifen i diskutonim gjërat që kishin të bëjnë me kapituj të ndryshëm të diturisë. Kur ai thoshte mendimin me të cilin ne pajtoheshim, unë dilja dhe i vizitoja dijetarët e Kufës që të gjeja ndonjë hadith apo thënie që do ta përforconte thënien e tij, ndoshta gjeja dy apo tre hadithe dhe vija tek ai, ndonjërin e pranonte e ndonjërin e refuzonte dhe thoshte: “Ky nuk është i vërtetë (sahih) apo nuk është i njohur (ma`ruf), edhe pse i përshtatej mendimit të tij. Kurse unë i thosha: “Prej nga e di këtë? Ai thoshte: “Unë jam i ditur falë diturisë së dijetarëve të Kufës.”<sup>7</sup>

Edhe Imam Abdu'l-Vehhab Esh-Sha'rani cek se Ebu Hanife i ka mësuar hadithet nëpërmjet mësuesit të tij Ata'it, kurse Ata'i ka qenë nxënës i Ibn Abbasit r.a.<sup>8</sup>

Sa është angazhuar Ebu Hanife në tubimin dhe studimin e hadithit, dëshmon shembulli i Amr ibn Dinarit, muhaddithi i njohur nga Meka, i cili kur Ebu Hanife merrte pjesë në ligjëratat e tij, vetëm atij i drejtohej.<sup>9</sup>

Edhe thëniet e Mekij ibn Ibrahimit dhe të Jezid ibn Harunit, flasin afirmativisht për kompetencën e Ebu Hanifes në hadith:

أحفظ أهل زمانه .

“(Ebu Hanife) ishte hafidhi më i madh i hadithit në kohën e tij.”<sup>10</sup>

<sup>6</sup> Sipas: Vehbi Sulejman Gavoçi, Imam Ebu Hanife, kryejuristi musliman, pjesa e katërt, dorëshkrim në Logos-A, Shkup, që pritët të botohet gjatë vitit 2012.

<sup>7</sup> Vehbi Sulejman Gavoçi, Imam Ebu Hanife, po aty.

<sup>8</sup> Esh-Sha'rani, *El-Mizanu'l-kubra*, Hajderabad, India, 1394 h., fq. 83 sipas: [http://www.ipf.unze.ba/fileadmin/user\\_upload/TEKSTOVI/ZBORNİK\\_6\\_2\\_.pdf](http://www.ipf.unze.ba/fileadmin/user_upload/TEKSTOVI/ZBORNİK_6_2_.pdf).

Krsh.: Al-lameh Shibli Nu'mani, po aty, fq. 36 etj.

<sup>9</sup> Ukud'ul-Juman, Kreu 10, sipas: Al-lameh Shibli Nu'mani, po aty, fq. 41.

<sup>10</sup> Ibnu Maxheh `Ilm Hadith, fq. 166, sipas: <http://alhaadi.org.za/articles/taqleed/1174-a-glimpse-of-imaam-abu-haneefahs-rahmatullahi-alayh-expertise-in-the-science-of-hadeeth.html>, në: <http://breziiri.com/2011/03/09/veshtrim-rreth-njohurive-te-imam-ebu-hanifes-ne-shkencen-e-hadithit>.

Edhe shembulli i Mis'ar b.Kidemit, hafidhit të besueshëm të hadithit nga Iraku, i cili, duke u kujtuar, thotë për Ebu Hanifen:

طلبت مع أبي حنيفة الحديث فغلينا ، وأخذنا في الزهد فبرع علينا ، وطلبنا معه الفقه فجاء منه ما ترون .

“Së bashku me Ebu Hanifen e kemi kërkuar (studiuar) hadithin dhe ai na tejkalonte! Kemi garuar në zuhd dhe ai na tejkalonte! Kemi zgjidhur çështje fikhere (shariatiko-juridike), kurse ai ka arritur atë që tashmë e dini!”<sup>11</sup>

Shpeshherë Ebu Hanife ulej në ligjëratat e Malikut, edhe pse ky ishte më i ri se Ebu Hanife. Një ditë derisa ishte ulur me Abdullah ibn Mubarekun, erdhi një njeri, të cilin Malik i tregoi respekt të jashtëzakonshëm dhe e uli afër vetes. Kur shkoi ky njeri, Imam Maliku e pyeti Abdullahun: “A e di kush është ai?” Ky ishte Ebu Hanife nga Iraku i cili, vetëm nëse dëshiron, mund të dëshmojë se kjo shtyllë është e bërë nga ari.”<sup>12</sup>

Me një rast tjetër Abdullah ibn Mubareku thotë:

أفقه الناس أبو حنيفة ، ما رأيت في الفقه مثله.

“Ebu Hanife është juristi më i madh. Unë nuk kam parë ndonjë si ai në fikh (jurisprudencë).”<sup>13</sup>

Rastet e tilla janë të shumta, që dëshmojnë namin dhe kompetencën e Imam Ebu Hanifes në shkencat islame.

<sup>11</sup> Edh-Dhehebi, *Menakibu Ebi Hanife, botim egjiptian*, pa vend dhe vit botimi, fq. 27, sipas: [http://www.ipf.unze.ba/fileadmin/user\\_upload/TEKSTOVI/ZBORNİK\\_6\\_2\\_.pdf](http://www.ipf.unze.ba/fileadmin/user_upload/TEKSTOVI/ZBORNİK_6_2_.pdf).

<sup>12</sup> Al-lameh Shibli Nu'mani, po aty, fq. 42.

<sup>13</sup> Tahdhibut-Tahdhib, vol. 10, fq. 450, sipas: <http://alhaadi.org.za/articles/taqleed/1174-a-glimpse-of-imaam-abu-haneefahs-rahmatullahi-alayh-expertise-in-the-science-of-hadeeth.html>, në: <http://breziiri.com/2011/03/09/veshtrim-rreth-njohurive-te-imam-ebu-hanifes-ne-shkencen-e-hadithit>.

## Raporti i Ebu Hanifes ndaj hadithit

Imam Ebu Hanife qëndrimet e tij besimore por edhe fikhore, pas Kur'anit, i ka bazuar në Sunnet, në burimin e dytë të Sheri'atit. Këtë e ka bërë duke u bazuar në ajetin kur'anor: *“E bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, ashtu që të mëshiroheni.”* (Ali Imran, 132). Përkundër kësaj fakti, qarqe të caktuara si në kohën e tij, ashtu edhe aktualisht, tri-llojnë, shpifin dhe zhvlerësojnë kontributin e Imam Ebu Hanifes në hadith dhe në përdorimin e hadithit në shkencat islame nga ana e Imami. Qysh gjatë jetës së tij, ai pati dëgjuar për, kinse, preferimin a analogjisë kundrejt hadithit<sup>14</sup> në çështjet fikhore, dhe pati reaguari prerazi:

*“Gënjejnë për Zotin! Shpifin të gjithë ata të cilët thonë se ne preferojmë analogjinë ndaj sunetit! Vallë, a ka nevojë të përdoret analogjia kur ekziston tekst i qartë i hadithit?”* Imami vazhdon të pohojë: *“Ne e kemi përdorur analogjinë vetëm në rast domosdoshmërie dhe këtë nëse nuk kemi mundur të gjejmë kurrfarë dëshmie në Kur'an, sunnet dhe në praktikën e as'habëve.”*<sup>15</sup>

Është e njohur edhe thënia e Imam Ebu Hanifes si përgjigje atyre që përpiqeshin ta denigrojnë atë:

*“Nëse hadithi është sahih, ai është medhhebi im.”*<sup>16</sup>

Këtë e forcon edhe rasti vijues: I qortuar nga halifi Xha'fer El-Mensuri se po i jep përparësi analogjisë kundrejt hadithit, Ebu Hanife përgjigjet:

*“O sundues i besimdrejtëve! Atë që e ke dëgjuar nuk është e vërtetë. Unë e marrë së pari Librin e Zotit, pastaj Sunnetin e Pejgamberit, pastaj vendimet e Ebu Bekrit, Umerit, Uthmanit dhe Aliut, dhe*

*vetëm më pastaj vendimet e as'habëve të tjerë. Por, nëse tek ata gjej qëndrime të ndryshme, unë i drejtohem gjykimit të lirë.”*<sup>17</sup>

Dijetarët konsiderojnë se arsyeja që Imam Ebu Hanifja nuk u preokupua me transmetimin e hadithit aq sa u preokupua me të kuptuarit e tij, fikhun e tij dhe mbledhjen e teksteve konsiston në konfirmimin e meseleve, unifikimin e dispozitave, njohjen e derogimit dhe të deroguarës, të përgjithshmes dhe të veçantës dhe të tërësishmes dhe të përcaktuarës.<sup>18</sup> Kështu patën vepruar edhe Ebu Bekri, Omeri, Uthmani e Aliu r.a. Ata qenë në përcjellje të Muhammedit a.s. por nuk shquhen në transmetim të hadithit.<sup>19</sup>

Disa thonë se arsyeja për këtë atak ndaj Ebu Hanifes ka qenë për shkak të kushteve, kriterëve rigoroze të Ebu Hanifes në pranimin dhe transmetimin e hadithit. Ka shumë kushte, por disa më kryesoret janë këto:

1. Hadithi refuzohet nëse e kundërshton shkronjën e Kur'anit apo kuptimin e përgjithshëm të një fjale të tij, duke u bazuar në fjalët e Muhammedit a.s.: *“Hadithi duhet domosdo të pajtohet me Kur'anin, e nëse e kundërshton Kur'anin, ai nuk është prej meje.”*<sup>20</sup>
2. Nëse një hadith është në kundërshtim me hadithin tjetër autoritativ (meshhur).<sup>21</sup>
3. Nëse transmetuesi i hadithit nuk është fakih (jurist).<sup>22</sup>
4. Nëse transmetuesi i hadithit sillet në kundërshtim me hadithin e transmetuar.
5. Nëse hadithi vjen në kundërshtim me hadithin, të cilin e konfirmon edhe analogjia etj.<sup>23</sup>

<sup>17</sup> Ash-Sha'rani, Kitab'ul-Mizan, vëll. 1, bot. III, Egjipt, 1925, fq. 92-93. Një version të ngjashëm e thekson edhe Muhammed Ebu Zehre, po aty, fq. 274.

<sup>18</sup> Vehbi Sulejman Gavoci, Imam Ebu Hanife, po aty.

<sup>19</sup> Po aty.

<sup>20</sup> Ahmed Emin, Duha'l-islam, II, botimi IX, Kajro, 1979, fq. 186.

<sup>21</sup> Ibrahim Dzananovic, Idztihad u prva cetiri stoljeca islama Sarajevë, 1986, fq. 65.

<sup>22</sup> El-Mekkij, I, fq. 163, sipas: Ahmed Emin, II, po aty, fq. 190.

<sup>23</sup> Sipas: Nexhat Ibrahim, Vepra 5, Shkup, 2009, fq. 462-264. Konsulto gjerësisht: Mustafa Es-Sibai, Es-Sunnetu we mekanetuhu fi't-teshri'i'l-islam, Bejrut, 1976, fq. 422-423.

<sup>14</sup> Shih një analizë të frytshme: Al-lameh Shibli Nu'mani, po aty, fq. 141-147. Muhamad bin Al-Hasan Ash-Shaybani, po aty, fq. 32 e tutje.

<sup>15</sup> Muhammed Ebu Zehre, Ebu Hanife – hajatuhu ve atharuhu ve arauhu ve fikhuhi, (Kajro, pa vit dhe vend botimi), fq. 273.

<sup>16</sup> إذا صح الحديث فهو مذهبي، وابن عابدين في الحاشية، ٦٣/١.

6. Ka edhe një çështje të cilën e fokuson Kastalani në komentin e Sahihut të Buhariut, i cili thotë se arsye me relevancë është edhe qëndrimi i Ebu Hanifes se “*imani as nuk shtohet as nuk pakësohet*” dhe se “*imani përbëhet nga besimi dhe shqiptimi, por jo edhe nga veprimi*”. Ky qëndrim i ka shtyrë shumë dijetarë që të kenë qëndrim negativ ndaj transmetimeve të Ebu Hanifes dhe Ebu Hanifes në përgjithësi.<sup>24</sup>

Duke marrë parasysh se muhadithët apo fakihët tjerë kishin vendosur rregulla më të lehta për pranim dhe transmetim të haditheve, në pajtim me këtë ata kanë shënuar dhe tubuar më shumë hadithe sesa Ebu Hanife. Por, ky fakt nuk është tregues se Ebu Hanife nuk e njeh shkencën e hadithit apo e njeh atë në mënyrë të kufizuar. Përkundrazi, tregon në njohjen solide të shkencës dhe në aftësinë për të diferencuar hadithet e vërteta nga të pavërtetat, apo ato që nuk plotësojnë kriteret për t’u përdorur.

Është me rëndësi të ceket edhe një gjë që e aktualizon Al-lameh Shibli Nu’mani. Ai thekson se koncepti *muxhtehid* dhe *muhaddith* janë dy kategori tërësisht të ndryshme. *Muhaddithi* me vëmendje i hulumton të gjitha llojet e tregimit – udhëzimit, rrëfimit, thëniet për virtetet dhe të dhënat biografike. *Muxhtehidi* nga ana tjetër kryesisht merret me ato transmetime nga të cilat mund të nxirret parimi i ligjit. Për këtë arsye, muxhtehidët shumë më rrallë citojnë transmetime hadithesh krahasuar me muhadithët. Kjo edhe është një arsye me rëndësi përse Ebu Hanife më pak njihet si muhaddith e më shumë si fakih<sup>25</sup> dhe përse disa manipulojnë me faktet ndërsa këtë e bëjnë për interesa të ngushta.

Ndër kontributet më të vlefshme të Ebu Hanifes në zhvillimin e shkencës për hadithin është vlerësimi i transmetimeve, në bazë të të cilave ka nxjerrë udhëzime juridike, kurse në pajtim me hadithin. Burimi parësor i udhëzimeve juridike është Kur’ani, kurse pas tij vjen hadithi. Ndërmjet tyre nuk ka dallim thelbësor, Kur’ani është *wahj*

*metlu’* (shpallje e shkruar) kurse hadithi është *wahj gajru metlu’* (shpallje e pashkruar), por ndërmjet tyre ekziston dallimi në aspekt të dëshmisë. Meqenëse transmetimet ndryshojnë në aspekt të shkallës së dëshmisë dhe ky fakt duhet të merret parasysh gjatë nxjerrjes së udhëzimeve juridike. Klasifikimi i transmetimeve sipas tradicionalistëve në sahih (autentik, i vërtetë), hasem (i mirë), da’if (i dobët), meshhur (mirë i njohur), aziz (i shtrirë i kufizuar), garbi (i rrallë) është i mangët, sepse nuk i vlerëson si burime të urdhëresave juridike. Ata vetëm transmetimet da’ifë i konsiderojnë të pabazuar, duke i lënë të gjithë të tjerët barabartë të pranueshëm. Vlerësimi i tillë për ta nuk ka qenë i domosdoshëm, sepse nxjerrja e urdhëresave dhe udhëzimeve juridike edhe nuk ka qenë detyrë e tyre. Ebu Hanife ndihej i thirrur ta ndërmarrë këtë punë pionerike në sistematizimin e fikhut. Në pajtim me këtë, transmetimet i ka ndarë në tre grupe:

1) **Mutewatir** – është hadithi transmetuesit e të cilit në çdo fazë të transmetimit kanë qenë të mjaftueshëm ashtu që nuk ekziston mundësia të pranohet gënjeshtër si e vërtetë.

2) **Meshhur** – është hadithi i transmetuesit në të gjitha fazat, përveç fazës së parë, janë po aq të shumtë sikur edhe në traditën mutevatir.

3) **Ahad** – është hadithi i cili nuk është as mutevatir as meshhur.

Derisa dispozita juridike e nxjerrë nga tradita mutevatir është e plotëfuqishme dhe e bazuar, dispozita juridike e nxjerrë nga meshhuri nuk është e plotëfuqishme por mundet në mënyrë suplementare t’i përkufizojë urdhëresat absolute të Kur’anit dhe kështu ta plotësojë. Tradita *ahad*, meqë autenticiteti i saj është vetëm parashtrim, në asnjë mënyrë nuk ndikon në udhëzimet e qarta të dhëna në Kur’an. Ebu Hanife, duke zgjedhur rrugën e mesme, duke dëshmuar objektivitetin e gjykimit të tij dhe mendjemprehtësinë e mendjes së tij, nuk e ka refuzuar në tërësi tregimin e një personi (siç bënë mu’tezilitët) por as duke i pranuar për përfundimtare (siç bënë tradicionalistët) duke i kuptuar

<sup>24</sup> Al-lameh Shibli Nu’mani, Imam Abu Hanifa – zivot i djelo, Zagreb, 1996, fq. 119.

<sup>25</sup> Al-lameh Shibli Nu’mani, po aty, fq. 42-43.

tekstualisht dhe sipërfaqësisht, duke ndjekur rrugën e disa as'habëve, të Omerit r.a., Aishes r.a. dhe Abdullah ibn. Mes'udit r.a.<sup>26</sup>

Kjo i ka shtyrë disa mosnjohës të realitetit që të konstatojnë gabimisht se Ebu Hanife shumë vendime i ka marrë me hamendje e jo në bazë të Sunnetit të Pejgamberit të Allahut.<sup>27</sup> Lidhur me të tillët Imam El-Kevtheriu, All-llahu i Madhërishëm e mëshiroftë, thotë:

*“Kush mendon se Ebu Hanifja ka ditur pak hadithe apo se i ka përdorur shumë hadithet e dobëta (daif), ai nuk di asgjë nga gjërat që duhet ditur, siç nuk i di kushtet e pranimet të haditheve të caktuar nga dijetarët e mëdhenj (imamët e hadithit). Pos kësaj, ky bën gabim të madh kur njohuritë e imamëve muxhtehidë i mat me peshojën e tij që e ka e që me siguri se është e çrregulluar”.*<sup>28</sup>

### Kompetenca në kritikën e transmetuesve dhe në metodologjinë e studimit të hadithit

Kompetenca e Ebu Hanifes në kritikën dhe vlerësimin e hadithit ofron prova të mjaftueshme për ekspertët që ta klasifikojnë ndër njohësit e jashtëzakonshëm të kësaj disipline. Mendim të këtillë kanë pasur edhe Tirmidhiu, El-Bejhekiu, Imam Edh-Dhehebiu, Hafidh Ibn Haxher El-‘Askalaniu etj.<sup>29</sup>

<sup>26</sup> Al-lameh Shibli Nu'man, po aty, fq. 150-158.

<sup>27</sup> Disa dijetarë harrojnë se imamët e mëdhenj përfundimet e tyre fikhere nuk i kanë bazuar në transmetime të pasigurta. Në këtë frymë ka vepruar edhe Imam Maliku, i cili i kundërshton mbi 70 hadithe joautentike, duke e përdorë analogjinë në vend të tyre. Shih: Muhammed Muhammed Ebu Zehv, *El-Hadithu ve'l-muhaddithune ev 'inajetu'l-ummeti-islamijje bi's-sunneti'n-nebevijje*, Daru-l-kitabi-l-'arebi, Bejrut, 1984, fq. 286, sipas: [http://www.ipf.unze.ba/fileadmin/user\\_upload/TEKSTOVI/ZBORNIK\\_6\\_2\\_.pdf](http://www.ipf.unze.ba/fileadmin/user_upload/TEKSTOVI/ZBORNIK_6_2_.pdf).

<sup>28</sup> Sipas: Vehbi Sulejman Gavoci, Imam Ebu Hanife, po aty.

<sup>29</sup> Tirmizi, *Kitabu'l-'ilel, i shtypur së bashku me Sunenin e tij*, 5/696. El-Bejheki, *Delailu'n-nubuvve*, 1/43-46. (botim i Bejrutit, 1405 h.). Zafer Ahmed el-Osmeni Et-Tehanevi, *I'lau's-sunen*, Idaretu'l-Kur'ani ve'l-'ulumu'l-islamijje, Karaçi, Pakistan, 1985, fq. 332. Edh-Dhehebi, *Mizan al-i'tidal*, 1/380. Ibn Haxher, *Tehdhibu't-tehdeh*, 1/670. (Botimi: Mu'essesetu'r-risale, Bejrut, 1996). Krhs.: Et-Tahanevi, po aty, fq. 332. Muhammed Abdurreshid En-Nu'mani, *Mekanetu'l-Imam Ebi Hanifete fi'l-hadithi*, Daru'l-beshairi'l-islamijje, Bejrut, 1995, fq. 66-67.

Madje, Ebu Hanife nuk ishte muxhtehid vetëm në fushën e së drejtës islame, por ishte muxhtehid edhe në fushën e hadithit dhe të fushave të hadithit. Burime të shumta provojnë se Ebu Hanife ka kontribuar në përkufizimin e metodave të studimit të hadithit, siç është metoda e leximit dhe citimit të hadithit nga ana e *nxënësit te mësuesi* është më e mirë se citimi i hadithit nga ana e *mësuesit te nxënësi*.<sup>30</sup>

Po ashtu, lejimi i tij që te leximi i hadithit para mësuesit mund të përdoret shprehja *haddethena / na ka treguar, na ka përcjellë dhe ahberena / na ka njoftuar, lajmëruar, me ç'gjë i është kundërvënë* ‘Abdullah b. El-Mubarekut, Ahmedit dhe Nesaiut, më së miri e vërtetojnë ixhtihadin e tij në këtë fushë. Me metodën e tij janë pajtuar edhe ekspertët nga Hixhazi, Kufa, e sidomos nga Sufjan Eth-Thevriu.

Ebu Hanife iu kundërvu mendimit të Ez-Zuhriut, Esh-Sha'biut, Alkamit, Malikut e të tjerëve, të cilët pohuan se *al-munawala*,<sup>31</sup> si metodë e studimit të hadithit është e të njëjtit nivel dhe forcë sikurse edhe *es-sama*.<sup>32</sup> Kjo metodë e tij më vonë u aprovua thujtë nga të gjithë ekspertët e hadithit sikurse ‘Abdullah b. El-Mubareku, Esh-Shafiu, Ahmed b. Hanbeli, En-Neveviu etj., që e radhit Ebu Hanifen në shkencëtar të pavarur edhe në këtë shkencë të hadithit.

Ebu Hanifja është i shquar edhe me kontributin e tij të jashtëzakonshëm në bazat e hadithit: metodologjinë e shkencës së hadithit, në njohjen e njerëzve (transmetuesve) dhe pozitën e tyre, transmetimet nga mësuesit e tyre dhe transmetimet e nxënësve prej tyre. Ebu Hanifja dha kontribut të veçantë në përpilimin e rregullave të hadithit që u trajtuan në shumë libra të metodologjisë së hadithit që i transmetuan nga njerëzit e kësaj lëmie. Muhadithi i mirënjohur Mes'ud ibn

<sup>30</sup> Shih gjerësisht për këtë: Es-Sujuti, *Tedribu'r-ravi*, 2/10 dhe Zafer Ahmed el-Uthmani Et-Tehanevi, *I'lau's-sunen*, po aty, fq. 332.

<sup>31</sup> *El-Munawala (Dorëzimi)* ndodh kur mësuesi i jep nxënësit të vetë ndonjë përmbledhje të hadithit dhe i deklaron se ai këto hadithe i ka dëgjuar prej mësuesve të vet. Në këtë rast nxënësi mundet këtë përmbledhje ta përshkruajë ose eventualisht përmendsh ta mësojë dhe ato hadithe pastaj t'i transmetojë prej mësuesit përkatës. Shih: Mehmed Hanxhiq, Hyrje në shkencën e hadithit, Logos-A, Shkup, 1417/1997, fq. 49.

<sup>32</sup> *Es-Sam'a* (Dëgjimi) ndodh kur nxënësi ta dëgjojë hadithin nga goja e mësuesit, qoftë ky ta shqiptojë nga mbamendja apo nga libri. Sipas: Mehmed Hanxhiq, po aty, fq. 48-49.



Shejbe es-Senedi, në librin e tij “Et-Ta`lim” shkroi një kapitull të posaçëm që ka të bëjë me këtë çështje, dhe tha: “Dije që fjalët e Ebu Hanifes rreth *xherhit* dhe *ta`dilit* (dëmtimi apo mosdëmtimi i transmetuesve të hadithit) janë të pranuar, i kanë pranuar dijetarët që merren me këtë lëmi dhe kanë vepruar sipas tyre, sikur që i kanë marrë nga Imam Ahmedi, Buhariu, Ibn Muini dhe të tjerët.<sup>33</sup>

Meritat e Ebu Hanifes në shkencën e hadithit janë të konsiderueshme edhe pse të lëna në harresë dhe të pazhvilluara nga ai nivel. Fjala është për meritën e Ebu Hanifes në formulimin dhe aplikimin praktikë të parimit të kritikës racionale (dirajat), që nuk ka paralele në historinë e mësimit. Ibn Haxheri lidhur me këtë thotë se fatkeqësisht nuk ka pasur interesim për përpunimin e sistemit të kritikës shkencore dhe nuk janë shkruar vepra të mjaftueshme. Ebu Hanife fillimet e kësaj kritike i ka gjetur te as`habët, por që për fat të keq, në periudhën e mëvonshme kjo çështje u shty në plan të dytë.<sup>34</sup>

### **Musnedi i Ebu Hanifes**

Imam Ebu Hanife ka poseduar hadithe të shumta. Hafidh Zekerija ibn Jahja në veprën e vet *El-Menakib* e thekson transmetimin e Jahja ibn Nasir ibn Haxhibit, i cili thotë:

“E kam dëgjuar Ebu Hanifen - e mëshiroftë All-llahu i Madhëruar - i cili ka thënë: ‘Posedoj disa arka plot me hadithe; nuk kam transmetuar prej tyre përveç pak që është e dobishme’”.<sup>35</sup>

Po ashtu, El-Mueffiku transmeton se Ibn Xhurejxhiu ka thënë:

“Ebu Hanifja – e mëshiroftë All-llahu i Madhëruar – u përgjigjej meseleve (jepte fetva) duke u mbështetur në bazë të saktë (në ajet kur`anor ose në hadith).”<sup>36</sup>

Hasan ibn Zijadi thotë:

<sup>33</sup> Vehbi Sulejman Gavoçi, Imam Ebu Hanife, po aty.

<sup>34</sup> Al-lameh Shibli Nu`mani, po aty, fq. 140-141 e tutje.

<sup>35</sup> Vehbi Sulejman Gavoçi, Imam Ebu Hanife, po aty.

<sup>36</sup> Shih: Menakibu el-Mueffik, 1/95-96, sipas: Vehbi Sulejman Gavoçi, Imam Ebu Hanife, po aty.

“Imam Ebu Hanifja transmetoi katër mijë hadithe të karakterit juridik (ehadithu`l-ahkam): dy mijë të Hammadit dhe dy mijë të mësuesve të tjerë. Këto hadithe i kishte zgjedhur nga katërdhjetë mijë hadithe, e mëshiroftë All-llahu.”

Ne`im ibn Amri thotë:

“E kam dëgjuar Ebu Hanifen duke thënë: “Çudi, njerëzit thonë: “Unë jap fetva duke u mbështetur në arsyen time, po unë nuk jap fetva vetëm se i mbështetur në hadith!!”<sup>37</sup>

Por, vepra më e rëndësishme e Ebu Hanifes në hadith është *Musnedi*<sup>38</sup>, i cili përmbledhje hadithesh që i atribuohet Imam Ebu Hanifes. Por, ai nuk shkroi një libër të tillë. Atë e mbledhën dhe e shkruan nxënësit e tij, pas vdekjes së tij. Në këtë mënyrë kemi disa vepra të njohura me hadithe të vlefshme:

- *Kitabu`l-athar* i Ebu Jusufit,

- *Kitabu`l-atharu`l-merfu'a*, i Muhammed b. Hasan Esh-Shejbaniut,

- *Kitabu`l-atharu`l-merfu'a ve`l-mevkufe*, i Muhammed b. Hasan Esh-Shejbaniut,

- *Musnedi* i Hasan b. Zijad El-Lu`lu`it,

- *Musnedi* i Hammadit, birit të Ebu Hanifines.<sup>39</sup>

Ebu`l-Muejjid El-Havarizmi (vd. 665. h.), i motivuar nga fjalët denigruese të dijetarëve të ndryshëm adresuar ndaj Ebu Hanifes se ai nuk e njeh hadithin, se ai nuk ka vepër hadithesh, se ai nuk i ka kushtuar kujdes hadithit në punën e tij etj., iu përvesh punës dhe pas një angazhimi hulumtues zbuloi 15 musnedë të Ebu Hanifes.<sup>40</sup> Puna e tij

<sup>37</sup> Vehbi Sulejman Gavoçi, Imam Ebu Hanife, po aty.

<sup>38</sup> Gjatë vitit 2009 me angazhimin e Rustem Spahiut edhe në gjuhën shqipe e kemi veprën *El-Musned* të Imam Ebu Hanifes (Dr. Fuad Sediq, Musnedi i Imam Ebu Hanifes, Prishtinë, 2009, fq. 288).

<sup>39</sup> Kemi edhe musnedë të tjerë, si ai nga: El-Vehbiu, El-Harisi, El-Buhariu, Ibn el-Muzaffer, Muhammed b. Xha`fer al-`Adli, Ebu Nu`ajm El-Asbehani, Ebu Bekr Muhammed b. `Abdulbaki El-Ensari, Ibn ebi El-`Avvaam Es-Sa`diu, Ibn Husrew el-Belhiu, Ebu el-Muejjid Muhammed b. Mahmud El-Hawarizmi dhe Ibn `Ukde. Po ashtu, ekziston edhe musnedi i Darekutnit, Ibn Shahinit dhe i Hatib El-Bagdadit. Shih: M. Es-Siba`i, po aty, fq. 413-415.

<sup>40</sup> M. Es-Siba`i, po aty, fq. 414.

rezultoi edhe me shumë informacione dhe dëshmi se qyteti Kufa në kohën e Ebu Hanifes ishte qendër shkencore dhe intelektuale. Kjo gjendje ishte qysh nga qëndrimi i Abdullah ibn Mes'udit si guvernator në Kufa, i dërguar nga Umeri r.a. Kufa kultivoi frymën intelektuale që pak qytete e posedonin. Po ashtu, vizitat dhe udhëtimet e shumta të Ebu Hanifes në shumë qendra shkencore të asaj kohe flasin vetvetiu se vetëm fanatikët sektarë dhe pseudointelektualët mund ta kontestojnë kompetencën e Ebu Hanifes në hadith dhe shkencën e hadithit.<sup>41</sup> 'Ali b. Ebi Talibi r.a. madje qysh më herët që fascinoi me 'Abdullah b. Mes'udin r.a. dhe suksesin e arritur në Kufë: "Ky vend është i përplot me dije / hadith dhe fikh."<sup>42</sup>

### Pozita e Imam Ebu Hanifes në shkencën e hadithit

Përkundër kritikave të një numri dijetarësh, shumica e tyre konsiderojnë se Imam Ebu Hanife është imam në hadith dhe shkencën e hadithit.

Ebu Davud Es-Sixhistani, autor i *Sunenit*, njëres prej gjashtë përmbledhjeve më të njohura të hadithit, pohon: Allahu e mëshiroftë Malikun, Shafiun dhe Ebu Hanifen, të cilët ishin imamë në hadith."<sup>43</sup>

Abdumelik ibn El-Mubareku për Ebu Hanifen thotë: "Vërtet ai është truri (shpirti) i shkencës (së hadithit)."<sup>44</sup>

Hafidh Edh-Dhehebiu në veprën *Mizanu'l-i'tidal*, ka kritikuar muhaddithë të shumtë për shkak të mangësive, por Ebu Hanifen, Shafiun dhe Bihariun nuk i ka përmendur në kontekst negativ. Ngjashëm vepron edhe Hakim En-Nejsaburi në veprën e tij të njohur *Ma'rifetu ulumi'l-hadith*.<sup>45</sup>

<sup>41</sup> M. Es-Siba'i, po aty, fq. 415. Muhammed Ebu Zehv, po aty, fq. 146. M. Hanxhiq, po aty, fq. 23.

<sup>42</sup> M. Es-Siba'i, po aty, fq. 416. Vehbi Sulejman Gavoçi, Imam Ebu Hanife, po aty.

<sup>43</sup> Ibn Abdu'l-Berr, po aty, 2/163.

<sup>44</sup> Muhammed Ebu Zehreh, po aty, fq. 374.

<sup>45</sup> *Ma'rifetu ulumi'l-hadithi*, fq. 240-249, sipas:

[http://www.ipf.unze.ba/fileadmin/user\\_upload/TEKSTOVI/ZBORNIK\\_6\\_2\\_.pdf](http://www.ipf.unze.ba/fileadmin/user_upload/TEKSTOVI/ZBORNIK_6_2_.pdf).

Ibn Tejmijje flet me respekt për Ebu Hanifen.<sup>46</sup> E konsideron njërin prej imamëve më të njohur dhe fakih më të ditur dhe më të madh se Tahaviun e të ngjashëm. Në një vend tjetër Ibn Tejmijje cek se të katër imamët kanë qenë imamë në hadith, tefsir, tesavvuf dhe fikh.<sup>47</sup>

Këta dhe kolosë të tjerë të shkencës së hadithit dhe të islamit në përgjithësi, janë pajtuar se Ebu Hanife ka qenë imam edhe në hadith, duke pranuar saktësinë, mbamendjen dhe bazueshmërinë në pranimin dhe transmetimin e hadithit. Në këtë frymë Abdullah b. Davud El-Hurejbiu përfundon: *Myslimanët në namazin e tyre duhet t'i lexojnë dua Ebu Hanifes, për shkak të kujdesit, ruajtjes dhe kontributit të tij në sunnet dhe fikh.*<sup>48</sup>

Njohjen dhe vlerën e Ebu Hanifes në hadith e spikat edhe Imam Es-Serahsiu:

"Ebu Hanife ka qenë njohësi më i madh i hadithit në kohën e tij. Mirëpo, për shkak të kriterit të tij rigoroz në aspektin e saktësisë dhe kujdesit të madh që transmetimet e dobëta të mos përzihen me ato autentike, pak ka transmetuar hadith."<sup>49</sup>

Lidhur me këtë Imam Alaaddin El-Kasani pohon se hadithet që Imam Ebu Hanife i ka shpallur për autentike, askush pas tij nuk ka mundur t'iu gjejë të meta dhe mangësi.<sup>50</sup> Nga ana tjetër, Imam Shemsuddin Salih Shafi'iu pohon se Ebu Hanife bën pjesë ndër hafizët më të mëdhenj të hadithit, duke shtuar se Ebu Hanife është i pari që nxori zgjidhje shariatiko-juridike nga hadithi. Ai shton: Si do të mund të nxirrte aq shumë përfundime dhe të zgjidhë aq shumë çështje shariatiko-juridike sikur të mos t'i ketë kushtuar kujdes të duhur!?<sup>51</sup> Edhe

<sup>46</sup> Ibn Tejmijje, *Minhadžu's-sunneti'n-nebevijje*, 4/194-195.

<sup>47</sup> Ibn Tejmijje, po aty, 1/172-173.

<sup>48</sup> En-Nu'mani, *Mekanetu'l-Imam Ebi Hanife fi'l-hadithi*, fq. 32.

<sup>49</sup> Es-Serahsi, *Usulu'l-fikh*, 1/350. (Botim: *Daru'l-kitabi'l-arebi*, 1372 h.) Krhs.: En-Nu'mani, *Mekanetu'l-Imam Ebi Hanife*, fq. 57.

<sup>50</sup> El-Kasani, *Beda'i-sana'i fi tertibi'sh-shera'i*, 2/97. (Botim egjiptian, 1327 h.). Krhs.: En-Nu'mani, *Mekanetu'l-Imam Ebi Hanife*, fq. 58, sipas: [http://www.ipf.unze.ba/fileadmin/user\\_upload/TEKSTOVI/ZBORNIK\\_6\\_2\\_.pdf](http://www.ipf.unze.ba/fileadmin/user_upload/TEKSTOVI/ZBORNIK_6_2_.pdf).

<sup>51</sup> Shih: En-Nu'mani, *Mekanetu'l-Imam Ebi Hanife*, fq. 66.

shumë autorë të tjerë kanë dhënë mendimet e tyre të vërtetuara lidhur me Ebu Hanifen dhe kompetencën e tij në shkencën e hadithit.<sup>52</sup>

Në fund e shohim të rrugës të themi se shumë muhaddithë me kalimin e kohës kanë tentuar ta heqin etiketën, si dijetar jo mjaft i udhëzuar në shkencën e hadithit nga Ebu Hanifja, që ia patën ngjitur disa fanatikë sektarë dhe rigjidë. Edh-Dhehebiu, Ibn Kethiri, En-Neveviu, Es-Sem'aniu e të tjerë kanë konsumuar shumë kohë që të dëshmojnë se Ebu Hanife nuk është aspak më i vogël në hadith sesa që ka qenë në fikh.

### Në vend të përmbylljes

Imam Ebu Hanife ishte dijetar i përmasave botërore që nuk njeh kufij kohorë e hapësinorë, gjuhësorë, racorë apo territorialë. Ai paraqet autoritet kulmor në shumë shkenca sikurse janë akaidi, fikhu e hadithi etj. Mënyra e punës së tij i bëri parimet e shkollës së tij ndriçues jo vetëm për pasuesit e tij por në përgjithësi për myslimanët. Ndodhi që sistemi juridik që e hartoi mexhlisi privat i juristëve, me në krye Ebu Hanifen, të bëhej ligj i vendeve dhe perandorive me shekuj.

Njohja e Ebu Hanifes të hadithit dhe shkencës së hadithit dhe roli i tij në këtë fushë përkundër kontestimeve nga grupet apo individët kundërshtarë është evident dhe imponant. Thuajse shumica e autoriteve shkencore kontributin e tij e vlerësojnë, kurse vepra “El-Musned” (e botuar edhe në gjuhën shqipe) paraqet dëshminë më të mirë për konfirmimin tonë.

Me këto mendime nuk pretendojmë të themi se “gjykimet e Ebu Hanifes janë të pagabueshme dhe përfundimtare” por pretendojmë se “qëndrimet e Ebu Hanifes kanë qenë korrekte, aq sa ka qenë e mundshme për një muxhtehid.”<sup>53</sup>

*Nexhat Ibrahim*

## THE CONTRIBUTION OF ABU HANIFA TO THE SCIENCE OF HADITH

(Summary)

### Introduction

The contribution of Abu Hanifa to the science of hadith cannot be acknowledged in just one paper. Thus, our goal is to try and summarize the basic facts and to help clarify some key moments. Furthermore, this paper aims at proving the truth of the matter asserted before those who are not well informed and opponents as well as to refute fanatics for being biased about the views of Abu Hanifa regarding hadith and its use in analyzing Islamic issues in akaid, fiqh, etc. Recently, a number of writings from different viewpoints were made on this topic. Consequently, we will try not to repeat the things that have already been said.

<sup>52</sup> Shih: *Ikdu'l-xhevheri-s-semin, fi erbe'ine hadithen, min ehadithi sejjidi'l-murselin*, fq. 4-6. (Botim egjiptian, 1322 h.); *Mekanetu'l-Imam Ebi Hanife*, fq. 66-67.

<sup>53</sup> Al-lameh Shibli Nu'man, po aty, fq. 223.

نجد إبراهيم

## أبو حنيفة مساهمته في علم مصلح الحديث (خلاصة البحث)

مدخل

مساهمة الإمام أبو حنيفة في علم الحديث والامام بها من المستحيل أن يمحصر في مذكرة قصيرة كهذه. لهذا السبب، وهدفنا هو السعي لتقديم أهم البيانات والمساعدة في شرح وتوضيح بعض اللحظات الحاسمة. أيضا نسعى من خلال هذا الموضوع الى اثبات الحقيقة امام الذين لا يعرفون ولكن حتى امام لمعتريين والمتعصبين لدحض الأحكام المسبقة في شأن الموقف من أبي حنيفة عن الحديث واستخدامه في قضايا اسلامية مثل العقيدة والفقهاء الخ. يجب أن أعترف هنا أنه في الآونة الأخيرة كتبت هناك عدد من المقالات حول هذا الموضوع من زوايا مختلفة، لذلك جهودنا سوف تختصر في عدم التكرار.

## PORTRETE

*Kushtrim Shehu*

### ISMAIL QEMALI - FIGURË SHTETËRORE OSMANE DHE HERO SHQIPTAR (NË SHËRBIM TË TË DY VENDEVE)

Periudha e historisë parakombëtare shqiptare apo thënë më mirë periudha para determinimit të kombit shqiptar si njësi politike e pavarur mund të studiohet edhe përmes personaliteteve shqiptare. Një gjykim i tillë mbështetet nga gjendja shoqërore e shqiptarëve përgjatë historisë. Shkëlqimi individual i shqiptarëve në formacione politike të mëdha siç ishin Perandoria Romake dhe Perandoria Osmane është pasqyrë e mirë e mundësisë drejt njohurisë të shoqërisë shqiptare. Kjo situatë fiton edhe më shumë rëndësi pasi që personalitete të tilla janë të shumtë. Në rrjetin e gjerë të këtyre personaliteteve gjendet edhe figura e Ismail Qemalit, rreth të cilit ky shkrim mban barrën modeste të paraqitjes së personalitetit shumëdimensional të tij.

Njeriu i pavarësisë së Shqipërisë Ismail Bej Qemali, përkundër asaj që tek opinioni ynë i gjerë më shumë njihet dhe është cilësuar si kundërshtar dhe armik i shtetit osman, gjatë jetës së tij e tërë veprimtaria e tij jetësore përfshihet në shërbimin ndaj këtij shteti. Vlen të theksohet se populli shqiptar ishte komunitet i integruar në Perandorinë Osmane dhe që kishte mundësinë e integritetit në hierarkinë drejt-

tuese të kësaj perandorie. Siç e përmend edhe vetë Ismail Bej Qemali në librin e tij të kujtimeve, familja e tij ishte drejtuese dhe administruese e shumë pronave në Shqipërinë Jugore.<sup>1</sup> Gjenealogjia e familjes së Ismail Beut dërgon deri te sadrazami<sup>2</sup> Koxha Sinan Pasha, i cili jetoi në shek.XVI dhe që në historinë e shtetit osman njihet për sukseset e tij si udhëheqës ushtarak dhe politik. Edhe paraardhës të tjerë të Ismail Bej Qemalit ishin zotër të tokave në Shqipërinë Jugore dhe njëkohësisht mbanin lojalitetin e tyre ndaj shtetit osman. Duke qenë pasardhës i një familjeje me pushtet dhe me vlera elitare Ismail Bej Qemali arsimohet nga profesorë privatë apo tutorë familjarë për të vazhduar në institucione të mirënjohura arsimore si Liceu Zosimea. Prejardhja e tij dhe një shkollim i tillë hapte rrugën për shërbim në institucionet shtetërore osmane, në të cilat Ismail Bej Qemali shërbeu për më shumë se katërdhjetë vjet. Përveç kualifikimit të lartë Ismail Beu njihet për efikasitetin dhe aftësinë për të gërrshetur vlerat moderne administrative me realitetin, ku udhëhiqte.<sup>3</sup> Për të shteti osman ishte vlera që duhej ruajtur nga të gjithë elementet përbërëse të saj dhe që modernizimi i shtetit nënkuptonte afirmimin dhe zhvillimin e këtyre vlerave. Si i tillë Ismail Beu me punën e tij në fusha të ndryshme që shembull për udhëheqës tjerë osmanë. Koncepti i shërbimit ndaj shtetit osman duhet të kuptohet me pikëpamjen që jep edhe vetë Sami Frashëri ndaj përkatësisë shqiptare dhe lidhshmërisë me shtetin osman. Perandoria Osmane paraqet atë që cilësohet (vatan-i ummumi) atdhe i përgjith-

<sup>1</sup> Rreth jetës së Ismail Qemalit shërben libri i botuar fillimisht në gjuhën angleze “The Memoirs of Ismail Kemal Bey”, poashtu për njohuri më të gjera rreth familjes së tij mund të konsultohet edhe libri i kushëririt të parë Ekrem Bej Vlorës “Lebenserinnerungen” (Kujtime). Të dy librat gjenden të përkthyer në gjuhën shqipe dhe turke.

<sup>2</sup> Titulli sadrazam apo vezir-i azam do të thotë udhëheqësi i madh ose i parë apo udhëheqësi më i lartë shtetëror në kuadër të një këshilli me fuqi ekzekutive. Në ditët e sotme pushteti ekzekutiv meqënëse i takon qeverisë edhe titulli i sadrazamit duhet apo mund të kuptohet si titulli i kryeministrit. Sami Frashëri në veprën e tij enciklopedinë e njohur “Kamus’ul Âlam” përmend mbi 50 emra sadrazamësh me prejardhje shqiptare.

<sup>3</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Historia e Popullit Shqiptar II, Botimet Toena, Tiranë 2002, fq. 293.

shëm krahas përkatësisë shqiptare që shprehet me (vatan-i hususi) atdheun e veçantë, gjegjësisht Shqipërinë.<sup>4</sup>

Puna e Ismail Bej Qemalit së bashku me Mithat Pashën, babanë e konstitucionalizmit dhe parlamentarizmit osman bëri që vlerat demokratike dhe liberale të gjenin frymë në shtetin osman. Puna e përbashkët e të dyve në Vilajetin e Danubit (Bullgari) mundësoi që të hedheshin themelet e institucioneve moderne shtetërore. Shërbimi dhe sukseset tjera të Ismail Bej Qemalit bënë që të ishte i njohur në tërë sferën e hierarkisë osmane, ku për çështje të rëndësishme politike dhe administrative kërkohej mendimi apo edhe lakohej emri i tij për menaxhimin e çështjeve me rëndësi. Shërbimi i tij në Ministrinë e Jashtme osmane forcoi marrëdhëniet e shtetit osman me shtetet perëndimore. Njëkohësisht për shumë ambasadorë të huaj të cilët ishin akredituar në Stamboll, emri i Ismail Bej Qemalit ishte i njohur për shkak të afinitetit diplomatik të tij dhe bashkëpunimit reciprok që kishin së bashku. Janë të njohura raportimet e rregullta të Ismail Beut që i bënte Sulltanit, raporte këto që përfshinin ndonjë vilajet të posaçëm apo gjendjen e përgjithshme të shtetit. Të gjitha këto së bashku përbëjnë korpusin e gjerë të veprimtarisë së Ismail Bej Qemalit në administratën osmane.

Shpallja e konstitucionalizmit dhe hapja e Parlamentit osman më 1908, së bashku me zgjedhjen si deputet i zonës së Beratit të Ismail Bej Qemalit mundësoi edhe kyçjen e tij në sferën e jetës politike osmane. Aktiviteti i tij gjatë periudhës 1908-1912 në Parlamentin osman është përpjekje për mbarrësim të vlerave demokratike në tërë perandorinë. Udhëheqja që u bëri partive opozitare në Parlamentin osman ishte vlerë e mirëfilltë demokratike. Deputetë jo vetëm shqiptarë por turq, arabë, armenë e shumë të tjerë nga mbarë gjeografia osmane të cilët kishin synim vlerat liberale lider të tyre të zëshëm kishin Ismail Bej Qemalin. Promovimi i të drejtave kombëtare shqiptare në kuadër të shtetit osman qe veprimtari e Ismail Bej Qemalit si dhe e shumë deputetëve tjerë si Hasan Prishtina, Myfit Bej Libohova dhe Nexhip

<sup>4</sup> George W. Gawrych, "Tolerant Dimensions of Cultural Pluralism in the Ottoman Empire: The Albanian Community, 1800-1812", International Journal of Middle East Studies, vol.15, no.4, fq. 524.

Draga. Kundërshtimi që i bëhej instalimit të këtyre vlerave dhe refuzimi i të drejtave të komuniteteve në përgjithësi bëri që Ismail Bej Qemali dhe deputetët tjerë shqiptarë të fillojnë të mendojnë për pozicionimin e kombit shqiptar si njësi më vete.

Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë qe rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të intelgjencës shqiptare, pavarësisht se ku vepronte. Ismail Bej Qemali me pozicionet e tij të larta që kishte në shtetin osman në të kaluarën kishte përvojën e duhur dhe mundësinë për bartjen e çështjes shqiptare në konstelacionet e dhura ndërkombëtare. Me shpalljen e pavarësisë çështja shqiptare fitoi edhe juridiksht të drejtën e saj për vetëvendosje dhe futi në tryezat e bisedimeve ndërkombëtare pashmangshëm tashmë çështjen e shtetit shqiptar.

### Një jetë në administratë

Të qenit nëpunës në administratën osmane nënkuptonte që krahas aftësisë për menaxhim nëpunësit të kishin njohuri të gjuhëve perëndimore por edhe gjuhëve orientale si arabishten, persishten si dhe gjuhën e administratës së atëhershme gjuhën osmane. Shkollimi në Liceun Zosimea i mundësoi Ismail Bej Qemalit mësimin e këtyre gjuhëve dhe i hapi dyert për shërbim në administratë. Karrierën e tij si funksionar shtetëror e filloi në moshën 16-vjeçare pranë zyrës së përkthimeve të shtetit osman. Vlen të përmendet se e tërë karriera e tij përfshin periudhën më të ndërlikuar politike dhe me ndryshime dinamike të shtetit osman. Përpjekjet për modernizim lansohen nga vetë shteti dhe administrata si bartëse e këtyre përpjekjeve përjeton ndryshimet e thella dhe të shpeshta. Ismail Bej Qemali pas punës së tij në zyrën e përkthimeve filloi punën në vilajetin e Janinës si nëpunës i lartë në marrëdhëniet me jashtë. Më pas do të gjendej si ndihmës i valiut të Tërhallës për të vazhduar në poste të ndryshme administrative pranë Vilajetit të Danubit. Pikërisht bashkëpunimi që kishte me Mithat Pashën si udhëheqës i këtij vilajeti u bë përvojë e suksesit për mbarë vilajetet e tjera të shtetit osman. Detyrat dhe postet e njëpasnjëshme që mori u bënë mundësi për fitimin e përvojave të ndryshme në menaxhim por ishin

edhe fusha, ku tregoi sukseset e tij personale në administratë. Bashkëpunimi me liderët lokalë qofshin politikë, fetarë a ekonomik ishte risi në udhëheqjen osmane dhe ishte botëkuptim modern qeverisës. Hapja e bankave dhe institucioneve tjera ekonomike me karakter zhvillimor mundësoi përparimin e ekonomive vendëse dhe përhapja e liceve dhe shkollave profesionale krijoi kuadro të përgjithshme për administrim lokal. Tërë kjo orvatje krijoi një mirëqenie e cila ishte e lakmueshme për tërë vilajetet tjera të Perandorisë Osmane.<sup>5</sup> Përveç punës së tij në pjesën evropiane të shtetit osman veprimtaria e tij shtrihet edhe në qytete të rëndësishme të Anadollit. Qytetet si Kütahya, Bolu, Eskişehir, Mardin, Gelibolu, Kırşehir dhe Bursa janë vendet ku Ismail Bej Qemali solli frymën e administratës moderne. Aftësitë e tij prej drejtuesi janë vlerësuar nga shtetarë të tjerë dhe kanë shërbyer për ngritjen e tij në hierarkinë e lartë shtetërore.<sup>6</sup> Vendet si Libani, Iraku dhe Libia të cilat ishin pjesë e shtetit osman për shumë shqiptarë qenë vende ku administruan dhe punuan duke lënë gjurmë të suksesit dhe modernizimit të jetës dhe institucioneve administrative. Pikërisht në këto vende edhe Ismail beu ishte pjesë e administratës shtetërore. Përveç veprimtarisë së tij në sferën e administrimit lokal shkaku i afërsisë së tij me vlerat liberale emri i Ismail beut ishte i njohur në nivel qendror. Afërsia dhe bashkëpunimi me Mithat Pashën bëri që të ishte personalitet i mirënjohur edhe nga vetë sultani për të cilin vazhdimisht përgatiste raporte për çështje të ndryshme të shtetit. Mu për këtë për disa herë me rradhë ka qenë i graduar me Medalje të Lartë Osmane për efikasitetin në shërbime administrative dhe nga vetë sultani ka qenë i shpërblyer me asistencë nga thesari perandorak. Shërbimi në Ministrinë e Jashtme dhe në këshillin shtetëror për çështje juridike janë detyrat ku Ismail beu shfaqti afinitetin e tij për udhëheqje dhe kuptimin e vlerave të reformave që duhej ndërmarrë udhëheqja shtetërore në nivelin qendror. E gjithë veprimtaria e Ismail Bej Qemalit ishte përvojë e suksese

<sup>5</sup> Kemal Karpat “Osmanlı’da Değişim, Modernleşme ve Uluslaşma” İstanbul, 2006, fq. 47.

<sup>6</sup> Dritan Egro, “Zbulohet karriera e Ismail Qemalit si funksionar i Sulltanit” Gazeta Panorama, Tiranë, 28/11/2009.

sshme dhe ishte po ashtu përvojë e dalluar shkaku i aftësive personale për të bashkërenduar sistemin tradicional osman me vlerat moderne në të cilat kishte hyrë shoqëria osmane. Koordinimi i të dyjave së bashku spikati vlerat e tij dhe bëri që të jetë personalitet i dalluar në udhëheqësinë osmane.

### Shpresat dhe rendi i ri, Ismail Bej Qemali përfaqësues shqiptar

Pakënaqësitë lidhur me zhvillimet shoqërore që ngjanë pas vitit 1878 bënë që mes shqiptarëve dhe qendrës osmane të fillojë një tjetërsim i marrëdhënieve dhe mungesa e planifikimit ndaj kësaj problematike ngriti politizimin e çështjes shqiptare. Shqetësimet ndaj zhvillimeve të reja popullsia shqiptare përveç shtruarjes së kërkesave në rrugë institucionale shumëherë kërkesat e saj i shtronte përmes kryengritjeve që shfaqeshin si reaksion shoqëror ndaj paaftësisë së pushtetit për zgjidhje të problemeve.

Shqetësimet ndaj ecurive të reja të shtetit osman nuk ishin vetëm pjesë e shqiptarëve por e gjithë pjesës udhëheqëse, intelektuale apo thënë më shkurtimisht elitat osmane ishin tejet të pakënaqura me zhvillimet që ngjanin. Lidhur me këtë filloi zhvillimi i një botëkuptimi të ri që ishte tejet opozitar në nivelin politik. Botëkuptimi i ri filloi të formojë një bindje, e cila akuzonte udhëheqjen dhe sistemin ekzistent. Një mendim i tillë u institucionalizua përmes organizimit të Komunitetit Bashkim dhe Përparimi (Osmanlı İttihat ve Terakki Cemiyeti), i cili brenda vetes mblodhi forcat dhe ithtarët e idesë për modernizim më të thellë të sistemit politik osman dhe ndërtimin e konstitucionalizmit, i cili ishte abroguar më 1878. Ky komunitet veprimtarinë e vet e zhvillonte në vendet evropiane, ku krahas kongreseve të shumta botoonte edhe gazeta të ndryshme, përmes së cilave synonte vetëdijësimin për ndryshimet që duheshin ndërmarrë.

Brenda komunitetit kishte personalitete të ndryshme qoftë nga jeta politike, fetare dhe shumë krerë ushtarakë ishin element të këtij komuniteti. Vlen të përmendet se roli i Ismail Bej Qemalit në këtë kom-

unitet ishte i rëndësishëm shkaku i shfaqjes dhe përkrahjes së vlerave liberale.<sup>7</sup> Përvetësimi i sistemit decentralist dhe mbështetja e individualizmit ishin reflektim i rolit të tij. Meqenëse tërë anëtarët nuk ishin të një mendimi lidhur me vlerat të cilat duheshin ndërtuar bëri që të lindë fraksionarizmi përbrenda komunitetit. Ky fraksionarizëm do të vërehet edhe në ngjarjet e mëpasme dhe do të karakterizojë tërë periudhën dinamike në të cilën do të kalojë shteti osman. Megjithatë, domosdoshmërisht ekzistonte një pozicion i përbashkët lidhur me idenë e ndryshimit të sistemit shtetëror. Po ashtu e tërë kjo lëvizje ndonëse veprimtarinë kryesore e zhvillonte jashtë shtetit osman që përpjekje e forcave të brendshme për ndryshimin e sistemit dhe ndalimin e degradimit të mëtutjeshëm të shtetit osman. Komuniteti kishte lindur nga pjesëtarë të shoqërisë osmane, e nxitur nga faktorë shoqërorë të ndër-lidhura drejtpërdrejt me situatën politike në të cilën gjendej shteti osman.

Kryengritja që shpërtheu në Malësinë e Gjakovës u zgjerua në tërë Kosovën dhe tubimi tejet i madh i kryengritësve në Ferizaj rriti shqetësimin në Stamboll. Njëjtë sikurse tubimi në Ferizaj, dezertimi i disa grupacioneve ushtarake në Vilajetin e Manastirit që kërkonin shpalljen e konstitucionalizmit implikoi krerët e Komunitetit Bashkimi dhe Përparimi, të cilët duke shfrytëzuar pakënaqësitë e masave arritën t'i adresonin qëllimet e tyre për ndryshimin e sistemit udhëheqës shtetëror. Telegrafet e dërguara në qendrën osmane nga krerët e masave të tubuara në Ferizaj qenë vendimtare për shpalljen e konstitucionalizmit nga ana e sulltanit. Vlugu i shumtë i kërkesave të qyteteve të ndryshme nga Ballkani-Rumelia drejtuar kryeqytetit gjegjësisht Pallatit Perandorak Jëlldëz, me qëllim hyrjen në fuqi të kushtetutës dhe mbledhjen e parlamentit bëri që të shpallej dekreti perandorak dhe ngjarja të cilësohej si “Shpallje e Lirisë”.<sup>8</sup> Pas 30 vjetëve prapë Kushtetuta dhe Parlamenti zunë vend në shtetin osman.

<sup>7</sup> Şerif Mardin, “Jön Türklerin Siyasi Fikirleri 1895-1908” İletişim Yayınları, İstanbul, 2008, fq. 34.

<sup>8</sup> Mehmet Ö.Alkan, “Yadigar-ı Meşrutiyet” 1908 Seçimleri ya da 1324 İntihabı, İstanbul, 2010, fq.93.

Premtimet e bëra shqiptarëve nga Komuniteti Bashkimi dhe Përparimi ndikuan në rritjen e përkrahjes së krerëve shqiptarë ndaj këtij komuniteti. Shpallja e konstitucionalizmit ishte pritur me atmosferë të mahnitshme e festive në Stamboll, por edhe qytetet si Shkupi, Prishtina, Manastiri dhe Prizreni kishin festuar këtë ngjarje. Konstitucionalizmi nga masat ishte kuptuar si mundësi për zhvillim dhe kapërcim të gjendjes ekzistente. Afër tridhjetë përfaqësues shqiptarë do të zinin vend në Parlamentin osman. Çështja shqiptare përmes deputetëve ishte prezente në institucionin më të lartë shtetëror dhe tashmë nuk kishte mundësinë e neglizhimit të saj.

Ismail Bej Qemali në Parlamentin osman ishte përfaqësues i zonës zgjedhore të Beratit. Aktiviteti i tij prej deputeti përveç adresimit të çështjes shqiptare përfshin edhe shqetësimet lidhur me qeverinë e formuar nga Komuniteti Bashkimi dhe Përparimi. Shqetësime këto që lidheshin me papërvojën lidhur me udhëheqjen sidomos me çështjen e koncesioneve që u ipeshin kompanive ndërkombëtare për ndërtimin e rrjetit të hekurudhave, transportit rrugor dhe krijimit të transportit ujor. Diversiteti i ideve lidhur me shtetin kishte fraksionarizuar krerët e Komunitetit Bashkimi dhe Përparimi, por marrja e pushtetit që bëre shkak për thellimin e kundërshtive dhe fillimin e armiqësisë. Duhet përmendur se premtimet e bëra nga krerët e Komunitetit Bashkimi dhe Përparimi, nuk u realizuan por ato shkuan më tej në përkeqësimin e gjendjes eventuale të shtetit osman. Qëllim i tyre u bë eliminimi i çdo elementi opozitar duke mos njohur asnjë mjet etik politik por vetëm arritjen e qëllimeve të tyre. Organizimi për ndërrimin e Sulltan Abdylhamitit II ishte komploti fillestar që arritën ta realizonin. Përpjekjet për eliminimin e opozitës në parlament po ashtu ishte vazhde e mentalitetit të tyre. Masat e marrura në vilajetet e banuara me shqiptarë nuk nxitën gjë tjetër vetëm se pakënaqësinë e shqiptarëve ndaj shtetit osman. Tjetërsimi i tillë i pushtetit qendror zhvilloi një opozitë të fuqishme në të gjitha anët dhe në të gjitha pjesët e shoqërisë osmane.

Opozitës së formuar në Parlament vazhdimisht i printe Ismail Bej Qemali. Besimi që kishte në Parlament nga anëtarët e opozitës qofshin shqiptarë, arabë dhe turq vinin si shkak i përvojës së duhur dhe elo-



kuencës së pashoqe të tij. Fillimisht u printe opozitarëve të mbledhur rreth Partisë Liberale (Ahrar Fırkası), e cila më vonë do të bashkohej nën Partinë Liberalët e Bashkuar (Mutedil Hürriyetperveran Fırkası) për të përfunduar më vonë në Partinë për Marrëveshje dhe Liri (Hürriyet ve İtilaf Fırkası).<sup>9</sup> Opozita e formuar akuzohej për tradhti ndaj shtetit osman nga anëtarët e KBP-së që ishin njëkohësisht pjesë e qeverisë. Përkatësia e ndryshme etnike e anëtarëve të opozitës edhe pse ishte armë e fortë kundër kësaj akuze prapë qëllimisht ishin të identifikuar për nacionalistë dhe tradhtarë të shtetit. Këto akuza të bëra nga ana e anëtarëve të KBP-së ishin të paqëndrueshme ngase vetë sadrazami i asaj kohe shqiptarët i kishte quajtur si brilantë të kurorës osmane. Akuzat gjoja se Ismail Beu ishte agjikator anglez dhe punonte për interesat angleze ishin joreale. Vlonjati İsmail Bej Qemali u bë lider i natyrshëm i opozitës pasi prapa tij qëndronte dija shoqërore-politike, ekonomike, diplomatike, kultura e përgjithshme si dhe forca e talenti i tij i ligjërimit politik. Po të lexohen procesverbalet e Parlamentit osman të viteve 1908-1912, do të shihet se Ismail Bej Qemali është sikurse një hero i romaneve në këtë periudhë dinamike.<sup>10</sup> Diskursi që ngjante në parlament ishte rezultat i kundërshtive të thelluara mes dy grupeve sidomos qëndrimi dhe kritikën e opozitës përmes Ismail Bej Qemalit bënë që të ketë edhe përleshje fizike në Parlament.

Polarizimi i jetës politike osmane sjell përvoja të reja dhe dinamizëm të paparë më herët. Përkrahësit e sistemit ekzistent shfaqjen e institucioneve të reja shtetërore dhe fuqizimin e personaliteteve të reja politike e shihnin si rrezik për sulltanin dhe perandorinë. Të tillë përkrahës më së shumti ishin elementi fetar të cilët ndjenin shqetësim për rendin e ri dhe rrëshqitjen e sistemit nga ligjet islame në të cilat kishte themelet shteti osman. Një shqetësim i tillë fiton vëmendje me kryengritjen e njohur të 31 marsit në Stamboll. Ushtarakë nga garda personale e sulltanit dhe elementë fetarë të cilët shqetësimet e tyre për të ardhmen e shtetit dhe institucionit të sulltanit i shfaqnin me mosbesim

<sup>9</sup> Dr. Tarık Zafer Tunaya, "Türkiye'de Siyasi Partiler" İstanbul, 1952, fq.277.

<sup>10</sup> Necip Alpan, "Arnavutluğun Bağımsızlığı ve Avlonyalı İsmail Kemal" Ankara, 1982, fq.40.

ndaj institucioneve të reja të lindura pas shpalljes së konstitucionalizmit. Masa të mlllefosura i drejtohen edhe Parlamentit, ndaj të cilit shfaqën pakënaqësinë e tyre për neglizhimin e vlerave tradicionale që i bënte. Atmosfera e tendosur bëri që të ketë edhe vrasje brenda Parlamentit. Në negociata me masat deputetë të Parlamentit u munduan të gjenin marrëveshje dhe të qetësonin situatën e krijuar. Ismail Bej Qemali si personalitet i besueshëm nga të dy anët arriti që të marrë në dorë situatën dhe të krijojë atmosferën negociuese mes kryngritësve dhe deputetëve. Këto negociata më vonë do të kalojnë edhe vijën më të lartë institucionale për të arritur deri te sulltani. Bisedimet e Ismail Beut me sulltanin sollën ndryshimet qeveritare për të cilat pjesëtarë të KBP-së ishin të pakënaqur. Lidhur me këtë garnizoni i tretë i ushtrisë osmane nga pozicioni i Selanikut niset për në Stamboll nën komandën e Mahmut Shefqet Pashës. Ardhja e këtij garnizoni u proklamua si garanci e rendit të ri politik dhe ishte e koordinuar me KBP. Qëllimi parësor i ardhjes së tyre ishte rivendosja e pushtetit të KBP-së në institucionet shtetërore. Propagandimi kundër sulltanit dhe deputetëve opozitarë, ku merrnin pjesë edhe shqiptarët që pjesë e qëllimit të tyre për eliminimin e pjesës kundërshtuese dhe marrjen në dorë të pushtetit. Në drejtim të deputetëve Ismail Bej Qemali dhe Myfit Bej Libohova u bënë shpifje të planifikuara dhe u kërkua gjykimi i tyre nga gjykatat ushtarake. Ismail Beu akuzohej për puç kundër institucioneve shtetërore dhe aktiviteti i tij ndërlidhej me ngjarjen e 31 marsit. Për gjykimin e Ismail Beut nevojitej heqja e imunitetit të deputetit, gjë për të cilën u bë një diskutim i gjatë nga të gjithë deputetët dhe u konkludua se përveç rolit ndërmjetësues të Ismail Beut nuk kishte fakte për implikimin e tij në ngjarjet e 31 marsit. Vendosur sipas Komisionit parlamentar është vërtetuar se Ismail Bej Qemali nuk është përgatitës apo nxitës i ngjarjes së 31 marsit.<sup>11</sup> Akuzat dhe seria e shpifjeve nga pjesëtarët e KBP morën një hov të jashtëzakonshëm. Shkrimet në gazeta me përmbajtje kundër Ismail Beut bënë që të kërkojë sqarime re-

<sup>11</sup> Osman Selim Kocahanoğlu, "31 Mart Ayaklanması ve Sultan Abdülhamid" İstanbul, 2009, fq.611.

Citon: Edhe pse Allahu i Gjithëfuqishëm në Kur'an në shumë vende kërkon prej njerëzve, veçanërisht prej besimtarëve myslimanë, që pa farë kushti t'i nënshtrohen duke i kryer diçka nga urdhrat e Tij dhe duke ikur prej të gjitha atyre çka Ai i ka ndaluar, megjithatë, prapëseprapë mund të themi lirisht se s'ka njeri që s'gabon. Dallimi qëndron vetëm në atë që dikush gabon më pak e dikush më shumë.<sup>5</sup>

Muhamedi a.s. thotë:

*“Ai që pendohet është i dashuri i Zotit.”*

Për pendim nuk ka afat të caktuar e as të kufizuar.

Myderrizi i nderuar përfundon dispensën duke u penduar për gabimet e mundshme me fjalët:

***O Zoti i Madhërishëm! Pendohem për atë që me dashje ose pa të kam gabuar. O Zot, pendohem te Ti, Ty të kthehem dhe fenë e vërtetë e pranoj. Ty të besoj dhe gjithçka që iu është shpallur profetëve është e vërtetë dhe e drejtë.***

<sup>5</sup> Sadri Prestreshi, AHLAKU dispencë për klasën e dytë, fq.104, Medreseja e mesme Alauddin Prishtinë 1979.

*Eshhedu en la ilahe il-lall-llah ve eshhedu enne Muhameden abduhu ve resuluhu.*<sup>6</sup>

Lusim Allahun që kjo dua të jetë e pranuar dhe kjo vepër e tij të jetë shkak që Myderrizin e nderuar ta gradoj në xhenetet e larta.

<sup>6</sup> Sadri Prestreshi, AHLAKU dispencë për klasën e dytë, fq.109, Medreseja e mesme Alauddin Prishtinë 1979.



Kasim Gërguri

## A LOOK INTO MULLAH SADRI EF. PRESTRESHI'S MANUAL AKHLAQ II

### (Summary)

Every human community in the world has its own greeting traditions. Muslims all over the world use the Islamic form of greeting: Salaam.

From the religious viewpoint, it is recommended to greet someone, whereas it is obligatory to reply. The salaam of one person, who is a member of a larger group, will be sufficient on behalf of all the group. Likewise, if one person from the other group replies to the salaam, it will be sufficient on behalf of all the rest.

This is how the issue of salaam is presented in Sadri ef. Prestreshi's manual for second year students.

Akhlaq – manual for second year students, prepared by Sadri Prestreshi, Prishtina 1979, Published by the Alauddin Madrassa in Prishtina.

قاسم غرغوري

## لمحة عامة عن الأخلاق الثاني من الملا صدري أفندي بريستريشي (خلاصة البحث)

لكل مجتمع بشري في العالم علامات محددة، وبعبادتها الخاصة من تحية. حتى نحن المسلمين، وليس فقط في بلدنا ولكن أيضا في جميع أنحاء العالم بغض النظر عن المكان الذي نعيش فيه، لدينا تحية مشتركة و هي والسلام.

التحية في الاسلام تعتبر من الاشياء الفضلة دينيا و لكن ردها يعتبر واجبا او واجب كفاية و هذا يعنى ان في مجموعة من الاشخاص يكفى شخص واحد ان يرد يسقط عن البقية.

وهكذا يبدأ هذا الموضوع صدري بريستريشي موجهها كتيبه الى طلاب الصف الثاني لمدرسة "علاءالدين".

الأخلاق، كتيب للصف الثاني، اعداد من المدرس: صدري بريستريشي، بريشتينا ١٩٧٩، الناشر : مدرسة "علاءالدين" - بريشتينا.

## AKTUALITETE

*Esilda Luku*

### PREZANTIMI I PERIUDHËS OSMANE NË TEKSTET SHKOLLORE TË HISTORISË NË SHQIPËRI (2000-2010)

“Madhështia e së ardhmes lind nga rilindja e së kaluarës”<sup>1</sup>. Ky mision civilizues i atribuohet historiografisë kombëtare, në mënyrë të veçantë teksteve shkollore të historisë. Nëpërmjet tyre synohet që e kaluara të kuptohet në funksion të sotmes, dijet historike të shërbejnë për të përgatitur qytetarin e ardhshëm, si pjesëtar aktiv i perspektivës historike të shoqërisë demokratike. Këto synime realizohen atëherë kur historia kombëtare njihet në realitet dhe me objektivitet dhe kur ajo vlerësohet si pjesë e integruar e historisë së popujve të tjerë, të rajonit, të Evropës e të botës.<sup>2</sup>

Marrëdhëniet shqiptaro-osmane, të fundit të shek.XIV - fillimit të shek.XX, përfaqësojnë një periudhë të rëndësishme në kujtesën historike të kombit shqiptar. Shtrirja kohore mbi 500-vjeçare dhe bashkëpunimi shumëpërmasor ndërmjet dy popujve ka kushtëzuar trajtimin e merituar në tekstet shkollore të historisë. Për më tepër, njohja e së ka-

luarës dhe e trashëgimisë osmano-islame bart vlera të qenësishme për të kuptuar zhvillimet e sotme moderne.

Për të evidencuar shkallën e zbatimit të kriterëve shkencore, sasiorë dhe cilësorë, të paraqitjes së periudhës osmane në viset shqiptare janë analizuar tekstet më përfaqësuese të historisë së ciklit shkollor 9-vjeçar dhe parauniversitar në Shqipëri (2000-2010). Këto tekste përmbushin me përpikmëri parimin e historicizmit, që nënkupton zhvillimin e shoqërisë njerëzore në mënyrë kronologjike dhe konkrete.<sup>3</sup> “Të respektosh kronologjinë, nuk mjafton thjesht ta trajtosh procesin sipas rrjedhës së tij historike, por duhen zbuluar dhe trajtuar edhe lidhjet ndërmjet tyre. Kurse të respektosh nocionin e kohës, do të thotë të kuptosh kompleksitetin e fakteve, të ngjarjeve, të fenomeneve dhe dukurive historike që janë vendosur në një kohë dhe në një hapësirë të caktuar”.<sup>4</sup>

Zbatimi i kriterit kronologjik dhe rëndësia e pasqyrit të periudhës otomane vërehet në vendin që zënë marrëdhëniet shqiptaro-osmane në tekstet shkollore të historisë. Konkretisht, në librin “Historia e popullit shqiptar” për klasën e 9-të, trajtimi i Perandorisë Osmane përfshin 4 nga 14 kapituj, si vijon: Kapitulli 4 - “Epoka e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut”, f. 23-30; Kapitulli 5 - “Shqipëria nën pushtimin e Perandorisë Osmane (shek.XVI-XIX) f. 31-38; Kapitulli 6 - “Rilindja Kombëtare Shqiptare (vitet 30 të shek.XIX deri 1908) f. 39-52; Kapitulli 7 - “Rritja e Lëvizjes Kombëtare dhe shpallja e pavarësisë së Shqipërisë (1908-1912)” f. 53-60.<sup>5</sup> Ndërsa, në librin “Historia e popullit shqiptar” për vitin e katërt të shkollës së mesme, periudha osmane trajtohet në 8 nga 22 krerë, me titujt: Kreu III - “Shqipëria në Perandorinë Osmane (shek.XIV-XVIII), f. 54-80; Kreu IV - “Vendosja e plotë e sundimit osman në tokat shqiptare (shek.XVI-XVIII), f. 81-88; Kreu V - “Pashallëqet e mëdha shqiptare”, f. 89-99; Kreu VI - “Kul-

<sup>3</sup> Qazim Xhelili. *Didaktika e historisë*. Tiranë: SHBLU, 2001, f. 29.

<sup>4</sup> Bektash Mema. *Njohuri për kërkimin shkencor në fushën e historisë*. Tiranë: SHBLU, 2005, f. 23.

<sup>5</sup> Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu, Bedri Kola, Xhevair Lleshi. *Historia e popullit shqiptar: për klasën e 9-të*. Tiranë: Uegen, 2009, f. 4.

<sup>1</sup> Dritan Egro. *Historia dhe ideologjia: Një qasje kritike studimeve osmane në historiografinë moderne shqiptare*. Tiranë: Maluka, 2007, f. 213.

<sup>2</sup> Vilson Kuri, Roland Gjini. *Bazat teorike dhe praktikat e të mësuarit të historisë*. Tiranë: SHBLU, 2008, f. 81.

tura dhe fetë në Shqipëri (shek.XVI - '20 të shek. XIX)", f. 100-107; Kreu VII - "Etapa e parë e Rilindjes Kombëtare", f. 108-118; Kreu VIII - "Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881) Kriza Lindore dhe shqiptarët", f. 119-134; Kreu IX - "Lëvizja Kombëtare Shqiptare në vitet 1882-1908", f. 135-144; Kreu X - "Drejt pavarësisë së Shqipërisë", f. 145-166.<sup>6</sup>

Respektimi i parimit historicist, në paraqitjen e ndikimit të periudhës osmane në tokat shqiptare, nuk nënkupton progresin linear të shoqërisë. Sipas këndvështrimit evolucionist të historiografisë, gjendja aktuale perceptohet si një mënyrë më e përparuar organizimi në raport me të kaluarën. Studiuesi Antoni Smith vë në qendër të kësaj mitologjie etnike moderne idenë e zhvillimit linear. "Në njëfarë mënyre bashkësitë kanë një ekzistencë si qeniet në natyrë, dhe u binden ligjeve të njëjta të lindjes, rritjes, moshës së pjekurisë dhe rënies, dhe pastaj ringjalljes. Zhvillimi është linear më shumë sesa ciklik, sepse periudha e rënies shihet si diçka "e panatyrshme", një gjë që ka lidhje me njëllot "tradhtie" të brendshme, ose "nënshtrimi" dhe degradimi që vjen nga jashtë".<sup>7</sup> E tillë vlerësohet edhe periudha otomane për shoqërinë shqiptare.

Historiografia jonë përshkohet nga qasja dikotomike Lindje-Perëndim për trajtimin e marrëdhënieve dypalëshe shqiptaro-osmane. Sipas saj, Evropa përfaqëson botën e qytetëruar, përparimtare, Oksidentin, ndërsa Perandoria Osmane identifikohet me prapambetjen, "errësirën", "Lindjen barbare", Orientin. Dualizmi midis shqiptarëve evropiane dhe turqve aziatikë buron nga pikëpamjet orientaliste të kohës. "...Edhe më parë kishte pasur antagonizëm midis shqiptarëve dhe pushtetit qendror osman, por ai kishte qenë i karakterit krahinor, midis sundimtarëve feudalë shqiptarë, që kërkonin të ruanin autonominë, dhe midis politikave reformuese e centralizuese të Portës. Antagoniz-

<sup>6</sup> Muzafer Korkuti, Petrika Thëngjilli, Gazmend Shpuza etj. *Historia e popullit shqiptar: për klasën e katërt të shkollës së mesme të përgjithshme*. Tiranë: SHBLU, 2001, f. 345-346.

<sup>7</sup> Artan Puto. "Fryma romantike dhe nacionaliste në debatin për "identitetin shqiptar", *Përpyekja*, Viti XII, nr.23, Tiranë, vjeshtë 2006, f. 15.

mi u bë më i ashpër sidomos gjatë zbatimit të reformave të Tanzimatit në vitet 1830-1840, sepse me to u prekën të gjitha shtresat e popullsisë shqiptare dhe jo vetëm ata të elitës sunduese. Pas Lidhjes së Prizrenit ligjërimi nacionalist e radikalizoi antagonizmin, duke e paraqitur si përplasje të papajftueshme midis dy kombeve: midis kombit të lashtë evropian shqiptar dhe shtypësit aziatik dhe barbar turk".<sup>8</sup>

"Pushtimi osman" bëhet përgjegjës për kthimin e vendit disa shekuj mbrapa, për izolimin dhe për ndarjen e Shqipërisë nga ai që shihej si një vend i saj i natyrshëm, pranë dhe në kontakte të vazhdueshme me Evropën".<sup>9</sup> Shoqëria shqiptare përjetoi një periudhë regresi gjithëpërfshirës. "Lufta e shqiptarëve kundër ushtrive osmane (fundi i shek.XIV - fundi i shek.XV) pati si pasojë vendosjen e sundimit turk me rrjedhoja të rënda në ekonomi, por edhe në jetën politike, fetare e kulturore. U vranë shumë njerëz, u rrënuan dhe u grabitën pasuritë e Shqipërisë, u shkakuan dëme të mëdha e me pasoja, u godit jeta qytetare, zejtaria dhe tregtia u paralizuan. Emigrimi masiv solli të tjera plagë. Pushtimi osman i dha fund jetës së pavarur politike e shtetërore të shqiptarëve, duke e kredhur vendin në një prapambetje të thellë ekonomike".<sup>10</sup>

Në aspektin politik, periudha otomane konsiderohet shkaktare për frenimin e procesit të unifikimit të zotërimeve të feudalëve shqiptarë në një entitet të vetëm politik. Ky qëndrim i historiografisë nuk merr parasysh gjendjen e brendshme të viseve shqiptare. Në to mbizotëronte një rivalitet i ashpër midis feudalëve për sundim dhe për të zgjeruar territoret e tyre. "Sado që u shqetësuan nga depërtimi i turqve osmanë në Shqipëri, edhe pas betejës së Savrës bujarët shqiptarë nuk u bashkuan kundër tyre. Madje, pas vrasjes së Balshës II (1385) dhe pas vdekjes së Karl Topisë (1388) disa prej tyre, si Dhimitër Jonima, Teodor Muzaka, Vlash Mataranga etj., u shkëputën nga Principata e

<sup>8</sup> Enis Sulstarova. Arratisja nga Lindja: *Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja*. Tiranë: Dudaj, 2006, f.38-39.

<sup>9</sup> Artan Puto. "Disa aspekte të perceptimit të periudhës osmane në historiografinë shqiptare të periudhës së socializmit", *Përpyekja*, Viti IX, nr.18, Tiranë, vjeshtë-dimër, 2003.

<sup>10</sup> Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu etj, *Historia e popullit shqiptar: për klasën e 9-të...*, f. 30.

Balshajve apo nga ajo e Topiajve dhe formuan zotërime të pavarura”.<sup>11</sup> Në Perëndim, përtej Detit Adriatik, ishte Republika tregtare e Venedikut që pengoi krijimin dhe konsolidimin e principatave të pavarura shqiptare. “Pasi mori qytetet bregdetare, Venediku u kishte vënë synin Gjirokastrës dhe Kaninës”.<sup>12</sup>

Në kushtet e përçarjes politike, aristokracia vendase pranoi autoritetin osman për të ruajtur zotërimet dhe privilegjet e saj. “Më 1385 feudali shqiptar sundimtar i Durrësit (Durrazzo) Karl Topia, i përzënë nga pronat e tij prej një fisi sundimtarësh nga veriu, prej Balshajve, u bëri thirrje otomanëve për ndihmë. Balsha II nxitoi të kundërshtonte turqit, por qëndresa e tij u thye pranë lumit të Vjosës. Duket se pas fitores së otomanëve zotët feudalë kryesorë shqiptarë e njohën sovranitetin e Sulltanit”.<sup>13</sup>

Në veprimtarinë politike, prijësit shqiptarë u dalluan për qëndrime pragmatiste në mbrojtje të interesave të ngushta. “Është e vërtetë se ajo që i ka munguar më tepër shqiptarit ka qenë aftësia për t’i parë punët nga këndi i gjerë, nga ana publike dhe gjenerale, për të mos e ndarë veten e tij nga kolektiviteti. Ai ka qenë kurdoherë ekskluziv, as fare me pamje shoqërore”.<sup>14</sup> “Skënderbeut iu desh të shtypte edhe me dhunë kundërshtimin e një numri bujarësh të mëdhenj, të cilët të pakënaqur nga politika e përqendrimin të pushtetit filluan të largoheshin nga Lidhja Shqiptare dhe të kërkonin mbështetjen e Venedikut, të Napolit, ose të kalonin në tradhti, duke u bashkuar me turqit osmanë. Me ndërhyrjen në zotërimet e bujarëve të tjerë dhe me luftën kundër bujarëve separatistë, Lidhja e Lezhës po e humbte kuptimin e vet të mëparshëm. Vendin e saj po e zinte shteti shqiptar, që po merrte përherë e më tepër karakterin e një shteti të përqendruar dhe që erdhi duke u forcuar. Megjithatë, ky shtet nuk arriti të shtrihej në të gjitha krahinat e

Shqipërisë. Madje, dy nga bujarët më të mëdhenj të vendit, Dukagjinët dhe Arianitët, ruajtën të drejtën si sundimtarë më vete”.<sup>15</sup>

Fragmentarizimi i brendshëm dhe politikëbërja individualiste kushtëzuan ndarjen në dy rryma të kampit të rezistencës kundër pushtuesve otomanë, në vasalistët dhe skënderbegasit. Njerëz shumë të afërt të Skënderbeut, që kishin luajtur një rol të rëndësishëm në luftën anti-osmane, si nipi i tij Hamza Kastrioti, gjeneralë si Moisi Golemi, Stres Balsha etj., u shkëputën me radhë nga Skënderbeu dhe ishin për pranimin e vasalitetit dhe ruajtjen e vendit nga shkatërrimet e luftës.<sup>16</sup> “Në pritje të afatit (të dorëzimit të kështjellës së Beratit nga forcat osmane, E.L.), Skënderbeu u nis për të pushtuar një kështjellë aty afër. Moisi Golemi në brezin lindor lejoi një ushtri prej 40 000 vetash të kalonte nëpër fushën e Korçës e të dilte në Berat. ...Kur Skënderbeu e Gjergj Arianiti u kthyen për t’i ndihmuar, ishte tepër vonë. Beteja e Beratit ishte disfata e dytë, pas Sfetigradit. ...Djali i motrës, Gjergj Balsha, u dorëzoi osmanëve kështjellën e Modricës. Në vitin 1457 Hamzai kaloi në anën e osmanëve, meqënëse i humbi shpresat për t’i zënë vendin Skënderbeut, ku ai u bë me trashëgimtar”.<sup>17</sup> Rryma tjetër, e kryesuar nga Skënderbeu dhe përkrahësit e tij më besnikë ishte për rezistencë të armatosur antiosmane “në aleancë me popujt ballkanikë” me princin e Malit të Zi, Cernojeviq, hungarezët (Janosh Huniadin), Papatin dhe peshkopin e Ohrit. ...Mbas vdekjes së tij (Skënderbeut, E.L.) rezistenca luftarake u dobësua vazhdimisht derisa të gjitha territoret shqiptare ranë nën sundimin osman. Kjo ndarje politike shënoi një moment tjetër të rëndësishëm në krijimin e dy traditave themelore në mendimin politik shqiptar deri në ditët tona: nga rryma e “skënderbegasve” vijoi tradita e bashkëpunimit me “popujt e Ballkanit” kryesisht sllavët dhe grekët “kundër armikut të përbashkët”..., ndërsa nga rryma e “vasalistëve” vijoi tradita e “pranimit” të pushtetit osman, e integritetit në jetën politiko-ushtarake të saj, e karrierave të bujshme, e fushatave

<sup>11</sup> Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu, Xhevair Lleshi. *Historia e popullit shqiptar. Klasa XII*. Tiranë: Uegen, 2009, f.61.

<sup>12</sup> Muzafer Korkuti, Petrika Thëngjilli etj. *Historia e popullit shqiptar: për klasën e katërt...*, f. 62.

<sup>13</sup> Stavro Skëndi. *Zgjimi kombëtar shqiptar: 1878-1912*. Tiranë: Phoenix, 2000, f. 17.

<sup>14</sup> Artan Puto. “‘Feja e shqiptarit është ‘shqiptaria’: mit apo konstrukt historik”, *Përpjekja*, viti VI, nr.15-16, Tiranë janar-dhjetor 1999, f. 33.

<sup>15</sup> Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu, Xhevair Lleshi. *Historia e popullit shqiptar. Klasa XII...*, f. 75.

<sup>16</sup> Hysamedin Feraj. *Skicë e mendimit politik shqiptar*. Tiranë: Pegi, 2006, f. 45.

<sup>17</sup> Muzafer Korkuti, Petrika Thëngjilli etj., *op.cit.*, f. 68.

kundër grekëve e sllavëve etj., nga u krijua elita e mëvonshme kulturore-administrative dhe ushtarake shqiptare dhe nga lindi nacionalizmi shqiptar.<sup>18</sup>

Nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik, vendosja e sistemit të timarit i ktheu tokat e banuara nga shqiptarët në pronësi të sulltanit. Kjo politikë cenoj pushtetin e aristokracisë vendëse. “Duke e shpallur tokën si pronë shtetërore, kryezotët feudalë dhe institucionet fetare u zhveshën nga e drejta e pronësisë. ...u rëndua edhe gjendja e fshatarësisë me rritjen e numrit e të madhësisë së detyrimeve”.<sup>19</sup> “Brenda këtij sistemi dalloheshin tri kategori pronësie: timaret, ziametet dhe haset, të përhapura gjerësisht në viset shqiptare. Këto toka u jepeshin në zotërim feudalëve ushtarakë osmanë, të cilët duhej t’i shërbenin sulltanit. Por, tokat punoheshin nga fshatarët rajë, që duhet të paguanin një numër taksash e detyrimesh për shtetin osman dhe për zotëruesit e timareve, të ziameteve dhe të hasave. Me zgjerimin e sistemit të timarit u rrit shfrytëzimi ekonomik i shqiptarëve. Njëkohësisht nga Shqipëria nxirreshin forca të shumta njerëzore për nevojat ushtarake të Perandorisë”.<sup>20</sup>

Gjatë periudhës osmane, u përmirësua gjendja ekonomike e popullsisë në zonat urbane, falë zhvillimit të zejtarisë, tregtisë së brendshme e të jashtme. “Qytetet ishin kthyer në qendra prodhimi e shkëmbimi. Këtë veçori ua jepte pazari (çarshia). Në Shkodër, në Berat, në Elbasan e Prizren kishte tregje të mbyllura (bezistane), ku ruheshin e shiteshin mallrat e shtrenjta, bizhuteritë. Në fushën e prodhimit zejtar u ndie një rritje e llojeve të zejeve. Në shek.XVI kishte 40 lloje, dhe në shek.XVIII, 80 lloje zejesh. Ndër zejet kryesore ishin: lëkurëpunuesit, metalpunuesit, rrobaqepësit, mëndafshpunuesit etj. Zhvillimi i prodhimit e bënte të domosdoshme përpunimin dhe zgjerimin e rregullave që kishin lindur më parë. Zejtarët e tregtarët shqiptarë u bashkuan në disa organizata të quajtura esnafe, të cilat ishin të

<sup>18</sup> Feraj, *op.cit.*, f. 45-46.

<sup>19</sup> Petrika Thëngjilli. *Historia e popullit shqiptar: 395-1875*. Tiranë: Toena, 2000, f. 134.

<sup>20</sup> Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu, Xhevair Lleshi. *Historia e popullit shqiptar. Klasa XII...*, f. 91-92.

ndara sipas besimeve. ...Në këtë kohë mori zhvillim tregtia e jashtme. Tregtarët shqiptarë lidhnin Evropën Perëndimore me trevat e brendshme të Ballkanit. Lidhjet me tregtarët e huaj kishin arritur deri atje, sa të krijoheshin shoqëri të përbashkëta të tregtarëve vendës e të huaj. ...Nga viset shqiptare eksportoheshin prodhime blegtorale e bujqësore dhe importoheshin prodhime manifakture dhe industriale”.<sup>21</sup>

Dëshmi të trashëgimisë kulturore osmane në viset shqiptare vërehen te ndërtimet në arkitekturë dhe në infrastrukturë. “Në shek.XVI-XVII u ndërtuan shumë xhami, mesxhide (xhami pa minare), teqe, medrese etj., si xhamia e Bajazitit II në Berat, xhamia e Mirahorit në Korçë, xhamia Mbret në Elbasan, xhamia e Mehmet Pashës dhe ajo e Sirian Pashës në Prizren etj. Gjatë shek.XVII u ndërtuan edhe disa kisha”.<sup>22</sup> “...piktura nuk e ndërpreu zhvillimin e saj. ...xhamitë u zbuluan me disa arabeske dhe me kaligrafi arabe që pasqyronin citate nga Kur’ani. Kishat vazhdonin të zbukuroheshin me piktura murale dhe ikona”.<sup>23</sup> Tipar i urbanizimit oriental janë edhe objektet e shërbimit publik, si çekma e hamame dhe ndërtimet e kullave të sahateve. “Në shek.XVIII rritja e rolit ekonomik të qyteteve ...pati si pasojë përmirësimin e infrastrukturës rrugore si dhe ndërtimin e një numri të madh urash guri. Të tilla janë: Ura e Mesit (Shkodër), Ura mbi Osum në Berat, Ura e Urakës (Librazhd) etj.”<sup>24</sup>

Në aspektin fetar, gjatë periudhës osmane mori një përhapje të gjerë besimi islam në viset shqiptare. Përqafimi i fesë islame në radhët e shqiptarëve u realizua gradualisht dhe në mënyrë të vullnetshme. “Në fillim islamizmi u pranua nga një pjesë e aristokracisë shqiptare”.<sup>25</sup> Ajo synonte të ruante pronësinë mbi tokën nën institucionin osman të timarit. Për më tepër, konvertimi në islam konsiderohej si një mjet për të përfutur nga mundësitë dhe avantazhet e panumërta që

<sup>21</sup> Muzafer Korkuti, Petrika Thëngjilli etj., *op.cit.*, f. 82-83.

<sup>22</sup> Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu etj. *Historia e popullit shqiptar. Klasa XII...*, f. 110.

<sup>23</sup> Muzafer Korkuti, Petrika Thëngjilli etj., *op.cit.*, f. 102.

<sup>24</sup> Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë. *Historia e popullit shqiptar, V. I*. Tiranë: Toena, 2002, f. 714.

<sup>25</sup> Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu etj. *Historia e popullit shqiptar: për klasën e 9-të...*, f. 33.

ofronte Shteti Osman, pasi baza ekonomiko-politike e perandorisë ishte feja dhe jo nacionaliteti.<sup>26</sup>

Përhapja masive e islamit u kushtëzua nga një sërë faktorësh. Studimet historike, përfshirë edhe tekstet shkollore të historisë, nuk marrin parasysh ndikimin e kolonizimit turk në tokat shqiptare, si një element me rëndësi për konvertimin fetar. “Sikurse del nga defterët e hershëm të administratës shtetërore osmane, në Shqipëri, kolonët turq u prunë kryesisht nga Konja dhe Saruhani të Azisë së Vogël, ata u vendosën në afërsi të kalave ku ndodheshin garnizone turke, si rreth e rrotull Krujës, Gjirokastrës, Dibrës e gjetkë. Por, ... kolonizimi turk në Shqipëri nuk pati sukses siç ndodhi pjesërisht në disa vise të Thrakës, Bosnjës, Kosovës, Maqedonisë, Vllahisë. ... Për ideologët islamë, përqafimi ka qenë i vullnetshëm, mbasi ata pretendojnë se feja islame me epërsinë ideologjike, filozofike dhe morale që ka përballë feve të tjera, krijon bindje sapo njihesh me të. Përkundrazi, për historianët objektivë, rrënjët e konvertimit duhen kërkuar në dy drejtime: në radhë të parë, te degradimi ideologjik dhe institucional që pësuan të dy ritet e fesë së krishterë nga presioni i shtetit osman, dhe e dyta, nga diskriminimi politik, juridik dhe fiskal që ushtroi Perandoria Osmane ndaj të krishterëve ...”.<sup>27</sup>

Në tekstet shkollore të historisë, përhapja e islamizmit në tokat shqiptare argumentohet si rrjedhojë e sistemit të edukimit të djemve të familjeve të krishtera shqiptare në pallatin e sulltanit, presionit që ushtrohej nëpërmjet taksës së xhizjes të cilën e paguanin vetëm për të krishterët, mosmarrëveshjeve ndërmjet kishës katolike dhe asaj ortodokse, si dhe mungesës së një kishe të vetme kombëtare.<sup>28</sup>

Islamizimi i shqiptarëve ishte një proces relativisht i gjatë që filloi individualisht aty kah shek.XV dhe përfundoi masivisht në fund të shek.XVII. Duke qenë i tillë ky fenomen i ka specifikat e veta në kohë

dhe në hapësirë.<sup>29</sup> Në malësinë e veriut, shqiptarët përqafuan fenë islame për arsye pragmatiste, si përmirësimi i gjendjes ekonomiko-shoqërore, dhe dobësisë organizative e paaftësisë teologjike të klerit katolik. Popullsia e zonave fushore të Shqipërisë qendrore ishte më tepër e ekspozuar ndaj ndikimit osman. Ndërsa në jug, shqiptarët ortodoksë ishin nën varësinë e Patrikanës së Stambollit, e cila gëzonte një pozitë të veçantë në sistemin shtetëror të Perandorisë Osmane. “Më shpejt islamizimi u përhap në qytetet shqiptare, që ishin qendra administrative dhe ushtarake. Kështu në qytetin e Shkodrës numëroheshin në atë kohë 26 shtëpi myslimane, në Pejë e Vuçiternë nga 33 të tilla, në Prishtinë 51, në Tetovë 41 etj. Në qytete të tjera, si Berati, Elbasani etj., islamizmi filloi të përhapej gjerësisht në radhët e popullsisë vetëm gjatë gjysmës së dytë të shek.XVI. ... Kurse në popullsinë fshatare, deri në fund të shek.XVI, islamizmi u përhap me ritme të ngadalshme. Këto ritme u ndryshuan në shek.XVII, kur pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare, rreth dy të tretat e saj, mori fenë islame”.<sup>30</sup>

Në tekstet e historisë të ciklit shkollor 9-vjeçar dhe parauniversitar paraqitet pikëpamja se “islamizimi i popullsisë shqiptare ... u bë faktor i rëndësishëm për t’i shpëtuar asimilimit grek e sllav”. Konvertimi i shqiptarëve në islam i shërbeu presionit të sllavizimit në veri dhe hellenizimit në jug. Ashtu si serbët dhe grekët e përdorën fenë si një mjet ideologjik në procesin e ndërtimit të kombit, edhe shqiptarët islamën e përqafuan ... për të krijuar dimensionin fetar të identitetit etno-kulturore dhe politik shqiptar”.<sup>31</sup> Për më tepër, studiuesi D. Egro thekson domosdoshmërinë e trajtimit të kompleksitetit të rrethanave që kushtëzuan përhapjen e islamit në viset shqiptare. Sipas tij, Islami “nuk erdhi vetëm në trajtë njëdimensionale, pra thjesht dhe vetëm si një fe e re, e cila me kohë u përhap masivisht, por falë ardhjes së organizuar dhe si një nga shtyllat mbi të cilat ngrihej Shteti Osman. Islami e pa-

<sup>29</sup> Muhamet Mala. “Konvertimi dhe toleranca fetare te shqiptarët gjatë sundimit të Perandorisë Osmane”, *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike, 38, 2008, f. 202.

<sup>30</sup> Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu, Xhevair Lleshi. *Historia e popullit shqiptar. Klasa XII...*, f. 112.

<sup>31</sup> Egro, *op.cit.*, f. 169.

<sup>26</sup> Egro, *op.cit.*, f. 166.

<sup>27</sup> Kristo Frashëri. *Identiteti kombëtar shqiptar dhe çështje të tjera*. Tiranë: Edisud Spa, 2006, f. 75-76.

<sup>28</sup> Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu, Xhevair Lleshi. *Historia e popullit shqiptar. Klasa XII...*, f. 113.

rashtroi veten në shumë dimensione: fetar, kulturor, në arkitekturë, urbanizim, letërsi, arte etj. Pra ...Islami në viset shqiptare u prezantua si një qytetërim gjithëdimensional”.<sup>32</sup>

Në historiografinë shqiptare, përfshi edhe tekstet shkollore të historisë, vihet theksi te toleranca si “pasuri kombëtare e patundshme, e trashëguar shekull pas shekulli. Me kultivimin e këtij thesari të çmuar, shqiptarët janë dalluar dhe janë shembull për çdo popull në botë”.<sup>33</sup> “...populli shqiptar, megjithëse i ndarë në besime të ndryshme fetare, u tregua tolerant dhe ruajti gjithnjë të përbashkëta gjuhën, traditat, kulturën dhe identitetin e vet kombëtar. Shqiptarët, pavarësisht nga përkatësia fetare, kanë mbajtur lidhjet ndërmjet tyre dhe janë bashkuar gjithnjë kur e kanë kërkuar interesat e atdheut”.<sup>34</sup>

Luftrat shqiptaro-osmane të shek.XV, nën udhëheqjen e heroit kombëtar Gjergj Kastriotit (1405-1468), zënë një vend të veçantë në tekstet shkollore të historisë. Në to, rëndësia e të ashtuquajturës “Epokë e Skënderbeut” trajtohet si vijon: “Me gjithë rrjedhojat negative, lufta antiosmane e shek.XV përbën një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar. Ajo mbrojti lirinë për dekada të tëra dhe e forcoi unitetin kombëtar të shqiptarëve. Në zjarrin e luftës çlirimtare u forcua më tej ndërgjegja kombëtare dhe vetitë tradicionale të shqiptarëve, si dashuria për atdheun dhe lirinë, trimëria dhe guximi në luftën kundër armikut etj. Nën udhëheqjen e Skënderbeut u arrit për herë të parë bashkimi politik i shqiptarëve. Lufta fitimtare kundër pushtuesve osmanë dhe udhëheqësi i saj legjendar, Skënderbeu mbetën edhe për brezat pasardhës simbol krenarie kombëtare dhe shërbyen si burim frymëzimi për bashkimin e shqiptarëve në luftë për rifitimin e lirisë”.<sup>35</sup>

Kjo qasje glorifikon ngjarjet historike dhe figurën e heroit, Gjergj Kastriotit - Skënderbeut. Mision i tij paraqitet qëndresa e armatosur

për të mbrojtur dhe për të çliruar tokat shqiptare nga pushtuesi osman. Një këndvështrim i tillë nuk merr në konsideratë pozitën sociale të udhëheqësit, si posedues i zotërimeve të mëdha feudale, dhe synimet e tij për të ruajtur pronat në kuadër të sistemit osman të timarit. Këtë dobësi të historiografisë kombëtare e ka pranuar edhe prof. Aleks Buda, i cili ka pohuar mungesën e trajtimit të plotë të strukturës ekonomiko-shoqërore të Shqipërisë në shek.XV, e në mënyrë të veçantë ndikimin e saj mbi luftën shqiptaro-osmane.<sup>36</sup>

Për të identifikuar përkatësinë evropiane të qytetërimit shqiptar i kushtohet vëmendje rëndësisë ndërkombëtare që pati lufta antiosmane në shek.XV. Heroi kombëtar, Skënderbeu, iluminohet me apelativin “Athleta Christi”, si mbrojtës i krishtëritimit dhe lirisë së vendeve të Evropës. “Qëndresa heroike dhjetëravjeçare e shqiptarëve kundër ushtrive të Perandorisë Osmane, kur ajo ishte në kulmin e saj, e pengoi vërshimin osman drejt Italisë dhe Evropës. Në këtë mënyrë ajo mbrojti jo vetëm lirinë e vendeve të Evropës Perëndimore, por edhe zhvillimin dhe përparimin e gjithanshëm të tyre. Kjo luftë e bëri mjaft të njohur Shqipërinë në Evropë dhe në botë dhe i zgjeroi lidhjet e saj me vendet e tjera”.<sup>37</sup>

Veprimtaria politike, ushtarake e civilizuese e udhëheqësit u fetishizua postmortum në memorien kolektive dhe historike të shoqërisë në mbarë botën. “Kujtimi i tij mbeti gjithnjë i gjallë nëpër këngët, gojëdhënat e tregimet e shumta popullore që i dhanë atij tiparet e një figure legjendare”.<sup>38</sup> “Për hir të veprës së tij madhështore, Gjergj Kastrioti Skënderbeu ka hyrë në radhët e kolosëve të historisë, shkëlqimin e të cilëve rrjedha e shekujve e ka ndriçuar më tepër. Grafiku i veprave historike dhe letrare kushtuar personalitetit të Skënderbeut dhe luftës që ai udhëhoqi vazhdimisht është rritur. Dëshmi është vendi i rëndësishëm që kanë zënë në historiografinë evropiane emri dhe

<sup>32</sup> *Ibid*, f. 176.

<sup>33</sup> Mark Krasniqi. *Toleranca në traditën shqiptare*. Prishtinë: Akademia e Shkençave dhe e Arteve të Kosovës, 2007, f. 9.

<sup>34</sup> Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu, Xhevair Lleshi. *Historia e popullit shqiptar. Klasa XII...*, f. 113.

<sup>35</sup> *Ibid*, f. 87-88.

<sup>36</sup> Aleks Buda. *Studime historike*. Prishtinë: Akademia e Shkençave dhe e Arteve të Kosovës, 2006, f. 265.

<sup>37</sup> Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu, Xhevair Lleshi. *Historia e popullit shqiptar. Klasa XII...*, f. 88.

<sup>38</sup> *Ibid*, f. 89.

vepra e tij. Jo vetëm për nga numri i veprave të botuara, por edhe për nga vlera e tyre e brendshme, çdo shekull e ka tejkaluar shekullin e mëparshëm. Në ditët tona, historiografia skënderbegiane ndodhet në lulëzimin e saj të plotë. Rruga që ajo ndoqi deri në ditët tona përbën një histori më vete. Një histori që ka filluar gati pesë shekuj më parë”.<sup>39</sup>

Heronjtë i lindin kërkesat historike. Përpara detyrave të reja të mëdha të epokës, populli shqiptar lindi heroin e vet, Skënderbeun.<sup>40</sup> “Atij i duhej të hynte në laboratorin e shndërrimit të historisë në mit. Rreth figurës së tij ...u mbështollën bashkë faktet historike, të vërtetat, gjysmë të vërtetat e sajimet. Skënderbeu u bë hero kombëtar, ndonëse në të vërtetë veprimtaria e tij s’i kishte përfshirë asnjëherë të gjithë shqiptarët - ajo s’ishte shtrirë as në Kosovë, as në pjesën më të madhe të jugut të vendit”.<sup>41</sup>

Tekstet shkollore të historisë përshkohen nga nota të forta nacionaliste e romantike në paraqitjen e periudhës osmane në viset shqiptare. Glorifikimi i qëndresës së shqiptarëve kundër pushtuesit osman, me rëndësi për lirinë dhe progresin brenda e jashtë vendit, dikton nevojën e historiografisë kombëtare për “dekonstruktimin e miteve, që nuk nënkupton assesi mohimin e tyre”.<sup>42</sup> “Miti i jep ekzistencë kolektive një dimension të përkohshëm, ai rrënjës në anëtarët e një komuniteti një të kaluar, e cila mund të jetë e pasaktë, por që ndjehet si autentike, gjithashtu ai u jep atyre sensin e një të ardhmjeje të përbashkët. ...përdërisa miti është një aspekt i ekzistencës kolektive, ai formon një pjesë të teorive të veprimit kolektiv. Mitet ndihmojnë për të mbështetur kombet dhe për këtë arsye vetë kombet mbështeten te mitet. ...Në këtë aspekt mitet kontribuojnë në krijimin e identitetit, duke përcaktuar kufijtë e këtij identiteti, duke bashkuar me njëri-tjetrin anëtarët e kombit, duke përjashtuar ata që nuk konsiderohen si të tillë,

<sup>39</sup> Flamur Hadri. *Skënderbeu në historiografinë evropiane*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1998, f. 156.

<sup>40</sup> Buda, *op. cit.*, f. 262.

<sup>41</sup> Piro Misha. “Fenomeni nacionalizëm dhe kriza shqiptare”, *Përpyjekja*, viti VI, nr.15-16, Tiranë janar-dhjetor 1999, f.25.

<sup>42</sup> Puto. “Fryma romantike dhe nacionaliste ...”, f. 15.

nëpërmjet krijimit të botëkuptimeve kolektive, me anë të të cilave individët njohin vetveten dhe bashkëkomunitarët e tyre”.<sup>43</sup>

Ky konstrukt historik për zgjidhjen e çështjes kombëtare u ndërtua nga ideologët e periudhës së Rilindjes (vitet ’30 të shek XIX - 1912). Ajo vlerësohet “një epokë e ndritur historike. Rilindja Kombëtare Shqiptare çoi përpara trashëgiminë më të mirë të shekujve të kaluar, traditën e çmuar morale dhe politike, me të cilën ngjalli krenarinë e shqiptarëve në luftën çlirimtare të kombit dhe një mbështetje historike e kërkesave të ligjshme, për të vënë në podin e nderit historinë dhe epokat e mëdha, ku kishte ecur Shqipëria”.<sup>44</sup>

Retorika romantike-nacionaliste e Rilindjes krijoi “shqiptarizmin”, konsakruar në devizën “Feja e shqiptarit është shqiptaria”.<sup>45</sup> Elita intelektuale nuk mund ta përdorte fenë për vizionin e saj kombformues. Në sistemin shtetëror osman, etniciteti përcaktohej mbi bazën e përkatësisë fetare. “...Porta e Lartë e njëjësonte kombësinë me fenë, d.m.th myslimanët i quante “turq”, ortodoksët “grekë” dhe katolikët “latinë”.<sup>46</sup> Kjo politikë kushtëzoi ideologjinë nacionaliste t’i paraqesë shqiptarët si “popull jo shumë fetar”.<sup>47</sup>

“Duke filluar nga shek.XIX ka pasur përpjekje të vazhdueshme për ta neutralizuar praninë e përçarjeve fetare si pengesë për politikën e identitetit kombëtar shqiptar. Derisa asnjë nga besimet nuk ishte në pozita të bashkonte të gjithë shqiptarët në një platformë fetare, i vetmi mjet mbeti gjuha; gjuha shqipe shumë e dallueshme nga gjuhët e fqinjëve të afërt (sllavë dhe grekë), ishte i vetmi faktor që mund të zbuste ndryshimet ndërmjet feve dhe identiteteve të ndryshme fetare”.<sup>48</sup>

<sup>43</sup> George Schopflin, “Natyra e mitit: Disa aspekte teorike”, *Përpyjekja*, viti VI, nr.15-16, Tiranë janar-dhjetor 1999, f.9.

<sup>44</sup> Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu, Xhevair Lleshi. *Historia e popullit shqiptar. Klasa XII...*, f. 121.

<sup>45</sup> Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu etj, *Historia e popullit shqiptar: për klasën e 9-të...*, f. 42.

<sup>46</sup> *Ibid*, f. 39.

<sup>47</sup> Puto. “Fryma romantike dhe nacionaliste ...”, f. 29.

<sup>48</sup> Ger Duijzings. “Qerbelaja e Naim Frashërit: Feja dhe politika në Shqipëri”, *Përpyjekja*, viti VI, nr.15-16, Tiranë janar-dhjetor 1999, f.45.



Në këtë drejtim, për përparimin kulturor dhe konsolidimin e ndër-gjegjes kombëtare, detyrë thelbësore mbetej përcaktimi i alfabetit për shkrimin e gjuhës shqipe. “Duke iu rikthyer vizionit nacional-romantik të mbështetur mbi triptikun komb-gjuhë-qytetërim, partizanët e alfabetit latin, partizanët e konstruksionit kombëtar ...e stolisnin alfabetin e “tyre” me cilësor që ishin sinonime të progresit dhe të qytetërimit. Alfabeti latin ...ishte mënyra me anë të së cilës gjuha dhe kombi shqiptar mund të vihehin në rrugën e kulturës dhe të qytetërimit, me qëllim që të arrihej “koncerti i kombeve evropiane”.<sup>49</sup> Kjo pikëpamje diktoi veprimtarinë e Kongresit të Manastirit (1908), që “ripohoi edhe njëherë vendosmërinë e shqiptarëve për të mbrojtur individualitetin e tyre kombëtar, kundër orvatjeve të xhonturqve për t’u imponuar alfabetin arab dhe për t’i identifikuar ata me turqit”.<sup>50</sup>

Fryma romantike-nacionaliste përshkoi edhe Lëvizjen Kombëtare Shqiptare (1878-1912). Vonesa e saj, në krahasim me lëvizjet e popujve të tjerë të Ballkanit, argumentohet si rrjedhojë e faktorëve të jashtëm, kryesisht shtypjes së Perandorisë Osmane. Ky fakt historik nuk i atribuohet “vetëm përkatësisë së njëjtë fetare të shqiptarëve me popullsinë turke të PO, por edhe “alergjisë” së Fuqive të Mëdha evropiane për një shtet me popullsi myslimane në Evropë. Kjo platformë u shfrytëzua edhe nga qarqet nacionaliste të krishtera ballkanike, të cilat në këtë mënyrë justifikonin copëtimin dhe aneksimin e trojeve shqiptare midis tyre, si e vetmja rrugë për të penguar mbijetesën e Turqisë në Ballkan”.<sup>51</sup> Në tekstin “Historia e popullit shqiptar” (2001) për shkollën e mesme të përgjithshme, rrethanat që kushtëzuan formimin e shtetit të pavarur shqiptar analizohen, si vijon: “Pavarësisht se lufta e popullit tonë nuk arriti të sinkronizohej me luftën e popujve të tjerë të robëruar të Perandorisë Osmane në gadishullin tonë, jo për fajin e tij, nuk mund të mohohet kurrësi ndihmesa e këtyre kryengritjeve në fu-

shat e betejave, për shembjen e sundimit osman në Ballkan. ...Shpallja e Pavarësisë shqiptare nuk ishte thjesht fryt i kombinacioneve diplomatike të Fuqive të Mëdha. Pa mohuar rolin e faktorëve ndër-kombëtarë në njohjen e pavarësisë së Shqipërisë, duhen vënë në pah, në radhë të parë, ndihmesa dhe roli i luftërave të popullit shqiptar në afrimin dhe përgatitjen e situatave të favorshme, që bënë të mundur shtrimin dhe zgjidhjen e çështjes shqiptare. Kjo duhet pasur parasysh jo vetëm përkundrejt pushtuesve osmanë, por edhe përballë synimeve shoviniste të monarkive ballkanike dhe synimeve të Fuqive të Mëdha që qëndronin pas tyre”.<sup>52</sup>

Në tekstet e historisë së ciklit shkollor 9-vjeçar dhe parauniversitar, periudha osmane në viset shqiptare trajtohet me këndvështrimin manikeist, d.m.th ndarjen përkatësisht “në të mirë dhe në të këqij” të marrëdhënieve me Perëndimin dhe Lindjen. Ky fakt evidencohet edhe në vlerësimin për Shpalljen e Pavarësisë. “28 Nëntori i vitit 1912, shënon një kthesë historike për popullin shqiptar, sepse nga njëra anë mori fund sundimi gati pesëshekullor i Perandorisë Osmane, nga ana tjetër u krijuan edhe kushte të reja politike për të dalë nga prapambetja e madhe, në të cilën e kishte lënë vendin sundimi i huaj dhe për zhvillimin e tij më të shpejtë ekonomik, shoqëror e kulturor”.<sup>53</sup>

Kjo qasje manikeiste e periudhës osmane, e cilësuar si “obskurantizmi turk”, lë në errësirë historinë 500-vjeçare të bashkëjetesës shqiptaro-osmane. Një pikëpamje të tillë ndan edhe vetë arkitekti i Shpalljes së Pavarësisë, Ismail Qemali: “Që nga ajo kohë (vdekja e Skënderbeut), megjithëse shqiptarët asnjëherë nuk kanë humbur dëshirën pasionante për pavarësi, ata kanë qenë i vetmi popull i Ballkanit me të vërtetë i lidhur me Perandorinë Otomane, gjithmonë të gatshëm për ta mbështetur atë, gjithmonë të lumtur që ndihmonin fuqizimin e saj dhe përfitonin nga ky fuqizim”.<sup>54</sup> Për rrjedhojë, “mosperceptimi i kësaj

<sup>49</sup> Nathalie Clayer. *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*. Tiranë: Botime Përpjekja, 2009, f. 583.

<sup>50</sup> Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë. *Historia e popullit shqiptar, V. II*. Tiranë: Toena, 2002, f. 394.

<sup>51</sup> Frashëri, *op.cit.*, f.130.

<sup>52</sup> Muzafer Korkuti, Petrika Thëngjilli etj., *op.cit.*, f. 164-165.

<sup>53</sup> Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu, Xhevair Lleshi. *Historia e popullit shqiptar. Klasa XII...*, f. 161.

<sup>54</sup> Noel Malcolm, “Mitet e identitetit kombëtar shqiptar”, *Përpjekja*, viti VI, nr.15-16, Tiranë janar-dhjetor 1999, f.193.

periudhe historike që zgjatet nga shek.XV deri në shek.XX si histori e një province të Perandorisë Osmane, por përkundrazi, si një histori e mirëfilltë pushtimi që mohonte bashkëjetesën dhe fenomenin e integritetit të shqiptarëve në strukturat osmane, natyrisht që në përfundim do të ishte vetëm ‘historia e një populli të lirë, që e shkoi jetën në luftë kundër regjimit osman’.<sup>55</sup>

Nga pikëpamja e metodologjisë shkencore të përdorur, në shkri-min e teksteve shkollare të historisë, vërehet mbizotërimi i stilit narrativ. Mendimi historicist thekson rëndësinë e analizës dhe të interpretimit kritik të fakteve, ngjarjeve dhe personaliteteve historike, me qëllim, që duke njohur të kaluarën të paratregojmë të ardhmen.<sup>56</sup>

### Përfundim

Në tekstet e historisë së ciklit shkollor 9-vjeçar dhe parauniversitar në Shqipëri (2000-2010), prezantimi i periudhës osmane në viset shqiptare përshkohet nga ideologjia nacionaliste e romantike e Rilindjes Kombëtare (vitet '30 të shek.XIX-1912). Historiografia shqiptare ndërton qasjen manikeiste të zhvillimit historik, në fund të shek.XIV - fillim të shek.XX, që mbështetet në përballjen e përkatësisë evropiane të qytetërimit shqiptar me të ashtuquajturin “obskurantizëm otoman”. Nga njëra anë, fetishizohen luftrat shqiptaro-osmane të shek.XV, nën udhëheqjen e Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, si mbrojtëse të krishtërimit dhe të lirisë e përparimit të civilizimit evropian. Nga ana tjetër, anatemohehet Perandoria Osmane si “shkaktare” e përçarjes politike, e prapambetjes ekonomike, e orientalizimit të shoqërisë dhe e trashëgimisë osmano-islame në Shqipëri.

Një qasje e tillë në studimet historike, përfshi edhe tekstet shkollare të historisë, shtron kërkesën për dekonstruktimin e miteve dhe plotësimin e këndvështrimit të njëanshëm të marrëdhënieve shqiptaro-osmane në kuadrin e Perandorisë. Periudha e sundimit pesëshekullor osman në tokat shqiptare nevojitet të parashtrohet si histori e një province të Perandorisë Osmane.

<sup>55</sup> Egro, *op.cit.*, f. 148.

<sup>56</sup> Karl Popper. *Mjerimi i historicizmit*. Tiranë: Onufri, 2003, f. 62.

Esilda Luku

## THE PRESENTATION OF THE OTTOMAN PERIOD IN HISTORY TEXTBOOKS IN ALBANIA (2000-2010)

### (Summary)

“Future glory is born by reviving the past”. This mission is attributed to our national historiography, in particular, history textbooks. Through them we aim at understanding the past in the function of the present. Historical knowledge should help prepare future citizens to become active members of the democratic society. These objectives are achieved when national history is taught objectively and when it is seen as an integral part of the history of other nations, the region, Europe and the world.

أسلدا لوكو

## عرض العصر العثماني في الكتب المدرسية للتاريخ في ألبانيا

(٢٠١٠-٢٠٠٠)

### (خلاصة البحث)

"إن عظمة المستقبل ينبع من إحياء للماضي". إن هذه المهمة الحضارية تعزوعلى التاريخ الوطني، ولا سيما كتب التاريخ المدرسية، و من خلالها يهدف فهم الماضي في ضوء الحاضر والمعلومات والتاريخية الحالية تعمل على اعداد مواطن المستقبل، عضوا نشطا في المنظور التاريخي للمجتمع الديمقراطي. وتحقيق هذه الأهداف عندما يعرف التاريخ الوطني في الواقع والموضوعية، وعندما يتم اعتباره جزءا لا يتجزأ من تاريخ الشعوب الأخرى، والمنطقة وأوروبا والعالم.

## AKTUALITETE

**Mr. Rexhep Suma**

### TERRORIZMI NË MEDIE

Këtë artikull do ta filloja me një thënie të Lari Gosmanit, presidentit të kanalit NBC-news, i cili thotë: “Detyrë e medieëve është përvijësimi apo mbulimi i tyre, por për të thënë të vërtetën....Shumë prej nesh, që punojnë në medie, do të kishin dëshiruar që të jenë të famshëm e të dashur, por më e rëndësishme është që ne jemi të saktë dhe korrektë.... dhe lëri ashklat të bien ku të munden.”<sup>1</sup>

Ndonëse një definim të qartë dhe të saktë lidhur me terrorizmin nuk ka ende, por ajo ka marrë ngjyra politike, fetare dhe nacionale, ashtu siç e definon Europol në raportin e tyre TE-SAT 2007, ku thotë: “Terrorizmi nuk është një ideologji apo lëvizje, por është një taktikë apo metodë për t’i përmbushur qëllimet politike”<sup>2</sup>.

Në raportin e tyre vlerësohet se të gjithë terroristët janë ekstremistë, por jo të gjithë ekstremistët janë terroristë. Një ekstremitet, jo patjetër duhet që në vetvete të përfshijë përdorimin e dhunës me qëllim të destabilizojë seriozisht apo të shkatërrojë politikën fundamentale, ekonomike apo strukturën sociale të një vendi, që kërkohet për një

shkelje ligji të shteteve anëtare. Gjatë historisë njerëzore, me miliona njerëz të pafajshëm janë vrarë si dënim ndaj mosbindjes apo pranimit të bindjeve të caktuara dhe kanë rënë viktimë të ideologjive terroriste dhe gjenocidale.

Vetëm në shekullin XX, të nxitur nga politikën keqbërëse, janë zhdukur në mënyrë të qëllimshme jo më pak se 167.000.000, madje kjo shifër mund të kalojë edhe 175.000.000. Sipas parashtrimit të fakteve që i ka bërë Zbigniev Bzhezinski, vetëm Hitleri ka marrë jetët e 17.000.000 njerëzve, ndërsa Stalini ia ka kaluar garën, duke vrarë 20.000.000 ose 25.000.000 njerëz të pafajshëm, kurse Revolucionari Komunist Kinez ka shkaktuar vdekjen e 29.000.000 njerëzve në Kinë.<sup>3</sup>

Ish-kryeministri anglez, Toni Bler, qartëson se nuk ka alternativë për luftën ndaj këtij rreziku, kudo që ai të ngrejë kokë. Nuk ka kërkesa të negociueshme. Terrorizmi duhet shkatërruar. Edhe Xhon Pilgeri në librin e tij, duke dhënë disa premtime të disa gazetarëve në Perëndim, ka bërë përpjekje të tregojë se tashmë ka mbaruar periudha e gazetarisë së mendimit të lirë. Grupet gazetareske Mardak deri te BBC-ja, lidhur me ligjet e medieëve, nuk kanë ndonjë ndryshim me njëra-tjetrën.

Tashmë janë tejkaluar kufijtë e lajmit, në mënyrë të tillë, që lajmi merret nga një burim dhe ai zmadhohet në mënyrë të padrejtë. Pilgeri, lidhur me metodën e paraqitjes së lajmeve dhe ndryshimet në mediet e Perëndimit, shkruan: “E ardhmja e të gjithë shoqërisë perëndimore shikohet vetëm në një anë”.

Të gjitha raportet, që janë për këtë shoqëri, janë ndryshuar në bazë të interesit që kanë ato për ne. Fjala “ne” është një fjalë e përdorur për fuqitë perëndimore, të cilët kanë mendimin e tyre për terroristët të mirë dhe të këqij, për viktimë me vlerë dhe ato pa vlerë. Kjo e vërtetë nuk mund të jetë shembull, kur disa veprimtari terroriste të përhapura, në disa raste të Al-Kaidës dhe në disa raste të subjekteve të tjera. Është shumë e vogël përballë terrorizmit të organizuar dhe historisë së kolo-

<sup>1</sup> Raphael Cohen-Almagor: “Media coverage of acts of terrorism, Canadian Journal of Communication pg 383, 2005.

<sup>2</sup> www.europol.europa.eu, 2007.

<sup>3</sup> Zbigniev, Bzhezinski: “Jashtë kontrollit”, Elena Gjika, Tiranë, 1995, f. 26.

nizatorëve përëndimorë. Shkrimtari i librit “Mos më thuaj gënjeshtër”, lidhur me politikat amerikane përkundrejt krizës në Irak, shkruan: “Në SHBA, duke u mbështetur te Kushtetuta, duhet të kemi mediet më të lira, heqja e kuptimit të humanizmit botëror, tashmë është bërë normale si një vitaminë dhe për të tjerët, të cilët në të kaluarën e kanë mbrojtur vendin e tyre. Irakianët nuk konsiderohen njerëz, ata janë të pistë dhe të këqij dhe përkundrejt tyre duhet të sillesh keq dhe ata duhet t’i torturosh dhe t’i gjuash.”

Ai, po ashtu, si gazetar shumëvjeçar, duke treguar eksperiencën e tij, e vë theksin në një pikë shumë të rëndësishme të gazetës “New York Daily News”, që shkruan: “Për çdo ushtar amerikan, që vritet në Irak, duhet të varen 20 irakianë.” Dy gazetatat amerikane “New York Times” dhe “Washington Post” kanë luajtur një rol shumë të madh në tregimin e fabrikave të Sadamit, ku nuk kanë shkruar as edhe një artikull të vërtetë, i cili do të vinte në pozitë të vështirë gënjeshtër e Bushit. Megjithatë, shumë organizata, siç janë Euskadi Ta Askatasuna (ETA) dhe Partia Punëtore Kurde (PKK), e cila vetveten e quan Kongra-Gel, që kryejnë sulme më shumë se disa organizata terroriste, nuk janë të etiketuara si terroriste.

Në rast se ato dhe mjaft medie të mëdha, do të paraqitnin në mënyrë të paanshme mashtrimet e Bushit, ndoshta sot do të ishin gjallë dhjetëra mijëra njerëz. Në përgjithësi, libri “Mos më thoni gënjeshtër” është duke bërë përpjekje për të vërtetuar të vërtetat e pathëna në një kohë kur ashtu siç shtohet edhe më shumë shumëllojshmëria e mjeteve të informacionit, aq më shumë rritet dhe fakti, që këto medie vihen në kontrollin dhe në rrethinat e poseduesve të fuqisë dhe të pasurisë.

### Portretizimi i grupeve fetare

Popujt dhe vendet e ndryshme të botës nuk duhet përcaktuar nga feja, përveçse kur një gjë e tillë është shumë e rëndësishme. Fraksionet e veçanta fetare nuk duhet portretizuar sikur bëjnë fjalë për besimin e tyre në përgjithësi. Portretizimet, sipas mësimëve të BBC-së, mund të jenë fyese, veçanërisht në rast se lënë të kuptohet se një fe e

veçantë është armiqësore apo e huaj për të gjithë ata që janë jashtë saj. Për shembull, transmetimi i skenave të aktivistëve islamikë, kur ata demonstrojnë me gjithë fuqinë e tyre, nuk duhet të përdoren për të përshkruar të gjithë botën islame. Termat e tilla, si “fondamentalistë”, “militantë” dhe “islamikë”, duhet të përdoren me kujdes tepër të veçantë. Ai që mund të cilësohet si një përshkrim i saktë i një grupi, mund të mos jetë i vërtetë për të gjitha grupet tjera të ngjashme.<sup>4</sup>

Profesor Brus Hofman nga Universiteti Georgetown shpjegon para kongresistëve amerikanë se si interneti krijon një forum mjaft të favorshëm për terrorizmin global. “Tani, terroristët mund t’u japin drejtim mesazheve të tyre, mund t’i përshtatin ato për cilindo shtresë të popullatës që përpiqen të arrijnë. Për shembull, sot ekzistojnë grupe terroriste, të cilat kanë faqe interneti në 26 gjuhë të ndryshme.”<sup>5</sup> Riza Spahija qartëson se në gjithë botën janë vërtetuar gjithsej 348 sulme terroriste. Shumica e këtyre sulmeve janë kryer kundër interesave amerikane në Amerikën Latine dhe bëhet e qartë se shumica e këtyre sulmeve nuk kanë ndodhur në Lindjen e Mesme apo në vende të tjera islamike. Të përmendim disa nga këto klane terroriste: ‘Ushtria e Kuqe’ në Gjermani, separatistët baskë në Spanjë, Tigrat Tamilë në Sri Lankë, Ushtria Nacionale Çlirimtare në Kolumbi e shumë të tjera, të gjitha këto klane terroriste dhe të tjerë nuk shikohen me të njëjtin nivel tmerri sikur shikohen grupe terroriste me sfond islamik.<sup>6</sup>

### Gjuha dhe terminologjia e medieve dhe e terrorizmit

Gjuha me të cilën mediet raportojnë dhe diskutojnë lidhur me organizatat terroriste dhe aksionet e tyre është tërësisht e rëndësishme, ashti siç gjuha e pranon dhe vendos parametrat e diskursit publik. Frazologjia dhe terminologjia e kryengritësve terroristë dhe e qeverive zyrtare janë vazhdimisht në veprim dhe media tenton të adaptojë fjalët apo frazat e tyre, të cilat në fund do të bëhen të pranueshme si rrugë

<sup>4</sup> “Vlerat dhe standardet e BBC-së”, f. 79.

<sup>5</sup> [www.voanews.com/albanian.11.09.2007](http://www.voanews.com/albanian.11.09.2007).

<sup>6</sup> <http://albpr.org>

për të shprehur atë ide në forumin publik. Pos kësaj, nëse një organizatë terroriste arrin që të nxisë mediet të përqafojnë nomenklaturën e tyre, kjo për ta paraqet një fitore psikologjike shumë të rëndësishme dhe shumë domethënëse.

Studimet e bëra në këtë fushë qartësojnë se relacionet mes terrorizmit dhe medieve janë fokusuar në përgjigjen e medieve ndaj incidenteve terroriste.<sup>7</sup>

Ata në mënyrë të përgjithshme janë pajtuar me atë që relacionet mes terrorizmit dhe massmedieve janë simbiotike dhe se terroristët përdorin mediet si kanal për mesazhe politike, që të përcillet nga target audienca që të plotësojë dëshirat për lajme tërheqëse.<sup>8</sup> Disa studime të tjera theksin e tyre e kanë fokusuar gjithashtu në aspektin politik, legal apo në aspektin psikologjik të marrëdhënieve mes medieve dhe terrorizmit, kurse një pjesë e madhe e tyre injorojnë metodat tjera të analizës.

Kur një gazetar interviston një terrorist, është një shans i mirë që ai pa qëllim -pa dashje adopton nga gjuha romantike (terminologjinë) e të intervistuarit, që shpesh josh gazetarët që pavetëdijshtëm i pranon ato si shembull të këtij fenomeni, ku kemi rrëmbimin e vrasësit të ish-kryeministrit italian Aldo Moro, kur botuesi i gazetës "La Repubblica" vendosi kryetitullin "Ata goditën zemrën e shtetit", frazë e drejtpërdrejtë, e cila shihet që është nga parafrizat dhe deklaratat e Armatës së Kuqe "...ne kemi bartur sulmin në zemrën e shtetit."<sup>9</sup> Po ashtu, është shumë me rëndësi që gazetari t'i kontrollojë ndikimet emocionale gjatë përshkrimit të një incidenti. Janë katër shprehje, si disa emra neutralë për gazetarët për të përshkruar një nga kryengritësit terroristë, si 'terrorist', 'ushtar', 'luftëtar të lirisë', 'kriminel', apo 'gueril' që të gjitha i kërkojnë gazetarit të japë një gjykim moral.

<sup>7</sup> Brigitte Nacos, "Terrorism and the Media" (New York: Columbia University Press, 1994) and Philip Schlesinger, *Media, State and Nation: Political Violence and collective Identities* (London: Sage Publications, 1991).

<sup>8</sup> Nacos, *ibid*, pp.48-53.

<sup>9</sup> Giovanni Bechelloni, "Il Colpo di Stato in Diretta", *La Repubblica*, (17 March 1978) cited in Robin Erica Wagner-Pacifici, *The Moro Morality Play: Terrorism as Social Drama* (Chicago: The University of Chicago Press, 1986) p.90.

Fryma e terrorit fillon që në qelizën bazë të shoqërisë, në familje. Atje nuk duhen kultivuar e lejuar shfaqje të terrorit psikologjik dhe aq më pak të terrorit fizik ndaj pjesëtarëve të familjes, të vegjëleve e të mëdhenjve. Një baba pijanec terrorizon familjen. Një i droguar, gjithashtu. Në institucione, si në shkolla, për rregull e qetësi të njohur, një alarm i rremë, terrorizon qindra veta, që kërkon rregulla të brendshme të forta.

Koncepti terrorizëm lidhet me krimin, me politikën, me synime për të terrorizuar masa popujsh, zonash, kontinentesh, në pamje të ndryshme, për të futur me forcë ide, qëndrime, praktika, politika apo filozofi, duke ia imponuar në shumë forma popujve, pakicave kombëtare e zonave të caktuara. Bota është në zhvillim, në një progres të pandërprerë. Terrorizmi, si një shqetësim serioz, ka qenë dhe është një pjesë e rrezikshmërisë së ekzistencës së saj. Kjo është pamja e përgjithshme. Por, terrorizmi shfaqet edhe nga individë, grupe familjesh, fisesh apo grupime të tjera relativisht të caktuara për të mposhtur në mendime e veprime, në qendra të caktuara, grupime apo individë të tjerë, për t'i imponuar ato, duke i terrorizuar në pamje të ndryshme.

Kryeministri anglez, Bler, duke mbrojtur intervenimin në vendet ku ata mendojnë se ka 'terrorizëm', shprehet se pas këtyre sulmeve ata mbrojnë kulturën dhe vlerat e tyre. "Ne nuk do të kemi sukses vetëm me mjete ushtarake apo sigurimi. Kjo është një sfidë politike. Terrorizmi rekruton anëtarë, duke u bazuar mbi tërheqjen emocionale njerëzore. Prandaj, mund t'i kundërpërgjigjemi vetëm me një lloj kundërtërheqjeje të fortë dhe të përllogaritur mirë", thotë Bleri. Këto vlera janë universale. Ne duhet të sulmojmë të sigurt ideologjinë e ekstremistëve: pikëpamjen e tyre reaksionare mbi shtetin; refuzimin e tyre për të lënë njerëzit të zhvillohen në paqe; pikëpamjet e tyre regressive ndaj grave. Ne duhet të dënojmë jo vetëm metodat e tyre barbare të terrorizmit, por të sulmojmë ndjenjën e tyre të supozuar të padrejtësisë kundrejt Perëndimit. Ne na duhet të mbështesim dhe të ndihmojmë mobilizimin e islamikëve të vërtetë në këtë proces.

Nuk ka asgjë më absurde, se ideja që largimi i talebanëve në Afganistan, apo i Sadamit dhe i djemve të tij në Irak, si dhe zëvendësimi i

regjimeve të tyre me atë të votës së lirë, nën mbikëqyrjen e OKB-së, është në vetvete një sulm ndaj myslimanëve vendës. Ne duhet të tregojmë se ata që po vrasin me terror myslimanët janë në fakt myslimanë të tjerë dhe se duke vepruar kështu ata bien komplet ndesh me mësimet e Kur'anit<sup>10</sup>. Mirëpo, jo të gjithë njerëzit mendojnë sikurse qeveritarët perëndimorë, pasi ekzistojnë zëra më liberalë dhe të arsyeshëm, se duhet të gjendet një gjuhë e përbashkët mes dy civilizimeve dhe ekziston mundësia që të jetohet në paqe dhe qetësi. Një nga ata është edhe Ernesto Sabato, shkrimtar argjentinas me përmasa botërore, i cili flet me dhembje shpirti për dramën, krizën, pasigurinë e të ardhmen e njerëzimit. Dhe, ja si i drejtohet ai një njeriu të thjeshtë: “Do t’ju flisja për çka ndodh sot në botë. Për rrezikun, ku ndodhen të gjithë të pasurit dhe të varfrit. Pikërisht këtë nuk e dinë ata, njerëzit me pushtet. Nuk e dinë se edhe bijtë e tyre gjenden në një situatë të mjerueshme. Nuk mund të zhyteni në depresion, sepse është një luks i tillë, të cilin nuk mund t’ia lejojnë vetes prindërit e fëmijëve që vdesin urie. Dhe, nuk mund të mbyllemi me kyç nëpër shtëpitë tona. Duhet t’i hapemi botës. Mos mendo se shkatërrimi është atje jashtë, por djeg si një zjarr brenda dhomave tona të ngrënies. Jeta dhe toka janë në rrezik”. Dhe, a e dini kujt i drejtohet Ernesto Sabato?! - Të gjithë atyre që janë për një botë të lirë, ku të gjithë duhet patjetër të ndërtojnë një strategji të re me islamin dhe kjo strategji nuk do të jetë një strategji lufte mes dy qytetërimeve e kulturave, por një strategji bashkëpunimi, mirëkuptimi dhe pranimit, duke integruar qytetërimet, kulturat dhe civilizimet mes feve. Ernesto Sabato i referohet në një vend Helder Linin: “...Qeveritë kanë harruar në mbarë botën se qëllimi i tyre është të promovojnë të mirën e përbashkët. Solidariteti luan një rol vendimtar në këtë botë pa krye, përjashtuese, të llojeve të ndryshme. Miliona qenie mbijetojnë heroikisht në mjerim. Ata janë martirët. Në këtë varfërim ekzistencial dhe metafizik, të gjithë janë viktimat të një qielli dhe të një çatie. Banalitetet, ku kalben ndjenjat më fisnike, e degjenerojnë njeriun në një karikaturë patetike, që nuk e gjen më veten

<sup>10</sup> <http://albpr.org>.

në të qenit njeri. Mjerë njeriu që mbështetet vetëm tek arsyeja-shpëtojme hera-herës e mbi të gjitha falë grave, jo thjesht, sepse dhurojnë jetën, por janë ato që mbrojnë këtë specie enigmatike.” Fatkeqësisht që zëri medias në të gjithë këtë vorbull dhe përplasjesh të civilizimeve shumë pak është dëgjuar në kohë dhe hapësirë të duhur, por edhe nëse ka pasur ndonjë reagim medial, ka qenë tepër vonë. Me rrëzimin e kullave binjake, Perëndimi ndërmori një fushatë të egër kundër vetë islamit si fe qiellore, duke e cilësuar këtë fushatë “luftë kundër terrorizmit”. Bile, presidenti Bush, duke iu drejtuar popullit amerikan në lidhje me zbatimin e politikës së jashtme amerikane, në mes të tjerave tha: “Ne duhet të luftojmë ‘boshtin e së keqes,’ ku përfshihen Iraku, Irani dhe Koreja e Veriut”. Pra, që këtu presidenti Bush kishte ndërtuar një strategji sulmi, kryesisht kundër vendeve islamike.

Vrasja e njerëzve të pafajshëm në kullat binjake u dënua nga mbarë opinioni botëror, si nga Lindja ashtu edhe nga Perëndimi. Të vrasësh njerëz të pafajshëm është krim. Organizatat me shtrirje evropiane, sikurse janë IRA dhe ETA, që kanë vepruar dhe që mund të vazhdojnë të veprojnë përsëri në vendet perëndimore, nuk janë organizata terroriste islamike, por organizata të religjionit të krishterë. Megjithatë, për këto dy organizata nuk mund të akuzohet krishterimi se po kryen veprime terroriste ndaj njerëzimit.

Perëndimi ka emërtuar “terrorizëm” vetëm ato vrasje masive që mund të bëjë Al-Kaida në vendet perëndimore, ose organizata të tjera, që fshihen nën këtë emër. Shpeshherë myslimanët janë quajtur nga Perëndimi si fundamentalistë. Sipas kryeministrit i Malajzisë, Mahathir Mohammad, i cili kritikoi sulmet antimyslimane të masmedias perëndimore, del se islami është një religjion paqeje, është një religjion për të gjitha kohët. “Fundamentalizmi është më absurdja e fjalëve. Ajo është e barabartë me ekstremizëm. Në qoftë se ende mësimet e islamit studiohen, atëherë do të jetë e qartë që myslimanët më të mirë janë fundamentalistët. Fondamenti (bazamenti) i islamit është i bazuar në paqen.”<sup>11</sup> Mirëpo, në botën e medias, disa gazetarë janë të detyruar

<sup>11</sup> <http://albpr.org>

që t'i përdorin fjalët që synojnë të jenë jashtë çdo qëndrimi neutral, sikurse janë: kriminel - revolucionar, terrorist - gueril, vrasës - luftëtar lirie, grup - armatë, element subversiv- çlirimtar, gjakderdhje - dëllirje, i çmendur - martir, mercenar - ushtar, kërcënim - paralajmërim, vrasës - hakmarrje, propaganda - komunikata, ekstremist fanatik - antiimperialist i përkushtuar, sulm-operacion, vrasës me para - shembull solidaritetit revolucionar, vrasës - drejtësi revolucionare.

Në fund, si konkludim, fjalët janë më shumë se një simbol i thjeshtë, që bartin një kuptim. Fjalët, po ashtu, influencojnë mendimet dhe limitojnë idetë dhe konceptet që mund të transferohen nga njëri te tjetri. Mediet, gjithashtu, luajnë rolin qendror në informimin e publikut, që fjalët mund të gjykojnë nga shoqëria, që të bëhen të përshtatshme në çdo diskurs të ri. Kjo është e një rëndësie si për kryengritësit terroristë, ashtu edhe për agjencitë shtetërore, ku mediet përdorin gjuhën e tyre për t'i përshkruar aktet e dhunës së motivuar politikisht.

### Intervistat (takimet) me terroristët

Mediet elektronike, në veçanti ato vizive, krahas mbulimit të përditshëm të ngjarjeve ditore, analizave, reportazheve e zhanreve të tjera të gazetarisë elektronike, publikut i ofrojnë edhe takime të drejtpërdrejta apo edhe të menaxhuara me terroristët, të çfarëdo rangu qofshin dhe të çfarëdo nacionaliteti e feje. Mundësia e daljes apo e paraqitjes së tyre me foto, apo edhe vetëm me zë, jep mesazhin e qartë që ata duan ta përçojnë deri tek audienca e caktuar apo target grupi. Mediet botërore u kanë krijuar mundësi dhe hapësirë personave, që nga disa medime cilësohen si terroristë, kurse nga të tjerat cilësohen si luftëtarë të denjë që luftojnë për parime dhe ideale. BBC-ja e sheh të rrugës të intervistojë terroristët vetëm kur në ato raste ata besojnë se interesi i publikut për këtë intervistë është shumë i madh, sesa zemërimi dhe fyerja që mund të shkaktojë ajo te publiku që e përcjell. Por, çdo përpjekje për të zhvilluar një intervistë me një terrorist, apo për-

faqësues të një organizate terroriste, duhet t'i referohet paraprakisht për miratim edhe përgjegjësit të politikës editoriale.<sup>12</sup>

Pra, edhe në kategorizimet e medieve që iu bëjnë krerëve të terroristëve dallojnë nga politikat menaxhuese. Në secilin medium, ku për dikë cilësohet si terrorist, kurse nga disa të tjera jo, kjo më së miri vërehet nga emetimet që i ka bërë rrjeti televiziv botëror "Al Jazeera" kasetave të kreut të Al-Kaidës, Bin Laden, kurse rrjetet tjera vazhdimisht e portretizojnë si kryeterrorist numër një në botë, edhe pse të gjitha faktet flasin se ai është rritur dhe është edukuar në gjirin e tyre. Media e publikon këtë qëndrim në mënyra të ndryshme, drejtpërdrejt apo tërthorazi, pa përjashtuar edhe ndonjë shërbim në kuadër të luftës politike që zhvillohet aktualisht në fushat ekonomike, shoqërore etj. Meqenëse mania e shfaqjet e terrorizmit janë produkt edhe i shoqërisë shqiptare, edhe media shqiptare, këtej e andej kufirit, nuk e ka për gjë të pasqyrojë pamje të terrorizmit, në tërë larminë e tij, pa i bërë demaskimin e duhur kësaj plage me rrezikshmëri të thellë edhe për shoqërinë tonë. Terrorizohen nxënësit e shkollave nga individë të veçantë, prindërit e tyre, qytetarë të tjerë, që nuk kanë asnjë faj, me telefonata mashtruese ose edhe me ndonjë grabitje fëmije. Media nuk ka përse të bëhet pre e propagandës së vet terroristëve, të cilat, për të siguruar mbështetje, u japin veprimeve të tyre karakter fetar.

Tjetër janë çështjet dhe interesat, qofshin edhe nacionaliste të mirëfillta, dhe tjetër është çështja fetare. Janë dhjetëra shkrime e informacione që aktet e organizatave të ndryshme i emërtojnë "terroristë islamikë", siç shihet dendur në medie, siç ka edhe artikuj kundërveprues, si: "Rrënjët dhe djepin e terrorizmit e gjeni te popujt e besimit të krishterë", në gazetën "Rimëkëmbja", 19 tetor, 2004. Në medie jepen materiale, herë-herë jo edhe tipike, për sensacione, pa bërë balancime, debate, pa sjellë edhe informacione që njoftojnë luftën kundër krimit që është i lidhur ose në shërbim të terrorizmit.<sup>13</sup> Shpeshherë mediet verbosen dhe i përshtaten politikës me vetëdëshirë apo qëllime

<sup>12</sup> "Vlerat dhe standardet e BBC-së", f.132.

<sup>13</sup> Dr. Musa Kraja: "Terrorizmi: Aktualiteti dhe lufta kundër Tij", revista "Univers", nr 6, Tiranë, 2005.

të caktuara dhe nuk janë në favor të publikut, duke fajësuar myslimanët e pafajshëm që ata janë terroristë. Zyra e Policisë Evropiane (Europol) publikoi raportin e parë për terrorizmin në vendet e Unionit Evropian. Për çudi, asnjë gazetë dhe medium tjetër evropian nuk i dha rëndësi këtij raporti, i cili tregon se "islamikët", në vitin 2006, kanë kryer vetëm një nga gjithsej 498 sulme terroriste që kanë ndodhur në zonën e EU-së. Vendet evropiane (EU) më të goditura nga sulmet terroriste janë: Franca me 294 dhe Spanja me 148 raste. Por, për habi, në vitet e fundit, "kërcënimi islamik" është bërë temë sensacionale e medieve botërore.

Në të gjitha lajmet mund të dëgjohet dhe të shihet si "myslimanët" u kërcënohen shteteve të cilat marrin pjesë në okupimin e vendeve myslimane. Sipas kësaj, do të mendonim se gazetarët evropianë do të ishin më shumë të lumtur nëse Zyra e Policisë Evropiane (Europol), në raportin e parë, do të shkruante për terrorizmin në vendet e Unionit Evropian.. "Asnjë gazetë ditore suedeze apo lajmet elektronike nuk e përmendën këtë raport. Ky raport është zhgënjim për të gjitha fushatat antiislame", thotë gazetari suedez Kristoffer Larsson.<sup>14</sup> Organizata separatiste baske ETA, udhëheq në këtë listë me 136 sulme terroriste dhe është përgjegjëse për sulmin në Madrid, ku gjetën vdekjen dy persona. Për fat, 497 raste të tjera kaluan pa vrasjen e personave të pafajshëm. Sikur fundamentalistët islamikë të ishin përgjegjës për shumicën e sulmeve terroriste në vitin e kaluar, pa mëdyshje se ky do të ishte një nga lajmet kryesore në të gjitha gazetatat ditore në mbarë Evropën. Një sulm me të vërtetë është shumë i vogël dhe nuk do të ndihmojë në vazhdimin e imazhit të krijuar të "kërcënimit islam". Krah numrit mjaft të vogël të sulmeve, raporti 44 faqesh i Europolit përmban disa faqe kushtuar terrorizmit islamik.

## Paralajmërimet për sulme terroriste

Qeveritarët shpeshherë kanë tërhequr vëmendjen e opinionit publik në fushatën zgjedhore, që të fitojnë pikë kundrejt rivalëve të tyre, duke bërë zhurmë për asgjë. Mandej, disa analistë veprimet e tilla i kanë quajtur si reagim ekstrem me kartën e terroristëve. Kështu, gjatë fushatës presidenciale në SHBA, kryetari Xhorxh W. Bush është akuzuar nga demokratët se ka shtuar masat e sigurisë në vend pa kurrfarë nevojë. Shefi i Sigurisë Kombëtare, Tom Rixh, ka cilësuar se gjendja e gatishmërisë ishte rritur nga disa informacione të reja dhe shumë specifike. Brenda pak ditësh nga shpallja e një gjendje më të lartë gatishmërie, një seri masash të reja sigurie kanë hyrë në fuqi në institucione të ndryshme financiare, që konsiderohen si më shumë të ndjeshme dhe të rrezikuara. Korrespondenti diplomatik i BBC-së, Jonathan Marcus, duke komentuar këtë gjendje, shprehet se shtrohen pyetje mbi ç'informacion u morën këto masa të reja sigurie dhe nëse ato u bazuan në të dhëna të reja apo në informacione që i përkasin të kaluarës, por që janë zbuluar kohët e fundit. Një valë arrestimesh në Pakistan dhe konfiskimi i kompjuterëve kanë treguar se Al-Kaida ka grumbulluar të dhëna të hollësishme për një kohë të gjatë, duke pasur në objektiv disa institucione specifike. Me gjithë shqetësimet në rritje për një sulm të mundshëm të Al-Kaidës në prag të zgjedhjeve presidenciale, administrata e presidentit Bush vendosi të forcojë masat e sigurisë. Megjithatë, drejtori i Sigurisë Kombëtare, Tom Rixh, theksoi se nuk kishte të dhëna për ndonjë sulm të menjëhershëm. Korrespondentët thonë se, duke mos pasur të gjitha të dhënat e shërbimit të zbulimit mbi bazën e të cilave u hodh ky hap, është vështirë të japësh një përgjigje të saktë se pse u rrit gjendja e gatishmërisë në Amerikë. Megjithatë, disa figura kryesore, nga radhët e demokratëve, thonë se presidenti Bush po luan deri në ekstrem me kartën e kërcënimeve terroriste. Sigurisht kjo është një pikë, ku presidenti Bush fiton shumë më tepër poenë, se rivali i tij demokrat, Xhon Kerry. Në një konferencë shtypi, Tom Rixh theksoi se masat e reja u morën si rezultat i

<sup>14</sup> www.iqna.ir



udhëheqjes së presidentit në luftën kundër terrorizmit. Nisur nga dëshitimet e shërbimeve të zbulimit përpara fillimit të luftës në Irak, shumë veta mbetën skeptikë.<sup>15</sup> Përveç kësaj, edhe shumë medie perëndimore kritikojnë ashpër administratën e Bushit, pasi ka bërë hapa shumë të gabuar në luftën kundër terrorizmit. Gazeta italiane "LIBERATION" thotë se impakti i 11-të shtatorit nuk është pakësuar, pesë vjetët e fundit kanë ndryshuar perceptimin tonë të ngjarjeve. Në të vërtetë, shton gazeta, besimi i tërë botës, sa u përket SHBA-ve, ka rënë në mes saj që gazeta e quan udhëheqje shkatërrimtare të Bushit. "Presidenti amerikan po ndihmon ta kthejë planetin në një shesh beteje të gjerë. Gazeta citon sulmet, si ato në Londër dhe në Madrid, si prova se lufta e Bushit kundër terrorizmit ka sjellë të "kundërtën e efektit të dëshiruar."<sup>16</sup>

### Feja si viktimë e terrorit

Mediet, si mekanizma që bartin peshën e informimit sa më objektiv të opinionit, nuk kanë bërë dhe aq që islami të paraqitet në esencën e tij, por me shkrime dhe emisione për qëllime të caktuara kanë deformuar realitetin rreth tij dhe njëherësh mbetet feja më e keqkuptuar në opinionin e gjerë. Mbështetësit e akteve të terrorizmit bartin me vete edhe emrin e forcës politike apo kriminale që përfaqësojnë.

Shkrimtari i njohur i letrave shqipe, që jeton jashtë trojeve shqiptare, Ismail Kadare, mendon se terrorizmi nuk ka sistem vlerash, ku mbështetet. Terrorizmi nuk ka atdhe. Ashtu si qyqja që nuk e ka çerdhen e vet dhe uzurpon çerdhet e të tjerëve, terrorizmi kërkon popuj, vende, ideologji, besime fetare, kauza politike, konflikte racore, acarime etnike, mjerime shoqërore e kështu me radhë, për të lëshuar në to vezët e veta, e për të pjellë pastaj racën e vet - terrorin. Identifikimi i terrorizmit me një popull ose me një grup popujsh, me një çështje madhore, me një besim fetar etj., është një keqkuptim tragjik. Për fat të

keq, ky keqkuptim po ecën dhe po kthehet në faktor të parë, për t'i dhënë terrorizmit atë që nuk e ka - një bazë, një truall, një besim.<sup>17</sup>

Para disa vjetësh, kur u vu bomba në Oklahoma City, kryetitulli i gazetës "Today" e vërtetonte sjelljen e mësipërme. Me fotografinë e një zjarrfikësi që mbante në duar një fëmijë të vdekur, titulli thoshte: "Në emër të islamit". Koha, natyrisht, vërtetoi se bigotëria e tillë dhe supozimet e tilla ishin jokorrekte, pasi doli se ky krim ishte kryer nga Timothy McVeigh, një radikal i djathtë, tashmë i dënua me vdekje. Njësoj kur eksplodoi bomba në metronë e Parisit më 1995, kjo u etiketua si vepër e fanatikëve myslimanë. Një mysliman i Kanadasë, i cili nën akuzën për anëtarësim në grupet terroriste ka qenë i burgosur në Amerikë, deklaroi se është përballur me keqtrajtime të shumta psikike dhe fizike. Maher Arar, i cili ka qenë i burgosur në Amerikë, deklaroi se për shkak të torturave të rënda që janë ushtruar ndaj tij, ai është detyruar të pranojë se është trajnuar në një kamp të terroristëve në Afganistan, në kohën kur ai thotë se asnjëherë nuk ka vizituar Afganistanin. Z. Arar është arrestuar nga forcat e sigurimit amerikan në kohën kur ai kishte udhëtuar drejt Nju-Jorkut. Kanali i **BBC**-së, në këtë raport, thekson se policia kanadeze u ka dhënë informacione të gabuara funksionarëve amerikanë dhe pikërisht këto informacione janë bërë shkak i burgosjes dhe i torturimit të këtij shtetasi kanadez.<sup>18</sup> Ky trajtim, që i bëhet islamit në botë nga disa politikanë, studiues, analistë, medie të shkruara dhe elektronike, në vendet perëndimore është me dashakeqësi, duke e paraqitur islamin si prishës i rendit në botë, si religjion i prapambetur, cinik, që është kundër vlerave, zhvillimit dhe civilizimit perëndimor. Kjo luftë është e organizuar nga persona, grup personash dhe organizma të fshehta që janë armiq jo vetëm të religjionit islam, por edhe i të gjitha religjioneve të tjera të krishtera e më gjerë. Ky qëndrim po mbahet edhe në Kosovë, nga disa medie të shkruara dhe elektronike, nga disa politikanë, gazetarë, analistë e pseudoanalistë etj. Këta po bëjnë lojën, që urdhërohet nga jashtë, duke

<sup>17</sup> Ismail Kadare: "Fetë dhe qytetërimet në mijëvjeçarin e ri", [www.alb-net.com](http://www.alb-net.com), 11.10.2003.

<sup>18</sup> [www.mesazhi.com](http://www.mesazhi.com), 14.11.2007

<sup>15</sup> [www.albnet.gr/world/3gusht.htm](http://www.albnet.gr/world/3gusht.htm)

<sup>16</sup> [/www.bbc.co.uk..09.06.2006](http://www.bbc.co.uk..09.06.2006)

ndezur zjarrin e armiqësisë mes tri religjioneve fetare në Kosovë, ku ka sunduar gjithmonë dashamirësia mes tyre, respektimi i vlerave të religjioneve dhe toleranca ndërfetare. Jo vetëm kaq, por edhe disa nga krerët e udhëheqësve shqiptarë nuk kanë kontribuar në kultivimin e kulturës dhe tolerancës që kanë shqiptarët mes feve që janë të pranishe në shoqërinë shqiptare. Mirëpo, ka edhe shembuj të mirë nga mediet elektronike, ku çmohet feja. Më 15 tetor 2004, në ditën e Ramazanit, Radiotelevizioni Shqiptar njoftoi se në Francë është një komunitet me 5 milionë banorë të fesë islame, të cilët në mënyrë masive dhe të ndërgjegjshme dënojnë dhunën dhe terrorizmin. Por, në të njëjtin njoftim jepen edhe intervista grash të fesë islame, gjithnjë në Francë, që ankohen se nuk është e drejtë të identifikohen me krimin dhe terrorizmin, vetëm se janë myslimanë, pasi ata, myslimanët, janë për paqen, kundër terrorizmit dhe krimit. Terrorizmi dhe krimi nuk kanë pse identifikohen me përkatësinë fetare, sepse kjo gjë ndikon negativisht në mentalitetet dhe psikologjinë e njerëzve.

Presidentit të Shqipërisë, Alfred Moisiu, në Universitetin e Oxfordit mbajti një ligjëratë me temën “Toleranca ndërfetare në traditën e popullit shqiptar”, ku, në mes tjerash, tha se në Shqipëri nuk ka myslimanë të vërtetë, pasi ata vetëm nga lëkura janë myslimanë, ndërsa në përmbajtje janë të gjithë të krishterë. Kjo deklaratë mund t’i japë të drejtën presidentit që më vonë të bëjë konvertimin e të gjithë myslimanëve në të krishterë. Ky është, pra, kërcënimi psikologjik që ka ndikuar shumë në fyerjen e pjesëtarëve të komunitetit mysliman, pasi rëndë ka fyer ndjenjat fetare të tyre. Për presidentin Moisiu më mirë do të ishte, që para pjesëmarrësve të tregojë kulturën e tolerancës që kanë shqiptarët për të gjitha fetë e jo ta fyejë mbi 70% e popullit të vet, të cilin e ka përfaqësuar para intelektualëve evropianë. Në studimin e tij, të cilin e ka realizuar në Britani të Madhe në vitin 1997, Runnymede Trust ka ardhur në përfundimin se “islamofobia është frikë nga islami ose urrejtja ndaj tij. Në vendet perëndimore shekuj me radhë islami është paraqitur si religjion ekstrem dhe i rrezikshëm, ndërsa në dy dekadat e fundit propaganda e këtillë kishte arritur kulmin. Islamofobia është pjesë përbërëse e të gjitha medieve dhe vepron në të

gjitha pjesët e shoqërisë.”<sup>19</sup> Pyetja që shtrohet për fillim është: a është e drejtë që të gjithë myslimanët dhe islami të identifikohen me terrorizëm, vetëm pse disa që e quajnë veten myslimanë kanë bërë ndonjë akt terrorist apo të ngjashëm? Ose: a janë këto akte terroriste ekskluzivitet vetëm i personave me prapavijë ‘myslimane’? Këto pyetje a e kanë arsyeshmërinë e tyre në faktin se, bazuar në burimet e islamit, në Kur’an dhe në Sunnet (thënie profetike), cilido që i bën dëm tjetrit, cilido që e cenon të drejtën e tjetrit, e lëre më cilido që vret të pafajshmin jo vetëm që nuk mund të quhet mysliman, por me vullnetin e Perëndisë ka rregulla të posaçme për ndëshkimin e të tillëve në këtë botë dhe të njëjtët i pret gjykimi i drejtë i Zotit në përjetësi. Pastaj, nëse bazohemi në standarde të njëjta me ato që satanizojnë myslimanët, atëherë përfundimet mund të jenë shokante dhe të papëlqyeshme, duke nxjerrë në pah gjithë hipokrizinë e të logjkuarit të tillë. Se numri i të krishterëve, përkatësisht i atyre me prapavijë krishtere, gjithandej historisë, të cilët kanë bërë aksione terrorizmi dhe masakra të papara në njerëz të pafajshëm, i tejkalon pjesëtarët e cilitdo besim tjetër, kjo nuk është për t’u diskutuar. Shembujt e mëposhtëm do ta dëshmojnë këtë. Mirëpo, përse mediet, autoritetet kishtare, sikur edhe të gjithë misionarët tjerë të krishterë, kurrë nuk përdorin etiketimin ‘terrorizëm kristian’? Përse nuk u binden fjalëve të vetë Jezusit : “Mos gjykoni se do të gjykoheni” ose ‘përse shikoni halën në syrin e tjetrit, kur keni trarin në syrin tuaj’. Do të fillojmë me të famshmin Timothy McVeigh, i cili jo shumë vite më parë, më 1995, hodhi bombën në Oklahoma Citi, duke shkaktuar dëme gjigante dhe humbjen e jetës së shumë njerëzve. Dan Barker me të drejtë shtron pyetjen “Përse Timothy McVeigh nuk quhet terrorist kristian” ? E pra, përse? Ky terrorist, sipas raporteve të FBI-së, ishte i lidhur me grupet e djathta ekstremiste, të cilat në agjendën e tyre kishin tematikë kristiane. Qëllimet e tij ishin të ngjyrosura me bindje dhe ide të krishtera. Gjithashtu, grupi i famshëm racist, Ku Klux Klan, kishte një agjendë biblike në përndjekjen, masakrimin, vrasjen, djegien dhe maltretimin e qindra mijëra ze-

<sup>19</sup> Dr. Murad Hofmann: “Islami në mijëvjeçarin e tretë”, Furkan, Shkup, 2007, f .90

zakëve amerikanë. Ata thirreshin në Bibël dhe besonin të kryenin vullnetin e Jezu Krishtit në këto aksione të tyre. Përse, pra, këta nuk quhen terroristë kristianë dhe Bibla në këtë rast 'libër i terroristëve'? Duke shkuar mbrapa në historinë e këtyre afro-amerikanëve të shtypur për një kohë të gjatë nga të bardhët kristianë amerikanë, ne gjejmë një fakt tjetër zhgënjyes. Skllavërimi i tyre dhe marrja rob nga Afrika ishte iniciuar nga grupe të bardhësh amerikanë, të cilët midis tyre kishin edhe misionarë biblikë. Edhe më zhgënjyes është fakti se këta misionarë kristianë, të cilët gjoja shqetësoheshin për shpëtimin e këtyre zezakëve, ishin krijuesit e absurdit më të madh në histori: krijimit të kishave në bazë ngjyre dhe race. Kështu, deri vonë, zezakët ishin të ndaluar të ndiqnin shërbimet në kishat e të bardhëve. Dhe, shumica e këtyre zezakëve të robëruar dhunshëm ishin myslimanë, të cilët më vonë, nën presionin e terrorit të të bardhëve kristianë, u konvertuan në të krishterë. Përse këta ndërrues të dhunshëm të besimit nuk quhen terroristë dhe fundamentalistë? A ka nevojë këtu të përmenden sulmet terroristë të kryqëzatave, të cilat ishin nisur nën flamurin e dogmave kristiane, gjoja për të çliruar vendet e shenjta nga paganët myslimanë? Është përmendur lufta e pestë botërore më herët, e cila paskësh pasur mundësi të ndodhte kaherë, po qe se myslimanët do t'i bindeshin Kur'anit, gjithnjë sipas propagandës antiislamike. Vallë, kaq naivë të jenë njerëzit e tillë, sa të mos dinë se që të dy luftërat botërore të deritanishme u nisën nga jomyslimanët, përkatësisht nga ata që e konsideronin veten për kristianë, të paktën, e jo nga myslimanët. Pse Hitleri, bie fjala, a ishte mysliman? Hitleri ishte një kristian i devotshëm. Po pra, përbindëshi, i cili ishte strumbullari i Luftës së Dytë Botërore dhe i cili vrau me qindra mijëra njerëz të pafajshëm. Ai nuk ishte mysliman, por një kristian i betuar. Besimi kristian ishte ai që atë e udhëhiqte drejt aksioneve të tilla. Është fakt gjerësisht i njohur se ai thirrej në ide biblike dhe të krishtera, në aksionet e tij famëkëqija. Në vijim do të japim disa fragmente të shkrimeve të tij vetëm sa për ta ilustruar këtë: "Ndjenjat e mia si i krishterë më drejtojnë të Zoti im dhe Shpëtimtari im si një luftëtar. Ato më përkujtojnë mua një njeri, i cili dikur në vetmi i rrethuar vetëm nga disa pasues, i njohu këta çifutë për atë

çfarë në të vërtetë ishin dhe i thirri njerëzit për t'i luftuar ata. Në dashurinë e pafundme si kristian dhe si njeri, unë lexoj nëpërmes pasazheve, të cilat na tregojnë se si Perëndia më në fund u ngrit në madhësinë e tij dhe mori kamxhikun për t'i dëbuar nga Tempulli ata këlysh nepërkash dhe gjarpërinjsh. Sa i tmerrshëm ishte luftimi i tij kundër helmit çifut...<sup>20</sup>

### **Mediet kosovare dhe çështja e terrorizmit (vështrim kritik)**

Terrorizmi është produkt i krimit të organizuar, i politikës së lidhur me këtë krim, aleat i tij, prandaj edhe duhet demaskuar e duhet luftuar bashkë me krimet e të gjitha ngjyrave. Terrorizmi, pavarësisht nga emrat, demagogjitë, nga idetë që përdor në realizimin e objektivave të veta, nga maskimet e komplikuara që bën, ai paraqitet para masës pa ideale, pa fe, pa aspirata të shoqërisë së mirëfilltë demokratike. Media e publikon këtë qëndrim në mënyra të ndryshme, drejtpërdrejt apo tërthorazi, pa përjashtuar edhe ndonjë shërbim në kuadër të luftës politike që zhvillohet aktualisht në fushat ekonomike, shoqërore etj. Meqenëse, mjerisht, mania e shfaqjet e terrorizmit janë produkt edhe i shoqërisë shqiptare, edhe media kosovare, nuk e ka për gjë të pasqyrojë pamje të terrorizmit, në tërë larminë e tij, pa i bërë demaskimin e duhur kësaj plage me rrezikshmëri të thellë edhe për shoqërinë tonë. Në SHBA, kur një grup i vogël terroristësh arritën të godasin superfuqinë e vetme të globit, në simbolin e fuqisë së tyre ekonomike, kullat binjake të Manhatanit, shkaktoi mijëra të vdekur. Vendi ku njëherë e një kohë qëndronin kullat binjake, tashmë ka marrë përmasat e një tempulli mitik për politikëbërësit amerikanë. Ngjarjet e 11 shtatorit, doemos kanë alarmuar edhe mediet kosovare, si ato të shkruara dhe elektronike, të cilat me vëmendje të madhe kishin përcjellë sulmet në kullat binjake. Televizioni i Kosovës dhe televizionet e shumta lokale në Kosovë, gjatë mbrëmjes janë kyçur drejtpërdrejt në rrjetin amerikan CNN me përkthim simultan për të përcjellë njoftimet më të reja

<sup>20</sup> [www.forumishqiptar.com](http://www.forumishqiptar.com)

për sulmet terroriste në Amerikë. Po ashtu, edhe shtypi i Prishtinës shkruan gjerësisht për sulmet e 11 shtatorit 2001. Kështu, "Bota sot" në gjerësinë e tërë faqes së parë ka titullin "Seri aktesh terroriste kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, supozohet për mijëra të vrarë", të cilin e shoqëron me disa pamje të Nju- Jorkut dhe me foto-grafinë e presidentit Bush. Gazeta tjetër "Zëri", në faqen e parë mban titullin kryesor "Sulm terrorist kundër Amerikës", kurse në faqet e brendshme boton reagimet për këto sulme si dhe një koment. Gazeta "Rilindja" tërë numrin (me faqe të zvogëluara) ia kushton këtyre sulmeve, në faqen e parë ka titullin "Sulm terrorist në SHBA" dhe po në faqen e parë boton një koment për këto sulme terroriste, kurse në faqet e tjera boton shkrime të ndryshme dhe shumë fotografi. E përditshmja tjetër, "Kosova Sot" titull kryesor ka "Terroristët sulmojnë Amerikën", duke ia kushtuar kësaj ngjarjeje tragjike edhe pesë faqe të tjera. Ndërkaq, "Koha ditore" në faqen e parë shkruan: "Në Nju-Jork sulmohet civilizimi botëror", kurse në faqet tjera shkruan gjerësisht për sulmet kundër Amerikës dhe boton një koment të gjatë. Mirëpo, mediet botërore kanë edhe disa rregulla, që gazetarët televizivë duhet t'i respektojnë në përballje me terroristët. Në paragrafin e dhjetë të Radio and Television News Directors Association (RTNDA) të Kodit etik kanadez, se reporterët televizivë gjithmonë duhet të tregojnë respekt për dinjitetin dhe këtë duhet ta bëjnë me të gjithë ata që kanë punë. Po ashtu, edhe në seksionin katër, pika a nr. 9.2 te Praktikat dhe standardet gazetareske, thuhet se "gazetarët e CBC-së duhet që të sigurohen se çdo veprim që ata e bëjnë nuk e largon rrezikun e jetës së rrëmbyesve apo interferon me orvatjet e autoriteteve t'i sigurojnë lirin apo qarkullimin e rrëmbyesve. Ata obligohen që të ruhen nga mundësitë e të qenit në dispozicion apo manipulimit nga terroristët apo rrëmbyesit ose pengmarrësit."<sup>21</sup> Terrori, sipas George Garbnerit, mund të ketë sukses vetëm atëherë kur aktet përcillen deri tek audienca me anë të të cilave terroristët vazhdimisht kërkojnë që të kenë impakt. Mediet në bartjen e terrorit janë duke kooperuar me

terroristët dhe kjo gjë i bënë ato bashkëfajtores. Gazetaria drejtpërdrejt mban përgjegjësinë<sup>22</sup>. Mediet tona duhet të jenë të kujdesshme në konsekuencat e mbulimit të tyre dhe nuk duhet që ta vënë në rrezik jetën e njeriut. Po ashtu, mediet nuk duhet që të zmadhojnë aktet terroriste dhe duhet që të përmbahen nga titujt që mbjellin frikë dhe panik, fotot e panevojshme që përmbajnë skena të gjakut. Asnjëherë mediet nuk lejohen që të marrin para apo të paguajnë për mbulimet e incidenteve terroriste. Po ashtu, është tejet i nevojshëm që të ketë një kooperim shumë të ngushtë me autoritetet shtetërore, të lihet linja e hapur, në mënyrë që të mos pengohen operacionet. Mediet tona elektronike, e në veçanti televizionet, e teprojnë në shfaqjen e dhunës të shkaktuar nga terroristët anekënd globit, duke ekspozuar skena të gjakut në kuadër të lajmeve ndërkombëtare, të cilat i marrin të gatshme dhe të servuara nga mediet e jashtme. Është tejet befasuese nëse në lajmet e TV-ve tona të mos ketë asnjë ngjarje, e cila nuk përmban njolla gjaku dhe aq më keq që këto skena përcillen në rrethin e ngushtë familjar, ku ka edhe fëmijë e adoleshentë.

<sup>21</sup> CBC Journalistic Standards and Practices (1993), f.62, [www.crtc.gc.ca](http://www.crtc.gc.ca) dhe [www.cbsc.ca](http://www.cbsc.ca).

<sup>22</sup> Raphael Cohen-Almagor: "Media coverage of acts of terrorism", Canadian Journal of Communication pg 401, 2005.

Mr. Rexhep Suma

## TERRORISM IN THE MEDIA

### (Summary)

I will start this article with a saying from Larry Grossman, the president of NBC News: "The job of the press is not to worry about the consequences of its coverage, but to tell the truth... As much as those of us as in the press would like to be popular and loved, it is more important that we are accurate and fair... and let the chips fall where they may."

Even though there is still no accurate definition of terrorism, the latter has been given political, religious and national connotation (Europol - TE-SAT 2007 report): "Terrorism is not an ideology or movement, but a tactic or a method for attaining political goals."

رجب سوما

### الإرهاب في وسائل الإعلام

#### (خلاصة البحث)

هذه المقالة سوف أبدأها بكلمة للارى غوسمان الذى يتأأس قناة ان بي سي نيوز، التي تقول: "إن مهمة وسائل الإعلام هو تغطيتها لقول الحقيقة .... والكثير منا الذين يعملون في وسائل الإعلام، كان بودنا ان نكون مشهورين و محبوبين، ولكن الأهم من ذلك هو أننا نكون دقيقين و أصحاباء ... والسماح للرقائق تقع فيها ما في وسعها".

وعلى الرغم من أن تعريفنا واضحاً ودقيقاً على الإرهاب لم يحدث بعد، لكنها اتخذت الألوان السياسية والدينية والوطنية، على النحو المحدد في تقرير ليوروبول TE-SAT 2007، والذي يقول: "الإرهاب ليس أيديولوجيا أو حركة، ولكن هو تكتيك أو طريقة لتحقيق أهداف سياسية"

## AKTUALITETE

*Sedat Islami*

### JA PSE NUK DUHET BOTUAR RUSHDIE NË GJUHËN SHQIPE

#### Abstrakt

“Vargjet satanike” është një novelë e autorit indiano-anglez, Selman Rushdie, botimi i së cilës ka ngjallur reagime të shumta, të cilat, në disa raste, kanë pasur epilog tragjik. Shkak ka qenë ofendimi që autori i bën Islamit, Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] dhe myslimanëve. Është diskutuar shumë për atë se ky libër paraqet apo jo fyerje në baza fetare dhe se përmbajtja e tij është apo jo në kuadër të së drejtës dhe lirisë së shprehjes dhe mendimit.

Ky punim trajton këtë libër dhe autorin e saj pikërisht nga ky aspekt. Me fakte dhe dëshmi, punimi vërteton se pse nuk do të duhej botuar fare ky libër dhe se si botimi i tij eventual nuk i bën nder askujt.

Punimin e kam ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë kam folur për biografinë e autorit, ndërsa në pjesën e dytë kam dhënë një letërnjoftim të shkurtër për librin duke trajtuar më pas qëndrimet pro dhe kundër tij si dhe duke diskutuar për arsyet e botimit respektivisht mosbotimit të tij në shqip. Përmbylljen e kam bërë me këshilla për format dhe mënyrat e reagimit për të parandaluar botimin eventual të librit.

#### Hyrje

Thirrja në ‘liri dhe të drejtë të shprehjes së mendimit’ për të ofenduar të tjerët, qofshin këta individë, kultura apo besime, nuk është tjetër vetëm se shkelje e kësaj të drejte dhe lirie, sikur që është shtrembërim i botëkuptimeve dhe domethënieve esenciale të tyre. Botimi i veprës së autorit kontravers, Selman Rushdie “Vargjet satanike” (The satanic verses) është një shembull tipik i shkeljes së kësaj të drejte. Përmbajtja fyese e librit për Islamin dhe myslimanët, në njërën anë, dhe insistimi me çdo kusht i publikimit dhe promovimit të tij nga qarqe politike dhe shkencore, në anën tjetër, ka vënë shumë pikëpyetje dhe dilema se athua çfarë fshihet prapa këtij libri, sidomos kur dihet se autori nuk ka kursyer nga fyerjet madje shumë të rënda edhe Mbretëreshën e Anglisë dhe kryeministren e asaj kohe, të ashtuquajturën “zonja e hekurt”, Margaret Thatcher? Ka qenë lajm për një kohë në Evropën Perëndimore.<sup>1</sup>

Këto dilema bëhen aktuale dhe shqetësuese edhe sot kur diskutohet për botimin e mundshëm të kësaj vepre makabre në shqip. Dëshira e autorit<sup>2</sup> dhe gatishmëria e partizanëve të tij, sidomos tash pas “pjekjes së kushteve”, siç konstaton një botuese e mundshme e tij<sup>3</sup>, lë shumë për të dyshuar në këtë drejtim. Athua vallë, lexuesi shqiptar nuk ka çfarë të lexojë vetëm se marrëzitë e Selmanit?!

Konsideroj se kjo dhe vepra tjera të ngjashme janë provokim i rëndë për myslimanët, sidomos kur kihet parasysh fakti se në Shqipëri dhe Kosovë shumica e popullsisë janë myslimanë. Arsyetimet pse duhet botuar kjo vepër janë trillime dhe asgjë më shumë. Është promovim i antivlerave dhe, bazuar në përvojat e mëhershme të vendeve tjera, provokim për incidente të mundshme. Madje, ç’është më e keqja se sikur me zor duan të na imponojnë arsyetimin e botimit të këtij libri, duke gjykuar para kohe se reagimet e mundshme fetare do të

<sup>1</sup> Shenavi, Fehmi. Men verae Selman Rushdi – esrarul muamereti alel Islam. F. 57.

<sup>2</sup> Gazeta Shekulli, edicioni online, 01.07.2006.

<sup>3</sup> Ibid.

ishin gabim<sup>4</sup>. Pra, është gabim që edhe nëse fyhesh, shahesh, ofendohesh, të reagosh. Ku mbeti e drejta dhe lira e shprehjes dhe mendimit?

Pavarësisht kësaj, konsideroj se, ndryshe nga qëllimet e botuesve që vetëm sipërfaqësisht synojnë promovimin e letërsisë ndërsa në thelb kanë komercializmin dhe fitimet e mëdha që sjellin vepra si kjo, reagimi për të ndaluar botimin e kësaj vepre të shëmtuar, jo vetëm që është e drejtë por edhe mbrojtje e saj.

## I. KUSH ËSHTË SELMAN RUSHDIE?

Përshkrimi i biografisë së tij, sigurisht se nuk bëhet nga kureshtja për t'u njohur me të. Përkundrazi. Detaje nga jeta e tij flasin për personalitetin dhe figurën e tij. Duke shpalosur këto detaje ne mund mësojmë të vërtetën për Selmanin, që mbase shumëkush nga artdashësit dhe letërsidashësit nuk e dinë.

Jam shumë i bindur se këto detaje, të paraqitura këtu dhe më pas edhe në pikën vijuese, jo vetëm te publiku mysliman, por edhe te laikët dhe gjithë të tjerët do të ngjallin ndjenjën e urrejtjes për këtë figurë kontroverse, të paorientuar e lapërdhare, sikur do ta ngjallin ndjenjën e neveritjes prej tij, për shkak të shthurjes dhe degjenerimit që reflekton në jetën e tij dhe promovon në veprat e veta, e me të cilat ai në fakt mburrej<sup>5</sup>. Ai, siç thoshte një mysliman i ri, *'nga një i panjohur do të shndërrohet në një të urryer.'*

Emri i tij i vërtetë ishte Ahmed Selman Rushdie, por nuk pëlqente këtë emrin e parë. Madje me 'facebook'-un<sup>6</sup> ka pasur një betejë ligjore, të cilën në fund e ka fituar, për ta regjistruar vetëm me këtë emrin e dytë, me të cilin njihej.

Është lindur në Mumbai, të Indisë. Babai i tij ishte pjesëtar i *'behaizmit'*<sup>7</sup>, një sekt që unanimisht nga dijetarët myslimanë është gjykuar

për të dalë (renegat) nga feja. Pra, prindi i tij nuk ishte fare mysliman, siç e dëshmon këtë edhe vetë Rushdie në një intervistë të tij<sup>8</sup>, edhe pse për habinë tonë prejardhja e tij vazhdon të përshkruhet në burime të ndryshme si islame.

Gjatë kohës sa ishte në Indi mësonte në një katedrale<sup>9</sup>, fakt që dëshmon për joislamizmin e familjes së tij, ndërsa pas shpërnguljes në Angli, megjithëse ishin familje e varfër, Selmani, ndiqte mësimet në një shkollë aristokrate, shkollën 'Rugby', e veçantë vetëm për familjet e shtresës së lartë, fakt tjetër që tregon për servilizmin e tyre ndaj pushtetit.

Pas konfliktit ndërmjet Pakistanit dhe Indisë për Kashmirin, vendi prej nga vinte Rushdie kishte mbetur nën Pakistan, kështu që, pas një kohe qëndrimi ai kthehet në Pakistan, vetëm se gjërat nuk i dalin siç priste. I mungonte jeta e shthurur dhe dëfrimet e zbavitjet, ndërsa Islami dhe traditat fetare ia ngulfasnin jetën. Po kështu e bezdiste fakti që duhej të punonte për të jetuar, ndryshe nga Londra atje ku e mbanin si "pëllumb."

Rushdie nuk ishte i sjellshëm me prindërit e tij. Këtë, përveç tjerash, e dëshmon edhe vetë ai kur flet në një intervistë se "më mirë ia del me babanë tash në ëndrra se kur ishte gjallë"...<sup>10</sup>

Gjatë qëndrimit në Pakistan ai demonstroi dy sekrete të personalitetit të tij:

1. Ambiciet për pasuri. Ishte i dhënë aq tepër pas pasurisë, saqë edhe me babanë e tij kishte konflikte përse ai nuk ia kishte mundësuar një jetë sa më luksoze atij. Në fakt, për krejt këtë fajtor kryesor e linte Islamin.
2. Urrëjtjen ndaj Islamit. Me t'iu dhënë rasti i parë, Rushdie shfaqte urrejtjen e vet ndaj Islamit. Kështu bëri edhe kur u punësua si tekstshkrues në televizionin pakistanez, por nuk i zgjati shumë, nga-se u dëbua si i pavlerë prej televizionit<sup>11</sup>. Më vonë, në mënyrë

<sup>4</sup> <http://www.gazetaexpress.com/?cid=1,112,78538>

<sup>5</sup> Ived, Ibrahim. *Ma dha ba'de i'lani Selman Rushdi teubetehu - dirasetun fennijetun ve mevdujjetun lil ajat esh shejtaniijeh*. F. 9.

<sup>6</sup> [http://www.bbc.co.uk/arabic/worldnews/2011/11/111115\\_rushdie\\_facebook\\_citory.shtml](http://www.bbc.co.uk/arabic/worldnews/2011/11/111115_rushdie_facebook_citory.shtml)

<sup>7</sup> Saud, Saib. *Err-rreddu alel murteddi Selman Rushdie shejtanu-s-sahajineti*. F. 11.

<sup>8</sup> Gazeta Bota sot, edicioni online, 29.06.2011.

<sup>9</sup> Saud, Saib. *Err-rreddu alel murteddi Selman Rushdie shejtanu-s-sahajineti*. F. 13.

<sup>10</sup> <http://www.24-ore.com/index.php/arte/libri/6477-romantiku-selman-rushdie.html>

<sup>11</sup> Saud, Saib. *Err-rreddu alel murteddi Selman Rushdie shejtanu-s-sahajineti*. F. 14-15.

deklarative, në intervista dhe gjetiu, Rushdie pranon se ishte ateist, dhe se edhe babai i tij kishte qenë i tillë.<sup>12</sup>

Ambientin islam në Pakistan nuk do të mund ta durojë gjatë, kështu që kthehet në Londër, ku gjen një grua, të afërt me shtëpi botuese, me të cilën edhe martohet.

Siç duket, Rushdie shihej si njeri i duhur për botën perëndimore, ngase nëpërmjet tij synonin realizimin e qëllimeve të pista të tyre. Ai do të avancohej, kuptohet pa meritë, aq sa edhe do të merrte çmim të madh letrar<sup>13</sup>, megjithëse kishte shumë më të zotë se ai në këtë fushë.

Selman Rushdie njihet si njeri i verbër pas parasë dhe famës, për hire të të cilave sakrifikon me çdo gjë, madje edhe me familje. Në tentim për të depërtuar në tregun amerikan, ai do të shkurorëzohet nga gruaja e tij e parë dhe do të martohet me një vajzë amerikane, por, për t'u hyrë në qejf amerikanëve, do të duhej të bënte diç, siç bëri për britanikët. Mendoi gjerë e gjatë dhe këtë e bëri duke sajuar histori të pagena, duke mbledhur fakte të pavërtetuara, duke shpifur dhe njolllosur Islamin dhe parimet e tij në librin monstruoz, librin më të shëmtuar të botës, më satanikun, të titulluar “Vargjet satanike”<sup>14</sup>.

Ky libër do të shkaktojë rrëmujën më të madhe, do të ngjallë reagime të shumta dhe nga qarqe të ndryshme, në disa raste edhe të rrezikshme, siç do të sqarojmë në pikën vijuese. Për pasojë, Rushdie do të jetojë i izoluar dhe nën kujdes të vazhdueshëm të forcave policore.

## II. PËRSE NUK DUHET BOTUAR “VARGJET SATANIKE” NË SHQIP?

### II.1. Njoftim me librin

“Vargjet satanike” është libri i katërt me radhë i Selman Rushdies. Është botuar në vitin 1988, nga shtëpia botuese “Viking”, e njohur për urrejtjen e saj ndaj Islamit. Ndonëse parapagoi Selmanin me plot

800.000 \$<sup>15</sup>, barra ia vleu qiranë, ngase ky libër u bë bestseller-i më i mirë i kësaj shtëpie gjatë gjithë kohës.<sup>16</sup>

Libri është i ndarë në nëntë kapituj dhe në secilin trajtohet temë e veçantë. Ai, në tërësi bjen ndesh me parimet islame porse më drejtpërdrejt këtë e bën në

1. Kapitullin e parë, kur flet për melekun Xhibrilin [*alejhis selam*]
2. Kapitullin e dytë, kur flet për Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*], duke e quajtur madje me emrin Mahound, me të cilin armiqte e thërrisin në mesjetë, në
3. Kapitullin e katërt kur flet për Aishen, gruan e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*]<sup>17</sup>.

Për përmbajtjen më të detajuar të librit do të mësojmë kur të përmendim arsyet pse nuk duhet botuar ky libër.

Libri është i botuar në dyzet gjuhë, ndërsa autori shpreson se gjuha shqipe do të jetë e dyzetënjës gjuhë e botimit të tij<sup>18</sup>.

### II.2. Reagimet pro dhe kundër librit

Libri “Vargjet satanike” provokoi rëndë besimtarët myslimanë në mbarë botën islame. Reagimet ishin të formave të ndryshme. Ekzistonte bindja dhe ideja në qarqet islame se ky libër, për dallim nga librat që trajtojnë Islamin negativisht, është më i shëmtuari, më ofenduesi, më fyesi, libri që shkel suazat e mendimit të lirë, madje besohej fuqishëm se prapa këtij libri fshihen sionizmi dhe imperializmi botëror, që Islamin dhe arabët mundoheshin t'i prezantonin para botës mbarë si fe, respektivisht popuj të prapambetur<sup>19</sup>. Nga këtu, studiues dhe

<sup>15</sup> Didat, Ahmed. *Shejtanijetul ajat esh-shejtaniijeh*. F. 54.

<sup>16</sup> Affani, Sejjid Husejn. *A'lam ve akzam fil mizan*. 2/77.

<sup>17</sup> Në mungesë të një kopje origjinale të librit, jam detyruar që t'i kthehem versioneve online, që radhitja nuk përputhej me origjinalin. Në arabisht, në çka jam mbështetur edhe më shumë, libri ishte i publikuar por pa emrin e përkthyesit dhe të shtëpisë botuese. Për këtë shkak, jam mbështetur më shumë në studime rreth librit, e me theks të veçantë në librin e Ahmed Didatit –Allahu e mëshiroftë!.

<sup>18</sup> Gazeta Shekulli, edicioni online, 01.07.2006.

<sup>19</sup> Saud, Saib. *Err-rreddu al el murteddi Selman Rushdie shejtanu-s-sahajineti*. F. 40.

<sup>12</sup> <http://www.24-ore.com/index.php/arte/libri/6477-romantiku-selman-rushdie.html>

<sup>13</sup> Saud, Saib. *Err-rreddu al el murteddi Selman Rushdie shejtanu-s-sahajineti*. F. 16.

<sup>14</sup> Ibid. F. 17.



kritikë nga bota islame, këtë libër e kanë klasifikuar si libër ‘me porosi’<sup>20</sup> apo si libër të tipit të orientalistëve<sup>21</sup>.

Botimi i librit u pasua me protesta në Londër, ku ekzemplarë të librit u dogjën në shesh. Ndërsa shtete si Indonezia, Tajlanda, Singapori, Venezuela, Tanzania, Bangladeshi, Sudani, Afrika e Jugut, Kenia, kanë ndaluar botimin apo shpërndarjen e këtij libri në vendet e tyre. Dijetarët myslimanë iu bënë thirrje shteteve që kultivonin raporte të mira me to që të mos lejonin qarkullimin e këtij libri në vendet e tyre. Irani, respektivisht Imam Homeini shfaqti një zemërim ekstrem, aq sa edhe nxori një fetva (13 shkurt 1989) për vrasjen e Selmanit.

Po kështu u shkruan libra dhe u mbajtën ligjërata të shumta përkritazi me këtë roman. Misionari i famshëm mysliman, Ahmed Didat, me nënshtetësi angleze shkroi librin “*Satanizimi i vargjeve satanike*” (Shejtani jetul ajat esh-shejtani jeh).

Rreth çështjes në fjalë u deklaruan edhe hoxhallarë dhe publicistë shqiptarë. Teologu, Ermir Gjinishi, jo vetëm që e cilësoi si libër provokativ por tha se shqiptarët kanë probleme tjera me të cilat duhet të merren. “*Ai është një libër që deformon të vërtetën islame. Në Shqipëri gjenden gjithmonë shkaqe që të bëhen debate apo diskutime që nuk janë të nevojshme për Shqipërinë, por ky është problemi i tyre. Natyrisht që botimi i këtij libri nuk do të ishte diçka pozitive*”.

Kundër është deklaruar edhe Forumi Mysliman i Shqipërisë, për faktin se ‘*janë shumë gjëra ofenduese në këtë libër që i bëhen profetit tonë...*’<sup>22</sup>

Se libri është vërtet ofendues kanë dëshmuar emra dhe personalitete edhe nga bota joislame. Dr. Robert Runcie, në emër të Kishës Angleze, thotë: “*Vetëm një i paafte mund të mos vërejë se sa shumë ka lënduar publikimi i librit të Selmanit myslimanët e Anglisë dhe të mbarë botës. Unë i kuptoj myslimanët dhe besoj fuqishëm se ofendimi*

*apo tallja dhe përqeshja me çfarëdo feje në botë nuk është më pak krim se përqeshja dhe tallja me fenë e krishtere*”.<sup>23</sup>

Nga ana tjetër, pati reagime pozitive të përkrahjes së rezervë të librit dhe autorit. E çuditshme është se si libri u promovua fuqishëm edhe nga ata që nuk i shpëtuan gjuhës së madhe të tij. Margaret Thatcher, atëbotë kryeministre e Anglisë, të cilën në këtë libër të pispillosur e quan “bushtër” (bitch), jo vetëm që nuk kundërshtonte porse mbante aq fort anën e tij sa që rastin e tij, pas reagimeve të myslimanëve dhe fetvasë së Homeinit, e konsideronte si rast tipik të shkeljes të së drejtës së shprehjes, edhe pse vetë ajo pati shtypur këtë të drejtë kur fjala ishte për sekretet e politikave të saj. Piter Rajtit (Peter Wright) ia ndaloi publikimin dhe shpërndarjen e librit të tij ‘*Spycatcher*’ (gjuetari i spiunëve) pasi që fliste për botën sekrete të saj<sup>24</sup>.

Jo vetëm politika i dha mbështetje. Ishin shkenca dhe mediumet që kontribuan në afirmimin e tij dhe të veprës së tij. E shihnin si art derisa Anglia, duke pasur parasysh përhapjen e këtij libri anekënd botës, pavarësisht përmbajtjes së tij, synonte globalizimin e novelës britanike<sup>25</sup>.

Botimi i mundshëm i kësaj vepre të Rushdies po diskutohet edhe te ne. Mediumet dhe botuesit paraprakisht janë në dijeni të problemeve që mund të shkaktojë botimi eventual i saj. Janë studiuar mirë rrethanat dhe tash viti 2012, shihet si koha më e përshtatshme për një gjë të tillë. Jam shumë i bindur, siç kanë nënvizuar edhe të tjerë, se një libër si ky është profitabil<sup>26</sup> dhe nuk ka rastësi botimi i tij këtë vit kur parashihet që në shtator të publikohet biografia e tij. Kësisoj, librit do t’i bëhej një reklamë dhe shitja e tij do të ishte e madhe.

Për dallim nga krahu fetar islam, mediat veprat e tij i perceptojnë si art<sup>27</sup>, dhe jo vetëm këtu te ne, por përgjithësisht ka qenë konstatim

<sup>20</sup> Didat, Ahmed. *Shejtani jetul ajat esh-shejtani jeh*. F. 82.

<sup>21</sup> Ived, Ibrahim. *Ma dha ba’de i’lani Selman Rushdi teubetehu – dirasetun fennijetun ve mevduijetun lil ajat esh shejtani jeh*. F. 10.

<sup>22</sup> <http://lajme3.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/1047217743/titulli/Botuesja-Arlinda-Dudaj-ndez-debatin--mbi-botimin-e-Vargjet-Satanike-te-Selman-Ruzhdie>

<sup>23</sup> Didat, Ahmed. *Shejtani jetul ajat esh-shejtani jeh*. F. 26.

<sup>24</sup> Shenavi, Fehmi. *Men verae Selman Rushdi – esrarul muamereti alel Islam*. F. 13.

<sup>25</sup> <http://gazeta-shqip.com/ndryshe/58023eea07c5dce9ad10e98d2e29d433.html>

<sup>26</sup> <http://www.gazetaexpress.com/?cid=1,112,78538>

<sup>27</sup> Gazeta Zëri, edicioni online, 24.08.2011.

se mediat njëanshëm mbajnë anën e tij<sup>28</sup>, për të mos thënë se, duke pasur parasysh arsyet e botuesve dhe vetë objektivat e librit njëanshmëria këtu nënkupton luftë mediale kundër Islamit.

Botuesit e mundshëm, në këtë rast shtëpia botuese “Dudaj” në Shqipëri, nëpërmjet drejtoreshës, Arlinda Dudaj, jep arsyet e saj të botimit. E përsëris prapë se dyshoj shumë në qëllimet e kësaj shtëpie botuese, e cila që në vitin 2004<sup>29</sup> pati diskutuar për botimin e kësaj vepre por duke mos parë atëherë kohën e përshtatshme. Tash, nëse nuk janë ato që përmenda sipër dhe shtoj edhe ndonjë rol a mision i ri i marrë për luftimin e kredos islame, nuk di çfarë tjetër ka. Nejse, të shohim njëherë arsyet ngase më gjerësisht do të flasim në vijim kur do të japim arsyet tona pse nuk duhet të botohet fare ky libër. Në fakt, këtu do të bëjmë përmbledhje të arsyeve nga A. Dudaj dhe të tjerë:

1) E drejta e shprehjes së lirë të mendimit. Çuditë si e klasifikojnë kështu këtë të drejtë kur ka të bëjë me ta ndërsa kur fjala është për myslimanët, atëherë ajo nuk njihet më si e drejtë si shkelje e rëndë, si fyerje e figurave. Qenka e drejtë të shahet e fyhet Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] madje duke mos e parë për të drejtë as reagimin eventual të myslimanëve, siç shprehej Trina Gojani<sup>30</sup>.

2) Krahassimi i saj me vepra të shëmtuara, si vepra e Hitlerit<sup>31</sup> që këto ditë doli edhe në shqip. Kjo është mbase arsyeja më qesharake. Athua vallë, duhet të bëhemi të këqij pse dikush është i keq?! Sa logjikë e prishur! Njeriu nuk duhet të bëjë keq pse bëjnë tjerët. Ja çfarë na mëson Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*]:

لَا تَكُونُوا إِمْعَةً تَقُولُونَ إِنَّ أَحْسَنَ النَّاسِ أَحْسَنُوا وَإِنْ ظَلَمُوا ظَلَمْنَا وَلَكِنْ وَطَنُوا  
أَنْفُسَكُمْ إِنْ أَحْسَنَ النَّاسُ أَنْ تَحْسِنُوا وَإِنْ أَسَاءُوا أَنْ لَا تَظْلَمُوا

<sup>28</sup> Shenavi, Fehmi. *Men verae Selman Rushdi – esrarul muamereti alel Islam*. F. 60.

<sup>29</sup> Gazeta Shekulli, edicioni online, 01.07.2006.

<sup>30</sup> Gazeta Express, edicioni online, 11 prill 2012.

<sup>31</sup> Ibid.

*Mos u bëni oportunistë, të thoni që nëse njerëzit bëjnë mirë bëjmë edhe ne dhe nëse njerëzit bëjnë keq – padrejtësi bëjmë edhe ne. Përkundrazi. Mëvetësohuni! Nëse bëjnë njerëzit mirë, bëni dhe ju, e nëse bëjnë keq, ju mos bëni!”<sup>32</sup>*

3) ‘Sepse është një nga romanet më të madhërishme të fundshekullit të njëzet. Një roman i rëndësishëm plot vitalitet, dëshpërim e shpresë.’ Unë nuk besoj kështu. Them, duke cituar Ahmed Didatin, se famë kësaj vepre nuk i është për vetë vlerat e saj, por për shkak të antivlerave. Është e tipit të veprave që praktikojnë rregullin ‘kundërshtoj, njihesh.’ Selmani është bërë i njohur duke kundërshtuar traditat dhe fenë e vendit prej nga vinte. Famë i është dhënë nga fetvaja e Homeinit, ndryshe, siç konstaton Didati, do të ishte një nga ato romanet fare pak të njohura.

4) ‘Rushdie nuk fyen Muhamedin dhe Kur’anin.’ Kjo është arsyeja më banale e dhënë. Ta quash të xhindosur, pispillosur, ta akuzosh për moral, e shumë gjëra tjera, që do t’i përmendim në pikën vijuese, e prapë të mos e cilësosh këtë për fyerje, vërtet është çudi. Ta mohosh Kur’anin si libër hyjnor dhe të thërrasësh për tjetërsimin e tij me arsyetimin se nuk vlen për këtë kohë, e prapë të thuhet se nuk ka thënë gjë të keqe, kjo edhe më e çuditshme. Apo, mos ndoshta duan sikur në rastin e parë që reagimet t’i shohin të pavenda të na bindin edhe këtu me dhunë se këto nuk janë fyerje.

5) ‘Thirrja e Salman Rushdie për liri nuk është kundër Islamit, por kundër Islamizimit politik, që pretendon të qeverisë çdo aspekt të jetës duke e nënshtuar të gjithë shoqërinë nën interpretimin e vet.’ Kjo arsye shpalos qëllimet dhe misionin e tyre. Ne nuk dimë përplot 1400 që ka Islam politik. Islami, siç thotë dr. Jusuf Kardavi, është ve-

<sup>32</sup> Hadithin e transmeton Tirmidhiu në Sunenin e tij ndërsa Albani e vlerëson për të dobët derisa të tjerë, për rrugë tjera të transmetimit të tij, mendojnë se hadithi është hasen.

tëm një. Kjo jep të kuptosh se kemi shumë 'islama.'<sup>33</sup> Në fakt, ky dhe termet e ngjashme, janë pjellë e orientalistëve<sup>34</sup> dhe të tjerë dhe këtu mund të konstatojmë se e përbashkëta e tyre është luftimi i Islamit. Ndryshe, Islami si tërësi përfshin edhe këtë aspekt të jetës publike.

6) Synimet dhe misionin e tyre për orientim të tërësishëm kah Perëndimi, qoftë kjo edhe në llogari të fesë dhe traditës. Ndue Ukaj, më qartë dhe drejtpërdrejt se tjerët, botimin e arsyeton me faktin se ky libër i kontribuon shkëputjes nga bota orientale (islame), kështu, si i tillë për ne - gjithnjë sipas tij- që jemi pjesë e proveniencës oksidentale, me kulturë, histori dhe letërsi, ...kjo vepër duhet të mirëpritet, sepse është vepër që komunikon në gjithë arealin perëndimor<sup>35</sup>.

Ndërsa Arlinda Dudaj këtë e arsyeton edhe me faktin se do të përvetësojmë imazh perëndimor atëherë kur të jemi çliruar nga autoriteti i fesë. 'Çdo autoritet, qoftë ky fetar, politik, kulturor, ekonomik mund të jetë një objekt për t'u kritikuar. Ky është kuptimi i një shoqërie moderne dhe të çliruar nga autoritarizmi. E nëse duam të bëhemi pjesë e saj, duhet ta kemi parasysh.'

Kjo nënkupton edhe atë se njerëzit janë aq të aftë saqë edhe Zotit mund t'i gjejnë vërejtje se nuk e paska pasur mirë këtë e atë në Kur'an. Ç'marrëzi të rënda janë këto! Kur'ani në fakt nuk është sikur librat tjerë që janë shtrembëruar. Ai, përkundër faktit se tashmë shënon shekullin e XV të tij, ende është mu ashtu siç e ka shpallur Zoti.

Në fakt, Kur'ani është i hapur për sfidim dhe përgjatë gjithë kohës nuk ka dalë njeri ta ketë sfiduar atë. Allahu i Madhëruar ka thënë:

<sup>33</sup> Kardavi, Jusuf. *Fetva bashkëkohore II*. 2/543.

<sup>34</sup> Orientalistët serb madje edhe sekularizmin e muslimanëve e konsideronin tejet të rrezikshëm. Mu për këtë shpikën këso termesh të panjohura më parë, 'Islami komunist', etj. Shih: Cigar, Norman. *Roli i orientalistëve serbë për justifikimin e gjenocidit ndaj muslimanëve në Ballkan*. F. 34

<sup>35</sup> Gazeta Express, edicioni online, 11 prill 2012.

وَإِنْ كُنْتُمْ فِي رَيْبٍ مِّمَّا نَزَّلْنَا عَلَىٰ عَبْدِنَا فَأْتُوا بِسُورَةٍ مِّثْلِهِ ۚ وَادْعُوا شُهَدَاءَكُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿٣٧﴾

**E në qoftë se jeni në dyshim në atë që Ne ia shpallëm gradualisht robit tonë, atëherë silleni ju një kaptinë të ngjashme si ai (Kur'ani) dhe thirrni (për ndihmë) dëshmitarët tuaj (zotërat) pos Allahut, nëse jeni të sigurtë (në thëniet tuaja se Kur'ani nuk është prej Zotit)."** (el-Bekare: 23.)

7. 'Paranoja për të censuruar nuk mundet kurrësi të shkatërrojë krijimtarinë letrare apo trashëgiminë kulturore botërore. Po të jetë kështu duheshin censuruar edhe Dante apo Shekspiri.'<sup>36</sup> Megjithatë, reagimet ishin në nivel botëror kundër veprës së Dantes, e cila fyente Islamin. Ishin këto reagime madje nga qarqe joislame. Janë pothuajse arsyet e njëjta pse është kërkuar ndalimi i saj nga organizata Gherush 92<sup>37</sup>. '...vepra 'Komedia hyjnore' e Dante Aligierit është homofobike. 'Komedia hyjnore' – shpjegon Valentina Sereni, presidente e Gherush 92 - paraqet një përmbajtje që është fyese dhe diskriminuese si në leksik ashtu dhe në substancë, p.sh.: vendi i rezervuar për Muhamedin në ferr, etj., dhe si e tillë ajo duhet ndaluar.'<sup>38</sup>

Si ka mundësi që librat hyjnorë të censurohen, ndërsa librat e lapërdharëve të tipit të Rushdies dhe të tjerëve të mos censurohen. Si të mos censurohet diç që në fakt është për t'u hedhur në kosh të plehrave?!

8) Logjika që kritika të mos tejkalojë rrafshin letrar. Ky është arsyetimi që jep Ndue Ukaj, por që nuk është me vend. Përderisa vepra provokon dhe trajton çështje shumë të ndjeshme, që nuk janë temë ve-

<sup>36</sup> <http://www.shqiptarja.com/news.php?IDKategoria=2730&IDNotizia=76203>

<sup>37</sup> Shoqatë intelektualësh jofitimprurëse, e cila merret me zhvillimin, të drejtat humane dhe zgjidhjen e konflikteve. Për më shumë shih: <http://www.gherush92.com/>

<sup>38</sup> Gazeta Express, edicioni online, 16 mars 2012.

tëm e letërsisë, ose më së paku e saj, atëherë patjetër se duhet të merret dikush me to. Komedia hyjnore për kohë të tëra është konsideruar madhështore, por për shkak se fyen myslimanët, siç thamë më parë, është protestuar nga jomyslimanë për ndalimin e saj<sup>39</sup>.

Këto ishin arsyetimet e tyre kryesore që flasin edhe për qëllimet që kanë, e që nuk dallojnë shumë nga ato të Selman Rushdies dhe atyre që qëndrojnë prapa tij.

### II.3. Përse nuk duhet botuar fare ky libër?

Arsye pse nuk duhet botuar ky libër ka shumë. Sa më shumë që thellohesh në të dhe diskutimet rreth përmbajtjes së tij do të gjesh gjithnjë një arsye më shumë pse nuk duhet botuar ai. Në vazhdim do të paraqesim një përmbledhje të disa prej arsyeve kryesore pse nuk duhet botuar ky libër, të dhëna nga kritikët dhe të përfituara nga shpjegimet e tyre.

#### 1) Liri i Rushdies bazohet në burime apokrifë

Frymëzimi i autorit për “Vargjet satanike” vjen nga disa rrëfime<sup>40</sup>, të cilat janë burimi kryesor i tij<sup>41</sup>, e që janë vërtetuar për të paqena, të shpifura<sup>42</sup>, apokrifë dhe të fabrikuara<sup>43</sup>. Fjala është për rrëfimin që përmendet në disa prej librave të komentuesve përkthas me kaptinën kur’anore en-Nexhm, apo më konkretisht për ajetet 19-20, se kinse Muhammedi [alejhis selam] paskësh lëvdur putat dhe idhujt me gjuhën e tij. Dijetarë me nam, si hadithologu shqiptar Muhammed Nasi-

ruddin Albani në ‘*Nasbul mexhaniik li nafi kissatil garanik*’<sup>44</sup> mohojnë kategorikisht një gjë të tillë.<sup>45</sup>

Pra, si mund të merret për madhështore një vepër, zanafilla e së cilës është shpifje. Apo, mos vallë na qenka art që të sajohet gjëra, të lejojme imagjinatën e tij të ‘fusë hundët’ edhe atje ku nuk i takon, të fantazojë çfarë të dojë e pastaj të dalim dhe këtë t’ua shesim njerëzve për art?! Ky art është çmenduri.

#### 2) Shkelje e së drejtës

Libri paraqet një shkelje të rëndë të së drejtës fetare. Dr. Sejjid Affani, madje e konsideron si fyerjen më të madhe në histori që i është bërë Pejgamberit Muhammed [alejhis salatu ves selam].<sup>46</sup> Përkundër kësaj, Selmani si kriminel është llogaritur si viktimë. Nuk janë ndalur së akuzuari viktimat (myslimanët) se sherri i tyre “bisha” nuk po mund të flenë<sup>47</sup> dhe se ata radikalët që po protestojnë kundër tij, në Indi tash së fundi (janar 2012), po pengojnë aktivitetet e tij letrare<sup>48</sup>. Bazuar në këtë, Selmanin e kanë glorifikuar si ‘martir i së drejtës dhe lirisë së shprehjes’<sup>49</sup> ndërsa veprën e tij dhe botimin e saj, pavarësisht se ofendon myslimanët, e kanë parë si të drejtë të shprehjes së mendimit.

Megjithatë, e drejta ka një kufi. Drita e kuqe për të ndizet në momentet që ajo cenon të drejtën e tjetrit. Selmani ka shkelur këtë në veprën e tij shumë herë, e vazhdon ta shkelë atë prapë. Ndonëse ishte deklaruar pro ndërtimit të xhamisë në Nju-Jork<sup>50</sup>, edhe pse nuk i interesonin fort, Selmani pati përkrahur ndalimin e xhamisë ndërsa qëndronte përkrah dhe mbështeste idenë e botimit të karikaturave fyese për

<sup>39</sup> Ibid, 11 prill 2012.

<sup>40</sup> <http://www.24-ore.com/index.php/arte/libri/6477-romantiku-selman-rushdie.html>

<sup>41</sup> Dëshmi tjetër e kësaj është mbështetja dhe inspirimi i tij (jo vetëm për këtë vepër) nga romani apokrif dhe tërësisht të shpifur ‘Njëmijë e një net’. Gazeta Shekulli, edicioni online, 01.07.2006.

<sup>42</sup> Affani, Sejjid Husejn. *A’lam ve akzam fil mizan*. 2/75.

<sup>43</sup> Ived, Ibrahim. *Ma dha ba’de i’lani Selman Rushdi teubetehu – dirasetun fennijetun ve mevdijetun lil ajat esh shejtaniijeh*. F. 7.

<sup>44</sup> F. 9.

<sup>45</sup> Shih: Arshin, Muhammed Ibn Abdullah. *Ma shaa ve lem jethbut fi-s-siretin nebevijeh*. F. 61.

<sup>46</sup> Affani, Sejjid Husejn. *A’lam ve akzam fil mizan*. 2/81.

<sup>47</sup> Gazeta Bota sot, edicioni online, 28.02.2009.

<sup>48</sup> Gazeta Koha ditore, edicioni online, 20.01.2012.

<sup>49</sup> <http://www.muslm.net/vb/archive/index.php/t-257716.html>

<sup>50</sup> Gazeta Bota sot, edicioni online, 14.09.2010.

Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*] dhe familjen e tij.<sup>51</sup> Tash kur përmenda karikaturat nuk kam si të mos përshkruajë fjalët e bukura të një studiuese gjermane të mediave, Teresa Naab, e cila ndonëse ishte për respektimin e lirisë së shprehjes së mendimit, siç jemi parimisht edhe ne, megjithëkëtë mendon se duhet të studiohen kufijtë e saj. Ndryshe kjo do të ishte një shthurje individuale dhe kaos shoqëror. Teresa kërkon që kufijtë e kësaj lirie dhe të drejte të kihen parasysh sidomos në raport me myslimanët, se çka apo cilat forma të shprehjes së mendimit janë të pranueshme, e cilat jo.<sup>52</sup>

Thënë të drejtën, puna nuk është se ata nuk i dinë këto gjëra, porse të drejtën dhe lirinë si të tilla i kanë konceptuar vetëm në raport me ta dhe jo myslimanët. E them këtë ndërsa parasysh kam dy fakte shumë me rëndësi:

- a) Liria e shprehjes së mendimit nuk qe respektuar nga ‘zonja e hekurt’ kur objekt i fyerjes ishte vetëm ajo dhe shoqëria e saj. Si koincidençë, në kohën kur u publikua libri në Angli ndërsa Mbretëreshën dhe kryeministren i cilësonte si bushtra si dhe përmbante fjalor shumë të ndyrë, fjalë që anglezët nga turpi nuk i thonë me emër por me shprehje tjera si fjala me katër shkrunja (f\*\*k), Selmani mbrohej, ndërsa një aktori amerikan që këtë fjalë e tha për politikën e Thatcher, Miki Rurk (Mickey Rourke), mediat jo vetëm që bënë bujë për fjalën e tij, porse kërkuar largimin e dhunshëm të tij prej Anglisë.<sup>53</sup>
- b) Poezia e shkrimtarit të famshëm gjerman, Gunter Grass<sup>54</sup>, në të cilën kritikohej Qeveria izraelite u prit aq keq nga mediat dhe opinionin ndërsa shkrimtarit iu bë presion i madh, që mbase mund të ketë shkak që ai përfundoi në spital<sup>55</sup>. Izraeli e pati bërë të madhe vetëm pse në Turqi në një reklamë televizive për një produkt sha-

<sup>51</sup> <http://www.muslim.net/vb/archive/index.php/t-257716.html>

<sup>52</sup> <http://www.dw.de/dw/article/0,,15881937,00.html>

<sup>53</sup> Didat, Ahmed. *Shejtani jetul ajat esh-shejtani jeh*. F. 28.

<sup>54</sup> Gazeta Express, edicioni online, 11 prill 2012.

<sup>55</sup> Ibid, 18 prill 2012.

mponi, shfaqej Hitleri<sup>56</sup>. Kjo në nivel ndërkombëtar ndërsa në nivel kombëtar (Shqipëri) probleme pati edhe me publikimin e librit të Hitlerit. Dritëro Agolli ishte kategorik për ndalimin e botimit të tij “*Mtein Kampf*” për shkak se libri nxit urrejtjen dhe ngjall terrorin shpirtëror.<sup>57</sup>

Përse të mos thuhet kështu edhe për librin e Selmanit, që shumë më shumë nxit urrejtje sesa libri i Hitlerit?!

### 3) Ofendimi i fesë islame. Shumë padrejtësisht dhe në mënyrë krejtësisht injorante znj. Dudaj konsideron se ky libër nuk ofendon Islamit dhe Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*]<sup>58</sup>.

Në librin e tij, siç kanë nënvizuar kritikë të shumtë, ka fyerje dhe sharje në adresë të Islamit, në përgjithësi dhe në atë të Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] në veçanti. Roald Dahl thotë se libri të jep përshtypjen se Selmani ka qenë shumë i vetëdijshëm për atë që ka shkruar dhe e ka ditur fare mirë se çka i revoltonte myslimanët, andaj edhe e ka shkruar. Nuk ka përse të shfajësohet...<sup>59</sup>

- a) *Zotin* e përshkruan vrazhdë, me cilësi dhe tipare që, absolutisht nuk përkojnë me Të. E përshkruan si të mbuluar nga inati dhe mëria, si armik të gjinisë mashkullore.
- b) *Xhibrilin*, e përshkruan si melek të rënë në dashuri me gra derisa nuk ngurron fare ta quajë me emra fyes, si: derr, xhin, kokëtul, etj.<sup>60</sup> Madje e konsideronte si promovues të homoseksualizmit dhe përkrahës të tij<sup>61</sup>.
- c) *Kur'anin* e quan jo vetëm djallëzor porse edhe si një projekt që është realizuar bashkërisht nga Zoti dhe djalli<sup>62</sup>. Faktikisht, ai e mohon Kur'anin tërësisht ngase dyshon në vahj (shpallje)<sup>63</sup>. Ma-

<sup>56</sup> Ibid, 26 mars 2012.

<sup>57</sup> Ibid, 11 mars 2012.

<sup>58</sup> <http://www.shqiptarja.com/news.php?IDKategoria=2730&IDNotizia=76203>

<sup>59</sup> Didat, Ahmed. *Shejtani jetul ajat esh-shejtani jeh*. F. 24.

<sup>60</sup> Shenavi, Fehmi. *Men verae Selman Rushdi – esrarul muamereti alel Islam*. F. 45.

<sup>61</sup> Affani, Sejjid Husejn. *A'lam ve akzam fil mizan*. 2/75.

<sup>62</sup> Shenavi, Fehmi. *Men verae Selman Rushdi – esrarul muamereti alel Islam*. F. 19-20.

<sup>63</sup> Affani, Sejjid Husejn. *A'lam ve akzam fil mizan*. 2/76.

dje tenton ta luftojë universalizmin e tij dhe thotë se këtu qëndron problemi te myslimanët ngase besojnë në validitetin e përhershëm të tij, për këtë arsye fton që Kur'ani të konsiderohet vetëm si dokument historik<sup>64</sup>.

- d) *Muhammedin*, [alejhis salatu ves selam] si profet të shpifur<sup>65</sup>, përbindësh mesjetar të fëmijëve derisa përgjatë gjithë kohës e thërret me 'Mahound'<sup>66</sup>, sinonim i djallit, me të cilin ekstremistët e krishterë e thërrisin në mesjetë<sup>67</sup>.

E përshkruan si njeri që vraponte pas të mirave të kësaj bote, me theks të veçantë ndaj grave, e madje edhe si njeri që edhe në llogari të monoteizmit, motos me të cilën shquhej misioni i tij, bënte kompromise me idhujtarët mekkas, e gjëra tjera që vetëm të vërteta nuk mund t'iu thuash ndryshe janë çdo gjë tjetër: shpifje, trillime, shtrembërime, tendenca, e çka jo tjetër?!<sup>68</sup>

- e) *Gratë e tij*, që kanë statusin e nënave të besimtarëve, i quante prostituta<sup>69</sup>.
- f) *Sahabet*, shokët e Muhammedit [alejhis salatu ves selam] si të dalë nga feja<sup>70</sup>.
- g) *Ritualet fetare*, si abdesin, namazin, etj, i sheh si gjëra të marra derisa Qaben e Madhëruar, jo vetëm që nuk e sheh më tepër se një shtëpi guri, porse e imagjinon veten brenda saj, jo për adhurim por për dëfrim në mesin e këngëtareve dhe lavireve<sup>71</sup>. Mekken e llogariste si vend injorance dhe idhujtarie<sup>72</sup>.

<sup>64</sup> [http://news.bbc.co.uk/hi/arabic/world\\_news/newsid\\_4140000/4140730.stm](http://news.bbc.co.uk/hi/arabic/world_news/newsid_4140000/4140730.stm)

<sup>65</sup> Affani, Sejfid Husejn. *A'lam ve akzam fil mizan*. 2/75.

<sup>66</sup> Saud, Saib. *Err—rreddu al el murteddi Selman Rushdie shejtanu-s-sahajineti*. F. 19.

<sup>67</sup> Shenavi, Fehmi. *Men verae Selman Rushdi – esrarul muamereti alel Islam*. F. 46.

<sup>68</sup> Ibid. F. 47.

<sup>69</sup> Affani, Sejfid Husejn. *A'lam ve akzam fil mizan*. 2/75.

<sup>70</sup> Shenavi, Fehmi. *Men verae Selman Rushdi – esrarul muamereti alel Islam*. F. 48.

<sup>71</sup> Ibid. F. 51.

<sup>72</sup> Affani, Sejfid Husejn. *A'lam ve akzam fil mizan*. 2/75.

#### 4) Personaliteti kundërthënës i autorit dhe natyra dyshuese e librit

Detaje të shumta nga jeta e Selmanit të bëjnë të dyshosh se prapa tij qëndron dikush dhe se ai është vegël e dikujt.

- a) Shkollimi, siç përmendëm më lart. Selmani në Indi u shkollua në shkollë të krishterë ndërsa në Angli, përkundër faktit që familja e tij ishte e varfër, u shkollua në shkollën, ku shkonin vetëm të pasurit.
- b) Tallja sistematike me myslimanët. Selmani di t'i tallë myslimanët në vazhdimësi, çka nëse ata kanë hequr dorë prej tij (nëse pranohet konstatimi se fetvaja nuk është valide më), ai nuk ka hequr. Në intervista jo rrallë me stilin e tij cinik, Selmani lëshon helm ashtu siç bën gjarpri. Ende tallet me atë se i vetmi element fetar në shtëpinë e tyre ka qenë mosngrënia e mishit të derrit dhe se kur e ka ngrënë ai për herë të parë nuk është goditur nga rrufeja<sup>73</sup>. Sikur që u tall edhe atëherë kur në vitin 1999 publikoi pendimin e tij nga ajo që kishte shkruar se kinse e kishte bërë nga injoranca. Tash kishte mësuar të vërtetën, andaj edhe që penduar dhe i kthehet fesë së tij. Shumë shpejt u kuptua se bëhej fjalë vetëm për tallje dhe asgjë tjetër<sup>74</sup>.
- c) Fama dhe pasuria, mbi të gjitha. Fakti se do të dëshironte që libri i tij të botohej në shqip, ngase kështu do të ishte gjuha e dyzetinjëtë në të cilën botohej ai, flet për këtë. Ndoshta kjo në rastin me autorë tjerë nuk nënkupton këtë, por në rastin e Selmanit, si vërejtje shumë e madhe i është dhënë se qëllime kryesore të tij kanë qenë paratë dhe fama, dhe jo tjerat.
- d) Veprimtaria e tij.
- a) Aspekti përmbajtësor i veprës së tij lë shumë për të dyshuar se prapa tij, siç thotë dr. Fehmi Shenavi<sup>75</sup>, qëndrojnë rryma ekstreme të krishtera, që synojnë realizimin e qëllimeve të tyre nëpërmjet tij. Qëndrimet e këtij krahu ekstrem, të cilët Islamin e quajnë fe të

<sup>73</sup> <http://www.24-ore.com/index.php/arte/libri/6477-romantiku-selman-rushdie.html>

<sup>74</sup> Ived, Ibrahim. *Ma dha ba'de i'lani Selman Rushdi teubetehu – dirasetun fennijetun ve mevdujjetun lil ajat esh shejtaniijeh*. F. 2.

<sup>75</sup> Shenavi, Fehmi. *Men verae Selman Rushdi – esrarul muamereti alel Islam*. F. 20.

djallit, ashtu siç Selmani i quan versetet kur'anore, pra ngjashmëria ndërmjet tyre Shenavin e bën të dyshojë shumë edhe në bashkëpunimin e mundshëm midis tyre.

- b) Nëse Shenavin e bënte të dyshojë kjo, atëherë Ahmed Didatin e bën të dyshojë politika, e cila ia mban anën Selmanit<sup>76</sup>. Këtë libër e sheh sikur të jetë me porosi nga Qeveria angleze.
- c) E ajo që të bën të dyshosh edhe më shumë për këtë janë disa nga bindjet e tij që përkohë me interesat politike të Perëndimit ndaj botës islame. Reformimin e botës islame, si shembull, me të cilën nënkupton modernizimin e Islamit dhe ndryshim e tërësishëm të tij, formal dhe përmbajtjesor, duke e shndërruar nga fe në ideologji që do të mund të intervenojë në të varësisht shijes së të fortëve, ngase nuk e sheh të aftë për të bashkëvepruar me kohën, Selmani e debaton shpesh<sup>77</sup>.

### 5) Luftimi i tolerancës

Nëse bota sot përpiket të krijojë një klimë respekti të ndërsjellë në nivel global, ndërmjet feve, kulturave dhe racave, atëherë me të lehtë do ta ketë punën pa promovimin e kësaj veprë dhe botimit të saj në gjuhë tjera. Dijetarët kanë tërhequr vërejtjen me kohë ndaj këtij libri, i cili inspiron për incidente ndëretnike në Evropë dhe motivon për to.<sup>78</sup> Ai paraqet myslimanët si bisha, si egërsira, si njerëz që duan vetëm të shkatërrojnë të prishin e ndëshkojnë njerëzit<sup>79</sup>.

Rushdie nuk kursehet as nga fyerjet në baza ngjyre. Ai përqesh zakëet dhe tallet me ta, duke i nënvlerësuar në raport me racën e bardhë<sup>80</sup>.

<sup>76</sup> Didat, Ahmed. *Shejtani jetul ajat esh-shejtani jeh*. F. 82.

<sup>77</sup> [http://news.bbc.co.uk/hi/arabic/world\\_news/newsid\\_4140000/4140730.stm](http://news.bbc.co.uk/hi/arabic/world_news/newsid_4140000/4140730.stm)

<sup>78</sup> Shenavi, Fehmi. *Men verae Selman Rushdi – esrarul muamereti alel Islam*. F. 60.

<sup>79</sup> Affani, Sejjid Husejn. *A'lam ve akzam fil mizan*. 2/77.

<sup>80</sup> <http://www.muslm.net/vb/archive/index.php/t-257716.html>

### 6) Libri i tij bazë dhe themel për probleme tjera fetare dhe shoqërore

Libri inspiron për të keq ndërsa përmbajtja e tij nxit për krime.

- a) Përshtkrimi i femrave të bardha si femra për shfrytëzim seksual dhe dëfrim me to, ka bërë që të regjistrohen krime pikërisht të kësaj natyre<sup>81</sup>. Dr. Vernon Jones pranon se tregimet ndikojnë shumë në sjelljet e të rinjve.<sup>82</sup>
- b) Guximi i tij për ta përshkruar Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*] me gjëra që njollosnin nderin dhe moralin e tij, siç përmendëm dhe më parë, mbase ka motivuar edhe publikimin e karikatave, nismë të cilën, siç kemi përmendur, e përkrahte edhe vetë autori.
- c) Reagimet kundër tij kanë përfunduar jo gjithmonë në mënyrë paqësore. Janë regjistruar viktima nga radhët e protestuesve<sup>83</sup> por edhe nga radhët e promovuesve. Në Japoni përkthyesi u vra ndërsa në Itali u plagos<sup>84</sup>. Reagimet, jo çdoherë bëhen kundër tij. Ka raste kur pikërisht simpatizantët e tij janë ata që reagojnë dhunshëm, siç ndodhi para ca kohe kur sulmuan një qendër islame në Londër<sup>85</sup>.

Kësisoj, parandalimi i botimit të kësaj veprë do të ishte lajm i mirë për sigurinë dhe stabilitetin shoqëror.

### 7) Gjuha denigruese dhe banale e autorit

Autori është ndër më të pispillosurit. Kjo flet edhe për personalitetin e tij prej një të shthururi. Përdor shumë fjalë të ndyra<sup>86</sup>, saqë disa kanë përmendur shifra shumë të mëdha. Fjalën me 'katër shkronja' e përmend 57 herë<sup>87</sup> ndërsa fjalë tjera të pahijshme përmend shumë, ose sipas një kalkulimi 2023 herë por që nuk di sa mund të jetë i vërtetë.

<sup>81</sup> Didat, Ahmed. *Shejtani jetul ajat esh-shejtani jeh*. F. 12.

<sup>82</sup> Didat, Ahmed. *Shejtani jetul ajat esh-shejtani jeh*. F. 12.

<sup>83</sup> Affani, Sejjid Husejn. *A'lam ve akzam fil mizan*. 2/78.

<sup>84</sup> Gazeta Bota sot, edicioni online, 28.02.2009.

<sup>85</sup> Affani, Sejjid Husejn. *A'lam ve akzam fil mizan*. 2/80.

<sup>86</sup> Ived, Ibrahim. *Ma dha ba'de i'lani Selman Rushdi teubetehu – dirasetun fennijetun ve mevdujetun lil ajat esh shejtani jeh*. F. 128.

<sup>87</sup> Didat, Ahmed. *Shejtani jetul ajat esh-shejtani jeh*. F. 26.

Autori etiketon me emra, gjë që sipas fesë sonë është e ndaluar<sup>88</sup>, sikur që akuzon gra për moral<sup>89</sup>, siç ishte rasti me Mbretëreshën, kryeministren, etj.

Kjo kishte bërë që Ahmed Didat të mendonte shumë seriozisht për të se është i sëmure psikik.<sup>90</sup>

## Përmbyllje

Si duhet të veprojmë për ndalimin e publikimit-shpërndarjes së këtij libri?

Mediumëve iu ka interesuar ajo se a do të reagohej apo jo, dhe nëse po, atëherë në ç'formë?<sup>91</sup> Kjo dëshmon se mediat janë plotësisht në dijeni për pasojat që mund të paraqet botimi i kësaj veprë, andaj edhe pyesin, por, çudi pse e duan botimin e tij, çfarë i motivon?!

Bazuar në përvojat e mëhershme, protestat, si formë demokratike e shprehjes së pakënaqësive, i shoh si hap të fundit. Këtë e them ndërsa kam parasysh se buja që është bërë rreth tij më së paku i ka bërë dëm atij. Përkundrazi, Selmani ka fituar shumë nga këto reagime. Sikur të mos ishte fetvaja për kokën e tij, Selmani do të ishte një novelist i panjohur<sup>92</sup>. Madje vetë ai shprehet se për famë i detyrohet pikërisht fetvasë.<sup>93</sup>

Kështu, veprimet tona, jo vetëm që do të duhej të ishin të koordinuara ngase ndryshe, siç thotë Didati, nuk mund t'u rezistosh pasojave të tij<sup>94</sup>, porse do të duhej përqendruar edhe në pikat në vijim:

a) Presion organeve qeveritare, në këtë rast Ministrisë së Kulturës, që të mos lejojë botimin apo shpërndarjen -në rast se vjen nga jashtë vendi-, sepse kjo do të ishte shkak për probleme të mundshme. Pa-

kënaqësitë me Selmanin në botën islame janë ende dhe vazhdimisht ngrihen kundër tij, siç ndodhi në Indi tash së fundi<sup>95</sup>. Botimi i tij, sidomos në Kosovë, do të ishte provokim i rëndë. Mos harroni, Afrika e Jugut<sup>96</sup> e ndaloi këtë libër vetëm për shkak se fyente fenë e 2% të banorëve të saj, ndërsa në Shqipëri dhe Kosovë, sidomos në këtë të fundit, myslimanët janë shumicë.

b) Reagimet nga komunitetet tjera fetare, siç bën paraardhësit e tyre, që ne i cituam më parë ngase fundja, edhe ata janë të ofenduar ngase Selmani është ateist dhe gjuhës së tij s'i shpëton fetar dot.

Këto forma reagimi shënojnë edhe fundin e këtij punimi modest, për suksesin e të cilit e lus Allahun e Madhëruar shumë!

## Bibliografi:

1. Kur'ani Fisnik.
2. Suneni i Tirmidhiut, versioni i librarisë digjitale 'Shamile.'
3. Shenavi, Fehmi. (...) *Men verae Selman Rushdi – esrarul muamereti alel Islam*. Kajro: El muhtar el islamijj.
4. Cigar, Norman. (2003) *Roli i orientalistëve serbë për justifikimin e gjenocidit ndaj muslimanëve në Ballkan*. Shkup: Logos-A.
5. Kardavi, Jusuf. (2007) *Fetva bashkëkohore*. Shkup: Furkan ISM.
6. Ived, Ibrahim. (1991) *Ma dha ba'de i'lani Selman Rushdi teubetehu – dirasetun fennijjetun ve mevdujjetun lil ajat esh shejtaniijeh*. El matbatu en nemudhexhijeh.
7. Saud, Saib. (1991) *Err-rreddu alel murteddi Selman Rushdie shejtanu-sahajineti*. Tarablus: Xherus bus.
8. Didat, Ahmed. (...) *Shejtaniijetul ajat esh-shejtaniijeh*. Kajro: Darul fadileh.

<sup>95</sup> Gazeta Bota sot, edicioni online, 20.01.2012.

<sup>96</sup> Didat, Ahmed. *Shejtaniijetul ajat esh-shejtaniijeh*. F. 70.

<sup>88</sup> Shih: Kur'ani: el-Huxhurat, 11.

<sup>89</sup> Shih: Kur'ani, en-Nur, 4; 23.

<sup>90</sup> Didat, Ahmed. *Shejtaniijetul ajat esh-shejtaniijeh*. F. 82.

<sup>91</sup> <http://lajme3.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/1047217743/titulli/Botuesja-Arlinda-Dudaj-ndez-debatin--mbi-botimin-e-Vargjet-Satanike-te-Selman-Ruzhdie>

<sup>92</sup> <http://www.ahewar.org/debat/show.art.asp?aid=129124>

<sup>93</sup> <http://www.mutawassetonline.com/issues/7720-كشـفـالمستـور بينـالخمينيـوسلمانـرشدي.html>

<sup>94</sup> Didat, Ahmed. *Shejtaniijetul ajat esh-shejtaniijeh*. F. 84.



9. Affani, Sejhid Husejn. (2004) *A'lam ve akzam fil mizan*. Dar Maxhid Ajseri lin neshri vet tevzië.
10. Arshin, Muhammed Ibn Abdullah. *Ma shaa ve lem jethbut fi-s-siretin nebevijeh*. Daru tajjibe.
11. Albani, Muhammed Nasiruddin. (1996) *Nasbul mexhanik li nefi kissatil garanik*. Bejrut: El mekteb el islamiji.
12. Gazeta Bota sot, edicioni online.
13. Gazeta Zëri, edicioni online.
14. Gazeta Koha ditore, edicioni online.
15. Gazeta Shekulli, edicioni online.
16. Gazeta Express, edicioni online.
17. [http://www.bbc.co.uk/arabic/worldnews/2011/11/111115\\_rushdie\\_facebook\\_citory.shtml](http://www.bbc.co.uk/arabic/worldnews/2011/11/111115_rushdie_facebook_citory.shtml)
18. <http://www.24-ore.com/index.php/arte/libri/6477-romantiku-selman-rushdie.html>
19. <http://www.muslm.net/vb/archive/index.php/t-257716.html>
20. <http://www.dw.de/dw/article/0,,15881937,00.html>
21. <http://www.shqiptarja.com/news.php?IDCategoria=2730&IDNotizia=76203>
22. <http://www.mutawassetonline.com/issues/7720--كشف-المستور-بين-الخميني-وسلمان-رشدي.html>
23. <http://www.ahewar.org/debat/show.art.asp?aid=129124>

Sedat Islami

## These are the reasons why RUSHDIE should not be published in Albanian

### (Summary)

“The Satanic verses” is a book, whose author is Salman Rushdie, a British-Indian novelist. Its publication caused huge commotion, which in a number of cases, had tragic consequences. The reason for this are the insults the author makes towards Islam, Muhammed [*alejhis salatu ves selam*] and Muslims. It has been widely discussed whether this book insults people on a religious basis and whether its publication falls within the right to freedom of thought and expression.

This article deals with this book and its author from this perspective. Through facts the article proves that this book should not be published in Albanian and that its eventual publication will not honor anyone.

سدات اسلام

## لماذا لا يجب ان تنشر رواية رشدي باللغة الألبانية (خلاصة البحث)

### ملخص

"آيات شيطانية" هي الرواية التي كتبها الكاتب البريطاني الهندي، سلمان رشدي، الذي أثار ردود فعل، في بعض الحالات، كان لها نتيجة مأساوية، و يرجع سبب ذلك ال الاهانة التي يكتها الكاتب الى الاسلام و محمد [صلي الله عليه وسلم] و المسلمين. و دارت مناقشات كثيرة عن ما يقدم هذا الكتاب أو لا إهانة للقاعدة الدينية وأن محتواه أو ليست ضمن القانون وحرية التعبير والفكر. وتتناول هذه الورقة هذا الكتاب ومؤلفه من قبل هذه الجوانب مع الوقائع والأدلة، لماذا لا يجب أن ينشر هذا الكتاب، وان نشره في نهاية المطاف لا يشرف أي شخص.

## KUMTESË

*Kasim Gërguri*

### VËSHTRIM DISPENSËS SË AHLAKUT II TË MULLA SADRI EF. PRESTRESHIT

Çdo bashkësi njerëzore në botë, përveç shenjave specifike, i kanë edhe zakonet e veta të përshëndetjes. Edhe ne myslimanët, jo vetëm në vendin tonë, por edhe në mbarë botën pa marrë parasysh se në ç'anë të botës jetojmë, e kemi përshëndetjen e përbashkët, Selamin.

Të dhënit selam është fetarisht e preferuar, kurse ta kthesh selamin është detyrë - vaxhib dhe është vaxhibi kifaje, domethënë prej një grupit mjafton një person ta japë ose ta marrë selamin "Shpëtimi dhe paqja qoftë me ju".<sup>1</sup>

Kështu e fillon temën Sadri ef. Prestreshi kur flet për SELAMIN në Dispensën e tij dedikuar nxënësve të klasës së dytë.

AHLAKU-Dispensë për klasën e dytë, e përgatiti arsimtari i lëndës Sadri Prestreshi, Prishtinë 1979, Botues Medreseja e Mesme Alaiddin e Prishtinës.

Historia Islame është e vjetër sa edhe vet njeriu, si pjesë e kësaj historie, kulture vlere e pasurie është edhe jeta dhe veprat e personaliteteve të shquar mysliman shqiptar të cilat BIRK, është përpjekur ti

hulumtoj e prezantoj si fakt, argument dhe dëshmi se toka shqiptare ka lindur, rritur e edukuar personalitete të shquar që kanë lënë gjurmë në historinë tonë dhe që jetën e tyre e përkushtuan në dobi të fesë e atdheut.

Në mesin e këtyre personaliteteve të shquara në thesarin e kulturës fetare Islame e shqiptare ka zë vend edhe personaliteti i Myderriz Sadri ef. Prestreshit i cili gjithë jetën e tij e kaloi në shërbim të fesë dhe në dobi të kombit e atdheut shqiptar.

Sadri ef. Prestreshi duke kryer një varg detyrash me përgjegjësi si: mësues, imam, vaiz, hatib, nëpunës në administratën e Kryesisë së BIK, edukator e së fundi edhe profesor, e bëri myderrizin të njohur gjithandej Kosovës dhe më gjerë. Pra Myderriz Sadri ef. Prestreshi pa dyshim ishte njëri prej hoxhallarëve dhe intelektualëve më të dalluar të kohës së tij.

Sadri ef. Prestreshi si profesor i lëndës së Ahlakut në Medresenë e Mesme Alaiddin të Prishtinës, duke parë mungesën e teksteve adekuate për nxënësit pa përtesë i qaset punës për nxjerrjen në dritë të një dispense sipas plan-programit për nxënës. Ne sot përmes kësaj dispense shohim kontributin e tij shkencor dhe fetar. Fillimisht përgatiti dispensën e vitit të parë që doli nga shtypi në vitin 1975 dhe katër vite më vonë më 1979 përgatiti dispensën tjetër për klasën e dytë të Medresesë.

Sadri ef. Prestreshi, në Medrese fillimisht ishte edukator e më vonë në procesin mësimor, myderriz i përkushtuar ku mbajti lëndën e Ahlakut, atë të Kuranit, e herë-herë e gjejmë edhe profesorë të lëndëve tjera, ku dha një kontribut të çmuar në fushën e edukimit dhe të arsimit të gjeneratave të reja.

Ishte një myderriz i afërt e i dashur me nxënësit e tij përse më së miri sot flasin ish-nxënësit dhe kolegët e tij, i përballur me mungesën e literaturës në gjuhën shqipe, myderrizi Sadri ef. Prestreshi, merr përsipër përgatitjen e dispensave për lëndën e Ahlakut.

Myderrizi, dispensat i kishte përgatitur sipas plan-programit mësimor të Medresesë në vitet e 70. Ajo që duhet potencuar me këtë rast është fakti se me përgatitjen e këtyre dispensave, përpos që u shënua

<sup>1</sup> Sadri Prestreshi, AHLAKU dispencë për klasën e dytë, Medreseja e mesme Alaiddin Prishtinë 1979, fq.28.

një hap i madh për literaturën e nxënësve të medresesë për lëndën e "Ahlakut", Myderrizi me këtë i bashkohet ulemave shqiptar që më punën e tyre kontribuuan në filltet e literaturës islame në gjuhën shqipe në Kosovë, ngase në këtë kohë dispensat e Medresesë kishin përdorim më të gjerë.

Temat për të cilat fletë Myderriz Sadri ef. Prestreshi janë të qarta dhe të argumentuara mirë me ajete kur'anore dhe hadithe të Pejgamberit a.s. po ashtu të ilustruara edhe me shembuj logjik, gjithashtu thënie të shkencëtarëve të ndryshëm të cilët flasin për çështje të caktuara.

Dispensa e Ahlakut është e formatit A4 e shkruar me makinë dore. Dispensa nuk ka parathënie as përmbajtje.

### **Tema e parë e është:**

#### **DASHURIA NDAJ ALLAHUT XH.SH.DHE FESË ISLAME**

Në këtë temë autori trajton shumë bukur dashurinë ndaj Allahut dhe fesë Islame duke argumentuar me ajete nga Kurani, hadithe të Muhamedit a.s. dhe citon një shkrimtarë arab i cili flet për dashurinë ndaj Allahut.

Citoj: "Sipas të dhënave, feja e lartë islame, u është shpallur të gjithë profetëve dhe që të gjithë e kanë predikuar po këtë fe. Meriton që me të vërtetë ta duam këtë fe dhe dashurinë ndaj saj ta manifestojmë në përgjithësi. Ta duash fenë do të thotë:

- ta duash Allahun xh.sh. Krijuesin tënd dhe Mirëbërësin më të madh;

- t'i duash të gjithë profetët e Tij, posaçërisht profetin e fundit, Muhamedin alejhis-selam.

Çfarë dashurie ndaj Allahut dhe profetëve të Tij, si themelues i rregullave islame, duhet të kultivojmë? Në këtë pyetje më së miri na jep përgjigje ajeti dhe hadithet e cituara më poshtë:

**"Thuaju: O Muhamed! Nëse e doni Allahun – më dëgjoni mua, Zoti do t'ju dojë dhe do t'ju falë mëkatet e juaja: Zoti është ai që do t'ju falë dhe është i mëshirshëm."** (Ali Imran, 31- 53 K).

Pastaj vazhdon me argumente nga hadithi i Muhamedit a.s:

"Se sa është e dobishme që ta duash Allahun dhe Muhamedin a.s. më së miri e vërejmë nga ky hadith sherif:

"Enesi, i biri i Malikut tregon se dikush e pyeti Muhamedin a.s.: "Kur është Dita e Gjykimit, o Profet? Muhamedi a.s. iu përgjigj: "Ç'ke përgatitur për Ditën e Gjykimit?" Ai iu përgjigj: "Nuk kam përgatitur shumë të mira prej namazit, as agjërimit, as sadakasë, por unë e dua Allahun dhe Profetin e Tij." Më tutje Muhamedi a.s. i tha: "Ti je me atë që e do."

Myderrizi Sadri ef. Prestreshi vazhdon me një poet arab, të cilit nuk ia përmend emrin i cili kur flet për dashurinë ndaj Allahut thotë:

"Gabon ndaj Zotit kur ti mendon se e do Atë, kjo është një gjë e pamundshme dhe krejtësisht e çuditshme. Sikur të ishte dashuria jote e singertë do t'i nënshtroheshe Atij. Me të vërtetë i dashuruari i nënshtrohet Atij që e don."<sup>2</sup> mbaron citati.

Pra në këtë mënyrë Myderrizi i qaset temave për të qenë sa më e kapshme për nxënësit e tij.

### **Me radhë na vie tema:**

#### **ISLAMI DHE DITURIA**

Autori këtë temë e shtjellon në mënyrë shumë të mire, fillimisht argumenton kërkimin e diturisë me ajete nga Kur'ani, hadihe nga Pejgamberi a.s. fjalë të rëndësishme nga sahabet e Pejgamberit a.s. dhe fakte bindëse nga historia Islame.

Autori zgjedh ajetet bazë për kërkimin e diturisë duke paraqitur në përkthim fjalët e Allahut:

**"Thuaj (o Muhamed): A mund të krahasohen ata që dinë dhe ata që nuk dinë?"** (Ez-Zumer, 9), pastaj,

**"Zoti i ngrit në shkallë të lartë ata (njerëz) të cilët besojnë dhe ata të cilët janë të pajisur me dituri."** (El-Muxhadele, 11)

Dhe Ajete të tjera lidhur me këtë temë.

Kurse nga hadithet e Pejgamberit lidhur me diturinë përzgjedhë:

<sup>2</sup> Sadri Prestreshi, AHLAKU dispencë për klasën e dytë, fq.3, Medreseja e mesme Alaud-din Prishtinë 1979.

“Ai që del prej shtëpisë së vet për ta kërkuar diturinë është në rrugë të Zotit xh.sh. derisa të kthehet.”

Kurse nga sahabët përzgjedhë Hazreti Aliun r.a., i cili ka thënë:

“Ajo ditë që më kalon pa mësuar diçka është ditë e pafatshme për mua.”<sup>3</sup> Për të vazhduar me fakte nga historia islame ku përmend qendrat kryesore të civilizimit dhe kulturës islame, duke filluar me Bagdadin, Kordobën, Kairon e në anën tjetër tokat e Azisë që kanë qenë të njohura për nga dituria e kultura siç ishin: Buhara, Samerkandi, Nisaburi, etj.

**Autori ajetet e Kur'anit** i përkthen tregon suren në të cilën gjendet ajeti, numrin e ajetit, gjithashtu tregon edhe faqen e Kur'anit që është e pazakontë ndër autorë.

Kurse hadithet e Pejgambetit a.s.vetëm i përkthen pa treguar kategorinë e hadithit dhe pa sened, po ashtu edhe fjalët e sahabëve dhe thëniet të shkencëtarëve e të tjerë.

Sipas hulumtimit tonë të gjitha hadithet janë të përzgjedhura nga koleksionet e njohura të haditheve.

### **Tema e tretë:**

### **ISLAMIZMI DHE HIGJIENA**

Në këtë temë Sadri ef.Prestreshi pasqyron rregulla të përgjithshme mbi pastërtinë shpirtërore dhe atë fizike. Në veçanti përkufizohet në mbajtjen e higjienës që është edhe parandalues i sëmundjeve. Citon:

Kur'ani dhe Muhamedi a.s. na mësojnë se trupi i njeriut dhe shpirti i tij janë rritur njëri me tjetrin dhe ndikojnë njëri në tjetrin. Nëse trupi është i sëmurë, atëherë edhe shpirti është i sëmurë dhe anasjelltas. Prandaj islami aq sa e edukon njeriun në pikëpamje shpirtërore aq më shumë e edukon edhe në pikëpamje trupore.

Allahu i Gjithëfuqishëm na udhëzon dhe thotë në Kur'an:

***“Me të vërtetë Allahu i do ata të cilët pendohen sinqerisht prej të gjitha mëkateve dhe ata të cilët kujdesen për pastrim.”*** (El-Bekare, 222)

Vetë Muhamedi a.s. me mënyrën e jetës së vet si edhe me fjalë ka dhënë udhëzime në pikëpamje të mbrojtjes së trupit me anën e pastërtisë. Kështu në një rast ka thënë:

*“Pastërtia është gjysma e imanit.”*<sup>4</sup>

**Sadri ef.Prestreshi** ishte pedant me qëndrim të prerë dhe bindës. Ishte i qartë dhe real në argumentimin e çështjeve fetare përmes Kur'anit dhe haditheve të Pejgambetit a.s. në lidhje me falltarët dhe hajmalitë ishte kategorik. Ai në rast të sëmundjes preferonte kurimin mjekësor. Citojmë thënien e tij në këtë kontekst:

Edhe përkundër kujdesit më të madh e ndonjëherë edhe nga pakujdesia, njeriu sëmuret dhe e humb shëndetin. A duhet të mjekohet me hajmal apo me ndonjë fall tjetër, apo do të shërbehet me shkencën e mjekësisë? Gjithqysh islamizmi porositi këtë të fundit, e kursesi hajmalitë dhe fallin apo njërin prej tyre e të ngjashme. Muhamedi a.s. thotë:

“Me të vërtetë kur Allahu e ka krijuar sëmundjen e ka krijuar edhe ilaçin e saj.”

Më lejoni që në pika të shkurtra të përmend titujt kryesor të dispensës Ahlaku II

**Qëndrimi i Islamit ndaj unitetit, solidaritetit dhe bashkësisë**

**Drejtësia dhe dashuria reciproke në islam**

**Përsëritja - selami**

**Sjellja e muslimanëve ndaj jomuslimanëve**

**Jeta familjare në Islam**

**Pozita e gruas në Islam**

**Vlera e punës**

**Tregtia dhe ekonomia në kuptimin Islam**

<sup>3</sup> Sadri Prestreshi, AHLAKU dispencë për klasën e dytë, fq.7, Medreseja e mesme Alauddin Prishtinë 1979

<sup>4</sup> Sadri Prestreshi, AHLAKU dispencë për klasën e dytë, fq.13, Medreseja e mesme Alauddin Prishtinë 1979

**Islami dhe lypja**

**Islami dhe vallazërimi**

**Sjellja e të gjallëve ndaj të vdekurve dhe ndalimi i të kërkuarit  
ndihmë prej tyre**

**Toleranca dhe Islami**

**Frika ndaj Zotit xh.sh.**

**Turpi ndaj Zotit xh.sh., ndaj botës dhe ndaj vetvetes**

**Falënderimi dhe sinqeriteti ndaj Allahut**

**Të mbështeturit në Allahun xh.sh. (et-tevekkul)**

**Kënaqësia me dispozitat e Allahut xh.sh.**

**Të kujtuarit e vdekjes**

**Vetitë e muslimanit të vërtetë të cilat janë bazë lumturie edhe në  
këtë botë**

**E keqja si rrjedhojë e mëkateve**

dhe krejt në fund myderrizi i nderuar e përfundon dispensën me temën

#### **PENDIMI (TEVBEJA)**

Citon: Edhe pse Allahu i Gjithëfuqishëm në Kur'an në shumë vende kërkon prej njerëzve, veçanërisht prej besimtarëve myslimanë, që pa farë kushti t'i nënshtrohen duke i kryer diçka nga urdhrat e Tij dhe duke ikur prej të gjitha atyre çka Ai i ka ndaluar, megjithatë, prapëseprapë mund të themi lirisht se s'ka njeri që s'gabon. Dallimi qëndron vetëm në atë që dikush gabon më pak e dikush më shumë.<sup>5</sup>

Muhamedi a.s. thotë:

*“Ai që pendohet është i dashuri i Zotit.”*

Për pendim nuk ka afat të caktuar e as të kufizuar.

Myderrizi i nderuar përfundon dispensën duke u penduar për gabimet e mundshme me fjalët:

***O Zoti i Madhërishëm! Pendohem për atë që me dashje ose pa të kam gabuar. O Zot, pendohem te Ti, Ty të kthehem dhe fenë e vërtetë e pranoj. Ty të besoj dhe gjithçka që iu është shpallur profetëve është e vërtetë dhe e drejtë.***

<sup>5</sup> Sadri Prestreshi, AHLAKU dispencë për klasën e dytë, fq.104, Medreseja e mesme Alauddin Prishtinë 1979.

*Eshhedu en la ilahe il-lall-llah ve eshhedu enne Muhameden abduhu ve resuluhu.*<sup>6</sup>

Lusim Allahun që kjo dua të jetë e pranuar dhe kjo vepër e tij të jetë shkak që Myderrizin e nderuar ta gradoj në xhenetet e larta.

<sup>6</sup> Sadri Prestreshi, AHLAKU dispencë për klasën e dytë, fq.109, Medreseja e mesme Alauddin Prishtinë 1979.

Kasim Gërguri

## A LOOK INTO MULLAH SADRI EF. PRESTRESHI'S MANUAL AKHLAQ II

### (Summary)

Every human community in the world has its own greeting traditions. Muslims all over the world use the Islamic form of greeting: Salaam.

From the religious viewpoint, it is recommended to greet someone, whereas it is obligatory to reply. The salaam of one person, who is a member of a larger group, will be sufficient on behalf of all the group. Likewise, if one person from the other group replies to the salaam, it will be sufficient on behalf of all the rest.

This is how the issue of salaam is presented in Sadri ef. Prestreshi's manual for second year students.

Akhlaq – manual for second year students, prepared by Sadri Prestreshi, Prishtina 1979, Published by the Alauddin Madrassa in Prishtina.

قاسم غرغوري

## لمحة عامة عن الأخلاق الثاني من الملا صدري أفندي بريستريشي (خلاصة البحث)

لكل مجتمع بشري في العالم علامات محددة، وبعبادتها الخاصة من تحية. حتى نحن المسلمين، وليس فقط في بلدنا ولكن أيضا في جميع أنحاء العالم بغض النظر عن المكان الذي نعيش فيه، لدينا تحية مشتركة و هي والسلام.

التحية في الاسلام تعتبر من الاشياء الفضلة دينيا و لكن ردها يعتبر واجبا او واجب كفاية و هذا يعنى ان في مجموعة من الاشخاص يكفى شخص واحد ان يرد يسقط عن البقية.

وهكذا يبدأ هذا الموضوع صدري بريستريشي موجهها كتيبه الى طلاب الصف الثاني لمدرسة "علاء الدين".

الأخلاق، كتيب للصف الثاني، اعداد من المدرس: صدري بريستريشي، بريشتينا ١٩٧٩، الناشر : مدرسة "علاء الدين" - بريشتينا.

## HISTORIOGRAFI

*Zachary Karabell*

### XHIHADI I SALAHUDINIT?

Ushtarët u shfaqën në periferi të Jerusalemit në fund të shtatorit, pak para vjeshtës solstike më 1187. Kishin kaluar gati një shekull që kur frankët kishin pushtuar qytetin, dhe asnjë ushtri myslimane nuk kishte qenë afër rimarrjes së tij. Pas masakrimit të ish-banorëve të tij më 1099, mbretëria e Jerusalemit hyri në një periudhë të gjatë të qetësisë dhe prosperitetit. Pelegrinët nga Evropa vinin e shkonin lirshëm, dhe mbreti merrte haraçin e qyteteve dhe zotëronte bregdetin e Palestinës.

Gjatë dekadave, megjithatë, frankët dështuan të zgjerojnë fitoret e tyre të para. Në vjeshtën e vitit 1187, megjithëse sundimtarët në Jerusalem ishin të vetëdijshëm për kërcënimin e afërt, ata ishin akoma të përgatitur keq, kur më në fund arriti në muret e tyre. Shtylla e ushtrisë së mbretërisë ishte shkatërruar vetëm disa muaj më parë, kur Salahudini, sulltani i Egjiptit dhe sundimtari i Damaskut dhe Alepit, asgjësoi ushtritë e Templarëve dhe frankëve në betejën e Hatinit. Mbreti i Jerusalemit u kap dhe u mbajt peng, ndërsa administrata e qytetit iu la mbretëreshës Sibylla dhe patriarkut. Fjala për avancimin e Salahudinit në Jerusalem, pas një sulmi në Askalan, i parapriu arritjes së tij, por

mbretëresha nuk mund të bënte asgjë veçse të shikonte qytetin nën rrethim.

Për pjesën e tij, Salahudini ishte fitues me madhështinë e asaj që ishte gati të arrinte. Ai, gjatë pesëmbëdhjetë vjetëve të mëparshme, ndryshoi peizazhin politik të Lindjes së Afërt dhe krijoi një dinasti të re që bashkoi Egjiptin dhe Sirinë për herë të parë në shekuj. Gjatë viteve të betejave taktike kundër të krishterëve dhe myslimanëve, ai kishte një qëllim në mendje: dëbimin e frankëve dhe krijimin e një perandorie të re me veten si sulltan në shërbim të Zotit. Tani, me ushtritë e tij të rreshtuara dhe të përgatitura për të pushtuar Jerusalemin, ai kujtoi se pse ishte aty në radhë të parë.

Vetëm disa javë më parë, jashtë Askalanit, një delegacion i tregtarëve nga Jerusalemi iu drejtua atij me një ofertë paqeje. Propozimi i tyre ishte që pasuria e Jerusalemit të mbetej e pavarur dhe e paprekur, por Salahudini do të bëhej sundimtar i rrethinave të tij. Salahudini, reputacioni i të cilit për drejtësi madje më vonë u bë edhe legjendë, mori me seriozitet sugjerimin e tyre. Ai e dinte se ajo që kishte ndodhur herën e fundit kur qyteti kishte ndryshuar sundimtarët, kur u boshatis dhe vendet e tij të shenjta u kthyen në skena të masakrave, dhe ai nuk dëshironte përsëritje. “Besoj”, i tha delegacionit, “se Jerusalemi është Shtëpi e Zotit, siç besoni ju gjithashtu, dhe unë me vullnet nuk do ta rrethoj Shtëpinë e Zotit apo ta sulmoj”. Ai tha se në këmbim për dorëzimin, ai do t’i lejonte të krishterët të mbanin pronat e tyre dhe një pjesë të tokës. Kjo ishte një ofertë e ngjashme me atë që kishin shpresuar, por ata refuzuan.

Në çdo çast tjetër gjatë shekullit të kaluar, kjo do të nënkuptonte fundin e qytetit dhe banorëve të tij. Por, Salahudini kishte një natyrë tjetër. I vendosur për të nderuar Jerusalemin, ai detyroi Balianin, një fisnik të ngarkuar me detyrën e pamundur të mbrojtjes së qytetit, që të vinte për marrëveshje. Pasi që myslimanët çanë muret, Baliani, i nxitur nga patriarku, shkoi nën flamurin e armëpushimit te tenda e Salahudinit. Armët e vetme që i kishin mbetur ishin fjalët, dhe ai paralajmëroi Salahudin që kalorësit e Jerusalemit, dhe Templarët e Hospitalerët mbi të gjithë, ishin të gatshëm të vdisnin si martirë duke



mbrojtur qytetin. Ata mund të humbnin në fund, tha ai, por do ta bënin këtë shtrenjtë. Salahudini hodhi poshtë paralajmërimin si një blufë të një njeriu të mundur, dhe ia kujtoi Balianit se çka kishte ndodhur kur të krishterët kishin marrë qytetin dekada më parë. A dëshironte Baliani të ishte përgjegjës për një masakër madje edhe më të madhe? Nuk ishte një kërcënim bosh. Salahudini kishte reputacion për tolerancë, por ai gjithashtu kishte shfaqur çaste zemërimi dhe mizorie. Sikur çdo sundimtar i suksesshëm i asaj kohe dhe vendi, ai ishte i aftë për dhunë. I përballur me realitetin e humbjes, frankët u dorëzuan.

Të premten, më 2 tetor 1187, trupat e Salahudinit morën kontrollin e Jerusalemit. Ata ishin shumë të drejtë ndaj të pushtuarve. Mbajtën disiplinën, dhe qyteti ndryshoi pronarët shpejt dhe pa gjak. Njerëzit e Salahudinit rimorën Kubën e Gurtë dhe Xhaminë Al Aksa, dhe ata e bënë këtë në një ditë plot simbolizëm. Sipas kalendarit mysliman, ishte përvjetori i udhëtimit të natës të Muhamedit, kur, për nder të passionit të Krishtit, ai u transportua me një krijesë magjike që i ngjante kalit, Burak, në Kubën e Gurtë dhe nga atje në qiell.

Salahudini ishte i nderuar me madhështinë e asaj që kishte arritur. Ai interpretoi rimarrjen e Jerusalemit si një shenjë të kënaqësisë së Zotit, dhe ishte i vendosur për të shfaqur respektin e tij. Kronistët e mëvonshëm të pallatit u përfshinë vetë në përshkrimin e asaj që ndodhi. Pas sigurimit të qytetit, Salahudini u fokusua në pastrimin e Xhamisë Al Aksa. Pasi ishte e okupuar nga Templarët për aq shumë vite, kjo nuk ishte një detyrë e lehtë. Por, me njerëz që punonin ditë e natë, ajo u restaurua shpejt. Pastaj, sipas kronistit Imad ad-Din,

*Lexuesit e Kuranit arritën, u bënë lutjet zyrtare, asketët dhe të devotshmit u mblodhën... Ata u bashkuan në grupe për t'u lutur dhe për t'u gjuhëzuar, duke përlur veten dhe duke rrahur gjokset e tyre, njerëz me pozitë dhe asketë, gjykatës dhe dëshmitarë, fanatikë dhe luftëtarë në Luftën e Shenjtë, duke qëndruar e duke u ulur, duke bërë rojë dhe të vendosur për t'u lutur gjatë natës... Tradicionalistët recituan, oratorët e shenjtë qetësuan zemrat e njerëzve, dijetarët debatuan, avokatët diskutuan, folësit rrëfyn.*

Megjithëse një numër i konsiderueshëm i të krishterëve të qytetit u mbajtën për haraç, ata u trajtuan ndershëm. Duke ditur angazhimin e Salahudinit për parimet bazike të Islamit, kjo kishte kuptim. Ai i mori seriozisht urdhrat e Kur'anit rreth Ithtarëve të Librit, dhe kjo mund të kishte udhëzuar zgjedhjen e predikuesit, i cili bëri predikimin e parë në Xhaminë e rishenjtëruar të Al Aksës: kryegjykatësi i Alepit, i njohur për elokuencën dhe diturinë e tij, i cili mbajti një leksion të pasionuar rreth rëndësisë së Jerusalemit për myslimanët kudo.

*“O njerëz”, thirri ai,*

*Gëzohuni lajmeve të mira. Zoti është i kënaqur me atë që keni bërë, dhe ky është kulmi i dëshirës së njeriut; Ai ju ka ndihmuar që të ktheni këtë deve të humbur nga rruga e gabuar dhe ta drejtoni në tufën e Islamit, pasi që të pafetë e kishin keqtrajtuar atë për gati njëqind vjet. Duke iu gëzuar pastrimit të Shtëpisë... Ajo ishte vendbanimi i babait tuaj Ibrahimit (Abraham), vendi ku profeti Muhamed, Zoti e bekoftë, u ngjiti në Qiej, kibla nga e cila jeni drejtuar për t'u falur në fillim të Islamit, vendbanimi i profetëve, streha e të shenjtëve, varri i të shenjtëve, vendi ku ka zbritur shpallja e Zotit, dhe ku gjithë njerëzit duhet të mbledhen në Ditën e Ringjalljes dhe Ditën e Gjykimit... Ai është qyteti në të cilin Zoti ka dërguar shërbëtorët dhe apostujt e tij, dhe Fjala, e cila ka hyrë te Maria dhe Jezusi.<sup>1</sup>*

Rimarrja e Jerusalemit ishte kulmi i ëndrrës për Salahudin. Në fillim të jetës së tij, ai dedikoi veten unifikimit të Sirisë dhe Egjiptit si një hap i parë i domosdoshëm për një sulm të koordinuar mbi shtetet kryqtare dhe xhevahirin e tyre, mbretërinë e Jerusalemit. Duke veshur mantelin e luftës së shenjtë, ai arriti ambicien e jetës së tij dhe dëboi të krishterët nga Kubeja e Gurtë. Dhe, në atë moment të lavdisë, pre-

<sup>1</sup> Imad al-Din është cituar në Gabrielli, *Arab Historians of the Crusades*, 160ff.; përgjigja e Salahudinit për delegacionin nga Jerusalemi dhe fjalimi i gjykatësit (kadi) të Alepit në xhaminë al-Aksa është cituar në Stanley Lane-Poole, *Saladin: All Powerful Sultan and the Uniter of Islam* (New York: Cooper Square Press, 1898, 2002), 224-25, 236ff., e cila është përkthyer nga Ibn Khallikan. Shih gjithashtu Runciman, *A History of the Crusades*, vol. 2, *The Kingdom of Jerusalem and the Frankish East, 1100-1187*.

dikuesi i tij i zgjedhur bëri një predikim triumfues që lidhte Jerusalemin me traditën biblike të Abrahamit dhe Jezusit.

Jerusalemi ishte i shenjtë për Islamin, pikërisht pasi kishte qenë i shenjtë për hebrenjtë dhe të krishterët. Më vonë u bë i shenjtë për Muhamedin dhe komunitetin mysliman, por vetëm për atë se ishte qytet i apostujve. Shkurtimisht, Jerusalemi ishte shenjtëruar në sytë e myslimanëve jo vetëm për këtë, por pasi ishte i shenjtë i të shenjtëve për Ithtarët e Librit. Për Salahudin, Jerusalemi ishte zam që lidhte Ithtarët e Librit me Islamin. Lufta e tij e shenjtë që kishte bërë kundër shteteve myslimane dhe të krishtera që i dolën rrugës së unifikimit të gjithë komunitetit të besimtarëve - krishterë, hebrenj dhe myslimanë - nën flamurin e Islamit dhe shtëpisë së Salahudit.

Kjo është një thirrje e largët sesi është parë zakonisht kjo periudhë. Thjesht bardhezija jonë kundër tyre, myslimanët kundër të krishterëve, nuk i afrohet shpjegimit se pse Salahudini bëri atë që bëri, dhe kuptimi modern i luftës së shenjtë nuk ndihmon. Megjithatë Salahudini është një nga disa myslimanët historikë, i cili gëzon imazh favorizues në Perëndim, kjo nuk do të thotë se ai kuptohet. Ai mund të ketë qenë një person fisnik krahasuar me bashkëkohësit e tij, por gjithashtu ai ishte njeri i kohës së tij. Ai zhvilloi xhihad kundër pushtuesve të krishterë nga Evropa si pjesë të një strategjie të madhe për të ndërtuar një dinasti dhe për t'ia kthyer Lindjes së Afërt madhështinë e shekujve VII dhe VIII.

### **Lufta e Shenjtë**

Salahudini nuk ishte i pari që përdori gjuhën e luftës së shenjtë, por para tij, ajo ishte e paefektshme. Madje, edhe me dështimin e Kryqëzatës së Dytë më 1147 dhe paaftësisë së princërve të krishterë për të pushtuar Damaskun, Jerusalemi mbeti i paprekur dhe i pasfiduar. Emirët turq dhe arabë të Sirisë dhe Egjiptit mbetën të paktën po aq të angazhuar në luftimin e njëri-tjetrit, ashtu siç ishin në luftimin e frankëve apo bizantinëve. Diku në mes të shekullit XII, megjithatë, peizazhi filloi të ndryshojë. Një varg i princërve të fuqishëm turq dhe

kurdë u bashkuan për të formuar shtetin e frikshëm rival të Jerusalemit. Plasaritja e parë që u shfaq në fasadën e frankëve ishte rënia e Edessas, dhe tjetra ishte debakli i të krishterëve në portat e Damaskut gjatë Kryqëzatës së Dytë. Nismëtar i kësaj të çare ishte sundimtari i Alepit, Nur al-Din.

Balanca politike në Lindjen e Afërt ishte përcaktuar nga dy rivalitete: një midis Alepit dhe Damaskut, tjetri midis mbretërisë së Jerusalemit dhe shteteve të afërta myslimane. Në Alep, Nur al-Din i njohur si “Mbreti i Shenjtë”, pasoi babanë e tij, Zengi, më 1146. Babai i tij paraqiste një hije të gjatë, prandaj frikësohej që emiri rival i Damaskut kishte hyrë në aleanca me mbretin e Jerusalemit vetëm për ta frenuar atë. Ky ishte rasti klasik i “armiku i armikut tim është miku im”. Gjithashtu, ky ishte edhe biznesi zakonisht në Lindjen e Afërt në këtë kohë. Një muaj, ushtritë ishin rreshtuar në anën e besimit, dhe të krishterët u bënë ballë myslimanëve. Pastaj, posa të vdisnin disa nga princërit, apo vriteshin, aleancat e vjetra prisheshin dhe formoheshin të reja, që nuk bazoheshin në besim, por në atë se kush çka dëshironte. Në rërën lëvizëse politike të rajonit, Bizantinët shpërngulën frankët, ndërprenë kryqëzatat nga Evropa, Fatimitët e Egjiptit, sulltanët selxhukë dhe emirët arabë garonin për epërsi. I vendosur në mënyrë strategjike në qendër të rrugëve dhe pozitës tregtare midis shteteve franke të brigjeve të Mesdheut dhe tokës turke, Damasku ishte çmimi kryesor.

Sundimtari i Damaskut bëri një aleancë të ftohtë me frankët në përndim dhe kërcënimin e Alepit dhe Nur al-Dinit në veri e lindje, duke u përpjekur ta trajtonte njësoj. Derisa ruajti teknikisht paktin e tij me Jerusalemin, ai në mënyrë agresive u përpoq ta mundte Nur al-Dinin, i cili përfundimisht u pajtua me partneritetet. Kjo prishi balancën midis Damaskut dhe mbretërisë së Jerusalemit dhe ndihmoi fillimin e Kryqëzatës së Dytë. Nur al-Dini pastaj shfrytëzoi rastin e krijuar pas largimit të ushtrive të dështuara të kryqtarëve pas vitit 1147 dhe shtriu sundimin e tij. Shtatë vjet më vonë, ai bëri atë që ushtritë e Kryqëzatës së Dytë nuk e bënë dhe pushtoi Damaskun.

Aneksimi i Damaskut, jo vetëm që transformoi Nur al-Dinin në një nga lojtarët më të fuqishëm në rajon; për shkak të karakterit të tij të pazakonshëm, por gjithashtu ishte shtytje e ndryshimit në ton. Nur al-Dini ishte më pak i prirë për të akomoduar frankët. Në vend të kësaj, ai dëshironte të largonte perëndimorët e shpërngulur. Ndryshe nga shumica e komandantëve myslimanë, të cilët i frikësoheshin mizorisë së tyre apo talleshin për druajtjen e tyre, por rrallë, nëse ndonjëherë, lavdëroheshin për karakterin e tij, Nur al-Dini lavdërohej për përvetësinë dhe devotshmërinë e tij. Dhe ndryshe nga shumë para tij, ai nixte jo vetëm nga ambicia, por edhe nga feja.

Imazhi i luftëtarëve myslimanë duke hyrë në betejë me Kur'anin në njërin dorë mund të jetë i njohur, por për myslimanët e Lindjes së Afërt në shekullin XII, mund të ketë qenë i huaj. Nur al-Dini ishte i shquar, jo pasi ishte model, por për shkak se ishte aq i ndryshëm. Ambicia ishte e zakonshme, por devotshmëria ishte një cilësi e rrallë te një princ. Juristët myslimanë, duke njohur që sundimtarët përdornin Kur'anin kryesisht kur iu konvenonte dhe bënë atë që dëshironin kur nuk duhej, kanë ardhur në konkluzion se është më mirë vuajtja nga mizoritë e të gjallit, madje edhe të sundimtarit të padrejtë, sesa rreziku i kaosit që mund të vijë si pasojë e përpjekjes për ta përmbysur atë.

Rezultati ishte një filozofi politike e akomodimit. Teologët myslimanë ishin hezitues të sfidonin ligjshmërinë e një sundimtari, nëse ka nderuar ai sundimtar apo jo ligjet e Islamit, që rrallë e bënin. Me rënien e fuqisë dhe prestigjit të kalifatit në Bagdad, dijetarët myslimanë adaptuan një qasje pragmatike për komandantët ushtarakë dhe e mbuluan me justifikim religjioz. Kjo nuk ishte tepër e vështirë, duke ditur se Islami, në zemër, përfshin nënshtrimin ndaj autoritetit final, Zotit. Të ballafaquar me ndarje politike, ulemaja theksuan detyrën e myslimanëve për t'iu nënshtruar me bindje sundimtarit. Nëse sundimtari ishte i padrejtë, ai në fund të fundit do t'i përgjigjej para Zotit, dhe ndërkohë, ishte përgjegjësi e çdo myslimani t'i bindej autoritetit të sundimtarit. Ulemaja, për pjesën e tyre, kishin detyrë që të siguroheshin se ligji religjioz, Sheriati të ruhej dhe të nderohej, nëse jo nga sundimtari, atëherë të paktën nga gjykatësit dhe dijetarët.

Karakteri i akomodimit dhe bindjes ishte sfiduar shpesh nga individët, por pa religjion të unifikuar, ulemaja ishin më pak të aftë për t'i rezistuar vullnetit të një sundimtari të veçantë në vend të peshkopëve, kardinalëve dhe papëve në Evropë në atë kohë. Nganjëherë, disa dijetarë do të denonconin sundimtarin për veprimet e tij, por zakonisht nga një distancë. Një gjykatës që jetonte në Bagdad mund të shante pa rrezik ndonjë emir në Siri, por mund të rrezikonte jetën e tij nëse thoshte të njëjtat gjëra në Damask. Ishin të rrallë individët, të cilët kishin qëndrim kundër shkeljes së perceptuar të ligjeve religjioze nga ndonjë sundimtar, dhe ndodhte edhe më rrallë që ndonjë individ, i cili pastaj nuk duhej të largohej nga zemërimi i sundimtarit.

Për dallim, Evropa në atë kohë ishte në mes të luftës të gjatë disa shekuj midis Kishës dhe shtetit. Kryqëzatat ishin mjete për t'i dhënë fund Kishës Katolike, e cila përdori thirrje për luftë kundër jobesimtarëve si një mënyrë për të fituar ndikim dhe fuqi. Kryqëzatat ishin zhvilluar jo vetëm kundër myslimanëve në Lindjen e Afërt, por gjithashtu kundër fiseve pagane në Baltik, kundër heretikëve në Evropë, dhe natyrisht kundër myslimanëve në Spanjë. Shumica e këtyre kryqëzatave ishin të nxitura nga kisha dhe papati, të cilët garonin me liderët politikë për pozitë dominuese në shoqëri.

Por në botën myslimane, klasa politike ishte dominuese. Në Bagdad, kalifati abasid vazhdoi përpjekjet për të tërhequr ndjenjat kolektive të pjesëve të botës myslimane, kryesisht për shkak se ishte përkujtues i një uniteti ideal. Fakti se një unitet i tillë rrallë kishte ekzistuar ishte më pak i rëndësishëm se fakti që ideali gjithmonë kishte qenë në qendër. Askush nuk mund të debatonte se bota myslimane kishte qenë e ndarë për shekuj, por dëshira për një komunitet (umet) të bashkuar nuk u venit kurrë. Nëse ndonjë gjë, ajo u rrit më fuqishëm sesa realiteti i botës myslimane që nënvizonte mungesën e tij. Si rezultat, derisa invadimi i kryqtarëve fillimisht nuk çoi në kundër reagim, inspirimet ishin atje. Paaftësia e shteteve myslimane të Lindjes së Afërt për të zmbarsur frankët ishte një përkujtues i zymtë i ndarjeve të tyre. Pas një përgjigje të vakët e tronditëse gjatë pjesës së parë të shekullit XII, liderët politikë dhe ushtarakë të Lindjes së Afërt nisën të

kanalizojnë ankthin dhe e përdorën atë për të krijuar një balancë të re të aftë për të sfiduar pushtuesit.

Është e pamundur të kuptohet ngritja e Nur al-Dinit, dhe pasuesit të tij Salahudinit, me këtë kontekst. Myslimanët nuk ishin të ndarë vetëm përballë të krishterëve perëndimorë, por ata vuanin nga trashëgimia e molisur e përçarjes doktrinare që kishte shqetësuar umetin që nga koha e Aliut dhe formimi i shiitëve. Për sunitët, shteti shiit i Fatimitëve në Egjipt ishte po aq shqetësues sa shtetet kryqtare në Palestinë. Që të dyja përfaqësonin pasojat e tmerrshme të përçarjes. Që të dyja demonstronin atë që mund të ndodhte nëse ndahej umeti.

Kur Nur al-Dini vdiq më 1174, ai u lavdërua kudo në Lindjen e Afërt si sundimtar i urtë, i matur dhe i devotshëm. Por, nuk ishte menjëherë e qartë se kush do ta pasonte. Kandidati më i mundshëm ishte zëvendësi i tij, Salahudini, guvernatori i Egjiptit, i cili kaloi më shumë se një dekadë duke u marrë me invadimet e frankëve dhe intrigat e shtetit Fatimit, që u shkatërrua shpejt. Nga viti në vit, Salahudini fitoi më shumë ndikim, i ndihmuar nga vdekja e rastësishme e rivalëve të ndryshëm. Fitoret e tij në fushat e betejave ishin impresionuese, por instinktet e tij politike ishin gjithashtu shumë të mprehta. Pas shumë vjetëve të manovrimit delikat, ai më në fund përfundoi jetën e perandorisë së dobët Fatimite dhe urdhëroi që emri i kalifit fatimit të hiqet nga lutjet e së premtës dhe emri i kalifit abasid sunit të përfshihet në vend të tij. Pastaj, kur dëgjoi për vdekjen e Nur al-Dinit lëvizi me shqetësim.

Ishte e natyrshme për Salahudin që të besonte se ishte trashëgimtar i duhur i Nur al-Dinit. Sikur ish-zotëriu i tij, ai deklaroi angazhimin e thellë për të sjellë Lindjen e Afërt nën një sundimtar sunit. Të paktën, kjo është përshtypja që i ka mbijetuar shekujve. Gjykuar nga disa histori bashkëkohore që kanë mbijetuar, është e vështirë të besohet se Salahudini ishte njeri prej mishi e gjaku. Ai ose ishte mjeshtër i propagandës apo ishte vërtetë i bekuar me mirësi e bujari dhe i motivuar nga një pasion i sinqertë për të bërë komunitetin mysliman një të tërë. Në të vërtetë, ai mund të ishte që të dyja.

Është ironike se Salahudini është i njohur në Perëndim. Në ditët e tij, ai ishte mbrojtësi më i madh i konceptit të xhihadit në botën myslimane. Sipas fjalëve të njërit nga biografët e tij,

Salahudini ishte tepër i kujdesshëm në zhvillimin e luftës së shenjtë, dhe ajo ishte në mënyrë konstante në mendjen e tij. Ndonjëri mund të betohet me dorën e djathtë pa u frikësuar se po bie në kontradiktë me këtë, që nga koha kur u nis, kishte synim xhihadin, derisa vdiq, ai nuk shpenzoi asnjë monedhë ari apo argjendi përveç në xhihad dhe vepra të mira. Zemra e mendja e tij ishin aq shumë të pushtuara nga ky zell i flaktë për xhihad sa që nuk mund të fliste për asgjë tjetër. Nga dëshira për të luftuar për kauzën e Zotit, ai la pas tij familjen, fëmijët, vendin e shtëpinë e tij.

Përveç që ishte luftëtar i shenjtë i përkushtuar dhe njeri i Zotit, ai ishte “i shoqërueshëm, i sjellshëm dhe i këndshëm... Pastërtia e karakterit të tij ishte gjithmonë e evidente: kur ishte në shoqëri nuk i lejonte askujt të fliste keq në prezencën e tij, duke preferuar të dëgjonte vetëm tiparet e tyre të mira; kur fliste vetë, kurrë nuk ishte i prirë të fyejnte ndokënd”.<sup>2</sup>

Nëse kjo nuk mjafton, ai ishte gjithashtu - në dukje - i pashëm, me sy të bukur e të plotë dhe mjekër të rregulluar. Ai ishte i prirë të sillej me bujari dhe fisnikëri në bashkëveprimet e tij me gra e fëmijë. Është thënë se ai ndante ushqimin e tij me lutësit e vizitorët, në nderim të një zakoni të vjetër të arabëve, në vend se të fshihej prapa ritualeve të përgatitura të monarkëve të mëvonshëm. Ai falej rregullisht dhe publikisht, dhe kënaqej me dëgjimin e ajeteve të Kur'anit të recituara nga lexues të zotë. Ai ishte dyshues ndaj filozofëve dhe mistikëve, të cilët shkonin përtej asaj që kishte diktuar Kur'ani dhe tradita. Është thënë pas vdekjes së tij se një nga pendimet e tij të vetme ishte se kurrë nuk ishte në gjendje të kryente pelegrinazhin në Mekë. Në fund të një liste të gjerë të tipareve të shquara të Salahudinit, të cilat përfshinë shumë faqe e mijëra fjalë, një nga biografët e tij shpjegoi se ato ishin

<sup>2</sup> Kronika për karakterin e Salahudinit vjen nga Baha al-Din ibn Shaddad, të cituar në Hallam, 155-5.

“thjesht disa shembuj të tipareve të zemërgjerësisë dhe fisnikërisë së tij. E kam kufizuar veten... me qëllim për të mos zgjatur tepër këtë libër dhe për të mos mërëzitur lexuesin”.

Me kalimin e kohës, Salahudini u përball me ushtritë e Kryqëzatës së Tretë, dhe imazhi i tij ishte lustruar në perfeksion. Por, në vitet menjëherë pas vdekjes së Nur al-Dinit, ishin disa që nuk u pajtuan me portretin e lavdisë. Pasi shumica e kronikave që mbijetuan janë biografi shenjtërosh, jo gjithçka që u shkruan për Salahudinin ishte aq lajkatuese. Një satirik ka përshkruar orgjitë e dehura, qatipët budallenj, ministrat gungaçë dhe gjeneralët frikacakë, të cilët luftonin vetëm kur fitorja ishte e sigurt. Sikur karagjozët e pallatit në Evropë, satirikët lejoheshin të përqeshin të fuqishmit, në një pikë. Ana e errët e devotshmërisë së Salahudinit mund të ketë qenë mungesë e humorit për vetveten, dhe ai aq u ofendua nga një përshkrim sa që dëboi autorin. Njeriu i gjerë u lëndua dhe u habit, dhe shkroi një letër të hidhur ku pyeste se çka kishte bërë për të merituar një trajtim të tillë. “Pse ke dëbuar një njeri të besueshëm, i cili nuk ka bërë asnjë krim dhe as vjedhje? Dëno myezinin (i cili thërret besimtarët të falen) nga tokat tua, nëse po largon të gjithë ata që po flasin të vërtetën”.<sup>3</sup>

Këto shënime të hidhura, megjithatë, u mbytnë nga kori i lavdërimeve, jo vetëm në kohën e tij, por edhe gjatë gjeneratave të ardhshme. Historianët perëndimorë ishin veçanërisht të impresionuar. Një nga studiuesit kryesor të shekullit XX të historisë së Lindjes së Mesme, H. A. R. Gibb, përmbloodhi trashëgiminë e Salahudinit në gjuhën që do ta bënte krenar një historian të pallatit. “Për një moment të shkurtër, por vendimtar, me mirësinë absolute dhe vendosmërinë e karakterit, ai ngriti Islamin nga brazda e demoralizimit politik”. Lavdërimi i madh nga një zotëri anglez i matur, por asgjë krahasuar me portretin e begatë të lënë nga Edward Gibboni në shekullin XVIII. Gibboni, i cili rrallë hezitoi të përdorë lapsin e tij për t’i bërë vetëvrasje karakterit, lartësoi Salahudinin mbi postin e tij dhe radhën e njerëzimit. Ai shkroi

<sup>3</sup> Cituar në Malcolm Cameron Lyons dhe D.E.P. Jackson, *Saladin: The Politics of Holy War* (New York: Cambridge University Press, 1982), 119-20.

se Salahudini, duke qenë i dhënë pas verës dhe grave si i ri, i pa gabimet e rrugëve të tij dhe e transformoi veten.

Veshja e Salahudinit ishte nga leshi i trashë; uji ishte pija e tij e vetme; dhe derisa rivalizonte përmbajtjen, ia kalonte thjeshtësisë së profetit të tij arab (Muhamedit)... Drejtësia e divanit të tij ishte e pranueshme edhe për lutësin më të dobët kundër tij e ministrave të tij... Aq e pakufishme ishte bujaria e tij sa që ndau 12 mijë kuaj në rrethimin e Akras... dhe në një pushtet ushtarak, haraçet pakësohen, dhe qytetarët e pasur, pa frikë apo rrezik, shijojnë frytet e ndërmarrjeve të tyre.

Por, Gibboni nuk ishte i verbër ndaj thelbit të Salahudinit. “Në një epokë fanatike, vetë fanatik, tiparet e singerta të Salahudinit komandonin respektin e të krishterëve; perandori i Gjermanisë mburrej me miqësinë me të; perandori grek (bizantin) kërkonte aleancën e tij; dhe pushtimi i Jerusalemit përhap, dhe ndoshta lartësoi famën e tij në Lindje dhe Perëndim”.<sup>4</sup>

Gibboni, i cili mishëronte vorbullën e kontradiktave që rrjedhin përmes shoqërisë angleze në shekullin XVIII, e cila ishte akoma e lidhur me kishën duke testuar kufijtë e asaj aleance, kuptoi se Salahudini ishte besimtar në thelb dhe krijues i perandorisë. Se cila kishte prioritet në shpirtin e Salahudinit është e pamundur të përcaktohet. Por, është e sigurt të supozohet se ringjallja e një shteti perandorak arab dhe shërbimi ndaj Zotit ishin një dhe të njëjta për të. Ambiciet e tij politike ishin plotësisht në pajtueshmëri me pasionet e tij religjioze, dhe entuziazmi i tij religjioz i dha atij fuqi dhe vendosmëri që shumicës së rivalëve të tij i mungonin.

Disa historianë perëndimorë kanë argumentuar se Salahudini ishte kryesisht pjesë e dinastisë, i cili manipuloi me shëmbëlltyrën dhe gjuhën religjioze për të justifikuar veprimet dhe për të krijuar imazhin e tij. Ata shkruan, drejtësisht, se midis vitit 1174, kur vdiq Nur al-Dini, dhe 1187, kur u mor Jerusalemi, Salahudini kaloi gati tre vjet në më-

<sup>4</sup> Gibbon është cituar në Hillenbrand, 185. Shih gjithashtu Edward Gibbon, *The Decline and Fall of the Roman Empire*, vol. 3 (New York: Heritage Press, 1946), 2084-85.

nyrë aktive duke luftuar sundimtarët tjerë myslimanë, dhe pak më shumë se një vit duke luftuar kryqtarët. Madje, edhe duke luftuar myslimanët tjerë, Salahudini përdori justifikimin e luftës së shenjtë. Kundër Fatimitëve shiitë kjo ishte e lehtë: luftërat midis sekteve rivale myslimane ishin saktësisht po aq të këqija dhe ideologjike sa luftërat midis sekteve të krishtera. Dhe duke gjykuar nga Testamenti i Vjetër, luftërat midis fiseve të ndryshme izraelite nuk ishin edhe aq çështje të civilizuara. Por, Salahudini u mbështet gjithashtu në gjuhën e luftës së shenjtë për të bërë të ligjshme fushatat kundër shteteve të tjera myslimane sunite.

Gjatë gjithë karrierës së tij, Salahudini i shkroi letra kalifit abasid në Bagdad, duke shpresuar të merrte bekimin. Madje edhe në mungesë të tij, ai pohonte se po vepronte si shërbëtor besnik i Komandantit të Besimtarëve dhe si shpatë e kalifit. Si i tillë, ai mund të largonte heretikët dhe të sillte qytet-shtetet myslimane endacake të rajonit përsëri në tufën e komunitetit të besimtarëve. Këto qytete që i rezistuan përgjërimit të tij, ai i sulmoi pasi po qëndronin në rrugën e Vullnetit të Zotit. Kur emiri i Mosulit refuzoi të përkulej, Salahudini pohoi se qyteti ishte elementi kyç në planin kryesor. Me Mosulin e sigurt në kampin e Salahudinit, pjesa tjetër e rajonit mund ta ndiqte, pa dyshim siç ndjek nata ditën tjetër. Çdo marrëveshje mund të jepej, dhe pastaj Jerusalemi dhe në fund Kostandinopoja, “derisa fjala e Zotit të jetë supreme dhe kalifati Abasid të shpërndante fjalën e pastër, duke i kthyer kishat në xhami”. Më vonë, ballë për ballë me liderët e Mosulit, Salahudini theksoi se kishte vetëm një arsye që kërkonte qytetin, dhe kjo nuk kishte të bënte asgjë me rrënjët e tij kurde. “Ne kemi ardhur”, deklaroi ai, “për të bashkuar fjalën e Islamit dhe për të rikthyer gjërat duke larguar dallimet”.<sup>5</sup>

Për Salahudin, përfundimet në fund të fundit justifikonin mjetet. Megjithatë dukej se nuk kishte asnjë kënaqësi në luftë, ai e shihte këtë

si një instrument të domosdoshëm. Në çdo fazë të karrierës së tij, ai ishte i gatshëm të identifikonte se çka duhej për të kaluar në fazën tjetër. Pasi që kishte ngurtësuar pozitën e tij në Egjipt, e dinte se aqma nuk mund të paraqiste një sfidë kredibile për mbretërinë e Jerusalemit. Për të bërë këtë, duheshin burimet e kombinuara të shteteve të ndryshme të Lindjes së Afërt. Nëse nuk i nënshtroheshin vullnetarisht atij, ai do t'i detyronte t'i bashkoheshin atij. Nëse kjo do të thoshte luftë, atëherë ai do të luftonte.

Por, xhihadi i Salahudinit nuk ishte xhihadi i shekullit XXI. Ai nuk ishte luftë e shenjtë e urrejtjes. Ai ishte luftë e rregullimit, luftës për Islam ortodoks më shumë sesa kundër të krishterëve apo kundër myslimanëve, që devijuan nga rruga sunite. Kishte një arsye që Salahudini kaloi më shumë kohë duke luftuar kundër myslimanëve të tjerë - duke përfshirë kultin e egër, fanatik dhe nganjëherë vetëvrasës të Vrasësve, të cilët ishin Al Kaeda e atyre ditëve - sesa bëri kundër të krishterëve. Por, kjo arsye nuk ka të bëjë asgjë me doktrinën. Ajo ishte taktike. Vetëm një Lindje e Afërt myslimane e unifikuar mund të mposhte mbretërinë e krishterë të Jerusalemit.

Nëse lufta e shenjtë kuptohet kryesisht si luftë kundër jomyslimanëve dhe myslimanëve që kanë devijuar, Salahudini nuk ishte shumë koherent. Por, problemi këtu nuk është xhihadi i Salahudinit; por sesi xhihadi është definuar nga perëndimorët dhe myslimanët në botën moderne.

Ashtu si ka evoluar Islami, ashtu ka ndodhur edhe me idenë e xhihadit. Tradicionalisht, ekzistojnë dy lloje të xhihadit në Islam: xhihadi i madh, i cili është lufta individuale për pastërti dhe xhihadi i vogël, që është fushata kundër atyre që çnderojnë apo humbin komunitetin e besimtarëve. Xhihadi i madh është diçka që të gjithë individët e devotshëm duhet ta zhvillojnë kundër dëshirave të tyre, veçanërisht atyre dëshirave që janë në kundërshtim me leximet kryesore të Kur'anit. Mistikët e Islamit, shpesh kanë folur për xhihadin si një natë e errët e shpirtit, ku luftëtari përballlet me demonët e tij dhe duhet të konfrontohet me ata që të qëndrojnë në rrugën drejt Zotit. Xhihadi i vogël mund të marrë formën e luftës kundër jobesimtarëve, por gjithashtu mund të

<sup>5</sup> Të dy citimet në Lyons dhe Jackson, 194 dhe 228, janë statistika rreth kohës që kryqtarët e kanë kaluar në fushatën kundër myslimanëve. Gjithashtu, për një portret skeptik të Salahudinit, shih, Andrew Ehrenkreutz, *Saladin* (Albany: State University of New York Press, 1972).

jetë çdo përpjekje e fokusuar për të kthyer shoqërinë myslimane. Lufta është një mjet; reforma politike mund të tjerë tjetri; dhe politikat ekonomike mund të jenë po ashtu.<sup>6</sup>

Kur Salahudini fliste për xhihadin, ai mendonte ribërjen e shoqërisë myslimane në Lindjen e Afërt, pasi që kjo ishte gjëja e duhur për të bërë, dhe pasi vetëm atëherë myslimanët mund të sundonin sërish Jerusalemin. Asnjëherë ai nuk është akuzuar për hipokrizi duke përdorur gjuhën e xhihadt për të avancuar ambiciet e veta, në shkallë të gjerë, pasi ai së pari kujdesej për shtëpinë e tij shpirtërore. Shkurtimisht, dukej se kishte pranuar xhihadin e madh para se të fillonte të voglin. Dhe këtu gjendet shpjegimi se pse Salahudini, luftëtari i shenjtë i pakrahueshëm, është megjithatë i admiruar në Perëndim dhe mbetet një ikonë në Lindjen e Afërt dhe në shumë pjesë të botës myslimane.

### Kryqëzata e Tretë

Por, ashtu si ishte edhe vazhdon të jetë i lavdëruar, Salahudini ishte gjithashtu një luftëtar i vërtetë. Admirimi i Salahudinit nga perëndimorët është po aq i mirë dhe i pastër sa që është gati karikaturë. Salahudini real, megjithatë, nuk ishte i prirë gjithmonë të falte armiqët e tij apo t'i trajtonte me butësi. Ai kishte pak tolerancë për mistikët, të cilët refuzonin të luftonin dhe në vend të kësaj i tërhoqi nga shoqëria për të provuar kuptimin e brendshëm të Kur'anit, dhe zhvilloi një urrejtje të ngulitur për të paktën një kundërshtar të krishterë, të quajtur Reynaldi i Châtillonit. Ky Salahudin, gjenerali i zemëruar, komandanti kokëfortë, i cili nuk ishte as kureshtar rreth teologjisë e as i mirë me ata që ishin, ishte lënë mënjanë i sigurt në të kaluarën.

Kjo do të thotë, ai nuk ishte ashtu sado që Reynaldi kishte shkatëruar neverinë. Ai kishte karrierë të ndryshueshme, si një aventurier, kalorës dhe i burgosur politik, i cili u martua më 1176, dhe kështu u bë sundues i njëres prej fortesave më madhështore në Jordani, kështje-

llës Kerak. Gërmadhat e saj ende inspirojnë frikë, të vendosura lart mbi Detin e Vdekur në tokën biblike të Moabit. Para se Reynaldi të bëhej pronar kështjelle, ai ishte i njohur për brutalitetin e tij. Në një rast ishte përfshirë në rrahjen e patriarkut të Antiochit, dhe pastaj ia leu plagët në fytyrë me mjalte, duke e lënë jashtë midis verës në shkretëtirën siriane që të torturohej nga mizat dhe mblodhi ngodhira derisa u pajtua të paguante një shpërblësë të tepruar. Posa mori kontrollin e kështjellës, Reynaldi siç duket u kënaq me flakjen e armiqve nga mbrojtja e tij.

Salahudini nuk do të brengosej shumë rreth asaj që Reynaldi i bëri patriarkut të Antiochit apo të krishterëve të tjerë që e kundërshtuan, por ai u ofendua nga sulmet e Reynaldit ndaj karvanëve të pelegrinëve të drejtuar për në Mekë. Jo vetëm rruga veri-jugore përmes Sirisë ishte arterie kryesore për pelegrinët, ajo ishte – ashtu siç ka qenë për shekuj – rruga kryesore tregtare. Duke shqetësuar karvanët, duke dëmtuar pelegrinët dhe duke vjedhur gjërat e tyre paraqiste një sfidë serioze për Salahudinin. Të njëjtën gjë e bënë sulmet e suksesshme të Reynaldit përgjatë Detit të Kuq. Çdo sundimtar, i cili ka aspirata të pranohet si një sulltan i suksesshëm duhet të jetë në gjendje të mbrojë qasjen në vendin më të shenjtë të Islamit. Nëse Salahudini nuk mund të garantonte sigurinë e pelegrinëve për të bërë haxhin vjetor në Mekë dhe Medine, ai nuk mund të kërkonte respektin e botës myslimane. Sulmet e Reynaldit gjithashtu rrezikonin të ardhurat e Salahudinit. Mbrojtja e karvanëve do të thoshte jo vetëm respekt, por të drejtën për të mbledhur pagesat modeste për shërbimin.

Sulmet e ndërmarra nga Reynaldi provokuan përgjigje vdekjeprurëse. Salahudini deklaroi luftë, mblodhi një ushtri prej mbi 12 mijë kalorësve dhe sulmoi mbretërinë e Jerusalemit. Frankët, duke njohur seriozitetin e kërcënimit, tejkaluan dallimet e tyre. Konti i Antiochit, i cili kishte flirtuar me Salahudin dhe madje kishte hyrë në aleancë preliminare me të, u bashkua dhe bëri paqe me Templarët dhe Hospitalerët. Shtetet kryqtare mblodhën një ushtri të frikshme, por kjo vetëm se keqësoi humbjen e tyre pasuese. Strategjia e tyre ushtarake ishte keq e konceptuar dhe dëshmoi se nuk pati përshtatje për kundër-

<sup>6</sup> Shih David Cook, *Understanding Jihad* (Berkeley: University of California Press, 2005); Sayyid Hossein Nars, *Islam: Religion, History and Civilization* (San Francisco: HarperSanFrancisco, 2003), 91ff.

shtarin e tyre. Ata u gënjyen në përballje me Salahudinin në vendin që kishte zgjedhur, në terrenin që kishte dëshiruar, dhe në orën që kishte zgjedhur. Rezultati më 1187 ishte një betejë shkatërruese në Cebin e Hattinit, një labirint i kodrave shterpë në perëndim të Detit të Galileut.

Në mëngjesin e 3 korrikut 1187, për ushtritë franke nuk pati agim. Në vend të kësaj, qiejt ishin mbuluar me tym të nxehtë. Ata kishin kaluar ditën paraprake në luginën e thatë të Hattinit, dhe edhe pse e dinin se Salahudini ishte afër, ata nuk e dinin saktësisht se ku. Atë mëngjes, të gllabëruar nga tymi i gjeneruar prej djegies së shkurreve dhe barit të thatë të shkaktuar nga forcat e Salahudinit, frankët e çorientuar u rrethuan dhe u asgjësuan. Mbreti i Jerusalemit dhe zotërinjtë e Templarëve dhe Hospitalerëve u kapën rob. Kështu i ndodhi edhe Reynaldit të urryer dhe relikës së çmuar e të pazëvendësueshme: një pjesë të Kryqit të Vërtetë.

Me të vdekur që ishin akoma në fushëbetejë, të kapurit robër u sollën në tendën e Salahudinit. Sipas një kronike franke të asaj që ka ndodhur, Salahudini urdhëroi sjelljen e një shurupi të holluar me ujë në një kupë ari. Ai e shijoi, pastaj ia dha mbretit të pinte, duke i thënë: “Pi fort”. Mbreti piu, si një njeri i etur shumë, dhe pastaj ia dha kupën Princit Reynald. Princi Reynald nuk donte të pinte. Salahudini u zemërua dhe i tha: “Pi, pasi më kurrë nuk do të pish!”. Princi iu përgjigj se nëse kjo kënaqte Zotin, ai kurrë nuk do të pinte apo hante asgjë nga këto. Salahudini e pyeti: “Princ Reynald, nëse më kishe mbajtur në burgun tënd ashtu siç po të mbaj në timin, çka, sipas ligjit tënd, do të më kishe bërë?” “Le të më ndihmojë Zoti”, iu përgjigj ai, “do të preja kokën”. Salahudini u tërbua shumë me këtë përgjigje të pacipë, dhe tha: “Derr! Ti je i burgosuri im, dhe akoma më përgjigjesh me këtë arrogancë?” Mori shpatën në dorën e tij dhe e goditi drejt e në trup. Memlukët, të cilët po qëndronin afër tij, nxituan dhe ia prenë kokën. Salahudini mori pak gjak dhe e hodhi mbi kokë si pranim se ishte hakmarrë. Pastaj, urdhëroi bartjen e kokës në Damask, dhe ajo u tërhoq zvarrë për t’u treguar saraçinëve, ndaj të cilëve princi kishte bërë padrejtësi, se çfarë hakmarrje pati.

Kronikat myslimane dallojnë vetëm në detajet e vogla. Në një, Salahudini dënoi Reynaldin që sulmoi pelegrinët në rrugën e tyre për në vendet e shenjta të Islamit. Por, të gjithë pajtohen se vetë Salahudini ekzekutoi Reynaldin, dhe pastaj kurseu jetën e mbretit të Jerusalemit dhe të tjerëve.<sup>7</sup>

Fitorja në Hattin hapi rrugën për rënien pasuese të Jerusalemit, e cila nxiti një valë tjetër të ushtrive kryqtare evropiane të vendosura për rikthimin e qytetit. As okupimi i Jerusalemit e as vrasja hakmarrëse e Reynaldit nuk njolloosi reputacionin e Salahudinit. Në vend të kësaj, Reynaldi mori goditjen e zemërimit të historisë. Megjithëse disa polemistë bashkëkohorë të krishterë denoncojnë Salahudinin dhe e përshkruajnë atë si djall i personifikuar, gjatë kohës ideja e sajuar e propagandës së luftës u zbeh dhe u shfaq një version më i butë.

Në shekullin XIX, Sir Walter Scott ktheu ekzekutimin e Reynaldit në një metaforë për fisnikërinë e Salahudinit. Në *Hajmali*, Reynaldi është zotëriu i madh i Templarëve dhe hipokrit intrigant besnik i lakmisë së tij të shtrembëruar. Vdekja e tij është prezantuar jo si një akt hakmarrjeje, por si një vepër heroike. Skena fillon me pritjen e Salahudinit për Richard Zemërluanin dhe shpurën e tij në një tendë në fushëbetejë të mbushur me qilima të materialit më të shtrenjtë me jastëk për mysafirët”, së bashku me llamba, sheqerka, “dhe hollësira të tjera të gatimit lindor”. Pastaj, derisa mysafirët shijonin sherbetin e ftohtë, Salahudini papritmas heq nga këllëfi kordhën e tij dhe ia pret kokën zotëriut të madh të Templarëve. Para se mysafirët e tij të tmerruar të nxjerrin shpatat e tyre, Salahudini shpjegon se i vdekuri kishte komplotuar kundër jetës së Richardit. Në këtë histori, Scotti rimodeloi ekzekutimin si një akt altruist të princit, i cili ruante nderin dhe kalorësinë.

Megjithatë, karakteri fisnik, në marrjen e Jerusalemit, Salahudini kishte kapur xhevahirin e kurorës së kryqtarëve. Mbretërit e Evropës,

<sup>7</sup> Kronika franke e Ernoul, e shkruar në vitin 1197, përkthyer nga Peter Edbury dhe Paul Hayams, në Fordham’s Medieval Sourcebook, [www.fordham.edu/halsall/source/1187.ernoul.html](http://www.fordham.edu/halsall/source/1187.ernoul.html). Shih gjithashtu kronikën e Ibn al-Athirit në Gabrielli, 122-25.



të nxitur nga papa, u përgjigjën me Kryqëzatën e Tretë. Richard Zëmërluani i Anglisë, Philip Augustusi i Francës, dhe Frederick Barbarossa i Gjermanisë u përgatitën për luftë. Deri tani, ideja kryqtare ishte sajuar në fabrikën e Evropës Perëndimore dhe Qendrore. Si asnjë lëvizje atraktive më parë kryesisht për të rinjtë, kryqëzata u bë fokusi qendror për kishën dhe fisnikërinë. Ushtritë e Kryqëzatës së Tretë ishin elita e Gjermanisë, Francës dhe Anglisë, dhe ata mund të kishin pasur sukses, por për fatkeqësinë e Frederick Barbarossas, i cili u mbyt në lumë pas fitores bindëse kundër selxhukëve të Anadollit. Rivaliteti midis Richardit dhe Philipit nuk ndihmoi shumë, dhe kokëfortësia e Richardit, derisa ishte në avantazh në fushëbetejë, nuk e bëri atë një aleat të lehtë.

Kryqëzata e Tretë kujtohet, nëse kujtohet fare, për luftën epike midis Richardit dhe Salahudinit. Ushtarakisht, të dy ishin madje të barabartë, por Salahudini, i pjekur, me shkathtësinë e mprehtë si një gjeneral në rënie, ia hodhi Richardit. E vetmja gjë më e keqe se humbja dhe rruga qorre në fushëbetejë është humbja e reputacionit të saj. Këtu humbi Richardi. Megjithëse secili kishte historianë dhe përkrahës palati, Salahudini u shfaq si kampion i padiskutuar i luftës së propagandës.

Përveç për atmosferën e nxehtë në historinë e Robin Hoodit, mbreti Richard mbijetoi si një sundimtar i patrembur dhe i ashpër i nxitur nga koprracia, epshi dhe tërbimi. Megjithëse kurrë nuk do ta dimë sesi ishte në të vërtetë, ndoshta ka më shumë të vërtetë në imazhin që ka mbijetuar. Fëmija i Henryt II, dhe pastaj legjendari Eleanor i Aquitaine, Richardi krijoi një reputacion të hershëm dhe të qëndrueshëm si lider, për të cilin mprehtësia dhe urtësia ishin koncepte të huaja. Kjo nuk ishte çështje e etikës së kohës së luftës, megjithëse edhe këtu, Richardi menaxhoi të ofendojë madje ndjeshmërinë më të egër të kohës së tij. Ajo ishte çështje kulture. Anglia mezi ishte larguar nga konfederatat fisnore analfabete, dhe shoqëria angleze kishte vetëm mbulimin mospërfillës të Krishterimit me shkrim e lexim të vogël të kufizuar në manastire. Egjipti dhe Siria e Salahudinit, në anën tjetër, kishin provuar gjashtë shekuj të sundimit mysliman dhe kishin për-

fituar nga kultura e lartë e Damaskut dhe Bagdadit. Kjo kulturë, e cila çmonte letërsinë, artin, shkencën, mjekësinë, astronominë, inxhinierinë, ligjin dhe bujqësinë, ishte ndërtuar mbi themelet e Greqisë, Romës dhe Bizantit, dhe pastaj ishte përzier me traditën e pallatit të Persisë së lashtë. Kryqtarët nuk ia kaluan myslimanëve në aspekte të caktuara - veçanërisht në ndërtimin e kështjellave, dhe jo rastësisht, në ndërtimin e mjeteve të rrethimit për t'i kapur ata. Por, në shumicën e aspekteve, rivaliteti midis Richardit dhe Salahudinit, sikur luftimi fillestar midis ushtrive kryqtare dhe myslimanëve të Lindjes së Afërt një shekull më parë, vuri përballë muskulin kundër trurit.

Muskuli nganjëherë kishte një avantazh dallues. Richardi, fizikisht një kuqo madhështor, i cili më vonë më shumë do të vërsulej mbi pre në sesa të komandonte nga lartësitë, sulmoi Lindjen e Afërt nga deti, pushtoi Qipron si një vend të avancuar, dhe pastaj mori Akrën pas një rrethimi të pasinqertë. Komandanti i garnizonit të Akrës u dorëzua para se të merrte urdhrat e Salahudinit që të mos bënte këtë, dhe Richardi mori kontrollin e një numri të madh të robërve. Rregullat që i trajtonin të burgosurit e luftës ishin të ndershme: do të vendosej haraçi, mjaft i lartë për të qenë fitimprurës për fituesit dhe ndëshkues për humbësit, por jo aq i lartë sa të mos mund të paguhej. Richardi, megjithatë, ishte i shqetësuar për të ruajtur gjendjen momentale dhe dëshironte të avanconte në brendësi. Ai nuk mund të shkonte askund derisa të zgjidhej fati i të burgosurve të tij. Negociatat ndaluan, dhe Richardi vendosi se nuk kishte nevojë për para apo bezdi. Urdhëroi ushtarët e tij të vrisnin tre mijë burra, gra dhe fëmijë të Akrës, të cilët ishin aq fatkeq sa të kapeshin. Një apologjet i krishterë ka thënë se ushtarët - që kërkonin të hakmerreshin për të krishterët e vdekur nga duart e Salahudinit - të gëzuar zbatuan detyrën e heqjes së kokës të zënëve rob”.<sup>8</sup>

<sup>8</sup> Runciman, *A History of the Crusades*, vol. 3, *The Kingdom of Acre and the Later Crusades*, 53. Për kronistin e krishterë shih *Itinerarium Peregrinorum et Gesta Regis Ricardi*, ed. William Stubbs, Rolls Series (London: Longmans, 1864), IV, 2, 4 (pp. 240-41, 243), përkthyer nga James Brundage në *The Crusades: A Documentary History* (Milwaukee: Marquette University Press, 1962), 183-84.

Masakra u ballafaqua me atmosferë miqësie. Për shumë muaj, ushtritë e Richardit dhe Salahudinit luftuan me ndalesa. Të kampuar afër njëri-tjetrit, kalorësit dhe ushtarët e secilës anë u miqësuan gjatë periudhave të gjata të pasivitetit. Sipas disa kronikave, luftëtarët madje mund të ndalonin luftimet midis betejës nëse perceptonin se asnjëra palë nuk ishte në avancim. Armët do të uleshin poshtë; do të kishte konverzacion dhe tregim historish; një anë do të bënte ftesë për darkë. Herëve të tjera, mbaheshin gara për të parë se kush kishte më shumë mjeshtëri në artet e luftës, dhe pastaj të gjithë lartësonin fituesit.<sup>9</sup>

Këta skena nuk përputhen me imazhin e luftëtarëve të egër të Zotit që konfrontohen kundër njëri-tjetrit me entuziazmin e besimtarëve të vërtetë. Në vend se të gjeneronte zemërim dhe urrejtje, besimi i Salahudinit shpesh krijonte dhembshuri. Ai respektonte gatishmërinë e të krishterëve për të luftuar dhe vdekur për Jerusalemin, dhe njëherësh dërgonte ushtritë për të vrarë sa më shumë që ishte e mundur prej tyre. Dhe me përjashtim të Reynaldit, ai mund të bënte gjithë këtë pa urrejtje. Besimi i tij, nëse duhet të besojmë se ai ishte po aq i sinqertë sa pohojnë kronistët, ishte i bazuar në përrallë. Islami i tij ishte Islami i nënshtrimit, i bazuar në vlerësimin se të gjithë njerëzit janë të gabueshëm dhe të gjithë janë mëkatarë. Zoti është rruga, dhe vetëm Zoti është gjykatësi. Salahudini bëri xhihad për lavdinë e Zotit dhe për Islam, e jo xhihad kundër armiqve të tij. Pati pengesa, por ato nuk ishin objekti.

Të krishterët gjithashtu kundërshtojnë karakterizimin e lehtë. Ata mund të flasin për të këqijat e të pafeve dhe lavdinë në masakrën e tyre. Ata mund të udhëtonin mijëra milje për të kthyer Varrin e Shenjtë nën kontrollin e krishterë dhe për ta pastruar Tokën e Shenjtë nga papastërtia e sundimit mysliman. Ata jo vetëm ishin të gatshëm të miqësoheshin me këta të pafe në ditët e mërzitshme të luftës në verën e nxehtë, por në vjeshtën e vitit 1191, ata ishin të gatshëm gjithashtu të anulonin gjithë këtë dhe të martoheshin.

Kjo nuk ishte zgjidhja më e kuptueshme, por pas më pak se dy vjet, ushtritë e Richardit ishin tendosur dhe avancimi i frankëve kishte ndaluar. Salahudini kishte absorbuar goditje më të mëdha pa u shkatërruar, dhe veç fitores së tij të përgjakshme në Akra, Richardi kishte bërë pak më shumë sesa sigurimi i bregdetit që deri së fundi kishte qenë me vendosmëri nën kontrollin e mbretërisë së Jerusalemit. Me Frederick Barbarosën të vdekur, gjermanët ishin në çrregullim, dhe Philip Augustusi ishte sëmurë dhe ishte kthyer në Francë, i kishte mbetur Richardit të sfidonte i vetëm Salahudinin. Por, i erdhi fjala se në Angli, vëllai i tij John po përpiqej t'ia uzurponte fronin, dhe Richardi kishte nevojë të largohej. Ai nuk kishte dëshirë të fitonte në Palestinë vetëm për të humbur fronin e tij në Angli.

Richardi bëri diçka që kishte shumë kuptim për të, megjithëse habiti bashkëkohësit e tij. I shkroi Salahudinit, “Dua të të përshëndes dhe të them se myslimanët dhe frankët po gjakosen deri në vdekje. Vendi është plotësisht i shkatërruar dhe të mirat e jetës janë sakrifikuar te të dyja palët. Ka ardhur koha për të ndaluar këtë. Çështjet kundërshtuese janë Jerusalemi, Kryqi dhe toka”. Richardi deklaroi se nuk mund të largohej pa siguruar të drejtën e krishterëve për t'u lutur lirshëm në Jerusalemin, dhe as nuk mund të largohej pa Kryqin e Vërtetë që ishte marrë nga Salahudini në betejën e Hattinit. Salahudini iu përgjigj shpejt: “Jerusalemi është yni po aq sa është i juaji; në të vërtetë ai është më i shenjtë për ne sesa për ju. Ai është vendi nga i cili profeti ynë përfundoi udhëtimin e tij të natës dhe vendi në të cilin komuniteti ynë do të mbledhet në Ditën e Gjykimit. Mos imagjino se mund ta braktisim atë... Toka ishte fillimisht e jona, ndërsa ju sapo keni ardhur dhe e keni marrë për shkak të dobësisë së myslimanëve që jetonin në atë kohë”. Ndërsa, për kërkesat e tjera të Richardit, Salahudini nuk i tha as po e as jo.

Negociatat pastaj morën një kthesë interesante. Nuk është e qartë se kush propozoi çka, por propozimi ishte i thjeshtë. Motra e Richardit, Joanna e Sicilisë do të martohet me vëllanë e Salahudinit, Seyf ad-Din, dhe të dytë “do të bëheshin monarkë të përbashkët që do të sundonin nga Jerusalemi. Të gjithë të burgosurit që mbaheshin nga të

<sup>9</sup> Runciman, vol. 3, 27.

dy palët do të liroheshin: Kryqi i Vërtetë do të kthehej në Varrin e Shenjtë, dhe Richardi do të lundronte për në shtëpi në Angli.

Kur Salahudini dëgjoi kushtet, udhëzoi delegatët e tij të thonë jo, me sa duket për shkak se mendonte se kjo ishte ose kurth ose një shaka. Vëllai i tij e mori idenë me më seriozitet, dhe pa hezitim u pajtua. Pa njohurinë e Richardit, një nga aleatët e tij të mëparshëm po negocionte gjithashtu kushtet me Salahudin, dhe Salahudini, kështu, e dinte se kishte luksin për të vënë kushte nga pozita e fuqisë. Por, oferta e Richardit për dorën e motrës së tij ishte e singertë, dhe të paktën për të, i bëri përshtypje të mirë strategjike. Luftërat midis princërve në Evropë shpesh përfundonin me krushqi midis familjeve rivale. Duke bërë fuqishëm fushatë kundër një armiku të denjë, ai vendosi se ishte koha për të ndaluar dhe për të lëvizur përpara. Martesa dukej natyrore dhe e domosdoshme, një komponent për të siguruar një paqe të qëndrueshme.

Kryqtarët e tjerë ishin më pak ekumenikë. Richardi kuptoi se jo vetëm motra e tij kundërshtonte idenë, por ajo kishte mbledhur edhe të tjerët në anën e saj. Atij iu bë presion për të tërhequr ofertën. Në vend të kësaj, ai i shkroi Salahudinit për të ndryshuar propozimin e tij fillestar. “Të krishterët nuk pranojnë martesën e motrës sime pa u konsultuar me Papën”, shkroi Richardi. “Nëse ai autorizon martesën, kjo do të ishte më mirë. Nëse jo, të jap dorën e mbesës sime, për të cilën nuk ka nevojë për pëlqimin e Papës”.

Salahudini, për pjesën e tij, mund të ketë qenë jo i gatshëm të nënshkruante një marrëveshje, duke ditur se lufta të cilës ia kishte kushtuar jetën ishte ende larg nga qëllimi final i dëbimit të frankëve nga Palestina. Por, ai pa rrënojat që kishin shkaktuar luftërat, dhe me Jerusalemin e sigurt në vathën e myslimanëve, u pajtua t’i jepte fund armiqësive. Atij iu përkujtua nga një gjykatës i ditur se madje edhe Kur’ani këshillon bërjen e paqes kur ishte e leverdishme. “Nëse ata anojnë nga paqja, edhe ti duhet të anosh nga ajo”. Sipas Imad ad-Din, Salahudini duhej të bindej nga komandantët e tij se paqja ishte e nevojshme, megjithëse ia kishte kushtuar jetën xhihadit. Ai ishte një portretizim i favorshëm, nëse ishte në mënyrë strikte i vërtetë apo jo,

pasi i lejonte atij të ruante reputacionin si luftëtar, por jo të atij të veprëruar nga entuziazmi saqë nuk mund të bënte atë që ishte më e mira për nënshtetasit e vet.

Rezultat i këtyre negociatave ishte marrëveshja që ua linte frankëve kontrollin e Antiochit, Tripolit dhe pjesës më të madhe të bregdetit. Tregtarët - pavarësisht besimit apo vendit të origjinës së tyre - u lejuan të vazhdonin tregtinë pa iu nënshtuar obligimeve të rënda. Dhe më e rëndësishmja nga të gjitha, Salahudini premtoi se çdo të krishteri që dëshironte të bënte pelegrinazhin në Varrin e Shenjtë në Jerusalem do t’i mundësohej udhëtimi i sigurt dhe hyrja pa pengesa.<sup>10</sup> Me këtë, përfundoi Kryqëzata e Tretë.

Dhe kështu, çka duhet të themi për xhihadin e zhvilluar nga një mysliman i devotshëm kundër një kryqëzate të ndërmarrë nga të krishterët që përfshinte masakra dhe heqje koke, por gati përfundoi me një martesë midis familjeve të dy kundërshtarëve kryesorë. Si duhet të interpretojmë Salahudin, i cili ishte njëkohësisht luftëtar i pakrahësueshëm dhe kundërshtar fisnik i imagjinatës perëndimore për shekuj më pas? Dhe më kompleksja nga të gjitha, si i ngremë idetë bashkëkohore rreth luftës, religjionit dhe Islamit me botën e shekullit XII?

Imazhi i sotëm i xhihadistit, si një individ, identiteti i plotë i të cilit është përfshirë në një ideologji bart vetëm ngjasimin kalues me Salahudin. Në fakt, nocioni i thjeshtë i një ideologjie që dominon të gjitha aspektet e jetës ka qenë i huaj për shumicën e kulturave gjatë gjithë historisë. Në shekullin XII, realitetet ditore të bujqësisë, transportit, strehimit, mbijetesës së sëmundjes dhe luftimit në luftëra të rënda e të lodhshme ishin zakonisht ide njoftimi.

Religjioni dhe besimet ishin një pjesë e kaleidoskopit. Nganjëherë, fjalët e Kur’anit dhe hadithit (traditave) i shtynë njerëz si Salahudini të vepronin ashtu siç bënë. Nganjëherë, fjalët e Biblës dhe papës nxitën njerëz si Richardi të luftojnë, apo të mos luftojnë. Por, herëve të

<sup>10</sup> Shumica e kronikave për propozimin martesor është marrë nga Baha ad-Din, në Gabrielli, 225-31. Ngurrimi i Salahudinit për t’u pajtuar për marrëveshjen është në Imad ad-Din, gjithashtu në Gabrielli, 236-37.

tjera, çështjet familjare, sfidat e dinastisë, problemet shëndetësore dhe rivalitetet politike kishin më shumë rëndësi. Nganjëherë njerëzit luftonin me fjalët e tekstit të shenjtë që kumbonte në veshët e tyre; dhe nganjëherë ata takoheshin në fushëbetejë, duke i rënë njëri-tjetrit në shpinë, dhe bënin lojëra.

Para rënies së Jerusalemit më 1187, shtetet kryqtare qeverisnin dhe bashkëjetonin me një popullatë të madhe të krishterë dhe me një popullatë myslimane edhe më të madhe. Rezultati ishte gati ekuivalent me Kordobën, por nuk ishte periudha e konfliktit e definuar nga besimi. Lufta midis Salahudinit dhe Richardit ka shenjë e konfliktit religjioz, por në fund, ajo ishte vetëm një luftë midis sundimtarëve që përfundoi në rrugë qorre dhe gati në paqe të siguruar nga martesat. Rrënja e konfliktit në botën moderne mund të gjendet në kryqëzata, por vetëm duke harruar pjesën më të madhe të asaj që në të vërtetë ka ndodhur.

Derisa lëvizja e kryqëzatave vazhdoi të lulëzojë për mbi një shekull në Evropë, Jerusalemi nuk u kërcënua seriozisht nga të krishterët perëndimorë. Më 1204, ushtritë e Kryqëzatës së Katërt, të transportuar nga flota veneciane, morën rrugë të tërthorë dhe zbarkuan në Kostandinopojë. Qyteti u grabit dhe u terrorizua nga ushtritë perëndimore, synimi i të cilave ishte çlirimi i Tokës së Shenjtë. Egërsia me të cilën Kryqëzata e Katërt, e kombinuar nga fisnikët francezë dhe gjermanë, sulmoi bastionin e Krishterimit Lindor ishte ndërtuar për shumë vite. Madje, që kur Alexius Komneni dërgoi Kryqëzatën e Parë në rrugën e saj, fyerja e Bizantit ishte rritur. Venecianët gjithashtu lakmonin pasurinë dhe ndikimin e Bizantit mbi rrugët tregtare detare të Mesdheut.<sup>11</sup>

Salahudini vdiq shpejt pas largimit të Richardit, dhe djemtë e tij krijuan një dinasti që u shpërnda për një kohë shumë të shkurtër. Pasuesit e tij ishin gjithçka që ai nuk ishte: despotik, hedonist, të padisiplinuar. Pushtimi pasues mongol që shkatërroi kalifatin abasid më 1258 do të kishte vazhduar në Kajro, dhe ndoshta matanë Afrikës Ve-

riore po të mos kishte qenë ushtria e robërve memlukë, të cilët së pari mbështetën dhe pastaj përmbysën djemtë e nipërit luksozë të Salahudinit në pallatet e tyre në Kajro. Ushtria memluke ndaloi mongolët në betejën Ain Jalut afër Nazarethit më 1260, dhe kalorësit kurrë nuk kërcënuan më Lindjen e Afërt.

Egjipti i memlukëve ishte një shtet stabil e i prosperuar, i lidhur me tregtinë me Perëndimin e Lindjen falë klasës së tregtarëve të suksesshëm hebrenj, të krishterë dhe myslimanë të të gjitha kategorive. Frankët dhe gjermanët kuptuan rëndësinë e Egjiptit, dhe kryqëzatat e mëvonshme të shekullit XIII synuan Egjiptin duke besuar se ishte çelësi strategjik për në Jerusalemin. Këto përpjekje dështuan. Egjipti i zmbropsi me lehtësi ushtritë e Evropës, dhe Kajroja mbeti e paprekur.

Siguria relative e Kajros ishte magnet, dhe midis shumë personave që joshi ishte një hebre spanjoll nga Kordoba, i cili arriti me pak më shumë se rrobat dhe disa libra të tij, pasi iku nga dhuna e kaosi që kishte gllabëruar atëherë Andaluzinë. Duke parë atdheun e tij të vërshuar nga ushtritë berbere nga Maroku dhe qyteti i tij, Kordoba, të shkatërruar seriozisht nga flakët, shkoi matanë Mesdheut në Egjipt. Po të kishte mbetur në Kordobë, ndoshta kurrë nuk do të kishte shkruar atë që bëri, apo të mësonte atë që mësoi. Por, pasi u mirëprit në pallatin e Salahudinit, ai lulëzoi, u ngarkua me një trishtim të thellë, por ishte i nxitur nga etja intelektuale. Trashëgimia më e rëndësishme e Salahudinit për Islamin është pushtimi i Jerusalemit. Pa pasur ndonjë qëllim, ai gjithashtu i dha formë evolucionit të Judaizmit modern, kur administratori i pallatit të tij në Kajro punësoi një të ikur hebre, Moses Maimonides, si mjek të pallatit.

Marrë nga libri *“Ithtarët e Librit: Historia e harruar e Islamit dhe Perëndimit”*, të autorit Zachary Karabell

*Përktheu:*  
**Fuad Morina**

<sup>11</sup> Për një kronikë të fundme të shkëlqyer, shih Jonathan Phillips, *The Fourth Crusade and the Sack of Constantinople* (New York: Penguin Group, 2004)

Zachary Karabell

## SALADIN AND HIS JIHAD?

### (Summary)

The soldiers arrived in the outskirts of Jerusalem at the end of September in 1187. Almost a century had passed since the Franks had occupied the city and no Muslim army had been able to retake it. After the massacre of its inhabitants in 1099, the kingdom of Jerusalem entered a long period of peace and prosperity. Pilgrims from Europe could come and go without restrictions of any kind, while the king collected taxes from the cities and controlled the coast of Palestine.

زاکاري کرابيل

## جهاد صلاح الدين؟

### (خلاصة البحث)

وبدا الجنود على مشارف القدس في أواخر أيلول، وذلك قبيل الانقلاب في خريف ١١٨٧. وقد رضى ما يقرب من قرن من الزمان عندما الفرنجة قد احتلوا المدينة، وليس هناك جيش مسلم لم يكن لها انعكاس القريب. بعد ذبح سكانها السابق في عام ١٠٩٩، دخلت المملكة في القدس لفترة طويلة من منة الهدوء والرخاء. وجاء الحجاج من أوروبا وذهب بحرية، و الملك كات يتقاضى الخراج من المدن والسواحل يمتلكها على حوض فلسطين.

## TRASHËGIMI ISLAME

*Abdurrahman ibn Haldun*

### MBI PËRPARËSITË E SHKENCËS SË HISTORISË DHE ANALIZËN E METODAVE TË SAJ ME NJË VËSHTRIM MBI GABIMET DHE PARAGJYKIMET E HISTORIANËVE DHE DISA NGJA SHKAQET E TYRE (Fragment nga vepra *El-Mukaddime*)

Dije se historia është njëra nga disiplinat e çmuara shkencore që sjell dobi të shumta dhe ka qëllim të pastër. Ajo na ofron të dhëna mbi gjendjet e popujve të kaluar në sjelljet dhe karakteret e tyre, mbi biografinë e të dërguarve si dhe mbi shtetet e dinastitë e mbretërve dhe qeverisjen e tyre. Për këtë nevojiten burime të llojllojshme, njohuri të gjera si dhe vërtetim dhe verifikim solid, gjëra këto të cilat e çojnë humltuesin kah e vërteta dhe e ruajnë nga gabimet e mashttrimet.

Në qoftë se studiuesi në punën e vet mbështetet kryekëput në transmetimin e ngjarjeve duke mos marrë për bazë parimet e zakoneve dhe ligjet e politikës, nëse nuk mbështetet në karakterin e qytetërimit dhe rrethanat e shoqërisë njerëzore, nëse nuk e krahason të padukshmen me të dukshmen, të tashmen me të kaluarën, mbase nuk do t'iu shpëtojë gabimeve, pengesave dhe largimit nga rruga e vërtetë.

Gjatë transmetimit të rrëfimeve e ndodhive, historianët dhe komentatorët kanë bërë gabime të shumta si pasojë e mbështetjes së tyre qenësore te transmetimi, duke mos çarë kokën se a është ai i shpifur apo i vërtetë si dhe duke mos i kushtuar vëmendje burimit të tyre. Nuk i krahasuan me ekuivalentët e ngjashmëritë e as që i vlerësuan me kriteret e urtësisë, në përputhshmëri me karakterin e qenieve duke e shpërfillur vëzhgimin dhe mendjemprehtësinë.

Kësisoj, ata u larguan nga e vërteta dhe ndoqën rrugën e imagjinatës dhe gabimit.

Kjo ndodhi veçanërisht gjatë të dhënave mbi sasinë e pasurisë dhe numrin e ushtarëve kur kjo përmendej në një kronikë të caktuar. Si rezultat i kësaj, të dhënat bëhen burim i qëndrimeve të rreme e absurde, përderisa ato patjetër duhet të mbështeten në burime të sigurt dhe të peshohen me parime e principe objektive.

Një rast i tillë është edhe ndodhia të cilën e transmeton El-Mes'udi dhe shumë historianë të tjerë lidhur me ushtrinë e Benu Israilëve,<sup>1</sup> të cilën Musau a.s. e numëroi në shkretëtirë. Pasi e kaluan ata që kishin mundësi, Musau a.s. ua dha armë vetëm atyre që i kishin kaluar të njëzetat e përpjetë, ashtu që numri i tyre i përgjithshëm ishte gjashtëqind mijë apo më shumë.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Ka për qëllim ushtrinë e Benu Israilëve e cila ka luftuar me Jushe'a Ibn Nunin pas daljes nga toka ku ata bredhnin (toka e shkretëtirës). Mbi këtë ngjarje, Ibn Hazmi në veprën e tij *El-Faslu fi-l-milel ve-l-ehva' ve-n-nihal* ka folur gjerësisht, ku, ndër të tjera thotë se "... numri i qyteteve të cilat i përmend Tevratit, e në të cilat ishin shpërndarë bijtë e Jakubit, ishte katërqind ...". Dhe shton duke thënë se "Ky vend ekziston edhe sot e kësaj dite dhe nuk ka një sipërfaqe më të madhe se sa 12 x 12 milje. Duke marrë parasysh këtë sipërfaqe, arrijmë në përfundim se kjo e dhënë është e papranueshme". (*El-Faslu fi-l-milel ve-l-ehva' ve-n-nihal*, f. 165-168).

<sup>2</sup> Përkundër kësaj, El-Mes'udi (346 h – 957 e.r.) ka meritë duke qenë historian i parë islam, i cili i radhiti ngjarjet sipas përmbajtjeve, derisa historianët e tjerë para tij, si Et-Taberi i radhitnin në bazë të kronologjisë. El-Mes'udi në veprën e tij *Et-tenbih ve-l-ishraf* i rezymon pikëpamjet e tij mbi filozofinë e historisë, gjithësisë, këndvështrimet e filozofëve mbi shkallëzimin, lidhjen ndërmjet mineraleve, bimëve e kafshëve. E gjithë kjo si përpjekje për t'i nxjerrë ligjet e përgjithshme të cilat vënë në dukje ngjarjet dhe ndodhitë në çdo kohë. Ky është një konstrukt të cilin e përfundoi Ibn Halduni në këtë vepër të tij.

Në bazë të madhësisë së Egjiptit dhe Shamit, përkatësisht territorit të tyre, është e pamundur që një ushtri të posedojë numër kaq të madh ushtarësh.

Po ashtu, në mes të një ushtrie kaq të madhe me atë numër ushtarësh, nuk mund të mos ndodhë ndonjë përlëshje a luftë për shkak të hapësirës së ngushtë dhe distancës po qe se rreshtohet në atë mënyrë sa kap syri i njeriut në dy, tri radha apo më tepër.

Si mund të luftojnë këto dy grupe, apo si mund të ndodhë mposhtja e njërit grup apo diç e ngjashme pa e ndier fare ana tjetër?

E tashmja është dëshmitare e kësaj, ndërsa e kaluara i ngjan aq së ardhmes mu siç i ngjan uji-ujit. Mbretëria dhe dinastia e Persisë ka qenë shumë më e madhe se ajo e Benu Israilëve. Këtë e dëshmon më së miri fitorja e Nabukodonosorit<sup>3</sup> ndaj tyre, me ç'rast ua pushtoi qytetet si dhe e shkatërroi Jerusalemin, kryeqytetin e mbretërisë së tyre, i cili më pas u shndërrua në një provincë të Perandorisë persiane.

Thuhet se kufijtë e saj i kishte nën kontroll mëkëmbësi i Marokut.

Provincat e tyre të Irakut, Huzistanit, Horasanit, Transoksanisë dhe të Derbendit<sup>4</sup> janë shumë më të mëdha se provincat e Benu Israilëve.

Megjithatë, ushtria e Perandorisë persiane asnjëherë nuk e ka mbërritur këtë numër, madje as përafërsisht. Ushtria e tyre më e madhe kishte qenë ajo në Kadisijje,<sup>5</sup> ku ishin mbledhur njëqind e njëzet mijë ushtarë, ndërkaq sipas transmetimit të Sejfit,<sup>6</sup> numri i tyre ishte

<sup>3</sup> Nabukodonosor është mbreti i cili e shkatërroi Bejtu-l-Makdisin (Jerusalemin) për herë të parë siç përmendet në Kur'an: **“E kur erdhi koha e përmbyshjes së profecisë për ngatërresën e parë, Ne dërguam kundër jush disa robër Tanët, luftëtarë të fuqishëm, të cilët shkëlën në çdo cep të shtëpive tuaja. Kështu u krye premtimi”**. (El-Isra': 5)

Ai i rrënoi faltoret, vrau burra, gra dhe fëmijë çifutë si dhe e rrëgoi Bejtu-l-Makdisin.

<sup>4</sup> Derbend / Portae Caspiae / – gjendet pranë detit Kaspik, i cili së bashku me ishujt e tij tani i takojnë Rusisë (vër. e përkth.).

<sup>5</sup> Kadisijje është një qytet dhe krahinë në Irak. Në vitin 15 h (636 e. r.) aty zhvillohet një betejë mes arabëve dhe persianëve, pas së cilës arabët shumë shpejt e morën në dorë tërë Persinë (vër. e përkth.).

<sup>6</sup> Sejfi ibn 'Umer el-Esedi ishte prijësi i besimtarëve në betejë a luftëra që i zhvillonin ata.

mbi dyqind mijë. Kurse, Aisheja dhe Ez-Zuhri<sup>7</sup> transmetojnë se ushtria e Rustumit<sup>8</sup>, e cila arriti në Kadisijje numëronte gjashtëdhjetë mijë ushtarë.

Po ashtu, sikur të kishin Benu Israilët një ushtri kaq të madhe, do të zgjerohej medoemos territori i mbretërisë së tyre, meqë numri i krahinave dhe provincave të një mbretërie varet kryesisht nga numri i mbrojtësve dhe ushtarëve në to, ashtu siç do ta sqarojmë këtë në nënkapitullin mbi provincat, në kreun e parë.

Kurse, provincat e Benu Israilëve nuk ishin të zgjeruara në territoret e tjera përpos në Jordani, Palestinë dhe në viset e Jethribit (Medines, vër. e përkth.) dhe Hajberit në Hixhaz, ashtu siç është e njohur.

Gjithashtu, ndërmjet Musaut dhe Israilit janë vetëm tre<sup>9</sup> breza, siç e përmendin këtë historianët.

Ai është Musa ibn 'Imran ibn Jas'her ibn Kaheth ibn Lavi ibn Ja' - kub që është Israili. Kështu ceket gjenealogjia e tij në Tevrat.

Ndërkaq, periudha ndërmjet tyre është siç e transmeton El-Mes' - udi, i cili thotë:

*“Israili arriti në Egjipt së bashku me djemtë e tij, ndërsa djemtë e tyre (nipat e tij, vër. e përkth.) kur erdhën te Jusufi, ishin shtatëdhjetë. Ata banonin në Egjipt deri në kohën kur dolën prej tij dhe u shpërngulën së bashku me Musain për në shkretëtirë.”*<sup>10</sup>

<sup>7</sup> Aisheja është bija e halifit të parë, Ebu Bekrit dhe gruaja e të dërguarit të All-llahut, Muhammedit a.s.

- Ez-Zuhri (671-742) është Muhammed ibn Muslim, i njohur si Ibn Shihab. Ishte i pari i cili filloi ta regjistronte hadithin (vër. e përkth.).

<sup>8</sup> Rustumi ishte komandanti persian, kurse Sa'd ibn Ebi Vekkas – komandant arab në betejën e Kadisijjes (vër. e përkth.).

<sup>9</sup> Përkundrazi, në të vërtetë janë katër breza. Ibn Halduni e shtjelloi këtë pikëpamje të tij duke u mbështetur në krahasimin e të padukshmes me të dukshmen si dhe me parimin: *“Karakterit nuk ndryshon kurrë; ai nuk mund të ndërrohet tek çdo njeri i mençur”*. Këtë e cek Ibn Hazmi në veprën e lartpërmendur (El-Faslu ..., 5 / 16). Është një parim shkencor që konsiderohet prej veprimeve të rëndësishme tek dijetarët muslimanë, siç është Ibn Hazmi, mirëpo tek Ibn Halduni është shfaqur në një formë më të plotë.

<sup>10</sup> Shkretëtira – është toka në të cilën kanë bredhur Benu Israilët plot dyzet vjet, pasi që refuzuan të hynin në tokën e shenjtë. All-llahu i Lartësuar thotë: **“All-llahu tha: “Ajo (toka e shenjtë) u është ndaluar atyre për dyzet vjet. Ata do të bredhin të çoroditur në për tokë, por ty mos të të vijë keq për atë popull të pabindur”**. (El-Maide: 26)

*Kjo periudhë zgjati dyqind e njëzet vjet, kohë kjo gjatë së cilës ata ishin nën sundimin e mbretërve koptë - faraonëve”.*

Prandaj, është e pamundur që gjatë një periudhe prej katër brezash,<sup>11</sup> pasardhësit të arrijnë një numër kaq të madh.

E nëse pretendojnë se numri i asaj ushtrie ishte në kohën e Sulejmanit a.s. dhe pas tij, kjo, gjithashtu nuk është e pranueshme, meqë ndërmjet Sulejmanit dhe Israilit kanë qenë njëmbëdhjetë breza: Sulejman ibn Davud ibn Isha ibn Avidh (thuhet edhe Avfedh) ibn Ba’iz ibn Selmun ibn Nahshun ibn ‘Aminadhab (thuhet edhe Haminadhab) ibn Rem ibn Hadrun (thuhet edhe Hasrun) ibn Baris (thuhet edhe Biris) ibn Jehudha ibn Ja’kub.

Gjatë njëmbëdhjetë brezave, në asnjë mënyrë, pasardhësit nuk mund të shumohen aq sa pretenduan ata.

Mund të ndodhë që të arrijnë në disa qindra e mijëra, por t’i tejkalojnë ato në numra disashifrorë, është, vërtet, shumë larg.

Po t’i vështrojmë faktet e tanishme dhe të dhënat e para pak kohe, do të bindeshim se pretendimet e tyre janë të kota dhe transmetimet e tyre – të rrejshme.

Në veprat që flasin mbi çifutët, pohohet se ushtria e Sulejmanit a.s. numëronte dymbëdhjetë mijë njerëz, njëmijë kuaj të zgjedhur dhe katërqind kuaj të tjerë, të gatshëm, të lidhur te portat e tij.

Kjo është e vërteta lidhur me ndodhinë e tyre, ndërsa trillimet dhe legjendat e masës nga radhët e tyre duhen shmangur dhe nuk duhet të merren fare parasysh.

Duhet përmendur fakti që në kohën e Sulejmanit a.s., shteti i tyre arriti kulminacionin dhe zgjerimin më të madh.

Nga ana tjetër, vërejmë se, sot, të gjithë njerëzit kur fillojnë të flasin mbi ushtritë e shteteve të kohës së tyre apo të kaluara, kur i përfolin rrëfimet mbi ushtritë e myslimanëve apo të krishterëve, apo

<sup>11</sup> Të njëjtën gjë e pohon edhe Ibn Hazmi në veprën e tij të sipërpërmendur (1 / 121), ku thotë se janë katër breza. Me emërtimin “brez”, Ibn Halduni këtu ka për qëllim brezin e Ibrahimit a.s., brezin e Is’hakut dhe vëllezërve të tij, brezin e Ja’kubit dhe djemve të tij, ku hyn edhe Jusufi a.s. të cilët hynë në Egjipt si dhe brezin e atyre që dolën nga Egjipti, ku bën pjesë edhe Musai a.s.

tregojnë vëllimin e pasurisë nga haraçi i mbretit, shpenzimet dhe mjetet e pasanikëve, e tejkalojnë kufirin dhe numrin e saktë duke u dhënë pas gjërave të çuditshme, të cilat nuk i pranon as feja e as mendja e shëndoshë.

E kur përgjegjësit e regjistrimit t’i hulumtojnë ushtritë e tyre, e ta zbulojnë sasinë e mjeteve dhe të ardhurave të pasanikëve si dhe t’i vënë në pah shpenzimet e tyre, nuk do të dalë as një e dhjeta e asaj që ata e pretenduan.

Kjo, për arsye se njeriu është i dhënë fort pas gjërave të çuditshme, të cilat shumë lehtë i shqipton, duke mos çarë kokën fare për pasojat e kritikës.

Ai, kësisoj, nuk e kontrollon veten për gabimet dhe lëshimet e bëra, nuk përkujdeset për objektivitetin dhe vërtetësinë e ndodhisë së caktuar, e madje as nuk i referohet studimit dhe hulumtimit.

Përkundrazi, e zgjat gjuhën dhe zhytet në biseda të gënjeshtërtë, i merr ajetet e All-llahut si objekt talljeje, blen gjeputura për zbavitje për të larguar nga rruga e All-llahut. Një punë e tillë është e kotë dhe e ka të garantuar dështimin.

Prej ngjarjeve të pambështetura të cilat i transmetojnë historianët është edhe rrëfimi mbi Tubët (Tubbe’a), mbretërit e Jemenit dhe Gadishullit Arabik.

Historianët përmendin se ata luftonin nga viset e tyre në Jemen e deri në Afrikë dhe Berber në viset e Marokut dhe se Ifrikish<sup>12</sup> ibn Kajs ibn Sajfi ishte njëri nga mbretërit e tyre të parë më të mëdhenj, i cili jetonte në kohën e Musait a.s. apo pak para tij.

Zhvilloi beteja në Afrikë, ku bëri kërdi në mesin e berberëve. Dhe ishte ai, i cili ua ngjiti atyre këtë emër pasi dëgjoi gjuhën e tyre që nuk e kuptonte, me ç’rast pyeti: “Ç’është kjo llomotitje?”<sup>13</sup>

Kësisoj, ata e morën këtë emër - *berberë* dhe që nga ajo kohë u quajtën ashtu.

<sup>12</sup> Me emrin e tij lidhet Afrika, e cila në të kaluarën përfshinte vetëm viset e Tunisit. Më pastaj, me këtë emër u quajt i tërë kontinenti.

<sup>13</sup> Fjala “berbere” nga gjuha arabe, do të thotë “llomotitje”. (vër. e përkth.).



Lidhur me të, historianët shtojnë se pasi u largua nga Maroku, i la atje disa fise nga Himjeri, të cilët u vendosën aty dhe u përzien me banorët e tij.

Disa prej tyre janë: Sanhaxhe<sup>14</sup> dhe Kutame. Mendimin se këto dy fise janë nga Himjeri<sup>15</sup> e mbrojnë Et-Taberi, El-Xhurxhani,<sup>16</sup> El-Mes'-udi, Ibnu-l-Kelbi dhe El-Bili, përderisa këtë e refuzon gjenealogjia e berberëve dhe e vërteta është se ata u takojnë atyre.

El-Mes'udi përmend, po ashtu, se njëri prej mbretërve të tyre me emrin Dhu-l-Idh'ar kishte jetuar para mbretit Ifrikish.

Ka sunduar gjatë kohës së Sulejmanit a.s. Zhvilloi luftë kundër Marokut dhe e mposhti. Ngjashëm me të, ai rrëfen edhe për djalin pas tij, Jasirin, duke thënë se arriti deri në *Vadi-r-reml* (Lugina e rërës), nga viset e Marokut.

Mirëpo, pasi nuk mund të depërtonte për shkak të rërës së madhe, u kthye.

Të njëjtën gjë rrëfejnë edhe për një mbret tjetër me emrin Es'ad Ebu Kereb,<sup>17</sup> i cili sundonte në kohën e Justasif-it, njëri nga mbretërit kenianë të Persisë.

Ai ishte mbreti i Mosulit dhe Azerbejxhanit. I sulmoi turqit të cilët i mposhti duke bërë masakër mbi ta. Më pas, i sulmoi sërish për së dyti dhe për së treti. Më vonë, i dërgoi tre bijtë e tij që të zhvillojnë luftë në viset e Persisë, të Sogdit<sup>18</sup> që ishin të populluara nga turqit në Transoksani dhe në viset e Perandorisë Bizantine.

Djali i tij i parë i nënshtroi krahinat deri në Semerkand<sup>19</sup> dhe arriti deri në Kinë, ku e takoi vëllanë e tij të dytë, i cili zhvillonte luftë në Sogd.

<sup>14</sup> Sanhaxhe - vend në Marok. Thuhet se ndodhej në Granadë, madje ishte edhe kryeqytet i saj gjatë sundimit të fiseve: Benu Nasr, Benu-l-Ahmer dhe Ez-Zejdun.

<sup>15</sup> Himjer janë një popull i lashtë semit në Jemen.

<sup>16</sup> Ai është Ali ibn Abdu-l-Aziz (ka vdekur në vitin 1002 në Rejj), njëri nga filologët e shquar arabë në Lindje (vër. e përkth.).

<sup>17</sup> Është fjala për mbretin për të cilin i Dërguari s.a.v.s. ka thënë: "*Dhe nuk e di se a ishte mbret i mallkuar*".

<sup>18</sup> Sogd - krahinë në Azinë e Mesme (vër. e përkth.).

<sup>19</sup> Semerkand - sot është kryeqytet i shtetit të Uzbekistanit. Në të kaluarën, ishte kryeqytet i krahinave të Sogdit në Azinë e Mesme.

Ai kishte ardhur aty përpara tij, kështu që të dytë i sulmuan territoret e Kinës dhe u kthyen me plaçka të majme duke i lënë në krahinat e Tibetit disa fise nga Himjeri, të cilët ende banojnë atje.

Djali i tij i tretë, arriti deri në Konstantinopojë, të cilën e rrethoi, i nënshtroi krahinat e Perandorisë Bizantine dhe u kthye.

Të gjitha këto rrëfime janë larg së vërtetës, thjesht hipoteza dhe paragjykime që u ngjajnë rrëfimeve të shpifura e të trilluara të predikuesve.

Kjo, për arsye se mbretëria e Tubëve ndodhej në Gadishullin Arabik, kurse qendra dhe fronti i tyre ishin në San'a të Jemenit.

Dihet se Gadishulli Arabik është i rrethuar me dete nga të trija anët: Oqeani Indian nga jugu, Gjiri Persik që kalon në Basra nga lindja dhe nga ana perëndimore - Kanali i Suezit, që kalon në Suez - territor i Egjiptit, siç mund të vërehet në hartat gjeografike.

Kësisoj, ata që dëshironin të depërtin nga Jemeni për në Marok, nuk gjenin rrugë tjetër pos Suezit.

Kurse, rruga aty, ndërmjet kanalit të Suezit dhe Detit Mesdhe zgjat dy ditë në këmbë apo më pak.<sup>20</sup>

Andaj, është larg mendjes që një mbret aq i madh, me një ushtri gjigante të kalojë nëpër këtë rrugë pa qenë ajo pjesë e territorit të tij.

Kjo është, natyrisht, e pamundur.

Ato territore i kontrollonin Amalikët, në Sham - Ken'anët, ndërsa në Egjipt - Koptët.

Pastaj, Amalikët e nënshtroan Egjiptin, kurse Benu Israilët - Shamin, përderisa asnjëherë nuk është përmendur se Tubët zhvilluan luftë kundër ndonjërit prej atyre popujve e as se nënshtroan ndonjë territor të tyre.

Gjithashtu, distanca ndërmjet Jemenit dhe Marokut është mjaft e largët, andaj edhe furnizimet dhe shpenzimet e ushtarëve janë të mëdha.

<sup>20</sup> Pas kritikës së tekstit dhe transmetimit të kësaj ndodhie, Ibn Halduni përdori këtu edhe një mori njohurish të ndryshme, të cilat sot njihen si "*faktet, të dhënat ndihmuese*", për të arritur tek një rezultat i pranueshëm dhe i kapshëm.

Kështu, po të kalonin nëpër territore të huaja, do të detyroheshin t'i rrëmbenin e t'i plaçkisnin ato në vendet nëpër të cilat kalojnë, gjë e cila, padyshim, nuk do t'i përmbushte nevojat e tyre.

E sikur t'i bartnin plaçkat nga territoret e tyre, një gjë të tillë kafshët bartëse nuk do të mund ta bënë. Prandaj, duhej të kalonin patjetër tërë rrugën nëpër territore të cilat më parë i zotëruan dhe i nënshtruan me qëllim që të furnizohen nga aty. E nëse pandehim që ajo ushtri të ketë kaluar nëpër ato vende pa i ngacmuar banorët e atjeshëm, me ç'rast të kenë arritur deri te furnizimi në mënyrë paqësore, kjo është edhe më e pamundur.

Në këtë mënyrë, arrijmë në përfundim që këto rrëfime e ndodhi janë të pabaza apo të trilluara. Ndërkaq, sa i përket luginës së rrërës (*Vadi-r-reml*), e cila është e pakalueshme për kalimtarët, një gjë e tillë nuk është përmendur asnjëherë në Marok, me gjithë numrin e madh të njerëzve që e kaluan atë dhe rrëfien mbi rrugët e saj në çdo kohë dhe nga çdo anë.

Kurse, beteja e tyre në viset e Lindjes dhe territoret e turqve, me gjithë faktin se rruga andej është më e gjerë se Kanali i Suezit, distanca këtu është shumë më e largët. Po ashtu, aty do t'i ndeshnin si kundërshtarë persianët dhe bizantinët, e kurrësi turqit.

Nga ana tjetër, nuk është transmetuar asnjëherë se Tubët i nënshtruan territoret e Perandorisë Persiane e as të asaj Bizantine, mirëpo zhvillonin luftë me persianët afër kufijve të territorit të Irakut, ndërmjet dy deteve, në Hira, në gadishullin mes Dixhles dhe Furatit dhe disa territore ndërmjet tyre.

Kjo ka ndodhur në mes të Dhu-l-Idh'arit dhe Kikavis-it, një nga mbretërit kenianë si dhe ndërmjet mbretit Ebu Kereb dhe Justasif-it.

Ndërkaq, të pretendohet se pas kenianëve dhe sasanidëve,<sup>21</sup> luftimet janë zhvendosur nga viset e Persisë për në territoret e turqve dhe tibetanëve, është një gjë thjeshtë e pamundur, për shkak të popujve që

i pengonin dhe i zmbropsnin nga ata si dhe për shkak të mungesës së furnizimit e ushqimit.

Shtoja kësaj edhe distancën mjaft të largët që u përmend më sipër.

Nga sa u tha, mund të vijmë në përfundim se këto informata janë të pabaza dhe të shpifura.

Po edhe sikur transmetimi të ishte i vërtetë, prapëseprapë do t'i njolloste ato, meqë nuk u transmetuan në formën e drejtë.

Ibn Is'haku rrëfen se një mbret tjetër i tyre u drejtua për në Lindje që të zhvillojë luftë në Irak dhe territoret e Persisë.

Ndërkaq, sa i përket luftës së tyre në viset turke dhe tibetane, një gjë e tillë nuk është e vërtetë në asnjë mënyrë siç u përmend më lart.

Prandaj, kurrësi mos u beso rrëfimeve të këtij lloji, por vështroji ato me kujdes dhe peshoji e krahasoji me parimet e vërteta e të shëndosha, në mënyrë që të arrish deri te korrigjimi në formën më të mirë.

E Zoti është Udhëzuesi te e drejta dhe e vërteta.

## Ekskurs

Pikëpamje më të largëta se këto i gjejmë te transmetimet e komentatorëve të Kur'anit mbi shpjegimin e sures El-Fexhr. Fjala është për ajetet kur'anore ku All-llahu i Lartësuar thotë:

***“A nuk e di se ç'bëri Zoti yt me Adin?”<sup>22</sup> Banorët e Iremit, me shtylla (pallatet)?” (El-Fexhr : 6-7)***

Kështu, theksojnë se “*Irem*” është emër i një qyteti i cili përshkruhej se kishte shtylla të larta. Ata transmetojnë, po ashtu, se Ad ibn Avs ibn 'Irem kishte dy djem, njëri nga të cilët quhej Shedid, kurse tjetri – Sheddad.

Ata e trashëguan pushtetin pas vdekjes së tij, por së shpejti Shedidi vdiq, kështu që e tërë mbretëria kaloi në duart e Sheddadit.

<sup>21</sup> Sasanidët janë një dinasti persiane, e cila ka sunduar nga deceniet e para të shek. III e deri në fillim të shek. VII të e. r. (vër. e përkth.).

<sup>22</sup> Ad, sipas Kur'anit, është emër i një populli të lashtë në Arabi, tek i cili ishte dërguar Pejgamberi i All-llahut, Hudi. Ata kanë jetuar në krahinën e Ahkafit, ndërmjet Jemenit, Omanit, Bahrejnit dhe Hadramevit.

Një ditë, ai kishte dëgjuar mbi përshkrimin e xhennetit dhe kishte thënë:

“*Do ta ndërtoj gjithsesi një të tillë*”. Atëherë, ngriti dhe themeloi qytetin ‘Irem në shkretëtirat e Adenit. Ndërtimi zgjati treqind vjet, kurse ai kishte nëntëqind vjet.

Ishte ai një qytet vërtet i madh, me pallate të arta dhe shtylla topazi e rubini. Aty kishte pemë të llojllojshme dhe lumenj që ridhnin.

Pas përfundimit të ndërtimit, ai hyri në të së bashku me suitën, përcjellësit dhe banorët e mbretërisë së tij.

Pasi kaloi në të rrugëtimin njëditor, All-llahu i Lartësuar ua dërgoi atyre një britmë nga qielli, e cila i shkatërroi të gjithë.

Këtë e përmend Et-Taberi, Eth-The’alibi,<sup>23</sup> Ez-Zamahsheri<sup>24</sup> dhe disa komentatorë të tjerë. Ata transmetojnë po ashtu për Abdullah ibn Kilabe, njëri nga sahabët,<sup>25</sup> se një ditë kishte dalë për t’i kërkuar devet e tij, me ç’rast kishte qëlluar në qytetin e ‘Iremit, nga ku mori aq sa mundi dhe më pas u largua.

Lajmi i tij arriti tek Muaviu<sup>26</sup>, i cili e ftoi dhe e dëgjoi rrëfimin e tij. Më pas, Muaviu e kërkoi Ka’b el-Ahbarin, të cilin e pyeti mbi këtë, e ai i tha:

“*Është ‘Iremi me shtylla të larta, në të cilin gjatë sundimit tënd do të hyjë një njeri prej myslimanëve, i shkurtër, me ngjyrë si të kuqërremtë. Në vetullën dhe qafën e tij ka një shenjë. Ai do të dalë për t’i kërkuar devet e tij të humbura*”.

Më pas, u kthye dhe sapo e pa Ibn Kilaben, tha: Për All-llahun, ky është ai njeri.

<sup>23</sup> Eth-The’alibi është Abdu-l-Melik ibn Muhammed Ebu Mensur en-Nejsaburi (961-1037), letrar, filolog dhe historian.

<sup>24</sup> Ez-Zamahsheri është komentues i njohur i Kur’anit (autor i veprës *El-Keshshaf ‘an ha-kaiki-t-tenzil*) dhe filolog, i njohur me nofkën Xharu-ll-llah (ka jetuar mes viteve 1075-1144).

<sup>25</sup> Përkundrazi, ai është njëri prej tabi’inëve. Emri i tij i plotë është Abdullah ibn Zejd el-Basri. Ka transmetuar nga Semure ibn Xhundub, Enes ibn Malik, Thabit ibnu-d-Dahhak dhe nga nëna e besimtareve, Aishja r.a. E kërkuan që ta emërojnë gjykatës në Basra, prandaj ai iku nga aty për në Sham. Vdiq në vitin 105 h. Dhehebiu e përmendi në *Tedh-kiretu-l-huffadh*, 1 / 94.

<sup>26</sup> Ai është Ibn Ebi Sufjan (603-680), themelues i dinastisë emevite.

Që nga ajo kohë, ky qytet sikur i humbi fare gjurmët e tij. Ai nuk u përmend asnjëherë në ndonjë sipërfaqe të tokës, ndërkaq shkretëtirat e Adenit, në të cilat ata pretendojnë se është ngritur qyteti, janë mes Jemenit dhe edhe sot e kësaj dite ndërtimet aty janë të pandërprera. Kalimtarët dhe udhërrëfyesit i dëftojnë rrugët e tyre nga çdo anë dhe asnjëherë nuk është transmetuar ndonjë e dhënë mbi këtë qytet.

Atë nuk e përmendi asnjë kronist e historian islam e as dikush nga popujt tjerë.

Sikur të thoshin se gjurmët e tij janë zhdukur në mesin e mbeturinave të humbura, do të ishte më e logjikshme, mirëpo pohimet e tyre vënë në dukje se ai ekziston.

Madje, disa prej tyre thonë se bëhet fjalë për Damaskun, duke u mbështetur në faktin që populli i Adit e zotëronte atë.

Disa të tjerë, bile, i shtyri llomotitja që të pretendojnë se ky qytet është i padukshëm dhe se në të mund të hyjnë vetëm sufite, mistikët dhe magjistarët.

Të gjitha këto janë paragjykime e hipoteza që u ngjajnë miteve e legjendave.<sup>27</sup>

Ajo që i shtyri komentatorët në një gjë të këtillë ishte ndërtimi sintaksor në fjalën “*dhati-l-‘imad*”, të cilën e shpjeguan si përcaktor të fjalës “*Irem*”.

Këtë ua mundësoi edhe leximi i Ibnu-z-Zubejrit “*Adi ‘Irem*”,<sup>28</sup> me anë të lidhjes gjinore pa tenvin.

Më pas, zunë t’i përmendin ato rrëfime të cilat u ngjanë më tepër tregimeve të shpifura e të trilluara. Ato janë më afër shpjegimeve të Sikavejhit, që bëjnë pjesë në grupin e anekdotave dhe mahive.

Përndryshe, shtyllat, siç është e njohur, janë shtyllat e tendave dhe shatorreve. Po edhe sikur të komentoheshin me të tjera, kjo s’do të

<sup>27</sup> Njëri prej sufive i kishte thënë një tjetri: “*Kam hyrë në ‘Irem, që ka shtylla të larta, në mbretëritë e All-llahut*”, kurse ai iu përgjigj: “*Unë kam hyrë në njëmijë qytete, në mbretëritë e All-llahut. Secili prej tyre ishte më i madh se ‘Irem*”.

Ndërsa, All-llahu i Lartësuar thotë: “*I cili nuk pati shoq askund*”. (*El-Fexhr* : 8) Shih: Ebu Talib el-Mekki, *Kutu-l-kulub*, 2 / 70.

<sup>28</sup> Në këtë mënyrë e lexoi El-Hasen dhe Ebu-l-‘Alije. Është një lexim që nuk është transmetuar pandërprerë (nuk është mutevatir), siç ceket në: *Takribu-n-neshr*, f. 188.

thotë në asnjë mënyrë që aty bëhet fjalë për një ndërtim të veçantë të një qyteti të caktuar apo ndonjë tjetër.

Ndërkaq, nëse lexohet me lidhje gjinore siç veprojnë Ibnu-z-Zubejri, atëherë këtu bëhet fjalë për lidhjen e familjes me fisin, si bie fjala: Kurejshu Kinane (Familja Kurejsh e fisit Kinane, vër. e përkth.), Iljasu Mudar, Rebi'a Nizar e të ngjashme.

A thua, vallë, kishte nevojë për këtë motiv të largët që rezultoi me tregime të tilla të pabaza, të cilat nuk i pranon libri i All-llahut për shkak se qëndrojnë larg së vërtetës.

Njëri nga rrëfimet e trilluara të cilin e transmetojnë të gjithë historianët është edhe tregimi mbi shkakun e hakmarrjes së Harun er-Reshidit ndaj Bermekidëve.<sup>29</sup>

Tregimi zë fill kështu: “El-Abase, motra e Harun er-Reshidit, kishte lidhje me Xha’fer ibn Jahja ibn Halid. Duke qenë se Xha’feri e donte, u kishte dhënë të pijnë verë ashtu që Harun er-Reshidi ia lejoi që të martohej me të, por pa u vetmuar, me shpresë që t’i ketë pranë së bashku. El-Abase, pastaj bëri dredhi dhe ia doli të takohet me të. Meqë e dashuronte tepër, Xha’feri fjeti me të - pretendohet në gjendje të dehur - dhe ajo mbeti shtatzënë. Kur i erdhi lajmi mbi këtë Harun er-Reshidit, ishte zemëruar shumë”.

Sa larg është kjo nga pozita e El-Abases në fenë, familjen, karrierën e dinjitetin e saj. Ajo rrjedh nga familja e Abdullah ibn Abbasit.

<sup>29</sup> Bermekidët – Tragjedia e tyre ndodhi në kohën e Harun er-Reshidit (187 h). Gjenezën e kanë nga qyteti Belh, ndërsa rrjedhin nga Bermuku, i cili ishte një nga mbikëqyrësit e mëdhenj të faltores Nevbehar në Belh. Me përkatësi fetare ishin zjarrfalës apo budistë. Halid ibn Bermek ishte njëri nga ministrat e Harun er-Reshidit, madje arriti në postin e ministrit të autorizuar, post ky i cili sot është i barabartë me atë të kryeministrit. Ishte ministër i të gjitha kabineteve. Djemtë e tij i emëroi në poste të larta brenda shtetit abasid. Autori i veprës *En-nuxhumu-z-zahire* shpreh: “Xha’fer el-Bermeki pati arritur famë e popullaritet të tillë që nuk e arriti askush para tij”. Fshehtësia e tragjedisë së tyre, siç përmend El-Hatib el-Bagdadi dhe Ibnu-n-Nedim në *El-Fihrist* ishte herezia dhe mosbesimi, pasi, që të gjithë përveç Muhammed ibn Halid ibn Bermek, ishin heretikë. Më pas, arroganca dhe tirania e tyre me pasuri dhe poste që i kishin, animi i tyre kah ale-vijtë, të cilët ishin armiq të abasidëve, të gjitha këto ishin faktorë të përbashkët që sollën tragjedinë e tyre.

Ndërmjet tij dhe asaj janë vetëm katër breza, që të gjithë njerëz fetarë dhe të devotshëm, e të shquar në ummetin islam.

El-Abase është bija e Muhammed el-Mehdi ibn ‘Abdil-lah Ebi Xha’fer el-Mensur ibn Muhammed es-Sexhxhad ibn Ali Ebi-l-hulefa’ ibn ‘Abdil-lah “*terxhumanu-l-Kur’an*”, (komentator i Kur’anit) ibn-ul-Abbas, xhaxhai i të Dërguarit s.a.v.s.

Ajo ishte bijë halifi dhe motër halifi. Gëzonte autoritet të lartë dhe ishte e stolisur me hilafet peygamberik, pasi ishte e lidhur familjarisht me të dërguarin e All-llahut s.a.v.s.

Dijetare e kohës dhe dritë e shpalljes. Jetonte një jetë tipike nomado-arabe, të thjeshtë e modeste, me besim të fortë në zemër, larg nga dëfrimet e argëtimet e luksit dhe jetës së shfrenuar e të shthurur.

A thua, ku do të gjendeshin dinjiteti, krenaria dhe nderi, sikur të humbeshin tek ajo? Ku do të gjendeshin pastërtia dhe çiltërsia, po të zhdukeshin nga shtëpia e saj? Si mund të bashkohet, vallë, prejardhja e saj me Xha’fer ibn Jahja-në, të njolloset krenaria e saj arabe me një rob të liruar persian.

Me pushtetin e gjyshit të tij nga Persia, apo me dashurinë e gjyshit të saj nga familja e të Dërguarit s.a.v.s. dhe fisnikët kurejshë?

Për më tepër, shteti i tyre mori fund me të dhe të atin e tij, të cilët Harun er-Reshidi i zgjodhi dhe i ngriti në pozita të larta.

Si mund të pranojë Harun er-Reshidi të bëhet mik me robërit persianë duke marrë parasysh ambiciet dhe synimet e tij të larta?

Sikur ta vëzhgonte hulumtuesi këtë me një vështrim objektiv e ta shikonte El-Abasen si një vajzë halifi prej halifëve të mëdhenj të kohës, do të refuzonte një gjë të tillë nga ana e saj, do ta konsideronte të shëmtuar dhe do të përpiqej ta përgënjeshtronte atë.

Sa e madhe është vlera e El-Abases dhe Harun er-Reshidit në krahasim me ata njerëz!<sup>30</sup>

<sup>30</sup> Një numër i madh i historianëve kanë pohuar se tregimi i El-Abases është i pathemeltë. Kështu, El-Xhehshejari, autor i veprës *El-vuzera ve-l-kuttab* (Ministrit dhe sekretarët) thotë:

“Abdullah ibn Halikani e pyeti Mesrur el-Kebirin, kryerës i ekzekutimit të familjes Bermek, mbi shkakun e dënimit të Bermekidëve nga ana e Harun er-Reshidit. Ai iu përgjigj:

Ç'është e vërteta, Bermekidët e shijuan dënimin si pasojë e shtypjes së tyre në shtetin islam si dhe përvetësimit të pasurisë së tatimit, saqë, shpeshherë, kur Harun er-Reshidi kërkonte një sasi të konsiderueshme të hollash, nuk mund të arrinte deri tek ato.

Në këtë mënyrë, ata arritën t'i vënë nën kontroll çështjet e tij dhe u bënë pjesëmarrës në qeverisjen e shtetit.

Ai nuk i kontrollonte ata në asnjë mënyrë, kështu që gëzonin një autonomi të plotë kundrejt çështjeve të sundimit të tij.

Si rrjedhojë e kësaj, ata arritën nam dhe popullaritet të madh. I hartuan postet e shtetit duke i rezervuar vendet e përgjegjësve për djemtë dhe të afërmit e tyre dhe në këtë mënyrë ia dolën që t'ua privojnë ato të tjerëve. Ata fituan, kështu, poste të ministrisë, sekretariatit, ushtrisë, rojes, gardës dhe shkrimit.

Thuhet se në oborrin e Harun er-Reshidit gjendeshin njëzet e pesë përgjegjës nga djemtë e Jahja ibn Halidit, të cilët gëzonin poste të gardës, shkrimit etj.

Për t'i arritur këto, ata garuan me nënshtetasit e tjerë duke i larguar me argumentimin e pozitës së babait të tyre, Jahja, i cili ishte nën mbikëqyrjen dhe përkujdesjen e Harun er-Reshidit, derisa u rrit në prehrin e tij, e pastaj u largua nga ai duke vënë nën kontroll çështjet e tij. Më parë e thërriste me emër përkëdhelës "O babai im", kurse më vonë ia doli të fitojë përparësi ndaj tij.

Bermekidët, kështu fituan guxim të madh, famë të gjerë, arritën përkrahjen e njerëzve, të tjerët i nënshtruan, kishin shpresa të shkurt-ra, te ta arrinin dhuratat e mbretërve dhe peshqeshet e princave nga krahinat më të largëta.

Duke arritur të fitojnë simpati dhe dashuri, ia dolën t'i fusin në thesaret e tyre të ardhurat e tatimit, të holla këto të cilat ua shpërnda-

nin farefisit të vet dhe dijetarëve shi'itë, u ofronin atyre dhurata, i lironin robërit<sup>31</sup> dhe u lavdëruan me gjëra, me të cilat nuk u lavdërua as halifi i tyre.

Lypësve u jepnin mjaft shpesh të holla e dhurata. I vënë nën kontroll fshatrat dhe tokat që ishin në periferi të qendrës së hilafetit si dhe territoret e ndryshme në krahinat tjera derisa e zemëruan parinë dhe nxitën urrejtjen e elitës, me ç'rast u zbulua fytyra e tyre e vërtetë e konkurrencës dhe zilisë.

Kështu, në strofullën e tyre komode u futën vëzhgues e lajmëtarë të ndryshëm, madje Benu Kahtabe,<sup>32</sup> dajallarë të Xha'ferit, patën qenë ndër lajmëtarët më të mëdhenj te ta.

Për shkak të zilisë së madhe që kishin në zemrat e tyre, ata, me gjithë lidhjet familjare e farefisnore, nuk patën fare mëshirë ndaj tyre.

Krahas kësaj, te zotëriu i tyre shfaqeshin shenjat e xhelozisë dhe tjetërsimit të cilat viheshin në pah nëpërmjet ndalesave dhe neverisë. Urrejtja të cilën e shkaktuan te ta dobësitë e autokracisë dhe vendosmëria në një veprim të tillë solli një kundërshtim të madh.

I këtillë ishte rrëfimi lidhur me Jahja ibn 'Abdil-lah ibnu-l-Hasen ibnu-l-Hasen ibn 'Ali ibn Ebi Talib, vëlla i Muhammed el-Mehdit, i quajtur me nofkën "*shpirt i pastër*" (en-nefsu-z-zekijje), i cili u ngrit kundër El-Mensurit.

Ky Jahja është ai të cilin el-Fadl ibn Jahja e ftoi të dorëzohet nga viset e Dejlemit,<sup>33</sup> në bazë të sigurisë nga vetë Harun er-Reshidi, i cili u dha për të një milion derhemë, siç e cek këtë et-Taberi.

Harun er-Reshidi, më pas e dërgoi te Xha'feri, i cili e burgosi në pallatin e tij, ku e mbajti një kohë, e më pas ishte lidhja familjare ajo

*Sikur ke për qëllim fjalët e masës e cila pretendon se kjo ndodhi për shkak të gruas ..., por, jo për Zotin ... kjo nuk ka kurrfarë lidhje, por, ndodhi për shkak të mërziisë, bezdisë dhe zilisë së robërve tanë".*

Ibn Kutejbe, ndërkaq, thotë:

*"Bashkëshorti i El-Abases ishte Muhammed ibn Sulejman. Pas vdekjes së tij, ajo u martua me një tjetër që quhej Ibrahim ibn Salih ibn Ali. Prandaj, si mund të jetë pohimi i tyre, i vërtetë? Kjo, vetëmse është gënjeshtër dhe fjalë e shpifur.*

<sup>31</sup> El-Asfehiani pati deklaruar se brenda shtetit të Harun er-Reshidit, ekzistonte edhe një shtet tjetër, në të cilin sundonin Bermekidët.

<sup>32</sup> Ata janë Benu (Kahtabe ibn Shebib), udhëheqës abasid i cili triumfoi mbi emevitët në Xhurxhan. Në atë kohë, Halid el-Bermek ishte përgjegjës për ndarjen e plaçkave të luftës.

<sup>33</sup> Dejlem është një pjesë malore e krahinës persiane Xhilan, në jug të detit Kaspik.

që e shtyri ta lirojë si dhe ndërmjetësimi i Bermekidëve për lirimin e tij.<sup>34</sup>

Më vonë, Harun er-Reshidi e kishte pyetur Xha'ferin për të dhe për shpifjen që kishte bërë ndaj tij, kurse ai u kujtua dhe i tha: E kam liruar.

Harun er-Reshidi shfaqti ndaj tij një lloj pëlqimi e miratimi dhe e fshehu në vete.

Kjo i dha shkas atij që ta hulumtojë çështjen e tyre, e cila rezultoi me rrëzimin e tyre të fronit, kështu që toka i gëlltiti ata dhe shtëpinë e tyre, me ç'rast epoka e tyre mori fund dhe u bë shembull për të tjerët.

Kush i vështron me kujdes rrëfimet e tyre dhe i studion detajisht të dhënat mbi ta dhe mbi shtetin islam, do ta vërtetojë këtë me argumente verifikuese dhe me shkaqe bindëse.

Shiko se çka transmeton Ibnu 'Abdi Rabbihi<sup>35</sup> mbi bisedën e Harun er-Reshidit me xhaxhain e gjyshit të tij, Davud ibn 'Ali, lidhur me ndëshkimin e tyre.

Shiko, po ashtu, se ç'përmend ai në kapitullin mbi poetët, në veprën e tij *El-'ikdu-l-ferid*, ku thekson bisedën e El-'Asmeiut<sup>36</sup> me Harun er-Reshidin dhe me El-Fadl ibn Jahja-në, në kuvendimet e tyre të natës, do të kuptosh se ajo që i shkatërroi ata ishte xhelozia dhe rivaliteti në të vënit kontroll halifin dhe të tjerët më poshtë.

Gjithashtu, të kihen parasysh komplotet e armiqve të tyre nga randa e parisë, të cilët futën te këngëtarët disa poezi ashtu që t'i dëgjojë halifi dhe në këtë mënyrë ta nxisin t'i shfaqë urrejtjet e tij ndaj tyre.

Fjala është për vargjet:

<sup>34</sup> El-Bermeki i dhuroi nga pasuria e tij dyqind mijë dinarë Jahjasë, i cili pati ikur nga be-teja "Feh", në Hixhaz, siç i pati dhuruar edhe një tjetri që ishte alevi, me emrin Ahmed ibn 'Isa ibn Zejd, shtatëdhjetë mijë dinarë. Ai e urrente Muhammed ibnu-l-Lejthin, një nga ministrat arabë në kohën e Harun er-Reshidit, për shkak të urrejtjes së tij ndaj persi-anëve. Bermekidët u munduan të thurin intriga ndaj Jezid ibn Mezid esh-Shejbanit, komandant arab i ushtrisë së Harun er-Reshidit.

Këto janë anime armiqësore nga heretikë të tillë të cilët i usurpuan, përvetësuan dhe i keqpërdorën pozitën e tyre, andaj edhe e merituan ndëshkimin.

<sup>35</sup> Ai është një letrar dhe poet arabo-spanjoll (860-940).

<sup>36</sup> Abdu-l-Melik el-Asme'i (740-828) është një filolog i shquar arab dhe mbledhës i poezive të vjetra.

*"Sikur Hindi të përmbushte ndaj neve atë që premtonte ta shërojë shpirtin tonë i cili lëngon."*

*Të nënshtrojnë bile një herë të vetme, i pafuqishëm është ai i cili nuk nënshton.*

Ndërsa, Harun er-Reshidi pasi e dëgjoi këtë, tha:

*"Po, për All-llahun, unë jam i pafuqishëm".*

Kështu, ata vazhduan t'i dërgojnë vargje të tilla që fshehnin xhelozin derisa e merituan mllëfin dhe hakmarrjen e tij.

Kërkojmë mbrojtjen e All-llahut nga mposhtja e njerëzve dhe përfundimi i keq. Ndërsa, sa i përket tregimit të maskuar e të trilluar se kinse Harun er-Reshidi paska pirë verë së bashku me shoqëri, kjo **"... ruana Zot, ne nuk dimë kurrjë të keqe për të ..."**. (Jusuf : 51)<sup>37</sup>

Si mund t'i mvishet një gjë e tillë Harun er-Reshidit, duke marrë parasysh pozitën e tij dhe zbatimin e përgjegjësisë fetare dhe ligjore në postin e hilafetit?!

Si mund të pretendohet një gjë e tillë për të duke qenë se ai shoqërohej me dijetarët dhe të devotshmit, zhvillonte bisedë me Fudajl ibn 'Ijadin, Ibnu-s-Semmakun dhe El-'Amrin, korrespondonte me Su-fjan eth-Thevrin dhe qante nga këshillat e tyre.

<sup>37</sup> Këtu më poshtë, po japim disa fjalë të dijetarëve lidhur me lavdërimin e Harun er-Reshidit dhe devotshmërinë e tij:

El-Xhahidh thotë: *"Ishte halifi më rigoroz përse i përket hulumtimit të fshehtësive të nënshtetasve të tij. Tregonte përkujdesje të madhe ndaj tyre dhe kishte vendim të prerë"*. Et-Taberi thotë: *"Zhvilloi luftë shtatë herë dhe përgatiti njëzet ekspedita për luftë, në tokë dhe në det"*.

Ibn Halikani thotë: *"Gjatë hilafetit të tij, nëntë herë kreu obligimin e haxhit dhe falte në ditë njëqind rekate"*. Ibnu-t-Taktaki thotë: *"Ishte njëri nga halifët që kishte fytyrë më të mëshirshme, ishte më i turpshëm prej tyre dhe më së shumti se të gjithë ata qante kur dëgjonte këshillat të mirë"*.

Ibnu 'Abdi Rabbihi thotë: *"E donte diturinë dhe e kërkonte, shoqërohej me dijetarët, i afronte ata dhe sillej me modesti para tyre"*.

El-Bagdadi thotë: *"Ishte njëri nga halifët më bujarë e zemërgjerë. Tek ai nuk humbte asnjëherë bamirësinë dhe dhurata që ia jepte dikush"*,

Në përgjithësi, bëhet fjalë për një njeri ndaj të cilit është shpifur lidhur me çështjen e pirjes së verës, robërshave e gjëra të tilla.

Bënte lutje gjatë tavafit në Mekë. Ishte një njeri i devotshëm, i cili i kushtonte kujdes kohëve të namazit dhe gjithnjë prezentonte në faljen e sabahut në kohën e tij.

Et-Taberi dhe të tjerët përmendin se ai falte çdo ditë nga njëqind rekate vullnetare. Një vit luftonte, kurse vitin tjetër shkante në Mekë, për kryerjen e haxhit.

Njëherë e pati qortuar tallësin e tij, Ibnu Ebi Merjem, i cili një natë bëri mahi duke qenë në namaz.

Harun er-Reshidi pasi e dëgjoi duke lexuar ajetin kur'anor: **“E përse unë të mos e adhuroj Atë i cili më krijoi ...”** (Jasin: 22) dhe duke thënë më pas: **“Për Zotin, nuk e di përse”**, nuk mund ta kontrollonte veten pa qeshur, por pas pak, u drejtua kah ai, i zemëruar, dhe i tha: **“O Ibn Merjem, madje edhe në namaz? Ki kujdes të bësh mahi me Kur'anin dhe me fenë, e pos tyre përdor ç'të duash”**.

Po ashtu, ai ishte pajisur me dituri dhe modesti, pasi qëllloi të je-tojë në një kohë, të afërt me të parët e tij të cilët ishin stolitur me ato veçori.

Ndërmjet tij dhe gjyshit të tij, Ebu Xha'fer nuk kishte kaluar kohë e gjatë. Ebu Xha'feri ishte një njeri që kishte arritur shkallë të lartë të diturisë dhe devotshmërisë, si para hilafetit ashtu edhe pas tij. Ishte pikërisht ai i cili duke i bërë me dije Malikut<sup>38</sup> që ta shkruajë librin *El-Muvetta'*, i kishte thënë:

**“O Ebu 'Abdullah, nuk mbeti në sipërfaqe të tokës njeri më i dijs-hëm se unë e ti. Unë, tani, jam i preokupuar me hilafetin, prandaj hartoje ti një libër për njerëzit, nga i cili ata do të kenë dobi. Evitoji në të lëshimet e Ibn Abbasit<sup>39</sup> dhe ashpërsitë e Ibn Umerit<sup>40</sup> dhe për-**

<sup>38</sup> Ai është Ebu Abdil-lah Malik ibn Enes el-Asbehi (712-795), njëri nga katër imamët e shkollave (medhhebeve) juridike sunnite. Në mesin e veprave të tij është edhe përmbledhja e haditheve *El-Muvetta' fi-l-hadith*.

<sup>39</sup> Ai është Abdullah ibn Abbas (619-687), kushëriri i Muhammedit a.s., i njohur edhe si transmetues i haditheve, prej të cilave 1660 janë përfshirë në dy përmbledhjet më të njohura (*Es-Sahihajn*) të Buhariut dhe Muslimit.

<sup>40</sup> Abdullah ibn Umer (613-692) është biri i halifit, Umer ibnu-l-Hattab. Në përmbledhjet e përmendura të haditheve, prej tij janë pranuar 2630 hadithe.

**gatite mirë për njerëzit!”** Maliku thotë: **“Për All-llahun, atëherë më ka mësuar se si të shkruaj!”**

Atë e ka mbërritur djali i tij, el-Mehdi, babai i këtij er-Reshidi. Nga modestia, nuk dëshironte t'ua siguronte fëmijëve të tij rroba të reja nga arka e shtetit.

Një ditë, kishte hyrë tek ai dhe e kishte hasur se si i mbikëqyrte rrobaqepësit, të cilët i qepnin rrobat e vjetëruara të fëmijëve të tij. El-Mehdi ishte neveritur prej kësaj, me ç'rast kishte thënë: **“O prijës i besimtarëve, unë marr përsipër obligimin që për këtë vit t'i siguroj rrobat për këta fëmijë nga të ardhurat e mia”**. Ai i qe përgjigjur: **“Mund ta bësh këtë”**, dhe nuk e ndaloi nga një gjë e tillë, mirëpo as nuk lejoi që për këtë të shpenzohet pasuria e myslimanëve.

Prandaj, a thua i ka hije er-Reshidi, me gjithë periudhën e shkur-tër pas këtij halifi dhe kujdesit të tij prindëror dhe mënyrën me të cilën ishte edukuar përkitazi me veprimet e këtilla në rrethin e familjes së tij si dhe përvetësimit të asaj sjelljeje, që t'i jepet verës apo të ve-pronte haptazi këtë?

Është e njohur se aristokratët arabë nga periudha paraislame përmbaheshin nga vera. Hardhia nuk ishte pema e tyre, ndërsa pirja e ve-rës ishte e qortuar te shumica e tyre.

Er-Reshidi dhe të parët e tij i largonin me vendosmëri të gjitha gjërat e qortuara që kishin të bënin me fenë dhe me këtë botë, kurse i përvetësonin të gjitha veçoritë e lavdëruara, cilësitë e përsosurisë dhe tiparet e beduinëve.

Shiko se çfarë kanë transmetuar et-Taberi dhe el-Mes'udi lidhur me tregimin mbi mjekun Xhibril ibn Bahtishu', kur në tavolinë para er-Reshidi ishte sjellë një peshk. Mjeku sugjeroi që ai të mos e hante dhe e urdhëroi shërbëtorin që ta çojë në shtëpinë e tij. Atëherë, er-Re-shidi e hetoi këtë dhe filloi të dyshojë në atë veprim. Mandej, e dërgoi tinëzisht shërbëtorin e tij, i cili e kishte parë duke ngrënë peshkun. Me qëllim që të arsyetohet, Ibn Bahtishu' përgatiti tri copa të peshkut në tri pjata. Në të parën, kishte përzier mishin, të përgatitur me erëza, pe-rime, salca të ftohta dhe ëmbëlsira. Në të dytën derdhi ujë të akullt, ndërsa në të tretën - verë të kulluar. Për të parën dhe të dytën, tha:

“Ky është ushqimi i prijësit të besimtarëve, o e përziu ai peshkun me diç tjetër o nuk e përziu fare”. Ndërkaq, për të tretën, tha: “Ky është ushqimi i Ibn Bahtishu’it”, dhe ia dha shërbëtorit.

Kur er-Reshidi e hetoi këtë dhe e thirri për ta qortuar, ky i kishte sjellë ato tri pjata dhe sqaroi se ajo copë peshku me verën ishte përzier, ishte shkrirë dhe ishte thërrmuar, ndërsa dy të tjerat ishin prishur dhe u ishte ndryshuar era. Ky ishte arsyetimi i tij.

Prej kësaj, shihet qartë se er-Reshidi i largohej verës dhe se një gjë e tillë ishte e njohur tek oborrtarët e tij dhe ata të cilët hanin me të.

Për të dihet me siguri se ka urdhëruar burgosjen e Ebu Nuvasit,<sup>41</sup> për shkak se i kanë ardhur informatat mbi zhytjen e tij në pirjen e verës, derisa ishte penduar dhe kishte hequr dorë nga ky ves.

Er-Reshidi pinte vetëm pije nga hurma, pije kjo e cila ishte e lejuar sipas shkollës juridike nga Iraku,<sup>42</sup> ndërsa fetvatë<sup>43</sup> e tyre lidhur me këtë janë të njohura.

Ndërkaq, sa i përket verës së pastër nga rrushi, ai nuk mund të akuzohet për këtë, e as nuk mund të pasohen të dhënat e pambështetura lidhur me këtë.

Ai nuk ishte njeri i tillë i cili do të kryente njërin prej mëkateve më të mëdha të ndaluara për pasuesit e islamit.

<sup>41</sup> Ai është poeti i famshëm që thuri poezi të shumta për verën. Ka jetuar në periudhën e dinastisë abaside (762-813).

<sup>42</sup> Shkolla juridike e Ebu Hanifes mbante qëndrim për lejimin e pijes, përveç rrushit, siç është elbi. Ata thanë se vera është vetëm ajo që nxiret nga rrushi, ndërsa nga pijet e tjera pos asaj është e ndaluar vetëm sasia e cila deh, e nën këtë sasi ajo nuk ndalohet. Ibn Rexheb el-Hanbeli thotë: “Ndonëse ata kanë dhënë mund përse i përket kësaj dhe janë të falur, e në mesin e tyre ka një grup dijetarësh”. (Shih: Xhami’u-l-‘ulum ve-l-hikem, hadithi nr. 46). Ruana Zot që Ebu Hanife ta ketë lejuar verën apo pijet dehëse, mirëpo ka dhënë një mendim siç u përmend më sipër. Ndonëse ai nuk përkon me mendimet e dijetarëve të tjerë, megjithatë Ebu Hanife ishte një dijetar i cili është përpjekur dhe ka gabuar, kurse dijetarët janë shprehur me mirësjellje ndaj tij, siç bëri Ibn Rexhebi. Redaktori thotë: “Vera është çdo gjë që e deh mendjen, qoftë nga rrushi, hurma, mjalti, dritërat, elbi e të tjera”. Këtë e shënojnë Buhariu, në kapitullin ‘Et-tefsir’, nr. 4619 dhe Muslimi, në kapitullin ‘Et-tefsir’, nr. 3032.

<sup>43</sup> Fetvatë (ar. fetva shm. fetava) – janë vendime juridiko-fetare të cilat i sjellin myftilerët (shërbyesit e lartë muslimanë nga radhët e njohësve të shquar të sheriatit), në lidhje me çështjet e paqarta dhe të diskutueshme nga fusha e së drejtës islame.

Të gjithë ata njerëz ishin larg nga të dhënit pas tepimit dhe luksit në veshjet e tyre, stolisjen dhe tërë atë që e përdornin, për vetë faktin se ishin mësuar me jetën e vrazhdë beduine dhe thjeshtësinë në fe, gjë të cilën as më vonë nuk e kishin braktisur.

E çfarë mendon lidhur me atë që kalon nga e lejuara në të palejuarën dhe nga e lejuara në të ndaluarën?!

Historianët et-Taberi, el-Mes’udi dhe të tjerët kanë rënë në ujdi lidhur me atë se të gjithë halifët e mëparshëm nga dinastia emevite dhe abaside u hipnin kafshëve me vetëm pak stoli nga argjendi në breza, shpata, kapistra dhe shala, dhe se halifi i parë i cili kishte praktikuar hipjen me stoli të arit ishte el-Mu’tezz ibnu-l-Mutevekkil, halifi i tetë pas er-Reshidit. I këtillë ishte rasti edhe me veshjet e tyre, e çfarë mendon, vallë, për pijet e tyre?

Kjo do të shpjegohet edhe më qartë kur ta kuptosh natyrën e shtetit në fillesat e tij të jetës beduine dhe freskisë së saj, siç do ta sqarojmë këtë në mesin e çështjeve të kapitullit të parë, nëse do Zoti. Me këtë përputhet apo është e afërt me të ajo që flitet përgjithësisht për Jahja ibn Ekthemin, kadiun dhe mikun e el-Me’munit,<sup>44</sup> respektivisht rreth asaj se si kishte pirë verë.

Thonë se një natë, gjoja, ishte dehur me miqtë e tij, me ç’rast ishte vendosur në mesin e luleve aromatike, ku edhe ishte zgjuar. Citojnë sikur ai kishte thënë:

*“O zotëriu im dhe prijës i të gjithë njerëzve,  
keq ka vepruar ai që verë për të pirë më dha.”*

*E shpërfillja atë që më jepte të pi, e ai më bëri  
ashtu siç po më sheh, pa mendje e fe më la”.*

Rasti i Ibn Ekthemit dhe el-Me’munit, përse i përket kësaj, ishte i ngjashëm sikurse ai lidhur me er-Reshidin. Pija e tyre ishte vera nga hurma, e cila sipas këndvështrimit të tyre nuk ishte e ndaluar.

Sa i përket dehjes, një gjë e tillë nuk ishte shprehi e tyre, kurse shoqërimi i tij me el-Me’munin ishte për shkak të afërsisë në fe.

<sup>44</sup> Njëri prej halifëve abasidë (786-833), biri i Harun er-Reshidit.



Është konfirmuar se ai kalonte natën te shtëpia e tij. Lidhur me vrytet dhe dashamirësinë e el-Me'munit, flitet se si një natë ishte zgjuar i etur, me ç'rast ishte ngritur duke prekur e kërkuar enën, nga frika mos po e zgjonte Jahja ibn Ekthemin.

Dihet mirëfilli se ata dy së bashku e falnin namazin e sabahut, e sa larg është kjo nga dhënia pas pijes!

Krahas kësaj, Jahja ibn Ekthem ishte njëri ndër dijetarët më të mëdhenj të hadithit. Atë e patën lavdëruar imam Ahmed ibn Hanbeli<sup>45</sup> dhe Isma'il el-Kadi.<sup>46</sup>

Prej tij ka shënuar hadithe et-Tirmidhi,<sup>47</sup> në veprën e tij *el-Xhami'*, ndërsa Hafidh el-Muzeni<sup>48</sup> ka përmendur se Buhariu, përveç në veprën *el-Xhami'*, ka shënuar prej tij edhe në vepra të tjera, prandaj akuza ndaj tij paraqet akuzën ndaj të gjithë atyre.

Po kështu është edhe me ata faqezinj të cilët flasin keq për Jahja ibn Ekthemin, duke thënë se ai shfaqte simpati ndaj djelmoshave, duke gënjyer para All-llahut e duke shpifur ndaj dijetarëve.

Për këtë, ata janë mbështetur në rrëfimet e pabaza të predikuesve, të cilat, mbase i kanë shpikur armiqtë e tij, ngase e xhelozonin për shkak të përsosurisë dhe miqësisë së tij me halifin. Pozita e tij në dituri e fe ishte e pastër nga gjërat e tilla.

Njëherë, ia kishin përmendur Ibn Hanbelit atë me çfarë e akuzonin njerëzit, e ai kishte thënë: *“Subhanall-llah! (I Lartësuar qoftë All-llahu!) E kush e thotë këtë?”* Ai e mohonte kategorikisht këtë. Atë e lavdëronte edhe Isma'il el-Kadi, i cili pasi që kishte dëgjuar se çfarë flitnin për të, ishte shprehur: *“Ruana Zot prej asaj që të njolloset drejtësia e një njeriu të tillë me gënjeshtat e horrave dhe xhelozëve!”*

<sup>45</sup> Njëri nga katër themeluesit e medhhebeve islame (shkollave juridike-fetare sunnite), i cili ka jetuar mes viteve 780-855. Sipas tij ka marrë emrin edhe shkolla hanbelite.

<sup>46</sup> Gjykatës i shkollës malikite, Isma'il ibn Is'hak el-Xhehdhemi (815-895) dhe autor i një numri të madh veprash në shkencat e ndryshme islame.

<sup>47</sup> Ai është Muhammed ibn 'Isa (824-893), njëri nga hartuesit e njohur të përmbledhjeve të haditheve.

<sup>48</sup> Isma'il el-Muzeni (791-878) është njëri nga dijetarët e shkollës juridike shafi'ite dhe kontribues i atij medhhebi.

Po ashtu ka thënë: *“Jahja ibn Ekthemi është më se i pastër para All-llahut që të mund të gjendet tek ai diçka prej asaj me çfarë e akuzonin lidhur me djelmoshat. Unë i njihja fshehtësitë e tij, me ç'rast he-toja se i frikësohej shumë All-llahut, mirëpo kishte edhe ndjenjë të humorit dhe moral të mirë, prandaj ishte akuzuar me gjëra të tilla”*.

Ibn Hibbani<sup>49</sup> e ka përmendur në veprën eth-Thikat, ku thotë: *“Nuk duhet të merret parasysh ajo çka flitet për të, ngase pjesa më e madhe e kësaj nuk është e vërtetë”*.

Një tregim i këtyllë është edhe ai që e transmeton Ibn 'Abdi Rabihi, autori i veprës *el-'Ikdu-l-ferid (Gjerdani i rrallë)*, mbi ndodhinë e zymbylesë, si shkak që el-Me'muni u bë dhëndër i el-Hasan ibn Sehlit,<sup>50</sup> duke u martuar me bijën e tij, Buran.

Një natë, duke shëtitur nëpër rrugët e Bagdadit, ai kishte hasur në një zymbyle të madhe, e lëshuar nga një tarracë, e lidhur fort nga litarë mëndafshi.

Ai u ul në të dhe u kap për litarë, me ç'rast ata u dridhën dhe ai u ngrit lart deri te një vend ku ishte njëfarë tubimi. Më pas, autori ka përshkruar mobilie luksoze që gjendeshin aty, kthinat e rregulluara, bukurinë e asaj pamjeje, e cila e mbërthen shikimin dhe e pushton shpirtin. Mandej, se si në atë tubim, mes perdeve, el-Me'muni i ishte shfaqur një grua jashtëzakonisht e bukur dhe tepër tërheqëse. Ajo e përshëndeti dhe e ftoi në shoqërim, kështu që ai së bashku me të kishte pirë verë deri në mëngjes.

Pastaj, ishte kthyer te vendi ku e prisnin shokët e tij. Ai, siç thotë tutje autori, ishte dashuruar aq shumë në të, sa që kjo e kishte nxitur që të martohet me të dhe kësaj të bëhet dhëndër i babait të saj. Sa larg është tërë kjo nga gjendja me të cilën njihet el-Me'muni për sa i përket fesë së tij, dijes, ruajtjes së traditave të paraardhësve të tij, halifëve të

<sup>49</sup> Sipas të dhënave, Ibn Hibbani (887/8-965), në veprën e lartpërmendur mbi transmetuesit e besueshëm të haditheve, nuk ka mbërritur deri tek periudha e Jahja ibn Ekthemit. Emri i plotë i Ibn Hibbanit është Muhammed Ebu Hatim el-Busti. Ka lindur dhe ka vdekur në Bust (Sixhistan). Ka udhëtuar shumë nëpër vendet islame të Lindjes. Ka qenë një historian, gjeograf dhe muhaddith i frytshëm.

<sup>50</sup> Ai është Ibn Abdil-lah es-Serhasi (782-851), vezir dhe vjehërr i halifit abasid, el-Me'mun.

drejtë dhe imitimit të jetëve të katër halifëve – shtylla të fesë. Mandej, është i njohur diskutimi i tij me dijetarët dhe zbatimi i urdhrave të Allahut të Lartësuar lidhur me namazet dhe dispozitat tjera.

Pra, si mund t'i përshkruhen atij ndodhitë e të shthururve të shfrenuar gjatë bredhjes së tyre natën, trokitjes nëpër shtëpi dhe pjesëmarrjes në ndeja, sikur beduinë të dashuruar?

Sa larg është kjo në raport me pozitën e bijës së el-Hasan ibn Sehlit, nderin e saj dhe pastërtinë e dëlirësinë në shtëpinë e babait të saj. Rrëfime të këtilla janë të shumta dhe të njohura në librat e historianëve. Hartimin dhe shkrimin e tyre e kanë nxitur vetëm zhytja e njerëzve të tillë në kënaqësitë e ndaluara dhe turpërimi i vajzave të tërhequra, me ç'rast e arsyetojnë dhënien e tyre pas kënaqësive si imitim në ata njerëz autoritativë. Prandaj, i vëren se si mjaft shpesh flasin mbi ndodhitë e tilla dhe i hulumtojnë ato gjatë shfletimit të faqeve të kronikave. E sikur t'i imitonin në gjërat tjera dhe në ato veçori të përshtatshme dhe të njohura të përsosurisë, do të ishte më mirë për ta sikur ta dinin (këtë).

Në një rast e kam qortuar një princ nga familja mbretërore, ngase kishte dëshirë ta mësonte këndimin dhe e donte shumë muzikën. Unë i thashë: “Kjo nuk është punë jotja dhe nuk i ka hije pozitës tënde”. E ai më tha: “Edhe Ibrahim ibnu-l-Mehdi<sup>51</sup> ka qenë pionier i kësaj mjeshtrie dhe prijës i këngëtarëve në kohën e tij!” Me këtë rast, ia ktheva: “I Lartësuar qoftë All-llahu! Sikur ta merrje shembull babanë apo vëllanë e tij? A nuk ke parë se si kjo e pengoi atë që t'i arrijë pozitën e tyre?” E ai s'ia vuri veshin kritikës sime dhe e ktheu shpinën! E All-llahu shpie në rrugë të drejtë kë të dojë Ai.

*Nga gjuha arabe:  
Jahja Hondozi*

*Abdurrahman ibn Haldun*

**THE EXCELLENCE OF HISTORIOGRAPHY -  
AN APPRECIATION OF THE VARIOUS  
APPROACHES TO HISTORY - A GLIMPSE  
AT THE DIFFERENT KINDS OF ERRORS  
TO WHICH HISTORIANS ARE LIABLE -  
SOMETHING ABOUT WHY THESE ERRORS OCCUR  
(Excerpts from Al Muqaddimah)**

**(Summary)**

IT SHOULD BE KNOWN that history is a discipline that has a great number of (different) approaches. Its useful aspects are very many. Its goal is distinguished. (History) makes us acquainted with the conditions of past nations as they are reflected in their (national) character. It makes us acquainted with the biographies of the prophets and with the dynasties and policies of rulers. Whoever so desires may thus achieve the useful result of being able to imitate historical examples in religious and worldly matters.

The (writing of history) requires numerous sources and greatly varied knowledge. It also requires a good speculative mind and thoroughness. (Possession of these two qualities) leads the historian to the truth and keeps him from slips and errors. If he trusts historical information in its plain transmitted form and has no clear knowledge of the principles resulting from custom, the fundamental facts of politics, the nature of civilization, or the conditions governing human social organization, and if, furthermore, he does not evaluate remote or ancient material through comparison with near or contemporary material, he often cannot avoid stumbling and slipping and deviating from the highroad of truth.

<sup>51</sup> Ai është biri i halifit abasid el-Mehdi dhe vëllai i Harun er-Reshidit. Ka jetuar mes viteve 779-838. Është marrë me muzikë dhe këndim.

عبد الرحمن بن خلدون

مزايا علم التاريخ وتحليله طرق أخطاء مع لمحة عامة عن  
والتحيزات من المؤرخين وبعض أسبابها  
(مقتطفات من مقدمته)  
(خلاصة البحث)

نعرف أن التاريخ هو واحد من التخصصات العلمية الثمينة التي تستفيد منها كثير وعزم. ويوفر لنا معلومات حول أوضاع الشعوب في الماضي والشخصيات في سلوكها، وثنائية من الرسل، فضلا عن الأسر الحاكمة لدول الملوك وحكوماتهم. هذا يستغرق مجموعة متنوعة من المصادر، والمعارف متنوعة مراقبة واسعة ومتينة والتحقق، وهذه الأشياء التي هي تؤدي الباحثون إلى الحقيقة، وحماية من أخطاء الاحتيال.

إذا كان الباحث في عمله يعتمد فقط على الأحداث الهينة دون مراعاة لمبادئ قوانين الجمارك والسياسة، إن لم يكن من حضارة تركز على حرف وظروف المجتمع البشري، إن لم يكن يقارن الحاضر مع الماضي و المخفى مع الظاهر وربما لن يتم حفظ الخطأ والإحباط وخروجا عن الصراط المستقيم.

## STUDIME

Prim. dr. med. sc. Ali F. Iljazi

## KURANI FAMËMADH NGA KËNDVËSHTRIMI SHKENCOR

Gjatë këtyre 14 shekujve asnjë libër nuk është lexuar, nuk është komentuar dhe nuk e ka formësuar mendimin njerëzor, siç e ka bërë Kur'an.

Te besimtarët që e lexojnë në gjuhën origjinale, Kur'an fisnik ka efekt të fuqishëm dhe mahnitës.

Gjuha e tij është e përshkruar nga fuqia e fjalës hyjnore, andaj edhe mesazhi i tij është madhështor:

***“Ne do t’u bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre derisa t’u bëhet e qartë se ai (Kur’-ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?”*** (Fussilet, 53)

Duke studiuar me vëmendje dhe hollësisht të vërtetat shkencore që ndodhen në Kur'anin famëmadh, lexuesi përjeton një tronditje të thellë shpirtërore, ndien një respekt dhe mahnitje.

Njerëzimi, në shkallë të ndryshme të zhvillimit të tij nëpër etapa, ka arritur të pasurojë fondin e vet me dije të ndryshme, andaj edhe zbulimet janë nëpër etapa, shkallë-shkallë. Shumëçka është zbuluar, por edhe më tej mbetet i gjerë diapazoni i asaj që nuk është zbuluar.

Gjithësia e paskajshme e fshehtësive ekzistuese sikur rritet dhe bymehet përherë e më shumë pas çdo zbulimi të ri shkencor.

Para gjeniut shkencor ato fshehtësi të shumta mbajnë shenjën e një infiniti të papërkufizuar dhe dehet në vrapin e tij hulumtues, duke mbetur gjithmonë i mahnitur dhe duke u përlur para Krijuesit të Gjithëdijshëm.

Përkujtojmë duke medituar versetin e Kur'anit fisnik:

***“Ai është që krijoi shtatë qiej palë mbi palë. Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontrast, andaj drejto shikimin se a sheh ndonjë çarje? Mandej, herë pas here drejto shikimin, e shikimi do të kthehet te ti, i përlurur dhe i molisur.”*** (El-Mulk, 3-4)

Gjatë leximit përjetohet gjithashtu ritëm i veçantë, përplot muzikalitet, një ritëm magjik, i butë, i ëmbël dhe i thellë, i cili trondit tërë qenien njerëzore.

Duke medituat me tërë qenien, lexojmë me vëmendje versetin e Kur'anit fisnik:

***“Është fakt se në krijimin e qiejve e të Tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det, që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon All-llahu prej së larti e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhap në të nga çdo lloj gjallese; në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit e Tokës, (në të gjitha këto), për një popull që ka mend ka argumente.”*** (El-Bekare, 164)

Fenomenet e ndryshme natyrore shënohen si argumente dhe simbole, të cilat udhëzojnë kah Kreatori dhe vëzhgimi real i tyre vërteton të vërtetat e mëdha që i janë ofruar njeriut përmes shpalljes. Ekziston një All-llah Fuqiplotë, ndërsa e tërë natyra paraqet dëshmi të pakontestueshme. Argumentet madhështore në Univers flasin me një gjuhë elokumente, me gjuhën e shkencës bashkëkohore, duke na bërë të mundur që të njohim planifikimin unik në shumëdimensionalitetin e fenomeneve natyrore dhe nëpërmes kësaj, dëshirën planifikuese, e cila qëndron pas të gjitha fenomeneve natyrore.

Posaçërisht, Kur'ani fisnik nëpërmjet vrojtimit, na shpall natyrën e pikturuar me të gjitha bukuritë dhe fenomenet, në mënyrë që këto t'i pranojë realiteti shpirtëror.

Versetet e shpallura kuranore janë shenjë e urtësisë dhe mirësisë së All-llahut të Madhërishëm, pikërisht siç janë madhështore veprat e Tij në krijimin e qartë, kurse veprat e Tij gjatë ndodhive janë argumente të fuqishme për ne, por vetëm nëse mund t'i shohim dhe t'i kuptojmë.

All-llahu i Madhërishëm në Kur'anin famëmadh thotë:

**“O ju njerëz, nëse dyshoni për ringjalljen, atëherë (mendoni krijimin tuaj që) Ne u krijuam ju prej dheu, pastaj prej uji, pastaj prej një gjaku të ngjizur, pastaj prej një sa kafshatë mishi, që është krijesë e formuluar ose e paformuluar, në mënyrë që t'ju sqarojmë. Ndërsa atë që e dëshirojmë Ne e përqendrojmë në mitër, deri në një afat të caktuar, e mandej u nxjerrim foshnjë dhe ashtu të arrini pjekurinë tuaj. Ka që dikush prej jush vdes herët, e dikush të jetojë deri në pleqëri të thellë, në mënyrë që të mos dijë asgjë nga dija që ka pasur. E ti e sheh tokën e thatë-të vdekur, e kur Ne ia lëshojmë asaj ujin ajo gjallërohet, shtohet dhe nga të gjitha llojet rrit bimë të këndshme.”**  
(El-Haxhxh, 5)

Dhe verseti kuranor në vijim:

**“Nga argumentet e Tij është edhe toka që ti e sheh atë të thatë (shkretëtirë), e kur Ne i lëshojmë asaj shiun, ajo gjallërohet e shtohet. E, s'ka dyshim se Ai që e ngjalli atë, do t'i ringjallë të vdekurit, pse Ai ka mundësi për çdo gjë.”** (Fussilet, 39)

Këto dy versete të Kur'anit fisnik përshkruajnë çfarë ndodh me tokën e tharë kur bie shi dhe përmend tri fazat nëpër të cilat kalojnë bimët, derisa të dalin në sipërfaqen e tokës, si dhe në fazën kur bimët japin frytet. Ç' thotë shkenca për fazat e mugullimit?

## 1. Lëkundja e truallit

Me lëkundjen e truallit kuptojmë lëvizjen e grimcave të truallit. Këto thërmija përbëhen nga bashkëdyzimet e shtresuara tokësore, gëlqerore dhe argjilore. Shtresat janë të vendosura njëra mbi tjetrën. Kur uji depërton në këto shtresa, ai shkakton fryrjen e thërmijave të dheut. Kështu shiu që bie në sasi të mjaftueshme, shkakton lëvizjen e thërmijave të tokës.

Kjo mund të shpjegohet kështu:

Rivënia elektrostатike në sipërfaqen e grimcave (e cila paraqitet pas kontaktit me ujin) shkakton paqëndrueshmërinë e tyre. Ne këtu mund të vërejmë qartë urtësinë hyjnore në krijimin e krijesave çift, gjë që tregon për stabilitet dhe shfaqje të harmonizuar. Lëvizja e grimcave të truallit ndodh gjithashtu për shkak të ndeshjes me grimcat e ujit. Botanisti Robert Braun (1828) ka vërejtur këto lëvizje të grimcave të truallit dhe i ka quajtur lëvizjet e Braunit.

Kurdo që uji gjendet në sasi të mëdha, kjo rrit distancën mes grimcave të truallit dhe lehtëson lëvizjen e tyre. Nëse sasia e ujit zvogëlohet, ato afrohen dhe ngadalësojnë lëvizjet dhe kjo vazhdon deri kur lëvizja të ndalet tërësisht.

## 2. Faza e fryrjes

Me këtë shprehje kuptojmë fryrjen dhe trashjen e grimcave të truallit. Kur uji dhe elementet ushqyese depërtojnë në to, defundohen mes shtresave dhe ky proces rezulton me rritjen e madhësisë së grimcave të truallit.

Kjo është analoge me bymimin e dheut (në eksperimentet laboratorike). Kur në dhe hedhim ujë në sasi të konsiderueshme, dheu fryhet për shkak të absorbimit të ujit.

Këtu kemi një dukuri tjetër e cila, për shkak të gravitetit, nuk lejon ujin të rrjedhë, sepse grimcat e dheut përmbajnë ujë dhe e bartin në shtresat e tokës dhe si pasojë e forcës tërheqëse elektrostатike dhe bashkimit (fuzionit) të ndërsjellë të grimcave të ujit, që i bën si një erë e

cila pengon rrjedhjen e ujit, graviteti ka mundësi t'i mbajë grimcat e ujit në sipërfaqen e saj.

### 3. Faza e mugullimit

Kur ka ujë të mjaftueshëm, embrioni i farës bëhet aktiv dhe thith materiet e thjeshta ushqyese. Rrënjët rriten teposhtë (me dëshirën e All-llahut), në mes grimcave të truallit.

Sythat primare rriten, të tjerët me radhë. Ata shkojnë lart nëpër grimcat e truallit dhe shpërthejnë në sipërfaqe të tokës, duke u kthyer kah drita.

Lexojmë dhe përkujtojmë versetin kuranor:

***“S’ka dyshim, All-llahu është zbërthyes i farës (i kokrrës së saj) dhe i bërthamës (së pemës). Ai nxjerr të gjallin nga i vdekuri dhe Ai është nxjerrës i të vdekurit nga i gjalli. Ky është All-llahu, e si atëherë shmangeni (nga besimi)?” (El-En’amë, 95)***

Teksti kuranor na pasqyron mrekullitë të cilat ndodhin në çdo moment dhe vazhdimisht, ditën dhe natën, mrekullitë nga të cilat buron gjallëria.

Teksti i Kur’anit famëmadh bën fjalë edhe për botën bimore, për skenat e shiut i cili bie rrëke nga qielli. Ai bën fjalë edhe për farën dhe bërthamën që mugullon dhe rritet, si dhe për frytet që piqen.

Kjo jetë kaq e llojllojshme dhe e pasur është një diapazon i gjerë për meditime dhe studim, prandaj atë duhet ta shikojmë me ndjenja të thella dhe zemër të hapur. Kështu, para nesh shtrihet një panoramë e re. Na duket se e shohim për herë të parë, të kthyer drejt nesh dhe të gjallë, ndërsa ne karshi saj. Ajo lëviz me gjallëri dhe ka vazhdimësi.

Një botë vërtet mahnitëse, e cila i nxit shqisat dhe intelektin e shtyn të meditojë.

Duke marrë parasysh faktin se jobesimtarët në zemrat e tyre nuk e ndiejnë brendinë e Kur’anit, ai i provokon me argumentin e realitetit, i cili është i pakontestueshëm:

***“Pra, nëse ata janë drejt, le ta sjellin një ligjërime si ai.” (Et-Tur, 34)***

Ky provokim i përsëritur në Kur’anin fisnik, të cilin mosbesimtarët e pritën me paaftësi, duke qëndruar para tij të humbur. Kështu do të qëndrojë secili individ jobesimtar deri në Ditën e Gjykimit.

Në këtë Kur’an mahnitës, vërtet gjendet një fshehtësi e veçantë. Këtë e përjeton secili që ballafaqohet me tekstin e tij, që nga fillimi, para se të fillojë të hulumtojë aspektet e mrekullive.

Njeriu ndien një fuqi të veçantë në shprehjet e Kur’anit fisnik. Ndien që ekziston diç pas shprehjeve të cilat i kupton intelektin nga shprehjet.

Ndihet se një element rrjedh në ndjenjat posa ta dëgjojë këtë Kur’an madhështor. Këtë disa e shohin qartë, e disa të tjerë jo.

Burimi i këtij elementi, i cili përshkon ndjenjat, është vështirë të përcaktohet.

A ka të bëjë kjo me shprehjen?

Apo mos ndoshta me kuptimin i cili fshihet?

Apo ndoshta me nuancat të cilat rrezatojnë?

Apo ndoshta me ritmin e veçantë kuranor, i cili ndryshon nga ritmi i fjalëve të tjera?

Apo me të gjithë elementet së bashku?

Pra kjo është fshehtësia e tekstit kuranor, të cilin e has secili që i qaset Kur’anit fisnik në fillim... dhe më pastaj, pas kësaj, vijnë fshehtësitë që arrihen duke vështuar, shikuar dhe menduar për strukturën e tërë Kur’anit.

Në metodën që ndjek Kur’ani në formimin e kuptimit të tërësisëm dhe real në njohjen njerëzore, ai i referohet natyrës së lashtë njerëzore dhe me një të folur të veçantë, i cili nuk është i njohur me të folurit njerëzor.

Ai rrotullon zemrën e njeriut nga të gjitha anët, i afrohet me kujdes duke e trajtuar si një ekspert i vërtetë në çdo skutë të fshehtë të zemrës.

Në Kur’anin fisnik hasim një baraspeshë absolute, pa kundërthënie, qofshin në pyetjet primare apo sekondare.

Këto dhe fenomene të ngjashme që janë të paarritshme, së bashku me fshehtësinë e fshehur, të cilës nuk ka mënyrë që t’i kundërvihet, i

japin këtij Libri karakteristikën e mrekullisë universale për të gjitha kohët. Ky është një realitet, të cilin nuk e mohon njeriu që i respekton ndjenjat e tij, e respekton të vërtetën e tij e cila shkëlqen fuqishëm, thellë dhe qartë, sa herë që takohet me Kur'anin famëmadh me zemër të pastër.

**“Pra, nëse ata janë drejt, le ta sjellin një ligjërim si ai.”** (Et-Tur, 34)

Çështja tjetër ka të bëjë me brendinë e ekzistencës së tyre. Ky është një fakt me të cilin ata duhet të ballafaqohen. Ata nuk kanë mënyrë që ta shpjegojnë, përveç ashtu siç thotë Kur'ani fisnik, e kjo është që ata e kanë Krijuesin i cili krijoi, e ky është All-llahu i Madhërishëm:

**“A mos u krijuam prej kurrgjësë, apo ata vetë janë krijues.”** (Et-Tur, 35)

Ekzistenca e tyre kështu pa Krijues, është një gjë që logjika e natyrës së lashtë njerëzore e refuzon që në fillim. Ndërsa, sa i përket çështjes se ata e kanë krijuar veten, është një gjë që ata nuk e kanë vërtetuar dhe që asnjë qenie nuk e ka pohuar. Nëse këto dy hipoteza nuk i pranon natyra njerëzore që nga lashtësia, nuk mbetet asgjë përveç të vërtetës të cilën e sjell Kur'ani famëmadh, e kjo është që të gjitha krijesat e kanë një Krijues absolut, një All-llah të Plotfuqishëm, i cili krijon dhe formëson, orienton, edukon dhe furnizon. Kjo është logjika e qartë dhe e thjeshtë.

Gjithashtu, Kur'ani i ballafaqon me krijimin e qiejve dhe Tokës që janë para syve të tyre. A thua ata i krijuan?

**“A mos ata i krijuan qiejt e Tokën? Jo, por ata nuk janë të bindur.”** (Et-Tur, 36)

Ata nuk mund të pohojnë se i kanë krijuar.

Më tej Kur'ani fisnik i lëshon një shkallë më poshtë se shkalla e krijimit dhe kreativitetit të tyre apo krijimit të qiejve dhe Tokës, duke i pyetur, mos vallë ata posedojnë depot e All-llahut, siç bën aluzion verseti kuranor në vijim:

**“A mos tek ata janë depot e Zotit tënd, apo ata i mbizotërojnë?”** (Et-Tur, 37)

All-llahu i Plotfuqishëm është Ai i cili jep, drejton dhe posedon e mbizotëron mbi gjërat. Ndërsa ata as nuk posedojnë gjërat, as nuk mbizotërojnë mbi gjërat.

Më pastaj e lëshon edhe një shkallë më poshtë duke i pyetur se a kanë mjet për ta dëgjuar shpalljen:

**“A mos kanë ata shkallë të larta që në to të përgjojnë? Pra, përgjuesit e tyre le të sjellin fakt të sigurt!”** (Et-Tur, 38)

Muhammedi, a.s., u thoshte atyre se ai është i dërguar të cilit i shpallet Kur'ani nga sferat e larta. Por, ata këtë e mohonin. Kur'ani kërkon prej tyre të sjellin një argument të fuqishëm për atë që flasin. Në këtë është aluzioni në fuqinë e Kur'anit, me të cilin ata ballafaqohen në versetet dhe argumentet, të cilat ata me kryelartësi dhe kokëfortësi nuk i pranonin.

Gjurmata e dëshirës së All-llahut gjenden në zemrën dhe ndjenjat e njeriut në çdo fazë dhe çdo situatë.

Përkujtojmë versetin e Kur'anit fisnik:

**“Dhe se Ai bën për të qeshë dhe bën për të qarë.”** (En-Nexhm, 43)

Në këtë verset fshihen shumë fakte. Nga ky dalin imazhe frymëzuese dhe kuptime të mëdha...

Pra, All-llahu i Gjithëdijshtëm mbolli te njeriu cilësinë e të qeshurit dhe të qarit. Qeshja dhe qarja janë një prej fshehtësive të organizmit të njeriut dhe paraqiten në këtë aparat të komplikuar të strukturës psikike, e cila nuk është asgjë më e vogël se struktura organike. Në këtë qenie të quajtur njeri ngërthehen, duke vepruar së bashku, faktorët psikikë dhe organikë dhe krijojnë të qeshurit dhe të qarët.

Pra, All-llahu i Plotfuqishëm krijoi te njeriu shkaqet për të qeshur dhe për të qarë. Shpesh qesh nesër për atë që ka qarë sot dhe qan sot për atë që ka qeshur dje. Nuk është ky shkak i çrregullimeve apo eksitimeve, por rezultat i gjendjeve psikike, motiveve dhe vlerave të cilat në ndjenjat e njeriut nuk mbesin në një gjendje të njëjtë.

All-llahu i Madhërishëm bën që njerëzit në një moment të qeshin e të qajnë, gjithnjë sipas rrethanave që veprojnë tek ai. Shpesh ndodh që një grup të qeshë ndaj grupit i cili qan.

Sa do të ketë prej njerëzve që kanë qeshur në këtë botë, por do të qajnë në botën tjetër, atëherë kur të qarët nuk bën dobi!

Andaj, Kur'ani fisnik për hipokritët thotë:

**“Le të qeshin pak (në dunja) e le të qajnë shumë (në botën tjetër). Ai është shpërblim i asaj që fituan.”** (Et-Teube, 82)

Kohëve të fundit, shkencëtarët zbuluan se në pjesën temporo-parietale ndodhet qendra me madhësi arre, nga e cila vijnë impulset për të qeshur dhe për të qarë. Kur kjo qendër dëmtohet, personi qesh ose qan pa kontrolluar ndjenjat e tij. Pra këtë qendër All-llahu i Madhërisëm e krijoi në trurin e çdo individi dhe vetëm Ai ka kontrollin mbi të.

Në tekstin e mëtejshëm të Kur'anit fisnik lexojmë:

**“Dhe se Ai është që jep vdekje dhe jep jetë (gjallëri).”** (En-Nexhm, 44)

Këto janë dy fenomene të njohura që ndodhin duke u përsëritur në çdo moment. Por, ato janë enigmë për njerëzit kur mundohen të njohin natyrën dhe fshehtësinë e tyre.

Andaj, pyetja mbetet e hapur:

Ç'është vdekja? Ç'është jeta? Çfarë është brendia e tyre, kur njeriu provon të depërtojë pas fjalëve dhe formës së tyre të cilat i sheh? Si hyri jeta në krijesën e gjallë? Nga erdhi? Çfarë është kjo gjallëri? Si erdhi dhe ku shtegton?

Çfarë është vdekja dhe çfarë ishte para largimit të jetës? Ku shkon pasi t'i lëshojë qeniet e gjalla?

Kjo mbetet fshehtësi pas vellos së lëshuar, në fuqinë e All-llahut të Gjithëdijshëm.

Ndodhin miliona imazhe të vdekjes dhe jetës në të gjitha botët e qenieve të gjalla, në një moment dhe mu në këtë moment. Sa milionë e milionë qenie të gjalla kanë vdekur? Sa milionë e milionë të tjerë kanë filluar rrugëtimin jetësor tek të cilët ka hyrë kjo fshehtësi dhe ti nuk e di kur dhe nga hyri ky gjallërim; nuk di askush pos All-llahut të Plotfuqishëm! Sa kesi imazhe dalin në shesh gjatë shekujve, kur fantazia zhytet në paraqitjen e të kaluarës së gjatë, e cila ka ekzistuar edhe para se të jetë njeriu në këtë planet.

Këto janë imazhe aq të shumta që i imitojnë këto pak fjalë, të cilat tronditin zemrën e njeriut në thellësi, kështu që ajo nuk mund t'i përballojë dhe t'i zotërojë, nën ndikimin e këtyre jehonave të fuqishme!

Analizojmë duke menduar versetin e Kur'anit fisnik në vijim:

**“Dhe Ai është që krijoi llojet - mashkullin dhe femrën nga pika e farës që hidhet.”** (En-Nexhm, 45)

Ky është një fakt real që përsëritet për çdo moment. Njeriu e harron këtë, sepse kjo ndodh dhe përsëritet para syve të tij. Kjo është më e mahnitshme se çdo mahnitje që mund ta prodhojë imagjinata e njeriut!

Pika e farës që hidhet ... tajitet... Një prej shumë sekreteve të organizmit të njeriut, sikurse lotët, djersa, pështyma! Dhe si kjo pikë, pas një periudhe të përcaktuar nga All-llahu i Gjithëdijshëm, bëhet njeri - femër ose mashkull!

Në këtë pikë, ky njeri me këtë strukturë madhështore dhe shumë të komplikuar?

Një qelizë mikroskopike që noton së bashku me miliona qeliza të tjera, ndodhet njeriu në miniaturë. Dhe cila mendje njerëzore që qëndron para këtij fakti madhështor mund të ndalet, të mohojë apo me mendjemadhësi të thotë: Kjo ndodhi si ndodhi dhe... lamtumirë?!

Kush është Ai që në këtë qelizë futi këtë predispozicion? Si funksionon ky kod gjenetik dhe kush udhëheq me të?

Kush është ai i cili ia skicoi rrugën këtij spermatozoidi, duke ia realizuar dëshirën e fshehtë të tij?

**“Ai është që vetëm Atij i takon sundimi i qiejve dhe i Tokës. Ai nuk ka as fëmijë e as nuk ka shok në sundimin e Tij. Ai krijoi çdo gjë, duke e përsosur në mënyrë të qartë e të matur.”** (El-Furkanë, 2)

Molekula e quajtur ADN, që gjendet në bërthamën e çdo 100 trilionë qelizave të trupit tonë, e përmban gjithë informacionin strukturor të trupit të njeriut. Informacioni që ka të bëjë me të gjitha karakteristikat e një personi, që nga pamja e jashtme deri në strukturën e organeve të brendshme, është i regjistruar në ADN me anë të një sistemi të veçantë kodimi. Informacioni në ADN është i koduar brenda sekuen-



cës së katër bazave speciale që e ndërtojnë molekulën. Këto katër baza janë specifikuar si A, T, G, dhe C sipas shkronjës me të cilën fillon emri i tyre. Të gjitha ndryshimet strukturore midis njerëzve varen nga ndryshimi në sekuencën e këtyre shkronjave. Kjo është pak a shumë si një kasafortë me të dhëna, e përbërë prej katër shkronjash.

Rregulli i shkronjave të ADN-së përcakton strukturën njerëzore deri në hollësitë e saj më të vogla. Përveç karakteristikave, si gjatësia, sytë, flokët dhe ngjyra e lëkurës, ADN-ja e një qelize gjithashtu përmban dizenjimin e 206 kockave, 600 muskujve, një rrjeti me 10000 muskuj dëgjimi, një rrjet me 2 milionë nerva optikë, 100 bilionë qeliza nervore, 130 bilionë metra enë gjaku dhe me 100 trilionë qeliza. Në qoftë se do të shkruajmë informacionin e koduar në ADN, atëherë do të na duhej të përpilonim një bibliotekë gjigante me 900 vëllime enciklopedike, me nga 500 faqe secili.

Kur merret në konsideratë se ka 200.000 gjene në trupin e njeriut, bëhet edhe më e qartë se sa është e pamundur që miliona nukleotide, të cilat i përbëjnë gjenet, të formohen rastësisht në sekuencat e duhura. Të gjitha informacionet për qenien e gjallë ruhen në molekulën e ADN-së. Vetëm kjo metodë kaq efikase e ruajtjes së informacioneve është një provë e mjaftueshme për faktin që jeta nuk erdhi rastësisht, por është krijuar në një mënyrë të mrekullueshme nga Krijuesi i plotfuqishëm.

Pohimi se jeta evuloi nga gjërat jo të gjalla, është një përrallë e parë e ëndrrave të evolucionistëve dhe është krejtësisht në kundërshtim me rezultatet e çdo eksperimenti dhe observimi.

Pra, mund të përfundojmë se kompetenca e krijimit i takon vetëm All-llahut të plotfuqishëm. Ta rikujtojmë versetin e Kur'anit fisnik:

**“Ky është All-llahu, Zoti, Krijuesi i çdo sendi, nuk ka zot pos Tij, e si prapësoheni?”** (Gafir, 62)

Roli i njeriut në krijim nuk kalon më shumë se lëshimi i lëngut spermatik në organin femëror. Këtu përfundon puna e njeriut, ndërsa më tej dora kreative e merr rolin duke formësuar etapë pas etape, siç bën aluzion verseti kuranor në vijim:

**“A më tregoni për farën që e derdhni: a ju e krijoni atë, apo Ne jemi që e krijojmë?”** (El-Vakia, 58-59)

Këtë nivel të meditimit mund ta arrijë çdo njeri. Kjo është mrekulli e mjaftueshme që të ndikojë te njeriu. Por ajo që ndodhi me këtë qelizë të dobët-spermatozoidi, pasi që të hidhet e derisa të bëhet krije-së e mrekullueshme, është më e çuditshme se fantazia jonë, diçka që i duket e pabesueshme mendjes se ajo ndodh vërtet, sikur për të nuk dëshmon çdo njeri.

Një qelizë e bashkuar fillon të ndahet dhe të shumëzohet në miliona e miliona qeliza të reja. Secili grup qelizash përbën specifikën e cila e dallon nga grupet tjera.

Këto qeliza janë eshtrat, muskujt, lëkurat, nervat, ... Më pastaj, këto janë qelizat për funksionimin e syrit, gjuhës, veshit dhe për funksionimin e gjëndrave me sekretim të brendshëm... Dhe secila prej tyre me precizitet të mrekullueshëm e di vendin e veprimit të saj.

Qelizat e syrit nuk gabojnë, për shembull të shkojnë në stomak ose në këmbë, dhe atje ta formojnë syrin. Por të gjitha punojnë me inspirim hyjnor, duke ndërtuar organizmin e njeriut në formën më të bukur dhe nën mbikëqyrjen e Gjithkrijuesit absolut, ngase njeriu nuk merr pjesë fare në këtë sferë të krijimit.

Nga krijimi i parë që është realitet i cili përsëritet dhe të cilin askush nuk mund ta mohojë, direkt drejtohet në ringjallje siç përkujton verseti kuranor në vijim:

**“S’ka dyshim se idhujtarët kriminelë, janë edhe në një huti edhe në zjarr të madh.”** (El-Kamer, 47)

Ringjallja tjetër është fshehtësi. Por, krijimi i parë për këtë është argument. Ai i cili krijoi çift mashkullin dhe femrën nga fara që hidhet, ka fuqi pa dyshim që ta ringjallë përsëri.

Krijimi i parë bart argument të dyfishtë për ringjalljen e sërishme. Gjatë krijimit të parë dhe ringjalljes së sërishme All-llahu i jep pasuri kujt të dojë nga robërit e Tij:

**“...ditën kur me fytyrat e tyre do të tërhiqen zvarrë në zjarr. “Vuajeni në dënimin Sekar (emër i një xhehennemi).”** (El-Kamer, 48)

I jep pasuri atij që do prej robërve të Tij në këtë botë, në forma të ndryshme të pasurisë: në mall, në shëndet, në pasardhës, pasuri në shpirt, në mendime, në lidhshmëri me All-llahun dhe furnizim të llojeve të ndryshme.

I jep pasuri kujt të dojë prej robërve të Tij, në botën tjetër. Jep kënaqësi kujt të dojë prej robërve të Tij në këtë dhe në botën tjetër.

Krijesat janë të varfra dhe të pakënaqura; nuk mund të pasurohen dhe të varfërohen përveç nga depot e All-llahut.

Përkujtojmë versetet e Kur'anit fisnik në vijim:

**“Vazhdo me këshillë, sepse këshilla besimtarëve u bën dobi. Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër, pos që të më adhurojnë. Unë nuk kërkoj prej tyre ndonjë furnizim e as dëshiroj të më ushqejnë ata. All-llahu është furnizues i madh. Ai - Fuqiforti.”** (Edh-Dharijatë, 55-58)

Këto versete përmbajnë një realitet të madh, njërën prej të vërtetave më të mëdha kozmike, pa kuptimin dhe njohjen e së cilës nuk ka jetesë të vërtetë në tokë, qoftë për jetën e individit ose shoqërisë, qoftë për jetën e tërë njerëzimit në çdo periudhë dhe epokë.

Aspekti i parë i këtij fakti është që ekziston një qëllim konkret i ekzistimit të xhinëve dhe njerëzve.

Ky qëllim është paraqitur në detyrën konkrete dhe kush e kryen e ka plotësuar qëllimin e ekzistencës së tij, ndërsa kush nuk e kryen jeta e tij ka ngecur pa qëllim.

Kjo detyrë konkrete, e cila lidh xhinët dhe njerëzit me ligjin e ekzistencës, është bindja dhe adhurimi ndaj All-llahut të Madhërishëm.

Njeriu e kupton që është rob, kështu që nuk kalon kufijtë e robit në ndjenjat dhe kërkesat e tij. Gjithashtu di që All-llahu është Zot. Për këtë nuk lëshohet në kompetencat që i takojnë All-llahut të plotfuqishëm. Emocionet e tij ndahen te ky kufi; All-llahu i kënaqur me të dhe ai i kënaqur me All-llahun.

Falënderimi i qoftë All-llahut për këto argumente kozmike. Falënderimi i takon vetëm All-llahut të plotfuqishëm në çdo situatë!

Tërësia e skenave kozmike bëjnë aluzion dhe duan të tregojnë dhe ta vërtetojnë se fuqia kreative e Tij nuk ka fund, se dituria e Tij nuk mund të përcaktohet, se dëshira e Tij absolute gjithashtu është e pafund:

**“Sikur të gjithë drunjtë në tokë të jenë lapsa dhe sikur detit t'i shtohen edhe shtatë dete (e të jenë me ngjyrë), nuk do të mbaronin fjalët e All-llahut (do të shteroheshin detet; do të soseshin lapsat, e jo mrekullitë e Zotit). All-llahu është Ngadhënjyesi i urtë.”** (Llukman, 27)

Andaj fjalët e All-llahut nuk mbarojnë kurrë, ngase edhe dituria e tij nuk mund të kufizohet, dëshira e tij nuk përfundon, dëshira e tij rrjedh pandërprerë, ajo është e përhershme dhe e pakufishme në kohë dhe hapësirë.

Drurët dhe detet treten, jeta dhe gjërat zhduken, zhduken format dhe situatat, por zemra e njeriut mbetet e përulur para madhështisë së Kreatorit të përhershëm:

**“Sikur të gjithë drunjtë në tokë të jenë lapsa dhe sikur detit t'i shtohen edhe shtatë dete (e të jenë me ngjyrë), nuk do të mbaronin fjalët e All-llahut (do të shteroheshin detet, do të soseshin lapsat, e jo mrekullitë e Zotit). All-llahu është Ngadhënjyesi i urtë.”** (Llukman, 27)

*Literatura e konsultuar:*

1. H. Sherif Ahmeti: "Kur'ani" – Përkthim me komentim , Prishtinë, 1988.
2. Jusuf b. Abdullah Ali: "The Meaning of the Holy Qur'an" Maryland, USA 1991.
3. Rama Atajiq: "Prijevod Kur'ana sa tefsirrom i komentarom na bosanskom jeziku", Sarajevë 2001.
4. Muhammed Sha'ravi : "Mrekullia e Kur'anit" Prishtinë, 1996.
5. Mustafa Mlivo: "Kur'an ispred nauke i civilizacije", Bugojna, 2001.
6. Keith Moore: "Developing Human" , 1998.
7. Abdul Mexhid Zendan: "Njëshmëria e Krijuesit", Furkan, Shkup 2000.
8. Gary Miller: "Qudesni Kur'an", 2003.
9. Husein Muhammed Dhehebi: "Komentimi shkencor i Kur'anit". Dituria Islame nr. 42 Prishtinë, 1992.
10. Harun Jahja: "Mrekullitë e Kur'anit" Tiranë, 2002.
11. Enes Kariq: "Semantika Kur'ana" Sarajevë, 1998.
12. Enes Kariq: "Uvod tefsirske znanosti" Sarajevë, 1995.
13. Feti Mehdiu: "Kur'ani kryevepër", Prishtinë, 1992.
14. Sejjid Kutub: " U okrilju, Kur'ana" Sarajevë, 1996.
15. Hamilton Brid Musman: "Human Embryology", Baltimore, USA, 1967.
16. Jusuf Raloviq: "Dituritë gjeografike në Kur'an", Shkup, 1999.
17. Mehmed Karahoxhiq: "Knjiga o stvaranju", Sarajevë, 2003.
18. Orijeta Deda, Samir Bulku: "Thesare në Kur'an" Tiranë, 2002.
19. Ali Iljazi: "Kur'ani dhe shkenca bashkëkohore" Gjakovë, 2000.
20. Ali Iljazi: "Kur'ani famëmadh nga këndvështrimi shkencor", 2002.
21. Ali Iljazi: "Kur'ani prijatar i shkencës" Gjakovë, 2003.
22. Rasim Bejtullahu: "Astronomia" tekst universitar, Prishtinë, 2003.
23. Nedim El Xhisr: "Vjetrovanje u Boga u svetlu filozofije, nauke i Kur'ana", Sarajevë, 1976.
24. David Levy: "Skywatching", Usa, 1994.

*Prim. dr. med. sc. Ali F. Iljazi*

## THE NOBLE QUR'AN FROM THE VIEWPOINT OF SCIENCE

### (Summary)

During the past 14 centuries no other book has been read more than the Qur'an. No other book has shaped the way humans think more than the Qur'an. The noble Qur'an has a strong effect on those who read it in its original language.

Its language is permeated by the strength of the divine word, thus, its message is magnificent:

We will show them Our signs in the horizons and within themselves until it becomes clear to them that it is the truth. But is it not sufficient concerning your Lord that He is, over all things, a Witness? (Fussilat: 53)

While reading the scientific truths presented in the noble Qur'an, the reader experiences a deep spiritual shock, feels respect and admiration.

د. علي الياسي

## القرآن الكريم من منظور علمي

### (خلاصة البحث)

خلال هذه القرون ١٤ ليس هناك كتاب واحد أكثر قراءة أو أكثر تعليقاً أو ساهم في تشكيل الفكر الإنساني، كما فعل القرآن الكريم. مؤمنون الذين يقرأون باللغة الأصلية، تأثير قوي ومذهل.

وصفت لغته من قبل قوة الكلمة الإلهية، وبالتالي رسالته هي رائعة:

سَنُرِيهِمْ آيَاتِنَا فِي الْأَفَاقِ وَفِي أَنْفُسِهِمْ حَتَّىٰ يَتَبَيَّنَ لَهُمْ أَنَّهُ الْحَقُّ ۗ أَوَلَمْ يَكْفِ

بِرَبِّكَ أَنَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ﴿٥٣﴾ (فصلت، ٥٣)

بعد أن يدرس الإنسان بعناية الحقائق العلمية في القرآن الكريم يحس القارئ بالتشويق الروحي، يشعر بالاحترام والإعجاب.

## FSHEHTËSITË E KURANIT

*Muhamed Zaglul En-nexhar*

### KUJDESI NDAJ PASURISË SË JETIMIT

**”Mos iu qasni pasurisë së jetimit, veçse me qëllim të mirë, derisa të arrijë moshën e pjekurisë. Dhe përmbushni zotimet. Me të vërtetë, për zotimet do të jeni përgjegjës”.** (Surja El-isra: 34).

Ky ajet kuranor ka ardhur në fund e çerekut të pjesës së parë të sures ”El-Isra”. Është sure mekkase. Ajetet e saj janë 111 pas ”Bismilahir”. Është quajtur me këtë emër për arsye se në fillimin e saj përmetet udhëtimi i Pejgamberit a.s., të dërguarit të fundit, nga xhamia e shenjtë në Mekë deri në xhaminë El-Aksa në Kuds.

Tema kryesore e sures ”El-Isra” është rreth besimit (akides islame), siç është qëllimi i të gjitha sureve mekkase. Lidhur me këtë temë kemi folur, atëherë kur kemi bërë fjalë për këtë sure të bekuar lidhur me shtyllat e besimit islam, jurisprudencën islame dhe fenomenet natyrore. Ndërsa këtu do të përqendrohemi në mrekullinë ligjore të ajetit që është objekt i shqyrtimit të kësaj teme.

### Aspekte të mrekullisë ligjore të këtij ajeti kuranor

Ky ajet kuranor flet për jetimin, pronar i pasurisë. Jetimi është ai që i ka vdekur babai ende pa e arritur moshën e pjekurisë, apo te dy prindërit. Në këtë situatë në të cilin jetimi nuk mund të menaxhoj pasurinë, pasuria e tij bëhet cak për çdo lakmitar që nuk e ka frikë Zotin.

Për këtë gjë Islami na ka urdhëruar të përkujdesemi për jetimin në rast se ai është i varfër, ose me caktua një njeri besnik që të kujdeset për të në qoftë se është i pasur, që të zëvendësoj atë në menaxhimin e pasurisë së tij me besnikëri dhe sinqeritet që t’i shtohet pasuria dhe të nxjerrë zeqat nga ajo pasuri.

Është kusht që kujdestari të jetë mysliman, i mençur, i moshës madhore, besnik, i lirë, të ketë aftësi të menaxhoj këtë pasuri, mund të jetë i afërm i familjes së jetimit apo jo. Zoti i lartësuar urdhëron çdo kujdestar të jetimit të pasur ta ruaj pasurinë dhe të punojë në shtimin e pasurisë me metodat më të mira, të jep zeqatin rregullisht derisa të arrijë moshën e pjekurisë që të jetë i aftë ta menaxhoj pasurinë e vet.

Gjatë kohës së kujdestarisë, nuk i lejohet kujdestarit të mos marrë asgjë nga pasuria e jetimit në qoftë se është i pasur dhe i sinqertë, dhe ai ka falur pasurinë, fenë, devotshmërinë për Zotin e tij. Por, nëse është i varfër i lejohet që të marrë shpërblim për menaxhimin e tij nëse ka familjar ose nga banorët e atij vendi ku jeton.

Kjo është për shkak se në pasurinë e jetimit ka lakmi dhe shejtani e nxit kujdestarin e jetimit dhe të gjithë ata që e rrethojnë se çdo njeri prej tyre ka të drejtë në këtë pasuri. Për këtë arsye, Zoti na ka paralajmëruar për kujdesin që të mos biem në një situatë të këfillë. Zoti i lartësuar ka thënë në Kur’anin famëlartë: **”Mos iu qasni pasurisë së jetimit, veçse me qëllim të mirë, derisa të arrijë moshën e pjekurisë. Dhe përmbushni zotimet. Me të vërtetë, për zotimet do të jeni përgjegjës.”** (El-Isra:34). Zoti na urdhëroi që të mos i afrohem pasurisë së jetimit, përveç se për të mirën e tij, në formë të shumësit, që i tërë komunitetit mysliman të jetë përgjegjës për jetimin dhe pasurinë e tij, sponsorimin dhe mirëmbajtjen e tij. Ky urdhër kuranor për këtë çështje është përsë-

ritur në më shumë se 20 ajete të Kur'anit në mënyrë të drejtpërdrejtë, por ajeti që më së shumti ka pasur ndikim në shpirtin e myslimanit, është fjala e Allahut të madhërishtëm: **”Vërtet, ata që e shpenzojnë pasurinë e jetimit pa të drejtë, vetëm mbushin barkun e tyre me zjarr dhe ata do të digjen në Zjarrin flakërues”.** (Surja Nisa 10).

Për këtë Profeti Muhamed a.s. e ka konsideruar marrjen e pasurisë së jetimit nga shtatë mëkatet e mëdha shkatërruese dhe ka thënë: ”Largohuni ose shmanguni shtatë mëkateve të mëdha!”. Shokët i thanë: Cilat janë ato o i dërguari i Allahut? Ai iu përgjigj: ”Mos besimi në Allahun, magjia, mbytja e një shpirti të cilin e ka ndaluar Zoti, përveç se në të drejtë, marrja e kamatës, marrja e pasuri së jetimit, dhe shpifja për besimtare të ndershme dhe lëshimi i frontit”.

Në këtë hadith, i dërguari i Zotit, Muhamedi a.s. e konsideron marrjen e pasurisë së jetimit nga mëkatet e mëdha shkatërruese. Personi, i cili e bënë këtë mëkat mund të jetë përgjithmonë në zjarrin e xehenemit në qoftë se nuk pendohet tek Zoti.

Nga aspektet e mrekullive ligjore në këtë çështje është sqarimi i situatës së dobëtit që është jetimi, i cili nuk ka fuqi dhe mundësi për menaxhimin e trashëgimisë që e ka trashëguar dhe kjo pasuri bëhet si mos të ketë pronar në të. Një pasuri e tillë është cilësuar që vërsulet në të çdo lakmitar. Dhe vjen shejtani me vesveset e tij për të bindur çdo njeri që ka lidhje me këtë jetim edhe ai që ka të drejtë në këtë pasuri. Dhe nga mashtrimet e tij është që e bashkon pasurinë e tij me pasurinë e vet dhe nga shpenzimet që bënë ja përket jetimit ose e ndërron pasurinë e tij të keqe me pasurinë e atij të mirë ka lloje të tilla të mashtrimeve.

Realiteti në këtë çështje është që ai kujdestari i jetimit është që ta ndjejë rëndësinë e amanetit që e ka marrë përsipër në qafen e tij, për të cilën do ta pyes Zoti për të. Detyra e çdo kujdestari për çështjen e jetimit është ta kthejë pasurinë tek pronari i tij në momentin kur e kupton se ai është i aftë i për menaxhimin e pasurisë pa asnjë vonesë.

Për këtë arsye lakmia e njerëzimit dhe vesveset e shejtanit na ka treguar Zoti që të kemi kujdes në ajetin e tij kuranor, ”surja Isra 34” ,që mos ti afrohem pasurisë së jetimit veçse për të mirë dhe ka përsë-

ritur këtë vërejtje në më shumë se 20 ajete kuranore të tjera. Kurse i dërguari i Allahut ka thënë:

”Keni kujdes në pasurinë e dy të dobëtëve ”Jetimit dhe gruas”.

Keni mëshirë për të dobëtit, sepse ju mund të fitoni dhe të furnizoheni nga lutjet dhe istigfaret e të dobëtëve. Se Islami është fe e mëshirës për të gjitha krijesat, veçanërisht për të dobëtët, dhe për të varfëritë, të cilët nuk kanë mundësi dhe forcë. Meqenëse këta të dobët dhe të varfër kanë nevojë për mëshirën e mëshiruesve nga robët e Allahut ata janë jetimët. Për këtë Islami i madhërishtëm na ka obligua për një përkujdesje të veçantë ndaj tyre, edukimin dhe përkujdesën ndaj e tyre. Ai na tërheq vërejtjen që të mos jemi mizor ndaj tyre, të kujdesimi për ruajtjen e pasurisë së tyre dhe shtimin e saj. Po ashtu na ka urdhëruar të mos marrim prej pasurisë së tyre vetëm në qoftë se kemi nevojë për të. Sepse përkujdesja e pasurisë së jetimit është përgjegjësi për kujdestarin e jetimit, dhe për të gjithë myslimanët. Kështu që duhet zbatuar urdhri në përpikëri që mos t’ju afrohet pasurisë së jetimit veçse për të mirën e tij. Zoti i lartësuar thotë në librin e tij të madhërishtëm: ”Mbajeni premtimin, se premtimi është përgjegjësi”, që do të thotë: Zbatoheni premtimin që ja keni dhënë Zotit të lartësuar, dhe zbatoni premtime të tjera, të cilat i ka urdhëruar Zoti i lartësuar dhe bëhuni të përpiktë në betimet si do që të jenë këto premtime si me Zotin e lartësuar po edhe me njerëzit sepse ju do të pyeteni për to ditën e kiametit.

E ka vërtetuar Kurani rëndësinë për mbajtjen e premtimit ose kryerjen e tij në shumë ajete, sepse mbajtja e premtimit është një nga mënyrat e detyrueshme për arritjen e myslimanëve në rrugën e drejtë, dhe përhapjen e kulturës, pastrimin e veprimeve, dhe respektin e vetës.

Marrë nga gazeta “El-Ahram”, 27.03.2012

Përktheu nga arabishtja  
Desara Vathaj

Muhamed Zaglul En-nexhar

## LOOKING AFTER THE PROPERTY OF ORPHANS

### (Summary)

And do not approach the property of an orphan, except in the way that is best, until he reaches maturity. And fulfill [every] commitment. Indeed, the commitment is ever [that about which one will be] questioned. (Al-Isra: 34)

This ayat appears in the Al-Isra surah. It is a Meccan surah. It has 111 verses. It is called Al-Isra because it mentions (in its opening verse) the journey of the Prophet, the last messenger, from the Holy Mosque in Mecca to the Al Aqsa Mosque in Quds.

محمد زغللول النجار

### رعاية أموال الأيتام

#### (خلاصة البحث)

وَلَا تَقْرَبُوا مَالَ الْيَتِيمِ إِلَّا بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ حَتَّىٰ يَبْلُغَ أَشُدَّهُ ۚ وَأَوْفُوا بِالْعَهْدِ ۚ إِنَّ الْعَهْدَ كَانَ مَسْئُولًا (سورة الإسراء: ٣٤)

لقد جاءت هذه الآية الكريمة في نهاية الثلث الأول من "سورة الإسراء" وهي سورة مكية. آياتها هي ١١١ "بعد البسملة". وهي تسمى بهذا الاسم لورود الإشارة في مطلعها إلى رحلة الاسراء لمخاتم الانبياء و المرسلين (صلعم) من المسجد الحرام في مكة إلى المسجد الأقصى في القدس.

## EDUKATË ISLAME

## PASOJAT E MOSRESPEKTIMIT TË PRINDËRVE

Prej të mirave të shumta që i është dhënë njeriut nga Zoti i madhëruar në këtë botë, janë edhe prindërit. Ata janë ardhmëria dhe shpresa e jetës sonë. Respektimi i prindërve është shkak i jetës së gjatë, suksesit, prehjes në vështirësi, plotësimit të dëshirave në lutje, qetësisë dhe rehatisë në jetë. Allahu xh.sh. e ka krahasuar respektimin dhe dëgjimin e prindërve me dëgjimin dhe respektimin e Tij.

Allahu xh.sh thotë:

***"Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve."***<sup>1</sup>

Pejgamberi a.s. është pyetur se: "Cila punë është më e dashur te Zoti i Madhëruar"? Tha: "Namazi në kohën e vet", i thanë, e pastaj cila? Tha: "Bamirësia ndaj prindërve"...<sup>2</sup>

Ndërsa mosrespektimi i tyre është njëra prej mëkateve të mëdha.

*Transmeton Ebu Bekrete Nufej r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë:*

*"A dëshironi t'ju tregoj për mëkatet më të mëdha?" Këtë e përsëriti tre herë. Ne i thamë: "Po, o i Dërguar i Allahut." Pejgamberi a.s. tha: "Me i bë shirk (shok) Allahut dhe mosrespektimi i prindërve..."*<sup>3</sup>

Pasojat e mosrespektimit të prindërve mund të ndahen në dy pjesë: ato në këtë botë dhe në botën tjetër.

## PASOJAT E MOSRESPEKTIMIT TË PRINDËRVE NË KËTË BOTË

Nga pasojat në këtë botë mund të jenë të shumta, por do të mundohemi t'i radhisim disa:

1. Hidhërimi i Krijuesit dhe mosrespektimi i urdhrave të Tij. Për këtë kemi ajetin kuranor ku Zoti i madhëruar na urdhëron t'i respektojmë prindërit. Allahu thotë: ***"Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as "of - oh", as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaj fjalë të mira (të buta, respektuese). Dhe në shenjë mëshire shtriye pranë tyre krahun përulës e respektues dhe thuaj: "Zoti im! Mëshiroi ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël".***<sup>4</sup>
2. Të nxihet fytyra dhe të hiqet ndriçimi i saj .Profeti a.s. thotë: *"Ruaje miqësinë me babanë tënd dhe mos e prish atë , sepse ta heq Zoti ndriçimin e fytyrës".*
3. Do të jetosh gjithë jetën i përbuzur dhe i nënçmuar, nëse nuk i respektton prindërit. Profeti a.s. thotë: *"I përbuzur është, i përbuzur është, i përbuzur është". Kush është ky o i Dërguar i Allahut e pyetën shokët? "Ai që i ka prindërit dhe nuk janë shkak që ai të hyjë në xhenet duke i respektuar."*<sup>5</sup>
4. Ndëshkimi do t'i përshpejtohet në këtë botë, para botës tjetër. Profeti a.s. thotë. *"Nuk ka gjynah që e përshpejton ndëshkimin në këtë botë para botës tjetër, siç është ndërprerja e marrëdhënieve me farefisën dhe*

<sup>1</sup> Kurani me përkthim dhe komentim, Sherif Ahmeti, suretu, El Isra, 23.

<sup>2</sup> Imam Nevevi "Rijadus-Salihin" Prishtinë, fq.144, hadithin e transmeton Buhariu dhe Muslimi, hadithi 317.

<sup>3</sup> Ibid hadithi, 342.

<sup>4</sup> Kurani me përkthim dhe komentim, Sherif Ahmeti, suretu, El Isra, 23-24.

<sup>5</sup> Imam Nevevi "Rijadus-Salihin" Prishtinë, fq.139, hadithin e transmeton Muslimi, hadithi 322.



*mosrespektimi i prindërve. Zoti i ndëshkon këta njerëz në këtë botë para botës tjetër.”*<sup>6</sup>

5. Të shtohen fatkeqësitë dhe vuajtjet. Pejgamberi a.s. në një hadith na tregon për një njeri i quajtur Xhurejxh, nga çifutët e hershëm, ishte nga njerëzit e mirë dhe që e adhuronte Zotin e Madhërishëm shumë. Një ditë tek sa falej, e thërret nëna, por ai nuk i përgjigjet dhe vazhdon të falet. Kjo ndodh edhe dy ditët tjera në vazhdim. Ditën e tretë, kur nëna e tij shikon që ai nuk përgjigjet, thotë. O Zot, mos ia merr shpirtin derisa ta sprovozh me një grua të keqe.

Pa kaluar shumë kohë një grua e përdalë e akuzon Xhurejxhin për imoralitet.

Më pas, Zoti i Madhërueshëm e shpëton atë nga kjo akuzë me një mrekulli, por ajo që na intereson, është se Zoti ia pranoi nënës lutjen e saj edhe pse i biri ishte duke u falur.<sup>7</sup> Vetëm që nuk ju përgjigj tek sa falej, i ndodhi gjithë ajo fatkeqësi.

Kurse sot kemi të rinj dhe të reja që qëllimisht e fyejnë nënën apo babanë, me qëllim që t'i shohin shokët dhe shoqet dhe që të tregojnë se ata nuk varen nga askush tani. Një rol të madh në mosrespektimin e prindërve sot luan dhe televizori, filmat e të cilit tregojnë se pavarësia e një të riu është kur nuk u bindet dhe nuk respekton prindërit.

6. Nuk do të mundesh që të shqiptosh shehadetin, në çastet e vdekjes. Alkameja, një nga shokët e Profetit a.s., kur i erdhi vdekja, nuk e shqiptonte dot shahadetin. Shqiptonte çdo fjalë tjetër përveç shahadetit. Të pranishmit nxituan për te Profeti a.s. dhe i treguan gjendjen e tij. Profeti a.s. i pyeti: - *“A e ka nënën gjallë ?”* - Po, i thanë. Profeti a.s. shkoi te nëna e tij dhe e pyeti: - *“A ka ndodhur ndonjë gjë jo e mirë mes teje dhe djalit tënd?”* - Po, o i Dërguari i Allahut, - i tha ajo, fëmijëve dhe gruas së tij i jepte fruta të mira, kurse mua më jepte çka tepronte.

Me qëllimin që të zbusë zemrën e nënës, Profeti a.s. u tha shokëve: - *“Ndizni një zjarr dhe hidheni Alkamen të digjet brenda”* - Kur nëna dëgjoi këtë, thërriti: - Mos e bëj, o i Dërguari i Zotit se e kam falur Alkamen.

Në ato çaste Alkame e shqiptoi shehadetin dhe vdiq.

Nëse prindërit kanë vdekur të zemëruar ndaj teje dhe ti nuk ke mundësi t'i kërkosh falje dhe t'i respektosh, pendohu dhe dhuroju punë të mira pas vdekjes.

Jep sadaka për ta, kryeje haxhin ose umren për ta, ndihmo të varfrit dhe mbaji lidhjet me të afërmit e tyre.

7. Nëse do të lutej prindi kundër teje, do t'i pranohet lutja. Profeti a.s. thotë:

*“Tre lloj njerëzve nuk mund që të mos u pranohet lutja ... dhe lutja e prindërit për fëmijën e tij”*.<sup>8</sup>

### **Pasojat e mosrespektimit të prindërve, të cilat do t'i vuash në botën tjetër**

Punët dhe veprimet e kësaj bote, myslimani i ndërlidh edhe me botën tjetër. Çdo gjë që vepron ai, ato vepra padyshim se do të shpërblehen nëse kanë qenë të mira, por edhe do të ndëshkohet, nëse ato janë të liga. Andaj, si pasojë e mosrespektimit të prindërve në botën tjetër ai do të dënohet:

1. Nuk do të shohë drejt teje Zoti i Madhëruar, ditën e kijametit. Profeti a.s. thotë:  
*“Tre lloj njerëzish nuk do t'i shohë Zoti, ditën e Kijametit, nuk do t'i pastrojë nga gjynahet dhe për ta do të ketë ndëshkim të dhimbshëm. Ai që nuk ka respektuar prindërit, një grua që sillej si burrë dhe brinari” (ai që nuk e ka gruan besnike dhe nuk e ndalon nga ajo që vepron).*
2. Nuk të pranohen punët e mira që ke vepruar. Shkoi një njeri te Pejgamberi a.s. dhe e pyeti. O i dërguari i Zotit, nëse fali namazin, jap zekatin dhe agjëroj ramazanin, a do të mi pranojë Zoti këto?

<sup>6</sup> Ibid, fq.141.

<sup>7</sup> www.buhariu.com, transmeton Ebu Hurejra, hadithi 1432.

<sup>8</sup> Ibid.

*“Ti pranon i tha Profeti a.s. dhe ti do të jesh me profetët, shehidët dhe njerëzit e mirë, veçse nëse nuk ke respektuar prindërit dhe ke prerë lidhjet me të afërmit.”<sup>9</sup>*

3. Do të vonohet hyrja jote në xhenet derisa të hyjnë të gjithë. Profeti a.s. thotë:

*“Nuk do të hyjë në xhenet asnjë mosrespektues i prindërve, derisa të gjykohen të gjithë krijesat”.*

### **Veçoritë e mosrespektimit të prindërve**

Dijetarët islamë kanë numëruar me dhjetëra veçori, të cilat konsiderohen mosrespektim i prindërve që njeriun e zhytin në gjynahe. Prej tyre do t’i përmend disa:

- Nëse e bën punën që prindërit e tij i shtyn të qajnë.

- Nëse i qorton ata dhe sillesh në mënyrë të vrazhdë me ta. Ka thënë Allahu xh.sh. në Kur’anin famëlartë:

*“...dhe mos i qorto (mos u sill vrazhdë me ta), po thuaju fjalë të buta dhe të mira”<sup>10</sup>.*

- Nëse nëna apo babai i thotë djalit të vet: O djalë bane këtë, e ai ia kthen: oh moj nënë, na lodhe edhe ti kështu e ashtu.

- Nëse mërrolesh para tyre, apo e prish çehren para tyre

- Kur të flasë babai apo nëna duhet t’i shikosh në sy, e të mos ua kthesh shpinën.

Transmeton Urvete bin Zubejr ka thënë: “Ai fëmijë që e tërheq babanë për këmishë, apo e tërheq nënën për fustani dhe i thotë ec këndeje e ec andej, është fëmijë që nuk i respekton prindërit e tij”.

Transmeton Omeri r.a. kur e kanë pyetur: si është sjellë djali yt me ty? Thotë Omeri r.a: natën kur kemi ecur, ka ecur përpara, e ka ruajtur babanë e vet, ka ecur ndonjëherë edhe mbrapa, djathtas, majtas. Kurrë djali im nuk ka hipur në katin e dytë, s’ka pranuar të jetë mbi kokën time assesi.

- Është e ndaluar ta kritikosh ushqimin. Pejgamberi a.s. ka qenë ai i cili kur i ka pëlqyer ushqimi ka ngrënë, e nëse nuk i ka pëlqyer ka thënë: Allahu bereqet ju dhashtë dhe nuk ka ngrënë, por s’ka thënë se ushqimi nuk po bëka. Ka ditur ta respektojë ushqimin, ka ditur ta respektojë bereqetin. E nëse këtë ia thua nënës, kjo është shenjë mosrespekti ndaj saj.

- Të mos urdhërohet nëna duke i thënë; oj nënë, dil bëje këtë apo atë punë.

Assesi fëmijët nuk guxojnë t’i thonë nënës bëje këtë apo bëje atë, vetëm nëse ajo e bën këtë vullnetarisht.

- Prej veçorive të mosrespektimit të prindërve është: që dikush kur të gradohet me ndonjë post, bëhet deputet, bëhet ministër etj: i vjen turp t’i thuhet se filani është babai im, i vjen turp t’i thuhet se filanja është nëna ime.

- T’i ofendosh apo mallkosh ata, është një prej mëkateve të mëdha.

- Të ngresh dorë ndaj tyre, të ngresh zërin ndaj tyre apo t’i dërgosh ata në shtëpi të pleqve dhe të mos interesohesh për ta.

Në fund e lusim Zotin xh.sh. të na bëjë prej atyre që i respektojmë prindërit, të na bëjë prej atyre që kujdesemi për ata deri në momentin e fundit, e të mos na bëjë prej atyre që t’i harrojmë të mirat e tyre, dhe të na bëjë ta fitojmë xhenetin përmes respektimit të tyre.

*Përgatitur nga:  
**Burim Bibaj***

<sup>9</sup> Ibid.

<sup>10</sup> Kurani me përkthim dhe komentim, Sherif Ahmeti, suretu, El Isra, 23.

## THE CONSEQUENCES OF THE LACK OF RESPECT FOR PARENTS

### (Summary)

Parents are a gift of God to mankind. They are the hope of our lives. The respect for parents brings longevity, success, the fulfillment of prayers, peace and tranquility in life.

Allah has asked human beings to recognize their parents after recognition of Allah Himself.

Your Lord hath decreed that ye worship none but Him and that ye be kind to parents.

## عواقب عدم اطاعة الوالدين

### (خلاصة البحث)

من الفوائد العديدة التي قدمها الله للإنسان في هذه الدنيا هم الآباء والأمهات. انهم المستقبل وأمل حياتنا. احترام الوالدين بسبب الحياة الطويلة و النجاح و تلبية رغبات السلام، والصلاة والطمأنينة في الحياة. الله سبحانه و تعالى قارن اطاعة و احترام الوالدين مع اطاعته ، قال الله تعالى: "وقضى ربك ألا تعبدوا إلا إياه وبالوالدين إحساناً".

## PORTRETE TË SAHABEVE

*Dr. Abdurrahman Rafet el-Basha*

### AMR IBN ASI

**"Amr ibn Asi hyri në Islam pas një të menduari të gjatë dhe meditimi të thellë. Pejgamberi a.s. ka thënë për të: U bënë myslimanë njerëzit, kurse besoi Amr ibn Asi".**

"O Zot i im, na urdhërova e ne bëmë mëkate...

Na ndalove e ne nuk u ndalëm...

Neve nuk na shpëton tjetër veçse mëshira Jote o më i Mëshirshmi mëshirues".

Me këtë lutje përulëse dhe shpresëdhënëse e përshëndeti Amr ibn Asi këtë jetë dhe pranoi vdekjen.

\* \* \*

Jeta e Amr ibn Asit është shumë e pasur dhe e begatë....

Gjatë jetës së tij, ia bashkëngjiti shtetit islam dy shtete të mëdha të botës: Palestinën dhe Egjiptin...

Myslimanëve u la një biografi madhështore, me të cilën e begatoi botën dhe bëri që njerëzit të merren me të për një kohë të gjatë.

\* \* \*

Ky tregim fillon, gjysmë shekulli para hixhretit, kur edhe lindi Amri... e mbaron në vitin dyzet e tre të hixhretit kur ai ndërron jetë...

Babai i tij është, As ibnu Vail, njëri prej njerëzve autoritativë gjatë kohës së injorancës dhe prijës prej prijësve të tyre të njohur. I takon familjes Dhuabe të fisit kurejsh...

Nëna e tij nuk ishte me ndonjë prejardhje të njohur. Ajo ishte një robëreshë.

Për këtë, ata të cilët ia kishin zili Amrit për sukseset e tij, kur ai ishte në postin e valiut, apo kur ishte duke folur nga ndonjë minber, me qëllim provokimi e pyesnin për prejardhjen e nënës së vet.

Kështu me një rast, njëri prej kundërshtarëve të tij e paguan një njeri që ta pyeste për nënën e tij, në momentin kur Amri ishte duke folur nga një minber.

I pranishmi u çua në këmbë dhe tha: Kush është nëna e princit?

Amri e përmajti veten, përdori urtësinë dhe mençurinë e vet dhe iu përgjigj:

Ajo është En-Nabigatu bintu Abdil-lah...

E kishte goditur shigjeta e arabëve në kohën e injorancës dhe është shitur në tregun e Ukadhit..

E bleu Abdullah ibnu Xhud'an...

Pastaj ia dhuroi As ibnu Vailit (do të thotë babait të Amrit).

I ka lindur fëmijë ...

Nëse dikush prej atyre që zilia ia ka brejtur zemrën, të ka premtua ndonjë shpërblim, ti merre atë.

\* \* \*

Myslimanët e Mekës, për t'i ikur persekutimeve të bashkombasëve të tyre, kishin filluar të shpërnguleshin në Abisini. Aty gjetën mbrojtje dhe mbështetje nga mbreti Nexhashiu. Kjo mbështetje, i kishte zemëruar parinë e kurejshëve. Për këtë arsye, vendosën t'i kthenin në Mekë, që t'i torturonin, ashtu siç ata dinin.

Për ta realizuar një qëllim të tillë, ata kishin zgjedhur Amr ibn Asin si përfaqësues të tyre në këtë mision, për shkak të lidhjeve të miqësisë që Amri kishte me Nexhashiun, mbretin e Abisinisë.

Kurejshitët e gatitën Amrin me dhurata të shumta e të çmueshme për t'ia dhënë Nexhashiut dhe parisë fetare.

Amri, u takua me Nexhashiun, në pallatin e tij, dhe pasi që e përshëndeti, e lavdëroi duke i thënë:

Një grup i njerëzve tanë, që kanë mohuar fenë e të parëve të tyre, kanë shpikur një fe të re...Kane gjetur strehim tek ti...Por, ata nuk e kanë pranuar as fenë tuaj.... Paria e kurejshëve më kanë dërgua mua të marrë lejen tuaj për t'i kthyer te populli i tyre, që t'i kthejnë në fenë dhe traditën e të parëve të tyre.

Nexhashiu urdhëroi që të prezantojë dikush nga sahabët. Pyeti se cila ishte feja e tyre, kush ishte Zoti i tyre që i besonin, dhe cili ishte pejgamberi i tyre që po i thërriste në fenë e re?!

Nexhashiu prej sahabëve, dëgjoi gjëra, të cilat ia qetësuan dhe ia kënaqen zemrën. Mësoi prej parimeve të fesë së tyre gjëra të arsyeshme dhe të dobishme, të cilat e bënë që edhe ai vetë ta admirojë këtë fe.

Refuzoi në mënyrë kategorike, që këta njerëz, t'ia dorëzojë Amr ibn Asit. Ia ktheu të gjitha dhuratat që ia kishte sjellë.

\* \* \*

Kur Amr ibn Asi kishte vendosur të kthehej në Mekë, Nexhashiu iu afrua dhe i tha: Si mund ta lëshosh rastin e Muhamedit o Amr, kur unë e di urtësinë dhe largpamësinë tënde ?!

Betohem në Allahun se ai është i dërguari i Allahut tek ju në veçanti dhe tek të gjithë njerëzit në përgjithësi.

Amri ia ktheu: A ti po thua këtë o mbret?!

Nexhashiu iu përgjigj: Po pasha Allahun... Dëgjomë mua o Amr dhe beso në Muhamedin. Ajo që i është shpallur atij është e vërtetë.

\* \* \*

Amr ibn Asi u largua prej Abisinisë i zvetënuar. U nis për në Mekë pa e ditur se si të veprojë. Fjalët që ia tha Nexhashiu nisën t'ia dridhnin zemrën.

Biseda e tij për Muhamedin dhe me të vërtetën që ai kishte ardhur, e shtynin që sa më parë të takohej me të... Por, kjo nuk ishte shkruar, ky takim u realizua vetëm në vitin e tetë të hixhretit.

Vetëm atëherë, Allahu ia kishte hapur zemrën Amrit për fenë e re. Për këtë kishte marrë rrugën e gjatë për në Medinën e ndritshme, që atje të takohej me të dërguarin e Allahut dhe ta shpallte Islamin para tij.

Në rrugën e tij për në Medinë, u takua me Halid bin Velidin dhe Othman bin Talha. Këta të dy po shkonin aty ku ishte nisur edhe Amri. Ia kishin mësyre aty ku ai ia kishte mësyre edhe Amri..

Amri iu bashkëngjiti atyre dyve dhe vazhduan rrugëtimin së bashku.

Kur arritën te Pejgamberi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, u zotuan të dy, Halid ibnu Velid dhe Othman ibnu Talha...

Pastaj, Pejgamberi a.s., ia shtriu dorën Amrit, i cili e kapi dorën e Pejgamberit a.s...

Pejgamberi a.s. iu drejtua Amrit: "Çka ke o Amr?!"

Amri ia ktheu: Të zotohem o i Dërguari i Allahut, por lute Allahun që të më falen mëkatet e mia të mëparshme.

Pejgamberi a.s. ia ktheu: "Islami dhe hixhreti shlyejnë mëkatet e mëparshme", atëherë u zotua.

Kjo ndodhi ka lënë gjurmë të thellë në jetën e Amr ibn Asit, për të cilën thoshte:

Betohem në Allahun, nuk i kam ngopur sytë e mi së shikuari Pejgamberin a.s., e as nuk jam lodhur duke shikuar fytyrën e tij deri sa kaloi në botën tjetër.

\* \* \*

Pejgamberi a.s., e shikoi Amrin me dritën e pejgamberisë. Dinte për fuqinë e madhe që ai posedonte. Për këtë edhe e caktoi në krye të ushtrisë myslimane në betejën "Dhatu-selasil", edhe pse në ushtri kishte ensarë dhe muhaxhirë. Ky ishte rast unikat në Islam.

\* \* \*

Pas vdekjes së Pejgamberit a.s., dhe ardhjes së Ebu Bekrit halif i myslimanëve, Amr ibn Asi dha një kontribut të rëndësishëm në luftërat kundër renegatëve....

Amr ibn Asi kishte shkuar te fisi benu Amir, dhe atje takohet me prijësin e tyre Kurre bin Hubejra, i cili thotë:

"O Amr, arabët nuk janë të kënaqur me këto të dhëna, që ua keni obliguar atyre, (ka për qëllim zeqatin).

Nëse i lironi prej tyre ata do t'u binden juve .....

Nëse refuzonin ta bëni një gjë të tillë, atëherë ata nuk do t'u binden juve pas sotit...."

Amri i bërtiti prijësit të Amirin e i tha:

Medet për ty!! A ke bërë "kufër" (mohimi i besimit) o Kurre?!....A po na frikëson neve me apostazinë (braktisjen e islamit) e arabëve?!....

Betohem në Allahun se do t'i lidhi kuajt në tendat e nënës tënde.

\* \* \*

Me vdekjen e Ebu Bekrit dhe me kalimin e hilafetit në duar të Omer El-Farukut, Omeri u mbështet në përvojën dhe aftësitë e Amr ibn Asit, të cilat i vuri në shërbim të Islamit dhe myslimanëve.

Nën komandën e tij u çliruan pjesa bregdetare e Palestinës, qytet pas qyteti...

Ngadhënjeu mbi ushtritë romake ushtri pas ushtrie. Pastaj e rrethoi Kuds (Jerusalemin).

Amri mbajti të rrethuar Kuds (Jerusalemin), kiblën e parë të myslimanëve dhe xhaminë e tretë të shenjtë, derisa komandanti i ushtrisë romake Arteboni, i kishte humbur të gjitha shpresat.

Ai u detyruar ta lëshojë qytetin e shenjtë. Kudi (Jerusalemi) iu dorëzua myslimanëve.

Patriku i Jerusalemit dëshiroi që akti i dorëzimit të bëhej në prezencën e halifit të myslimanëve.

Për këtë Amr ibn El-Asi i ishkrualti një letër halifit, Omer ibnul Hattabit, ku e ftonte të merrte pjesë në pranimin e dorëzimit të Kudit (Jerusalemit). Omeri r.a., erdhi dhe nënshkroi dokumentin e pranimit të qytetit.

Kështu, pra Kudi (Jerusalemi) iu kthye myslimanëve në vitin e pesëmbëdhjetë të hixnretit nëpërmjet duarve të Amr ibn Asit, Allahu qoftë i kënaqur me të.

Kur para Omer ibnul Hatabit, përmendej rrethimi i Kudit dhe shkathtësitë që Amr ibn Asi kishte treguar në atë rast, thoshte:

Kemi hedhur Artebonin e romakëve me Artebonin e arabëve.

Amri vazhdoi fitoret e tij me çlirimin e Egjiptit, duke ia bashkangjitur shtetit islam atë vend të çmueshëm.

Me këtë ai hapi para ushtrive myslimane dyert e Afrikës, vendeve të Magrebit e më vonë edhe të Spanjës.

\* \* \*

Nuk janë vetëm këto meritat e Amr ibn El-Asit r.a.. Amri ishte njëri prej dinakëve dhe gjenive të rrallë arabë.

Njëra prej dinakërive dhe gjenialiteteve të tij, shihet me rastin e çlirimit të Egjiptit. Vazhdimisht kërkonte prej Omer ibnul Hatabit ta çlirojë Egjiptin derisa më në fund mori pëlqimin e tij.

Për këtë ekspeditë ushtarake angazhoi katër mijë ushtarë.

Amri u nis me ushtrinë e tij, pa hasur në ndonjë rezistencë. Pas pak kohe, Othman bin Affani, hyn tek Omer ibnul Hattabi r.a. dhe i thotë:

O udhëheqës i myslimanëve, Amri është njeri i guximshëm që nuk i priton rreziqeve...

Ai e donë pushtetin .....

Frikësohem, se ka hyrë në Egjipt i papërgatitur, si nga aspekti i numrit të ushtarëve dhe të armatimit. Kam frikë se myslimanët do t'i ekspozohen rrezikut.

Omeri u frikua për lejimin e dhënë për çlirimin e Egjiptit, andaj e dërgoi një lajmëtar me një letër lidhur me këtë çështje.

\* \* \*

Lajmëtari arriti ushtrinë myslimane në Refah, në Palestinë. Kur Amri mori vesh për ardhjen e lajmëtarit nga ana e Omer ibnul Hatabit dhe pa se ai kishte me vete një letër, u angazhua me disa punë, me

qëllim që të vonohej në pranimin e tij, nga frika e përmbajtjes së letrës.

Vazhdoi me angazhime derisa ushtria kishte kaluar në fshatin e Arishit në Egjipt.

Pranoi lajmëtarin, pranoi letrën që kishte sjellë me vete nga halifi i myslimanëve. E hapi letrën në të cilën shkruante:

*"Nëse shkresa ime të mbërrin para se të hysh në tokën e Egjiptit, kthehu në bazën tënde..."*

*Por, nëse ke hyrë, atëherë vazhdo më tutje".*

Amri i thirri myslimanët. Ua lexoi shkresën e Omer El-Farukut, dhe tha:

"A nuk e dini se ne jemi në tokën e Egjiptit?!"

Ata iu përgjigjën njëzëri: Po gjithsesi.

Atëherë të vazhdojmë me begatinë e Allahut dhe me ndihmën e Tij.

Kështu deshi Allahu i madhërishëm, që Egjipti të çlirohet nën komandën e tij.

\* \* \*

Prej kurioziteteve të urtësisë dhe dinakërisë së tij është edhe kjo se në kohën kur po mbante të rrethuar njërin prej kështjellave të Egjiptit, patriku romak kishte dërguar lajmëtarin e tij, ku kërkonte prej komandantit të ushtrisë myslimane ta dërgojë një përfaqësues për të biseduar me të.

Disa prej myslimanëve shprehën gatishmërinë për të shkuar.

Por, Amri tha: unë do të jem i dërguar i popullit tim.

Shkoi te patriku. Hyri në kështjellën e tij, sikur ai ishte i dërguari nga ana e komandantit të myslimanëve.

\* \* \*

Patriku romak u takua me Amrin, duke mos ditur se kush ishte ai.

U zhvillua një dialog në mes dy palëve. Aty shihej gjenialiteti, urtësia dhe përvoja e Amrit. Patriku romak vendosi ta tradhtonte... Para

se të dilte ia dha një dhuratë të çmuar. Në ndërkohë urdhëroi rojat e pallatit ta vrisnin para se ai ta kalonte llogorin.

Amri në sytë e rojtarëve pa diçka që ngjalli dyshimin tek ai. U kthye përsëri dhe i tha patrikut:

Dhuratën të cilën më fale - zotëri - nuk mjafton për të gjithë kushërinjtë e mi. A më lejoni që nesër të vijë me dhjetë veta që të marrin nga dhuratat tuaja të çmueshme, ashtu siç mora unë?

Patriku u gëzua shumë nga ky propozim. Dëshiroi të mbyste dhjetë veta e jo vetëm një.

Rojave u dha shenjë ta linin të lirë.

Kështu, Amri shpëtoi.

Pasi u çlirua Egjipti dhe iu dorëzua myslimanëve. Patriku romak u takua me Amr ibn Asin, i cili e pyeti me habi:

A ti je ai?!

Amri i tha: Po, dhe e di se çfarë tradhtie më kishe përgatitur.

\* \* \*

*Dr. Abdurrahman Rafet el-Basha*

## AMR IBN AL AS

### (Summary)

"Amr ibn al As converted to Islam after long and careful consideration. The Prophet said about Amr: "The people have become Muslims, but Amr ibn al As has become a believer"

"O God, you ordered us and yet we sinned...

You stopped us and yet we did not stop...

Nothing can save us but your mercy, O the most merciful of all".

With this humble and promissory prayer Amr ibn al As said goodbye to life and greeted death.

*عبد الرحمن رأفت الباشا*

## عمرو بن العاصي

### (خلاصة البحث)

دخل الإسلام بعد تفكير طويل وعميق، وقال النبي صلى الله عليه و سلم عنه:

لقد دخل الاسلام أناس و آمن عمرو بن العاصي ."

" يا رب، امرتنا بان لا نرتكب أخطاء و نحن فعلنا وقفنا و لم نتوقف ...."

"لا يمكن ان ينقذنا الا رحمتك يا أرحم الراحمين ."

مع هذه الدعاء المتواضع ودع عمرو بن العاص هذه الحياة وقبل الموت.



## NGA E KALUARA JONË

**Qerim Bajrami\***

### Boshnjaket duke hedhur armët dhe uniformën e ushtrisë serbe në Reçan, prill 1999 “LËVIZJA E NËNAVE” 13 VJET PAS

**Është e vërtetë se nënat, faktikisht gratë, e kanë pasur rolin vendimtar në kthimin e armëve, përkatësisht demobilizimin e më të dashurve të tyre, posaçërisht në bllokadën e rrugës rajonale Reçan-Prizren, me qëllim që assesi të mos lejohej transferimi i të mobilizuarve me kamionë në pozita të reja, në frontin drejt kufirit Kosovë-Shqipëri.**

Ndonëse për “gjuajtjen” boshnjake, përkatësisht për kthimin e armëve dhe të uniformave të “ushtrisë së lavdishme serbe” në Reçan, përkatësisht në Zhupë afër Prizrenit, gjatë ditëve jashtëzakonisht të vështira të prillit të vitit 1999, kemi shkruar shpesh, më së shumti në revistën boshnjake “Selam”, kurrë nuk është e tepërt që ta kujtojmë atë akt spontan, por guximtar nga pjesa më e madhe e boshnjakëve të mobilizuar me forcë nga fshatrat e shumta afër Prizrenit.

Këtë akt, veterani ynë në kreun e jetës politike të Kosovës komuniste dhe RSFJ-së, z. Ilaz Kurteshi, do ta emëronte “Lëvizje e nënave”, në intervistën dhënë autorit të këtyre rreshtave, në revistën prizrenase “Selam”, në numrin që doli pak pas hyrjes së trupave të

NATO-s në Kosovë. (Duke e vazhduar kontinuitetin e ndërprerë nga lufta).

Adzo Iljaz këtë e kishte dhënë në kontekstin e një përgjigjeje më të gjerë dhe rekomandimit që “... politika e re boshnjake në Kosovë do të duhej të niste nga ajo - lëvizja e nënave”.

Është e vërtetë se nënat, faktikisht gratë, e kanë pasur rolin vendimtar në kthimin e armëve, përkatësisht demobilizimin e më të dashurve të tyre, posaçërisht në bllokadën e rrugës rajonale Reçan-Prizren, me qëllim që assesi të mos lejohej transferimi i të mobilizuarve me kamionë në pozita të reja, në frontin drejt kufirit Kosovë-Shqipëri.

Drama, që kishte zgjatur disa ditë nga pjesa e fundit e prillit, kishte përfunduar jo vetëm me mosshkuarjen në “front”, por edhe me kthimin e armëve dhe uniformave nga pjesa më e madhe e boshnjakëve të mobilizuar, që ishin mbledhur në Reçan. Fatmirësisht, nuk ishte vërtetësuar kërcënimi se oficerët dhe ushtarët e pranishëm serbë do të shtinin mbi të padëgjueshmit, për të cilën gjë thuhej se pritej urdhri i komandantit të kazermës prizrenase.

Pas këtij akti kishte pasur largim masiv të banorëve dhe braktisje të fshatrave, përmes majave të Sharrit, për të shkuar si refugjatë në Maqedoni, derisa pjesëtarët tjerë të këtij populli kishin kërkuar edhe mënyra të tjera të largohen nga Kosova. Një pjesë e madhe, të themi, kishte shkuar përmes Hungarisë drejt shteteve të Perëndimit, derisa ata nga rajoni i Pejës më së shumti e kanë braktisur Kosovën duke shkuar në Mal të Zi... Shumë prej tyre, pas këtij largimi kishin mbetur në ato shtete me statusin e refugjatit, duke ia dalë vetëm pas shumë vjetësh që ta rregullonin lejeqëndrimin në shtetet evropiane, SHBA apo Australi.

Për shkak të kthimit të armëve dhe të uniformave, njerëzit në këto fshatra ishin të përndjekur dhe një numër gjithnjë e më i madh është dashur të largohej nga Kosova. Edhe ashtu në Prizren gjatë pjesës së parë të prillit kishte pasur panik të madh, pasi që policia serbe dhe ushtria merrte me dhunë secilin qytetar të moshës rinore të secilës përkatësi etnike, me përjashtim të asaj serbe, duke i detyruar të hapnin istikame në kodrat përreth. Ata njerëz ishin dhe mbetën viktimë në ve-

te. Të mos flasim tani për zhvendosjen e dhunshme të gati një milion shqiptarëve drejt Shqipërisë dhe shteteve përreth (Maqedoni dhe Mal të Zi), menjëherë pasi filluan bombardimet. Pas kthimit të armëve dhe uniformave në Reçan, një pasiguri shtesë mbretëronte në këto fshatra, pasi që pas këtij akti kolektiv boshnjak dhe kthimit nëpër shtëpi të të mobilizuarve, policia serbe dhe ushtria filluan përndjekjen e të (de)-mobilizuarve.

### **E... secili prej nesh ka rrëfimin e vet të luftës**

Banorë të shumtë të Lubinjës, Eperme dhe Poshtme, Manastirit, Pllajnikut, Reçanit, Lokvicës, Nebregosit, Jabllanicës dhe Pouskaras... iknin me fëmijë në krahë dhe me më të afërmit e tyre përmes majave pjesërisht me borë të Sharrit drejt fshatrave më të afërme në Maqedoni. Vetëm një numër i vogël i tyre e pritën përfundimin e bombardimeve dhe kapitullimin serb, për t'u kthyer menjëherë në shtëpitë e tyre. Edhe banorët e Mushnikovës u shndërruan në refugjatë, duke kaluar malin e Sharrit, ashtu si edhe ata të Gornjeselës, derisa një pjesë e tyre përdori rrugën e Prevallës për të kaluar në anën maqedonase... Të qarat e fëmijëve, lodhja e tepërt, etja, uria... shkaktonin tek njerëzit habi rreth forcës dhe vullnetit të të parëve tanë, të cilët nëpër dimër përdornin këto shtigje, duke ngarkuar në shpinë thasët me drithëra, për t'i sjellë nga Tetova dhe fshatrat përreth nga ajo anë e Sharrit.

Edhe sot, 13 vjet më pas, secili prej këtyre njerëzve do të mund ta rrëfente tregimin e vet të luftës, mbase edhe me të gjitha detajet, apo edhe të shkruante shumë më tepër sesa këta rreshta të mi modestë.

Edhe mua më kujtohen të gjitha dhe i mbaj në mend edhe informatat e para rreth kësaj kryengritjeje (me marrëveshje) dhe kthimit të armëve, nga shumica e banorëve tanë të Zhupës dhe ata të Prizrenit, të cilët, përballë telasheve mbase edhe u detyruan që të vepronin kolektivisht, gjë e cila nuk është karakteristikë me të cilën mund të mburremi ne si popull gjatë kohëve të mira... Edhe para këtij akti - gjuajtjes së

armëve, natyrisht se një numër i madh i ne boshnjakëve kishim qenë jashtë.

Nga ana tjetër, ashtu si edhe shumica e shqiptarëve nga fshatrat e Kosovës, edhe popullsia e përgjithshme e fshatit Struzhja në Zhupe ishte dëbuar në mënyrë shtazarake nga formacionet serbe drejt Shqipërisë, në fillim të bombardimeve të NATO-s. Fat të njëjtë patën edhe disa familje nga fshati Mushnikovë.

Gjatë fundit të prillit të atij viti, si refugjatë në Maqedoni, pata përgatitur një tekst më të gjatë për gazetën sarajevase "Preporod", me titullin "Bosnja u përsërit të Kosovë" (derisa esenca e një teksti tim të publikuar më parë në atë gazetë kishte të bënte me lutjen Zotit që në Kosovë të mos përsëritej ajo që ndodhi në Bosnjë) me qëllimin që ta dërgoja përmes postës.

Në kapitullin e fundit të tekstit të përgatitur tashmë për dërgim e shtova informatën dhe disa detaje rreth gjuajtjes së armëve, të cilat arrita t'i mblidhja nga disa refugjatë tanë boshnjakë që kalonin nëpër Hungari, pasi që nuk kishim kurrfarë kontaktesh të tjera me njerëzit në Kosovë, me përjashtim të të dhënave të marra nga rrjetet e huaja televizive. Mendoj se kjo ishte edhe informata e parë e publikuar rreth kësaj ngjarjeje në Zhupë, derisa pas luftës dëgjova se edhe në televizionin shqiptar ishte dhënë lajmi "se (boshnjakët) 'tërbeshët' ia kishin kthyer Milosheviqit uniformën dhe armët".

Vëllai im, Bajrush, që së bashku me mua ishte familjarisht refugjat në Hungari, u nis i vetëm për në Sarajevë përmes Budapestit, duke takuar atje Xhezair Muratin, që sapo kishte ardhur nga Kosova. Ai i kishte treguar shkurtimisht se e kishin arrestuar në Prizren dhe e kishin marrë në pyetje pas "kthimit të armëve". Ai po ashtu i kishte treguar se ia kishin përmendur edhe disa aktivistë të tjerë boshnjakë dhe... "e kanë përmendur edhe haxhinë" (duke menduar në mua)... Por, pothuajse pas kthimit, Bajrush nuk e shihte të domosdoshme që menjëherë të ma tregonte një gjë të tillë, "për të mos më frikësuar"... Fatkeqësisht, në vend se të më "gjenin" mua "të kërkuarin", që edhe ashtu kisha dalë jashtë vendit, dy-tre policë të uniformuar serbë e kishin bastisur shtëpinë tonë të përbashkët dhe e kishin arrestuar vëllanë

tim, Faikun, të vetmin që kishte mbetur në shtëpinë tonë në Prizren, me “arsyetimin”: ... eja edhe ti me ne në stacion, pasi që Qerimi... nuk është këtu”. Kjo ngjarje atë e kishte tmerruar, por, fatmirësisht, siç tregon vetë, kishte shpëtuar pa u rrahur... E kështu me radhë...

Ky natyrisht është vetëm një detaj - personal - tashmë, falë Zotit, mbase edhe i parëndësishëm për opinionin e gjerë... Është i parëndësishëm në kontekstin e gjerë, posaçërisht nëse krahasohet me tragjeditë e shumta që ndodhën nëpër Kosovë gjatë atyre tre muajve, apo në muajt e mëparshëm. Mbase, këtë gjë më së miri e ilustron një konstatim që ma kishte dhënë një prizrenas pas kthimit tim në Kosovë dhe pasi që ai kishte treguar vuajtjet, duke më thënë “ta lëmë më këtë muhabet... pasi që shihet se secili prej nesh e ka rrëfimin e vet të gjatë të luftës”.

Po... pikërisht ashtu... Secili, mu secili kosovar, e ka rrëfimin e vet të luftës... Shumica e tyre, siç thashë, e kanë shumë të rëndë. Disa qytetarë të përkatësisë shqiptare kanë pësuar tragjedi që kurrë nuk do t’i harrojnë, pasi që kanë humbur më të dashurit e tyre... Tek të tjerët ai rrëfim, në të cilin e llogaris edhe veten, ka dalë të jetë më i lehtë.

### **Mosinteresimi i medieve të tjera - fat i popujve të vegjël?**

Megjithatë, për shkak të kësaj e përmenda tërë këtë gjë, pasi që njëmend, secili prej nesh e ka rrëfimin e vet të luftës, të cilin do të mund ta tregonte sërish, pasi që është ende i freskët.

Është e vërtetë se në mesin tonë ka të tillë që do të donin që “rrëfimi” i tyre i luftës nga viti 1999, e posaçërisht ai “i paraluftës”, të harrohej sa më shpejt... posaçërisht nëse ai “rrëfim” nuk është edhe aq i besueshëm tani. (Arsyeja është që mu gjatë këtyre ditëve ata kanë punë më të “mençura”, të themi rreth anëtarësimit në “borde organizative” të disa piknikëve masivë nëpër livadhe. Po ashtu, për hir të së vërtetës rreth rrëfimeve të luftës duhet të themi se pjesëtarët e popullit boshnjak në Kosovë kanë pasur edhe rrëfime të hidhura të pasluftës).

Por, me këtë rast nuk do të flasim rreth kësaj dhe as për rrëfimet e paraluftës... ashtu si edhe për anëtarët më të rinj të bordeve organiza-

tive të “piknikëve”... Arsyeja është të mos ia prishim poentën këtij rrëfimi tonë...

Dhe, rrëfimi ynë për kthimin apo gjuajtjen e armëve, në prill të vitit 1999, definitivisht NUK është treguar mjaft, pa marrë parasysh se ne në tekstet në “Selam”, posaçërisht në disa vazhdimet të punës së shkruar nga Ramiz (Imer) Shaipi, nga Lubinja e Epërme, jemi munduar që atë akt dhe aktorët e tij të mos lihen në harresë. Harresën, e cila është fat i popujve të vegjël, sipas një fraze të njohur.

Në të vërtetë, kur shpërtheu konflikti i armatosur në Maqedoni, më 2001, dhe kur banorët e tërë fshatit Vejsa nga ana e Sharrit ikën në Lubinjën e Poshtme nga ana tjetër (e jonë), vetëm pas një reportazhi të mirë të agjencisë së huaj - AP, me titullin “Boshnjakët ua kthejnë borxhin shqiptarëve”, përkatësisht përcjelljes së tekstit komplet në gazetën “Koha Ditore”, pak më shumë vëmendje iu kushtua edhe nga mediet tjera shqiptare mikpritjes së njerëzve tanë.

Unë, me atë rast, në njërën prej fjalëve hyrëse në gazetën “Selam”, mosraportimin e atij humanizmi boshnjak e pata lidhur me kontekstin e një heshtjeje të ngjashme të aktit të mëhershëm të kthimit të armëve në prill të vitit 1999, me pyetjen se a janë aktet e tilla të rezervuara vetëm për popujt më të mëdhenj nga ana e popullatës tonë të vogël në Kosovë. Si do të mund të sqarohej ndryshe mosinteresimi i atyre që ndikojnë në plasimin e informatave dhe u japin kah rrjedhave shoqërore?

### **Shënimi është përkujtuesi më i mirë**

Megjithatë, paradoks shtesë është dhe mbetet fakti se tek ne është gdhendur mendimi - se për një gjë të tillë nuk është e nevojshme të flitet shumë (publikisht) - ja... ka ndodhur, çfarë të bëhet, le të bëhet si të bëhet - dhe ashtu. Apo, në përdorim mund të vihet edhe një anë shpirtërore, që ka të bëjë me merhametin mysliman të tipit: “mjafton që Zoti ta dijë”.... E vërteta është se Zoti gjithnjë i di të gjitha, por po ashtu është fakt se njerëzit harrojnë dhe ka shumë të tillë tek të cilët ajo harresë është e qëllimshme.

Për këtë arsye është e nevojshme që njerëzit të mos lejohen të harrojnë dhe përkujtuesi më i mirë janë shënimet.

Për këtë arsye, ky rob i Zotit ende vazhdon t'ia kujtojë vetes, popullit të vet dhe të gjithë të tjerëve një akt të madh të popullit të vogël - kthimin e armëve dhe të uniformave ushtrisë së dhunshme dhe kriminale serbe, nga fundi i prillit të vitit 1999 në fshatin Reçan, mu në valën e luftës në Kosovë dhe bombardimeve të NATO-s mbi caqet ushtarake serbe.

Ky akt doli të mos ishte pasojë e politikës së organizuar atëbotë apo ndonjë aksioni tjetër të aktivistëve boshnjakë. Fakti se disa prej tyre pak para ose pas rebelimit ishin arrestuar apo “kërkuar” nga policia dhe Sigurimi Shtetëror, kishte qenë vetëm domosdoshmëri që ndonjë keqbërës nga radhët e policisë serbe apo politikës lokale të regjimit të arsyetohej para dikujt se e ka hetuar dikë apo diçka, në mënyrë që individëve në mesin e boshnjakëve t’iu vishej përgjegjësia për “organizimin” e këtij demobilizimi.

Ky aksion spontan dhe vullnetar në Zhupë, kjo “lëvizje e nënave”, pra, krahas frikës së arsyeshme të të mobilizuarve, më të afërmve të tyre dhe tërë popullit prej rezultatit të mundshëm të zhvendosjes nga shtëpitë në ndonjë vatër të luftës dhe frikës shtesë nga vrasja e të mobilizuarve, e kishte krijuar një vendosmëri të popullit që të këmbëngulte rreth mosshkuarjes në front, pa marrë parasysh rreziqet.

Pa pasur pretendime rreth ndonjë analize më të thellë dhe sqarimit, me këtë rast vetëm do të themi se kjo vendosmëri kishte rrjedhur nga ndjenja e humanitetit, prirjes për mosdhunë dhe drejtësi të popullit boshnjak në Zhupë - që të mos marrin pjesë në diçka që është e padrejtë, e dhunshme dhe kriminale dhe që është e drejtuar kundër shqiptarëve në Kosovë e më gjerë. Vetë ky akt i kthimit të armëve, sipas kësaj, është rrjedhë e trashëgimisë popullore, që ndodhet në thellësi të shpirtit të tij. Ai si i tillë është vetëm një nga aktet e tilla të ngjashme në historinë e kësaj popullate.

### **Akt të cilin nuk e “kënduan” as shkrimtarët e as këngëtarët... dhe që as nuk e lartësuan mjaft politikanët**

Fatkeqësisht, kthimi i atëhershëm i armëve dhe uniformave nga boshnjakët mund të thuhet se nuk është kënduar nga këngëtarët, nuk është shkruar (mjaft) nga shkrimtarët, derisa politikanët nuk e kishin lartësuar mjaft, në mënyrë që një gjë e tillë të shënohej në rajonin e Zhupas e edhe më gjerë.

Po që se e kërkojmë arsyen, le ta ofrojmë secili prej nesh përgjigjen e vet, ashtu siç e ka secili rrëfimin e vet të luftës.

Është e vërtetë se ka pasur premtime që dita e kthimit të armëve dhe uniformave të shpallej dita e Zhupas dhe se ajo ditë do të shënohej rregullisht në të ardhmen.

Në këtë aspekt, propozimi im shtesë është që krahas shpalljes së ditës së Zhupës, në Reçan të ngrihet përmendore (ndonjë çezmë, për shembull) me mbishkrimin që do të jetë dëshmi e shkurtër dhe e qartë e një akti guximtar të një gjenerate, akti që ka qenë një prej hapave që përcaktuan të ardhmen dhe mbijetesën e bashkësisë boshnjake, si në Zhupë, ashtu edhe Kosovë. Nuk mundemi as ta paramendojmë se çfarë do të ndodhte para ose pas luftës, po të niseshin boshnjakët e mobilizuar drejt fronteve, duke luftuar krah për krah me ushtrinë serbe.

Në emër të një akti të tillë të madh (për mundësitë tona) të popullit tonë, në emër të së vërtetës, nuk mund të lejojmë që ai të harrohet. Posaçërisht pasi që ekzistojnë përpjekje për relativizimin e të gjithave dhe barazimin e gjithçkaje. Dhe, nuk kanë qenë të gjithë të njëjtë, ashtu siç nuk janë të njëjta as rrëfimet tona të paraluftës dhe të luftës.

\* Autori është zëvendësministër i Ministrisë së Diasporës në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe nënkryetar i Këshillit Konsultativ për Komunitetet. Ky shkrim është botuar në portalin boshnjak Bosnjaci.net, ndërsa publikohet në “Edukata Islame” me lejen e autorit)

## INTERVISTË

*Intervistë me Hajrullah ef. Hoxhën, veteran i publicistikës islame në Kosovë*

## **“EDUKATA ISLAME” ME SUKSES I KA PËRMBUSHUR E TEJKBALUAR OBJEKTIVAT DHE PRITJET E THEMELUESVE DHE BOTUESVE TË SAJ**

*Hajrullah efendi Hoxha, është njëri ndër veteranët e publicistikës islame në gjuhën shqipe në Kosovë, që së bashku me H. Sherif ef. Ahmetin, janë nismëtarët dhe bartësit kryesorë të fillimit të botimeve të literaturës dhe periodikut me tematikë islame në gjuhën shqipe.*

*Për numrin e 100-të të “Edukatës Islame” me Hajrullah efendi Hoxhën biseduam ekskluzivisht për rrugën, sukseset, vështirësitë e sfidat që ka njohur “Edukata Islame” për këto 4 dekada, në këta 100 numra, me të cilët ka bërë historinë e fjalës së shkruar islame te ne.*

### **Pak biografi për Hajrullah Hoxhën**

Hajrullah Hoxha u lind në vitin 1939 në fshatin Korroticë të Epërme, komuna e Drenasit. Shkollën fillore katërvjeçare e kreu në Korroticë të Ulët, ndërsa gjimnazin e ulët në Komoran. Medresenë e ulët e kreu në Prishtinë, kurse të mesmen dhe kualifikimin e lartë profesional në Sarajevë. Në vitin 1964 u punësua imam në Deçan, kurse në vitin 1969 u transferua për imam dhe referent fetaro-arsimor në Mitrovicë. Në vitin 1979 u emërua administrator në Kryesinë e Shoqatës së



*Hajrullah efendi Hoxha*

Ylemave në Prishtinë, ku punoi deri në vitin 1998, pastaj ai kaloi në Kryesinë e Bashkësisë Islame dhe u emërua sekretar i Redaksisë për Botime islame. Këtë detyrë ai e kreu deri në vitin 2005, kur edhe u pensionua. Hajrullah Hoxha është autor i “Takvimit” dhe bashkëpunëtor i rregullt i revistës “Edukata Islame”, në të cilën, që nga themelimi i saj e deri më sot, kontribuoi me më së 60 punime. Diku 40 prej tyre janë nga fusha e historisë islame, përkatësisht vazhdimet e punimit me titull: “Muhamedi a.s. dhe përhapja e fesë islame”. Ndërsa, të tjerat janë përkthime me përmbajtje të

ndryshme nga gjuha boshnjake dhe arabe. Ai disa kohë ka qenë korrektues i “Edukatës Islame”, një mandat katërvjeçar kryeredaktor i saj, ndërsa nga numri 55/1992 e deri 100/2012 sekretar i Redaksisë, përveç në “Edukatën Islame”, ai ka të botuar artikuj të shumtë në “Takvim” dhe në revistën “Dituria Islame”. Jeton dhe vepron në Prishtinë.

**Edukata Islame:** *Hoxhë efendi, ju jeni ndër të paktë themeluesit e publicistikës islame te ne, a na thoni në çfarë rrethanash është vendosur për themelimin dhe botimin e revistës “Edukata Islame”, kur dihet që atë kohë në pushtet ishin komunistët?*

**Hajrullah efendi Hoxha:** Në skenën politike të Jugosllavisë, pas rënies së regjimit famëkeq të Rankoviçit, i cili që nga koha e Luftës e Dytë Botërore, duke ushtruar dhunë sistematike mbi popullatën shqiptare pengoi zhvillimin dhe përparimin normal të tyre në aspektin kombëtar dhe fetar, ndodhën ndryshime të mëdha. Në këto rrethana të krijuara në prag të viteve të 70-ta të shekullit të kaluar, populli shqiptar në Kosovë dhe në viset tjera, përherë të parë filloi ta ndjejë veten

të lirë dhe të ketë të drejtë për t'u ankuar publikisht në tubime zyrtare për të gjitha padrejtësitë që i ishin bërë dhe t'i gjykojë bartësit e tyre me emër dhe mbiemër. Këto ndryshime pozitive u kurorëzuan me përmirësimin e marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare të ndërprera për dy dekada. Andaj, si rezultat i ndryshimeve të përmendura pozitive padyshim ka qenë edhe vendimi për botimin e "Edukatës Islame".

Vendimi për botimin e revistës "Edukata Islame" mund të themi se nuk ka qenë vetëm kërkesë e kohës, por edhe imperativ i saj, sepse nevojat dhe kërkesat e popullatës shqiptare të besimit Islam për ta njohur fenë e tyre përmes literaturës të botuar në gjuhën shqipe për çdo ditë ishin më të mëdha. Popullata shqiptare e pas Luftës së Dytë Botërore, e cila ishte 98% analfabetë ajo tani ishte arsimuar në masë të madhe, duke filluar nga ata që e kishin vetëmësuar shkrim - lexim shqip e deri, tek ata që kishin doktoruar në shkenca të ndryshme.

Nga ana tjetër, botimi i kësaj reviste do t'u shërbente atyre si armë mbrojtëse nga akuzat e pabaza të propagandës antifetare, e cila ishte e pranishme sidomos në arsim dhe në mjetet e informimit. Pas përmirësimit të marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare, propaganda në fjalë kishte marrë përmasa edhe më të mëdha nga ndikimi i frymës ateiste që mbretëronte në këtë të fundit, ku feja ishte e ndaluar me ligj.

Kjo propagandë përbëhej nga kombinimi ekstrem i ideologjisë komuniste, staliniste dhe të asaj nacionaliste kurse parulla kryesore të saj ishin: *Feja është opium, Feja e shqiptarit është Shqiptaria*, dhe fenë katolike na e kanë imponuar me dhunë romakët, fenë ortodokse bizantinët, ndërsa fenë islame turqit, dhe si të tilla të gjitha janë të huaja për ne. Ata, me këtë rast nuk dinin ose nuk donin ta dinin se, si parullën e parë Marks, ashtu Pashko Vasa të dytën, i kanë thënë në rrethana të caktuara historike nga shkaqet dhe qëllimet e caktuara, andaj si të tilla ato nuk i përgjigjeshin as kohës as vendit as realitetit. Ndërkra, sa i takon parullës së fundit ata totalisht harronin se edhe komunizmi si ideologji dhe sistem të cilin e respektonin dhe adhuronin shqiptarët si këndej ashtu edhe andej kufirit nuk ishte prodhim shqiptar por imponim nga sllavizmi serbo-rus. Andaj, kushti në fjalë është dashur të vlejë edhe për këtë të fundit ose për asnjërën. Në shtypin

ditor gjithashtu bërja synet e fëmijëve u quajt akt barbar që lë pasoja psikike te fëmijët gjatë tërë jetës se tyre. Ndërkaq, në qendrat spitalore të Perëndimit shumë njerëz në atë kohë i bënë synet fëmijët e tyre edhe pse nuk i takonin fesë islame, këtë e bënë në emër të higjienës dhe preventivës nga sëmundjet venerike.

Viktimat e një propagande të tillë tendencioze ishin sidomos gjeneratat e reja, të cilat duke mos pasur mundësinë për t'u njohur me mësimet e vërteta të fesë islame, shumica e tyre formonin botëkuptime të gabuara për të. Andaj, marrja e vendimit nga Shoqata e Ylemave për botimin e revistës "Edukata Islame" në rrethanat e lartpërmendura ishte një akt sa i rëndësishëm po aq i guximshëm dhe jo vetëm i nevojshëm por edhe i domosdoshëm. Ky vendim u realizua falë angazhimit vetëmohues të, H. Sherif Ahmetit, kryetar i Shoqatës së Ylemave, dhe të disa bashkëpunëtorëve të rinj, të cilët kishin diplomuar në Medresenë e Sarajevës ose të Prishtinës, dhe tashmë ishin punësuar në Bashkësinë Islame.

Do theksuar se në vitin 1971 ndodhën dy ngjarje me rëndësi të madhe fetare dhe kombëtare: vendimi për botimin e "Edukatës Islame", që u bë gurthemel i publicistikës islame në gjuhën shqipe, dhe vendimi për hapjen e Universitetit të Prishtinës, i cili u bë vatër e shkencës, arsimit dhe kulturës shqiptare.

**Edukata Islame:** *Hoxhë efendi, a na thoni tash e kujt ishte nisma për botimin e saj?*

**Hajrullah efendi Hoxha:** Iniciatori kryesor i nismës për botimin e revistës "Edukata Islame" ka qenë kryetari i shoqatës së Ylemave, H. Sherif ef. Ahmeti, natyrisht në marrëveshje paraprake me kryetarin e Kryesisë së Bashkësisë Islame, Hfz. Ismail ef. Hakiun, Zoti i mëshiroftë të dy.

Nga ardhja e tij në krye të shoqatës më 1969, ky ishte hapi i dytë i tij në këtë drejtim, pas botimit të Takvimit për herë të parë në gjuhën shqipe për vitin 1970.

**Edukata Islame:** Paraprakisht a është debatuar në forumet e Shoqatës së Ylemave për botimin e ndonjë reviste apo të literaturës në përgjithësi?

**Hajrullah efendi Hoxha:** Shoqata e Ylemave që nga viti 1962 e shtypte Buletin Informativ në dy gjuhë serbokroatisht dhe shqip për nevojat e saj interne. Ky Buletin kishte karakter informativ për aktivitetet dhe veprimtaritë administrative si të Shoqatës së Ylemave ashtu edhe të Bashkësisë Islame. Si i tillë ai më nuk i përgjigjej kohës as nuk i plotësonte nevojat e anëtarësisë së shoqatës se lëre më kërkesat e të interesuarve për literaturë fetare, numri i të cilëve shtohet çdo ditë e më tepër. Duke u bazuar në faktet e lartpërmendura dhe pas një diskutimi të gjithanshëm, Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës Ilmiye (i cili më vonë u quajt: Kryesia e Shoqatës së Ylemave), në mbledhjen e mbajtur më 2 shkurt 1971, mori vendimin për botimin e një reviste fetare, e cila me përmbajtjen e saj do t'i plotësonte si nevojat e anëtarësisë së vet ashtu të lexuesve të tjerë të interesuar. Në bazë të propozimit të kryetarit të Kryesisë së Bashkësisë Islame, H. Ismail Hakiut, revista u emërtua "Edukata Islame".

**Edukata Islame:** Pasi që Shoqata e Ylemave ka qenë themeluese dhe botuese e "Edukatës Islame", mundësisht, na i thoni disa fjalë për veprimtarinë e saj?

**Hajrullah efendi Hoxha:** Shoqata e Ylemave është themeluar dhe ka vepruar në kuadër të Bashkësisë Islame. Anëtarë të shoqatës kanë qenë imamët, punëtorët administrativë të organeve të Bashkësisë Islame dhe të Medresesë, imamët e ramazanit dhe muezinët.

Shoqata i ka pasuar organet e veta prej këshillave në terren e deri te kuvendi. Edhe pse i ka pasur organet e ndara me Bashkësinë Islame, kanë bashkëpunuar ngusht mes vete në organizimin dhe zhvillimin e jetës fetare ndër pjesëtarët e besimit islam. Shoqata e Ylemave më tepër është marrë me çështjen e shtypit fetar, për arsye, se ndër detyrat kryesore të saj, sipas statutit, ka qenë kujdesi për botimin e revistës së saj, të Takvimit dhe të edicioneve tjera me përmbajtje islame për nevojat e veta dhe të Bashkësisë Islame.

**Edukata Islame:** Me çfarë vështirësishë është përballur redaksia e revistës në fillim të punës së saj?

**Hajrullah efendi Hoxha:** Qysh në fillim të punës së saj, redaksia e revistës u ballafaqua me vështirësi të natyrave të ndryshme, në mesin e të cilave më e theksuara ka qenë mungesa e bashkëpunëtorëve. Kjo ndodhte për arsye se shumica dërrmuese e gjeneratave të mëparshme të ylemave edhe pse ishin ixhazetli - të diplomuar dhe posedonin aftësi të mëdha profesionale, për shkak të mosnjohjes së rregullave të gjuhës dhe metodave të shkrimit, nuk ishin në gjendje të shkruanin qoftë edhe një artikull në gjuhën shqipe.

Ata kishin mësuar dhe ishin diplomuar nëpër medrese të ndryshme, gjatë sundimit të Jugosllavisë monarkiste, e cila ua kishte ndaluar me ligj popullatën shqiptare si shkollimin ashtu shtypin në gjuhën amtare. Në anën tjetër edhe ne gjeneratat e reja, të cilat ishim shkolluar, në medresetë me plan-program të reformuar, ku mësoheshin përveç lëndëve fetare edhe ato shkencore të shkollave të mesme laike, për shkak të papërvojës dhe mosekzistimit të literaturës fetare të mëhershme në gjuhën shqipe, të cilën do të mund ta shfrytëzonim, ose ta merrnim si model sesi duhet shkruar, kishim probleme të caktuara në këtë drejtim.

Burim kryesor i literaturës me të cilën kishim mundësi të shërbeheshim ka qenë në gjuhën arabe ose boshnjake, të cilat disa prej nesh nuk i njihnin mirë. Pavarësisht nga kjo që u tha më lart, mendoj se të shkruarit është një mjeshtri në vete, e cila kërkon talent, prirje, njohje dhe aftësi, vullnet dhe durim. Sipas përvojës sime shumëvjeçare, do të thosha se vula e suksesit në këtë çështje janë këto dy të fundit. Prandaj, falë vullnetit të pathyer dhe punës vetëmohuese të një grupit të vogël bashkëpunëtorësh të rregullt në krye me h. Sherif Ahmetin, "Edukata Islame" nuk e ndërpreu rrugëtimin e saj, ndërsa me arritjen e kuadrove të afta të shkolluara në qendra të ndryshme universitare të botës islame, problemi i bashkëpunëtorëve, gradualisht vinte duke u eliminuar.

**Edukata Islame:** *Hoxhë efendi, kush ishin atëkohë bashkëpunëtorë të revistës?*

**Hajrullah efendi Hoxha:** Bashkëpunëtorët e parë më kryesorë të revistës “Edukata Islame” në vitet e para të botimit të saj kanë qenë, H. Sherif Ahmeti, hfz. Muharrem Adili, h. Rashit Osmani, m. Bajruh Ahmeti, H. Jashar Jashari, H. Jetish Bajrami, Hfz. Avni Aliu, T. Nelaj (Feti Mehdiu), Ibrahim Spahia dhe unë. Kryeredaktor i revistës ka qenë h. Sherif Ahmeti, ai ishte shtylla kryesore për përgatitjen e saj, i cili me aftësitë e tij të larta profesionale e redaktoi dhe e pasuroi me tema bashkëkohore për një periudhë të gjatë afro shtatëmbëdhjetëvjeçare. Shpeshherë për shkak të mungesës së materialit të nevojshëm, në fillim ai detyrohej të merrte pjesë me dy ose tre artikuj në një numër.

**Edukata Islame:** *Si e priten besimtarët dhe masa e gjerë botimin e revistës "Edukata Islame"*

**Hajrullah efendi Hoxha:** Gjatë sundimit të sistemit komunist jugosllav, edhe pse feja ishte formalisht e lirë, si në Kosovë ashtu edhe në viset tjera shqiptare rrethanat politiko-shoqërore dhe mungesa e kushteve të nevojshme, kanë qenë shkaktare kryesore për mosbotimin e literaturës islame në gjuhën shqipe për një kohë të gjatë. Mirëpo, dëshirat, nevojat dhe kërkesat e besimtarëve, qofshin ata të moshuar apo të rinj, autodidaktë apo të shkolluar çdo ditë e më tepër vinin duke u shtuar. Shpeshherë këto kërkesa ata i drejtonin në Bashkësinë Islame ose në Shoqatën e Ylemave, duke i kritikuar për mosangazhim të nevojshëm.

Një numër i konsiderueshëm i tyre, pasi që dinin gjuhën serbokroate, ngase ishin të detyruar ta mësonin në shkolla dhe në ushtri, mungesën e shtypit islam në gjuhën shqipe e plotësonin me marrjen e shtypit që botohej në Sarajevë. Në rrethana të tilla dalja nga shtypi e revistës “Edukata Islame” u mirëpritte shumëkush me gëzim dhe kënaqësi të papërshtatshme. Një gëzim i tillë kishte karakter të dyfishtë: fetar dhe kombëtar.

Pas daljes nga shtypi të kësaj reviste, falënderimet dhe urimet me dëshirë të sinqerta për sukses dërguar redaksisë së saj përmes telefonit

ose letrave me postë kanë qenë të shumta. Me këtë rast do të theksoja përmbajtjen e një letre të tillë nga një lexues dhe bashkëpunëtor i “Edukatës Islame”.

“Unë, si lexues i pasionuar dhe njëkohësisht deri diku edhe bashkëpunëtor i faqeve të kësaj reviste të ndritshme, jam gëzuar që kjo revistë është duke depërtuar pa pengesa ndër lexues, ndoshta me ndonjë vonesë nganjëherë por edhe kjo e ka arsyen e vet. Masa myslimane shqiptare duhet të jetë krenare që në historinë e saj po përjeton daljen e kësaj reviste në gjuhën amtare, në të cilën janë duke u shqyrtuar tema autoriale për mbarë masën myslimane e sidomos atë rinore, e cila shumë pak di për islamizmin dhe principet e tij. Pra revistës në fjalë i dëshirojmë suksese po ashtu edhe bashkëpunëtorëve të saj dëshiroj përparim dhe hapje të horizonteve të ndritshme islamike. Me përshëndetje të përzemërta Eselamu Alejkum, Ibrahim Spahija.(shih: Edukata Islame, nr. 8).

Gjithashtu, urimet e tilla të shprehura gojarisht as me rastin e takimit me lexuesit e kësaj reviste nuk mungonin. Me një rast në bisedë e sipër një xhematli nga Llapi më pati thënë: “Unë, prej fillimit kur ka dalë “Edukata Islame” rregullisht e kam marrë dhe e kam lexuar me kënaqësi të madhe sidomos shkrimet e mulla Sherifit dhe shkrimet tua. Keni bërë punë të madhe, Zoti ju shpërbleftë me të mirat e Tij. Sikur të kishit mundësi për t'i tubuar ato shkrime në një libër do të ishte edhe më mirë, sepse do ta merrnin jo vetëm ata që nuk i kanë lexuar por edhe ne që i kemi lexuar”.

Pasi që nga Lufta e Dytë Botërore, “Edukata Islame” ishte revista e parë dhe e vetmja fetare në gjuhën shqipe në të gjitha trevat shqiptare, dalja e saj u mirëpritte edhe ndër shqiptarët në Maqedoni, Mal të Zi dhe diasporë. Interesimi për marrjen e saj, i cili realizohej përmes organeve të Bashkësisë Islame të vendeve të lartpërmendura dhe përmes parapagimit në redaksinë e saj, ishte i madh. Këtë mund ta vërtetojë mesë miri edhe ky rast. Gjatë luftës kur ishim refugjatë në Maqedoni, imami i xhamisë kryesore të Reçicës së Madhe-afër Tetovës, mulla Taxhudini, më vendosi për strehim në familjen e tij. Kur më prezantoi në familje se kush jam me emër e mbiemër dhe ku



punoi, babai i tij tha: “Ky emër po më duket si i njohur, a mos je ti një Hajrullah Hoxha, që me mulla Sherif Ahmetin e keni qitur “Edukatën Islame”? Pasi që iu përgjigja pozitivisht i thashë: “Po kah të ka rënë në dorë ty “Edukata Islame”? Ai më tha: “Në atë kohë Taxhudini ka qenë në Siri, duke studiuar. Në fillim unë i kam marrë disa numra të saj në Bashkësinë Islame në Tetovë, të cilat ende i kam dhe nga njëherë ose i marrë dhe i lexoj vetë ose ua jap fëmijëve për t’i lexuar”. Unë me këtë rast mbeta i habitur për faktin se edhe pse kishte kaluar një kohë e gjatë nga ajo kohë, përjetimet dhe kujtimet për të ende i kujtonte me mall e respekt.

Për daljen e revistës “Edukata Islame” që gëzuar shumë edhe veprimtari i çështjes fetare dhe kombëtare imam Vehbi Ismaili, emigrant i Shqipërisë në SHBA, Zoti e mëshiroftë. Ai me rastin e vizitës së tij në Shoqatën e Ylemave, ku u prit nga H. Sherif Ahmeti, H. Ismail Haku e shumë të tjerë, atë gëzim dhe kënaqësinë e tij e shprehu përmes urimeve dhe dëshirave të sinqerta për punë të mbarë dhe të suksesshme. Duke pasur parasysh se në Shqipëri jo vetëm shtypi por edhe feja tërësisht ishte e ndaluar, dhe se askund tjetër nuk botohej literaturë islame në gjuhën shqipe përveçse në Prishtinë, si njeri vizionar dhe largpamës, na tha: “Pasi që keni të drejtë për të botuar revista dhe libra fetare në gjuhën shqipe, për çka ndiej kënaqësi të madhe, do t’u sugjeroja që ato t’i botoni me tirazh sa më të madh, sepse mund të ndryshojë situata politike në Shqipëri dhe të lirohet çështja e fesë, kështu që ato do t’u hyjnë në shërbim vëllezërve tanë shqiptarë-muslimanë atje”

Nga kjo kuptohet sesa ai e çmonte lart fjalën e shkruar fetare në gjuhën shqipe dhe se sa e madhe ishte shpresa e tij për ta parë Shqipërinë të lirë nga diktatura komuniste. Më në fund kjo parandnjë dhe dëshirë e tij u realizua ngase i dha Zoti ymër për ta parë Shqipërinë e lirë, ndërsa ne e përmbushëm dëshirën e tij ngase në vitet 90, kur u shkatërrua komunizmi, ku jo vetëm numra të ndryshëm të “Edukatës Islame” që i kemi pasur tepricë në depo, por tërë literatura e botuar nga Shoqata e Ylemave dhe Bashkësia Islame që e posedonim ua dërguam falas në Shqipëri.

**Edukata Islame:** *Atë kohë në çfarë rrethanash ka punuar redaksia e një reviste fetare, gjithnjë duke pasur parasysh se keni vepruar në sistemin komunist?*

**Hajrullah efendi Hoxha:** Në sistemin komunist jugosllav, besimi, manifestimi dhe predikimi i fesë, kanë qenë të lejuara dhe garantuara me ligj. Megjithatë, propaganda antifetare dhe pengesat e natyrave të ndryshme ndaj institucioneve fetare, sidomos në Kosovë, kundër islamit, asnjëherë nuk kanë pushuar.

Edhe pse në rrethana të tilla kontradiktore dhe në kushte jo të mira, redaksia e “Edukatës Islame” e zhvilloi punën e saj me sukses duke mos rënë në kundërshtim me rregullat ligjore të parapara për shtyp.

Në fillim, edhe çështja e shtypjes së “Edukatës Islame” ishte problem. Drejtorët e shtypshkronjave, si komunistë të përjetuar, refuzonin shtypjen e saj vetëm pse kishte karakter fetar, me përjashtim të atij të shtypshkronjës “Progres” në Mitrovicë. Në atë kohë unë isha imam në Mitrovicë dhe kisha raporte të mira me drejtorin e shtypshkronjës në fjalë, i cili ishte një njeri dinjitoz dhe intelektual i mirëfilltë.

Pas një bisede të shkurtër pa kurrfarë ngurrimi ai e pranoi ofertën tonë për shtypjen e “Edukatës Islame”. Pra, duke iu falënderuar guximit qytetërues të z. Burhan Gashit, Zoti e mëshiroftë, respektit të tij ndaj fesë islame dhe fjalës së saj të shkruar në gjuhën shqipe, si Takvimi një vit më parë, ashtu “Edukata Islame” e panë dritën e botimit. Në këtë shtypshkronjë të dy botimet e përmendura u shtypën rregullisht për afro 20 vjet.

Gjatë kohës së sundimit komunist çdo vepër para se të dilte nga shtypi duhej censuruar (redaktuar) rreptësisht nga prokurori publik. Andaj, me rastin e përgatitjes së materialit për botim për çdo numër është dashur t’i kushtohet kujdes i veçantë që të mos ketë në të elemente antiligjore ose politike. Më kujtohet si sot kur me një rast lidhur me këtë h. Sherif Ahmeti më pati thënë: “Hajrullah, besoj se ti në pikëpamje fetare nuk gabon, por ki kujdes në pikëpamje politike, sepse shumë lehtë ajo mund të shkaktojë ndërprerjen e mëtejshme të “Edukatës Islame”.

Për shkak të rrethanave të ndërlikuara politiko-shoqërore në prag të viteve 90-ta, redaksia e “Edukatës Islame” u përball me vështirësi të natyrës së ndryshme, madje edhe të natyrës politike. Me një rast, papritmas, me erdhën në zyrë dy njerëz të pushtetit (Këshilli Koordinues Krahinor i LSPP), një serb e një shqiptar. Ky i fundit ishte Sherefedin Sylejmani, komunist i hershëm, ndërsa atë të parin nuk e njoha as që i kam lodhur mentë për t’ia mbajtur emrin në mend. Si kryeredaktor (i zorit) i “Edukatës Islame” që isha në atë kohë, kërkuam prej meje me këmbëngulje botimin e saj në dy gjuhët serbokroate dhe shqipe, për nevojat e anëtarësisë dhe të myslimanëve nga territori i Sanxhakut, pasi që ajo ishte organ i shoqatës që vepron në nivel të Republikës të Serbisë. Një kërkesë të tillë kurrë njëherë nuk e kishin bërë, as gojarisht as me shkrim imamët e Sanxhakut.

Sikur ta kishin bërë, sigurisht do t’ua kishim pranuar me kusht që atë ta botonin ndaras njësoj siç patëm vepruar me Kalendarin e murit. Mirëpo, kërkesa e tyre dukej qartë kishte karakter tendencioz dhe me prapavijë politike. Duke pasuar parasysh të gjitha këto, u mundova t’u përgjigjem në mënyrë sa më të shkurtër dhe sa më racionale duke thënë, Imamët dhe myslimanët e Sanxhakut kanë literaturë të mjaftueshme në gjuhën e tyre amtare që botohet në Sarajevë, ndërsa sa i përket botimit të “Edukatës Islame” në gjuhën serbokroate, pasi është organ i Shoqatës që vepron në nivel të Republikës së Serbisë, nuk kemi mjete financiare. Pas kësaj Sherefedini, më tha: “Mjetet financiare ua sigurojmë ne”, ndërsa shoku i tij shtoi, “Së paku temat kryesore të përkthen serbokroatisht”.

Atëherë unë u thash: “Temat më kryesore të “Edukatës” janë marrë e përkthyer nga Gllasnku i Sarajevës, të cilat ata i kanë lexuar shumë herët, sepse Edukata del 3-4 herë në vit”.

Në realitet ashtu edhe ishte, sepse gati çdo numër të “Edukatës Islame” ka pasuar nga një temë të përkthyer nga Husein Xhozo ose Sinanudin Sokolloviqi. Me kaq mori fund biseda rreth kësaj çështjeje por ata shkuan të pakënaqur, ngase nuk hasëm në mirëkuptim për realizimin e qëllimeve të tyre.

**Edukata Islame: Si bëhej shpërndarja e Edukatës Islame ?**

**Hajrullah efendi Hoxha:** Shpërndarjen e “Edukatës Islame”, Shoqata e Ylemave, si botues i saj, e bënte përmes këshillave të saj në terren, ndërsa këto të fundit përmes anëtarëve të tyre - imamëve dhe myezinëve, i shpërndanin në xhamia. Përveç territorit të Kosovës, në bazë të kërkesave kemi dërguar edhe në këshillat e Bashkësisë Islame: Bujanoc, Preshevë, Kumanovë, Shkup, Tetovë, Gostivar, Dibër, Strugë, Beograd, Titograd dhe Ulqin. Transportimi i saj në këshillat brenda Kosovës zakonisht bëhej me veturë të Shoqatës, ndërsa jashtë Kosovës, me anë të postës. Përveç dërgesave me shumicë, në redaksi kanë qenë të parapaguar një numër i konsiderueshëm i lexuesve nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Diaspora, të cilëve “Edukatën Islame” rregullisht ua dërgonim me anë të postës.



*Hajrullah efendi Hoxha*

Si shpërndarjen e “Edukatës Islame” ashtu edhe të literaturës tjetër rregullisht e kemi bërë me H. Abdullah Zhegrovën - Zoti e mëshiroftë! Ai në atë kohë një mandat ishte kryetar i Shoqatës së Ylemave, kurse pas vdekjes së H. Jakup Hoxhës, u emërua si sekretar i saj. Pas daljes së çdo botimi nga shtypi, pavarësisht nga kushtet atmosferike të kohës me shi apo borë, të ftohtë apo të nxehtë, ne sa më parë e kemi shpërndarë atë në terren. Shpeshherë kemi udhëtuar natën, madje edhe kur nuk ishte gjendja e mirë e sigurisë, ngase deri në drekë punonim në zyrë. Me gjithë gjendjen shumë të rëndë politike në vitet e 90’ta, demonstratat e shumta dhe kontrollimet e rrepta policore, ne nuk ndaleshim së qarkulluari, sa që njëherë ka ndodhur që ora policore na ka zënë në qytetin e Suharekës. Shpeshherë kemi qenë të ndaluar dhe kontrolluar nga policia serbe. Kështu vepruam me vite të tëra deri më 28.12.1992, kur ai ndërroi jetë në udhëtim e sipër. Atë ditë duke u kthyer nga Prizreni, ku morëm nga shtypshkronja “Takvimin” për

vitin 1993, unë u ndala në Komoran për të vazhduar rrugën për Prishtinë, ndërsa ai shkoi për të shpërndarë Takvimin në Drenas, Shteraj, Mitrovicë dhe në Vushtrri, ku edhe banonte. Në hyrje të Mitrovicës, pas ndërrimit të një gome të veturës, me të hyrë brenda ai kishte ndërruar jetë.

Nuk ishte lehtë të ndahemi nga një shok i dashur e i ngushtë, me të cilin ishim shoqëruar gjatë shkollimit për 8 vjet, katër vjet në Prishtinë dhe katër tjera në Sarajevë. Me të kishim punuar më se 13 vjet në një zyrë, ishim shoqëruar çdoherë kur dilnim në terren deri në ditën kur ndërroi jetë. Zoti i madhërishtëm e shpërbleftë dhe na bashkoftë me të në Xhennet!

Me një rast, derisa ishim duke e shpërndarë “Takvimin” për vitin 1993, me Salih Jasharin, policia na kontrolloi, dhe vetëm pse e panë xhamin e “Hysrev Begut” në ballinën e tij, na kërcënuan: “Çfarë po ju duhet juve xhamia e Sarajevës? A mos keni lidhje ju me myslimanët e Bosnjës, të cilët po luftojnë kundër nesh?”

Gjithashtu edhe çështja e shitjes së literaturës islame fetare ka qenë tejet e kufizuar me ligj. Ajo ka pasur të drejtë të behët vetëm në zyrat e Bashkësisë Islame dhe të Shoqatës së Ylemave, nëse kjo e fundit ka pasur të veçanta, në xhamia dhe oborret e tyre, ndërsa në vendet publike ose në treg ka qenë e ndaluar. Kjo është dëshmuar praktikisht në disa raste, ku milicia ua ka konfiskuar ose i ka marrë në pyetje shitësit e saj dhe ua ka tërhequr vërejtjen duke i kërcënuar, nëse prapë vazhdojnë.

**Edukata Islame:** *Hoxhë efendi, Edukata tani po përgatit të botojë numrin e saj të 100-të, si e përshkruani rriten e saj?*

**Hajrullah efendi Hoxha:** “Edukata Islame” gjatë veprimtarisë së vet dyzetenvjeçare u përball me vështirësi dhe probleme të natyrës së ndryshme duke filluar nga ato me karakter profesional e deri tek ato me karakter politik. Mirëpo, falë angazhimit vetëmohues të botuesit të saj, kryeredaktorëve, bashkëpunëtorëve dhe stafit teknik ajo arriti që të mbijetojë dhe ta kryejë me sukses misionin e saj për të cilin ishte themeluar. Kohën e veprimtarisë së “Edukatës Islame” mund ta

ndajmë në tri periudha: Periudha e parë fillon në vitin e daljes së saj 1971 dhe vazhdoi deri në prag të viteve të 90-ta. Periudha e dyte fillon në vitet e 90-ta dhe vazhdoi deri pas luftës, ndërsa periudha e tretë filloi në vitin 2001 dhe vazhdon deri më sot kur po e botojmë numrin 100-të jubilar të saj.

Fillimin e periudhës së parë e karakterizonte numri i kufizuar i bashkëpunëtorëve dhe tirazhi i vogël prej 1000 ekzemplarëve, mirëpo kohë pas kohe si numri i bashkëpunëtorëve ashtu dhe tirazhi erdhën duke u shtuar. Të gjithë bashkëpunëtorët gjatë kësaj periudhe ishin vetëm nga kuadrat e Bashkësisë Islame, për shkak të sistemit komunist, me përjashtim të z. Ibrahim Spahisë dhe Ferid Berishës, të cilët ishin punëtorë të arsimit, si ish-nxënës të medresesë (i pari i medresesë “Isa beg” të Shkupit, ndërsa i dyti i asaj “Atik” të Gjilanit, dhe Mehmet Zhinipotokut, me punë të përkohshme në Francë. Kryeredaktor i saj gjatë kësaj periudhe ishte H. Sherif Ahmeti, i cili me aftësinë profesionale dhe punën e tij të palodhshme bëri që “Edukata Islame” të vazhdojë daljen e saj me rregull. Ndërsa falë kërkesave gjithnjë më të mëdha nga lexuesit tirazhi i saj arriti deri në 5000 copë.

Periudhën e dytë e karakterizojnë siç dihet vështirësitë e ndryshme, gjendja e rëndë politike, dhuna shtetërore dhe lufta. Të gjitha këto shkakton daljen me shumë vështirësi të revistës “Edukata Islame” sa që e herë- herë edhe me pauza të gjata.

Edhe pse numri i bashkëpunëtorëve nga radhët e intelektualëve ishte në shtim e sipër, cilësia e përmbajtjes ishte përmirësuar dhe numri i faqeve ishte shtuar, tirazhi i saj, shkak i gjendjes së vështirë, gradualisht vinte duke u zvogëluar deri sa zbriti në 1000 copë. Në fillim të kësaj periudhe unë isha kryeredaktor, ndërsa nga viti 1992 e deri 2001 ishte H. Resul Rexhepi.

Për shkak të ndryshimeve organizative në Bashkësinë Islame dhe ndërprerjes së veprimtarisë së Shoqatës, Bashkësia Islame më 2001, mori mbi vete botimin e mëtejshëm të “Edukatës Islame”.

Periudhën e tretë të “Edukatës Islame”, e cila fillon në vitin 2001 dhe vazhdon deri më sot e karakterizon ajo që është më e vlefshmja në botë – liria, e cila u arrit falë Zotit të madhërishtëm, e pastaj atyre

që sakrifikuan jetën ose pasurinë e tyre si dhe falë ndihmës ushtarake së Aleancës Veri-Atlantike me në krye SHBA-të.

Duke filluar nga botimi i parë i saj pas luftës, në “Edukatën Islame”, shihen ndryshime të mëdha si në formën ashtu edhe në përmbajtjen e saj. Këto ndryshime pozitive më së miri vërehen në përbërjen e Redaksisë, të drejtuar nga publicisti i njohur, z. Qemajl Morina, anëtarë të cilës ishin si p.sh. akad. Jashar Rexhepagiqi, akad. Pajazit Nu-shi, Dr. Ejup Sahiti etj. Numri i intelektualëve të tillë është i madh edhe në mesin e bashkëpunëtorëve të “Edukatës Islame”. Andaj, falë punës së palodhshme të kryeredaktorit të saj, z. Qemajl Morinës dhe bashkëpunëtorëve të tij, “Edukata Islame” për nga përmbajtja gjatë kësaj periudhe është shumë më e pasur me tema të zgjedhura dhe aktuale, ndërsa madhësia e saj ka arritur deri në 350 faqe. Për kundër tërë kësaj, tirazhi i “Edukatës Islame” prej 1000 copë është tepër i vogël dhe i pajustificueshëm, duke marrë parasysh se numri i imamëve në Kosovë arrin përafërsisht shifrën e njëjtë.

Nga numri i parë deri në numrin 100 jubilar të saj, në “Edukatën Islame”, janë botuar artikuj dhe punime të ndryshme me karakter fetar, shkencor, kulturor dhe kombëtar. Në të janë shtjelluar tema nga Akaidi- besimi, Fikhu- jurisprudenca islame, Ahlaku- morali dhe etika, Tefsiri- komentimi i Kur’anit, Hadithi- thëniet dhe veprimet e Muhamedit a.s., Historia Islame, si dhe tema tjera shkencore, filozofike, pedagogjike sociale dhe kulturore. Në këto tema dominon metoda e interpretimit bashkëkohor të mendimit islam për njeriun, fenë dhe botën.

**Edukata Islame:** A i ka përmbushur “Edukata” objektivat dhe pritjet e themelueseve të saj?

**Hajrullah efendi Hoxha:** Edhe pse u themelua dhe veproi një kohë të gjatë në sistemimin komunist - antifetar, “Edukata Islame” arriti të prezantojë me sukses dhe në mënyrë të drejtë parimet, mësimet dhe vlerat e mirëfillta të fesë islame. Në faqet e saj u trajtuan dhe u shqyrtuan me përkushtim ide dhe tema të rëndësishme fetare, etike, kultur-

ore, filozofike, sociale dhe shkencore. Si e tillë, ajo gjatë veprimtarisë së saj 41-vjeçare ka dhënë një kontribut të çmuar fetar e kombëtar.

“Edukata Islame”, sipas mendimit tim, në këtë mënyrë jo vetëm që e arsyetoi themelimin dhe ekzistimin e saj por me sukses i ka përmbushur madje edhe i ka tejkaluar objektivat dhe pritjet e themeluesve dhe botuesve të saj.

**Edukata Islame:** Si e shihni çështjen e publicistikës islame në gjuhën shqipe?

**Hajrullah efendi Hoxha:** Publicistika islame në gjuhën shqipe, nga themelimi i saj e deri më sot, është zhvilluar në mënyrë institucionale në kuadër të Shoqatës së Ylemave dhe Bashkësisë Islame, mirëpo, me fillimin e proceseve demokratike në vitet 90-ta, ajo mori karakter edhe privat. Kur i shoh sot libraritë private të stërmbushura me literaturë islame në gjuhën shqipe, e cila numëron sigurisht me mijëra tituj, duke filluar nga Ilmihali e deri te komentimet voluminoze të Kur’anit, dhe e krahasoj me kohën kur e kemi pasur të shtypur në gjuhën shqipe vetëm Ilmihalin e vogël (1957), zemra më kënaqet dhe sytë me mbushen me lot nga gëzimi. Mirëpo, kur mendoj nganjëherë pa emocione dhe i analizoj autorët dhe titujt e kësaj literature, përmbajtjen dhe kohën e shkruar të saj, si dhe përzgjedhjen e titujve për botim pa kriterë të mirëfillta, filloj të them me vete:

“Nga kush po financohet botimi paushall i kësaj literature islame në gjuhën shqipe?! Nëse investitorët e saj janë myslimanë të sinqertë dhe dashamirë të islamit dhe të myslimanëve, atëherë pse këtë punë nuk ua kanë besuar zyrtarisht organeve të Bashkësisë Islame, të cilat janë kompetente për çështjet fetare dhe kanë kuadro për përzgjedhjen e titujve sa më të nevojshëm për vendin tonë, si dhe për kontrollimin e përkthimit të tyre që të jetë sa më i përpiktë dhe më i rrjedhshëm? Pse këtë punë ua kanë besuar personave të caktuar madje edhe laikë, të cilët në mënyrë private i përkthejnë titujt e caktuar, i botojnë dhe i shesin sikur të ishte mall i kontrabanduar? Çfarë kanë nevojë lexuesit e rëndomtë për një literaturë të tillë voluminoze, në të cilën përfshihen edhe shumë vepra të shkruara para më së njëj miq vjetëve, në kohën e

dekadencës së myslimanëve, në të cilat janë shqyrtuar çështje dhe probleme të atëhershme, e që sot nuk janë fare aktuale? Kujt i duhet një literaturë e tillë, e cila e orienton vëmendjen e lexuesit më tepër kah problemet e së kaluarës sesa kah problemet aktuale dhe perspektiva e së ardhmes? Të gjitha këto, e shumë dilema të tjera, më bëjnë të brengosem dhe të dyshoj: Vallë a mos një veprimtari e tillë i ka shkaqet dhe qëllimet e caktuara, në mesin e të cilave është edhe mbjellja e farës së përçarjes së myslimanëve në bazat e medhhebeve dhe sekteve të ndryshme, pasojat e së cilës tashmë kanë filluar të jenë të pranishme thuajse në çdo mjedis.

Botimi i tillë i literaturës pa plan dhe pa kontrollim të saj, dhe shpërndarja e saj masive, në hapësirat shqiptare, sidomos pas luftës në Kosovë, sipas mendimit tim u përngjan vërshimeve të përroskave ose lumenjve që nuk e kanë shtratin e rregulluar pas shirave të mëdha. Me ç'rast ato më tepër u sjellin dëme sipërfaqeve të tokave të vërshuar sesa dobi.

Me qëllim që të mos ndodhë diçka e tillë edhe në Bashkësitë Islame në trojet shqiptare, do t'i sugjeroja që të formojnë nga një organ-institut të veçantë botues, me ekspertë të zgjedhur në lëmi të ndryshme, i cili do të drejtonte dhe kontrollonte tërë veprimtarinë botuese të saj, qofshin ato revistat apo botime tjera të veçanta.

**Edukata Islame:** Në Edukatën Islame jeni i pranishëm me punimin "Muhamedi a.s. dhe përhapja e fesë Islame" nga numri 1 deri në atë 60, në 38 vazhdime, si keni pasur durim të shkruani për 25 vjet rreth në një temë?

**Hajrullah efendi Hoxha:** Në "Edukatën Islame" nr. 1, është botuar vazhdimi i tretë i punimit në fjalë, ndërsa dy pjesët e para kanë qenë të botuara në dy numrat e fundit të "Buletinit Informativ". Ndërsa, sa i përket çështjes së durimit, ai ka qenë i bazuar në vullnet të pathyeshëm dhe në dëshirë të madhe, të cilat së bashku më kanë shoqëruar vazhdimisht dhe i kam kuptuar dhe vlerësuar si dhurata tepër të çmueshme nga Allahu i madhërishtëm. Megjithatë, dëshira, vullneti dhe

durimi në fjalë kanë qenë të bazuara: Në ndjenjën e dashurisë ndaj Allahut xh.sh, të Dërguarit të tij dhe Fesë Islame;

Në ndjenjën e përgjegjësisë morale për shfrytëzimin dhe përhapjen e diturisë së poseduar. Në dëshirën e madhe për t'ua bërë të mundur popullatës shqiptare të besimit islam për ta njohur biografinë e Muhamedit a.s. dhe të fesë islame në mënyrë të drejtë përmes fjalës së shkruar në gjuhën amtare. Në shpresën e madhe për shpërblimin e begatshëm të Allahut xh.sh., për mundin dhe kontributin e dhënë në udhëzimin e njerëzve në rrugën e drejtë të Tij.

Duke u mbështetur në fjalët e Muhamedit a.s. thënë shokut të tij: "O, Muaz, nëse Allahu e drejton një njeri përmes teje në rrugë të drejtë, më e dobishme është për ty se e tërë bota dhe çka ka në të".

**Edukata Islame:** Pasi që punimi në fjalë është i një rëndësie të veçantë për faktin se për herë të parë është shkruar te ne për jetën e Muhamedit a.s., a mendoni për ta tubuar e botuar atë në një vëllim?

**Hajrullah efendi Hoxha:** Lidhur me këtë çështje kam pasuar sugjerime dhe propozime edhe më herët nga disa dashamirë të mi, mirëpo vetëm kohëve të fundit kam vendosur që t'i rikthehem ta korrigjoj tërë atë material dhe ta përgatis për botim. Por, edhe kjo ka punë dhe do kohë.

Nëse kam ymër dhe më punon shëndeti, shpresoj se kjo punë me ndihmën e Zotit do të kryhet me sukses, mirëpo nëse ndodh e kundërta, jam i bindur që do ta përfundoni ju.

**Edukata Islame:** Hoxhë efendi, cila është porosia juaj për lexuesit dhe bashkëpunëtorët e "Edukatës..."?

**Hajrullah efendi Hoxha:** Kushtet për punë, mundësitë dhe rrethanat tani, krahasuar me atë kohë kur kemi punuar ne janë të pakrahasueshme në çdo aspekt: politik, ekonomik, profesional, teknologjik, informativ etj., me fjalë të tjera ato sot janë ideale, andaj vetëm kërkohet shfrytëzimi i tyre në mënyrë maksimale. Në kontekst të kësaj për lexuesit e "Edukatës Islame", bashkëpunëtorët dhe anëtarët e redaksisë me këtë rast porosia ime është:

Të punojnë edhe me më përkushtim, në përhapjen e mendimit dhe mësimave islame, përmes fjalës së shkruar në gjuhën shqipe duke llogaritur këtë si një obligim të domosdoshëm fetar me përgjegjësi të madhe morale. Të gjithë i përshëndes përzemërsisht me selam dhe iu dëshiroj suksese në punë.

Gjithashtu, edhe revistës "Edukata Islame", me rastin e botimit të numrit jubilar i dëshiroj shtegtim të pandalshëm në rrugën e saj të trasuar që katër dekada, si dhe suksese të reja.

**Edukata Islame:** *Hajrullah efendi, ju faleminderit shumë për këtë intervistë të dhënë, gjatë së cilës ndiem kënaqësi të veçantë. Ne ju dëshirojmë shëndet dhe suksese në punën tuaj?*

**Hajrullah efendi Hoxha:** Në fund e falënderoj Allahun e madhërishtëm që më ka bërë të mundur që edhe unë të jem prej atyre që kanë kontribuar me shkrime për të mirën e islamit dhe të myslimanëve shqiptarë. Ndërsa juve që e keni paraparë këtë intervistë me mua si një dëshmitar i gjallë i rrjedhave në redaksinë e "Edukatës Islame" dhe si një bashkudhëtar i saj i pandalshëm, ju falënderoj përzemërsisht dhe ju dëshiroj sukses.

*Intervistoi:*  
**Ramadan Shkodra**

## RECENSIONE

*Qemajl Morina*

### ASPEKTE TË HARRUARA TË MARRËDHËNIEVE TË ISLAMIT ME PERËNDIMIN

Ky është një lexim në thellësi të historisë së harruar midis Islamit dhe Perëndimit. Edhe pse është më se e qartë, se ne jetojmë në një botë të ndarë për shkak konfliktit të vazhdueshëm mes myslimanëve, të krishterëve dhe hebrenjve në të gjitha anët e botës. Mirëpo, marrëdhëniet mes Islamit dhe Perëndimit asnjëherë nuk ishin marrëdhënie armiqësore, ato ishin dëshmitare të marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe të lulëzimit gjatë katërmëdhjetë shekujve të kaluar.

Libri i sapobotuar “Ithtarët e librit... historia e harruar e Islamit dhe e Perëndimit” i autorit Zakeri Karabell, botim i kompanisë Koha-Prishtinë, përkthyer nga origjinali në anglisht, nga Fuad Morina. Libri në fjalë është shkruar me një metodë analitike, në formë tregimi të shkëlqyer, se këto tri

fe, të cilat një ditë prej ditëve luftuan njëra kundër tjetrës, ato edhe mësuuan njëra prej tjetrës si dhe bashkëjetuan njëra me tjetrën. Rikthimi kësaj historie të harruar është çështje e domosdoshme për të arritur në një botë që do të jetonte në paqe dhe siguri.

Në këtë studim hulumtues voluminoz, (335 faqe), në aspektin historik dhe jetësor, vërteton se secila prej këtyre tri feve përmban farën e paqes në brendinë e saj. Kështu brenda kishave në të gjitha vendet e botës, besimtarët u drejtohen njëri-tjetrit me përshëndetjen “Paqja me ty”! Po ashtu nëse hyn në çfarëdo dyqani, në shtëpi apo në xhami në çdo pjesë të botës islame do ta dëgjosh përshëndetjen “Esselamu alejkum” (Paqja qoftë mbi ty)! Përgjigja është po e njëjta “Dhe mbi ju qoftë paqja!” Kurse hebrenjtë në Izra-

el çdo bisedë e fillojnë dhe e mbarojnë me përshëndetjen “Shalom!” “Paqe!” Shtrohet pyetja, përse atëherë depërtuan imazhet e armiqësisë mes Lindjes dhe Perëndimit?

Sipas vlerësimit të Karabellit, hulumtuesit të besueshëm nuk ka munguar trashëgimia e bashkëjetesës së përpëruar, sepse secili student në të shumicën e universiteteve do të marrë leksione ose do të lexojë njërin nga mijëra libra dhe artikuj, të cilët janë me bollëk në këtë lëmi. Mirëpo, në një formë apo tjetër, ky ndërgjegjësim pozitiv mbetet i mbyllur në bibliotekat universitare apo i kufizuar në kuadër të kolegjeve universitare.

Si rezultat i kësaj e tërë ajo që dëgjojnë njerëzit në Amerikë dhe Evropë janë jehona e pushtimeve islame, kurse në botën islame kujtimet e okupimit imperialist dhe agresionit evropian mbeten nën hijen e bashkëjetesës dhe bashkëpunimit.

### Kush po ushqen urrejtjen mes Islamit dhe Perëndimit?

Autori këtë e përkufizon në dy pika: injoranca dhe kujtimi selektiv. Ai pohon se nëse në ndjenjat tona mbi-sundojnë faktorët e urrejtjes, nënçmimit, të luftës e pushtimit, nëse ne nuk shohim ndonjë rrugë tjetër për të depërtuar, dhe nëse ne shohim se feja është burim kryesor i konfliktit, ne nuk do të kemi mundësi të kufizojmë

faktorët, të cilët nuk kanë kurrfarë lidhjeje me fenë... A janë këto vetëm teori abstrakte?

Natyrisht se jo. Përgjigja vjen nga vetë libri. Amerikanët, sa për ilustrim, janë të prirë të besojnë, se nëse myslimanët nuk bëhen më pak myslimanë sesa që janë tash dhe nëse ata nuk anojnë më shumë nga konceptet perëndimore, atëherë terrorizmi, përhapja e armatimit bërthamor dhe luftërat do të mbeten të pashmangshme.

Karabell, në rreshtat librit të tij, ngre njërin nga dilemat filozofike më problematike, e cila shkakton rivalitet në tërë botën, ajo është “problematika e posedimit të vërtetës absolute”. Kjo në realitet është shkaktare kryesore pas tendencave raciste nga e cila në shekullin e kaluar ranë viktimat miliona njerëz.

Është e saktë se konfliktet fetare ndikojnë dhe ende vazhdojnë të ndikojnë në thesarin e bashkëjetesës paqësore mes besimtarëve të tri feve monoteiste në tërë botën, duke marrë parasysh se ithtarët e tyre e përbëjnë më pak se gjysmën e njerëzimit të botës. Andaj, nisur nga kjo pikë ai përfundon për domosdoshmërinë e shqyrtimit me objektivitet dhe pozitivizëm, me dashuri dhe sinqeritetin më të madh trashëgiminë e bashkëjetesës paqësore, nëse nuk mund të arrijmë te një siguri absolute e botës, ai së paku mund të çojë deri te një e vërtetë e pa-

mohueshme se Islami dhe Perëndimi nuk kanë nevojë “të ngatërrohen në vallen e vdekjes”, siç e quan ai. Myslimanët, të krishterët dhe hebrenjtë jetuan për shekuj një jetë produktive, mësuan njëri-tjetritin dhe mësuan njëri prej tjetrit.

Në rreshta të librit hasim momente të dritës dhe të vërtetës të një autori neutral. Ai ndriçon gjendjen e hebrenjve në botën arabe dhe atë islame deri në përfundimin Luftës së Dytë Botërore dhe se si ata jetuan të lumtur nën pushtetin e myslimanëve, ku gëzuan sigurinë e plotë, lirinë dhe autonominë, të cilat nuk i kishin gëzuar as nën sundimin e të krishterëve. Sistemi islam lejonte pluralizmin fetar. Ai nuk i obligonte ithtarët e feve tjera të braktisin fenë e vet e të konvertoheshin në Islam.

Që nga shekujt e parë të Islamit, shtetet e krishtera dhe ato myslimane bënë tregti mes vete dhe gjatë katërmëdhjetë shekujve, ushtarët e krishterë luftuan në radhët e ushtrive myslimane. Kurse në shekullin e njëzet arabët e krishterë u bënë faktor kyç për formimin e shteteve bashkëkohore arabe të Lindjes së Mesme.

Karabell, në vijim paraqet modele të bashkëjetesës islame-krishtere-hebreje në Anadaluzi. Ai shpjegon se vetëm çereku i atyre marrëdhënieve mund të thuhet se u karakterizua me dhunë dhe urrejtje. Në ndërkohë që tre

të katërtat e skenës tjetër ajo mungon. Marrëdhëniet mund të përshkruhen në mes respektit të ndërsjellë deri te bashkëpunimi efektiv për qëllime të përbashkëta. Në objektivat e përbashkëta zakonisht përfshiheshin projekte shkencore dhe misioni i përkthimit të filozofisë së botës së vjetër dhe urtësisë së saj.

Në të njëjtën kohë ka pasur bashkëpunim të rastit mes bujqve myslimanë dhe të krishterë në Andaluzi, të cilët në shumë raste festonin festat njëri-tjetrit dhe luteshin njëri pranë tjetrit. Ata dëshironin të kishin bereqet sa më të bollshëm, andaj e shihnin të arsyeshme që i krishterë të përsëriste lutjet e myslimanit, kurse myslimani të përsëriste himnet e të krishterit. Ata besonin se këto lutje të përbashkëta mund ishin një garanci për rënien e shiut, ujitjen e tokës dhe prodhimin e bollshëm të të lashtave. Andaj, përkufizimi i momenteve të dhunës dhe përshkrimi i tyre si një fakt historik më shumë se të tjerët, konsiderohet shprehje mbërim dhe falsifikim i historisë deri në shkallën e kthimit të historisë në dialektikë.

Prej Andaluzisë, Karabell na shfaq qeron deri në Konstantinopol, te Sulltan Mehmet Fatihu, i cili e pushtoi kryeqendrën e Romës (Bizantin Lindor) të atëhershëm në vitin 1453. Ai na rrëfen tregimin e tij, mbi lirinë e fesë në atë kohë, si njërin prej aspe-

kteve të bashkëjetesës në refuzimin “valles së vdekjes”, siç shprehet ai. Shtrohet pyetja: Çka kishte ndodhur atje?

Sulltan Mehmet Fatihu nuk mundi ta shihte qytetin e tërë të zbrazet nga banorët e tij grekë. Për ta ruajtur vitalitetin e tij, ai ndërmori atë që duhej të bënte një burrë shteti, sigurimin e të drejtave të gjithë qytetarëve. Si shembull konkret për ndalimin e zbrazjes së qytetit ai u ofroi banorëve kompenzimin e pasurisë së dëmtuar apo të shkatërruar gjatë veprimeve luftarake.

Si stimulim tjetër, Sulltan Fatihu u premtoi se ai nuk do të ndërhyjë në çështjet fetare. Mirëpo, meqenëse patriku i kishës ortodokse, në kohën e rënies së Konstantinopolit ishte jashtë vendit, për këtë, sulltani urdhëroi nëpunësit e tij të hulumtojnë në qytet që të gjejnë ndonjë prift, i cili meriton të jetë në atë post. Ata e gjetën një murg që quhej Ginadijos, i cili ishte i njohur për urrejtjen e tij ndaj pushtetit politik të Romës. Ky person u shpall i pari i kishës. Për një kohë të shkurtër, Ginadijos përfitoi besimin dhe respektin e sulltanit. Për çka ky i fundit e rrethoi me respekt të lartë, duke i dhënë të drejtën ta vizitojë atë në çfarëdo kohe si dhe duke ia dhënë lirinë e fjalës për t’iu drejtuar atij në çfarëdo kohe. Në janar të vitit 1454, sulltani e vendosi në postin e patrikut duke i dhënë qeverisje të plotë në administrimin e

jetës së përditshme të banorëve të krishterë në qytet. “Duke mos i munguar asnjë të drejtë, të cilën e gëzonin në kohën e perandorëve të krishterë”.

Prej Andaluzisë në Bizant e deri në shekullin e njëzet, Karabell përcakton dy faktorë që kanë pasur ndikim të thellë në bashkëveprimin e myslimanëve, të krishterëve dhe hebrenjve mes tyre në shekullin e njëzet. I pari është revolucioni arab kundër osmanlinjve dhe i dyti është themelimi i shtetit çifut në Palestinë.

Mirëpo, lexuesi analitik e kupton atë që e shkroi Karabell, se shfaqja e shtetit izraelit ishte “kryengjarja” në prishjen e marrëdhënieve islamo-perëndimore në shekujt bashkëkohorë. Kjo çoi në rikthimin e së kaluarës së trazuar në dritën e së tashmes. Shtrohet pyetja si dhe përse ndodhi kjo?

Në çmontimin e kaptinës “Lindja e Izraelit dhe pasojat e shfaqjes së tij”, sipas Karabellit, gjejmë një sinjal shumë të rëndësishëm, se pikëpamja perëndimore në të shumtën e rasteve kundruall “nacionalizmit islamik” e përdor imazhin e konfliktit arabo-izraelit për ta sendërtuar historinë e islamit në tërësi dhe se qëndrimet e botës arabe tejet armiqësore ndaj izraelitëve që fillojnë nga mesi i shekullit njëzet kthehen në një mijë e pesëqind vjet më parë. Nëse arabët dhe myslimanët aktual e urrejnë apo janë armiqësor ndaj shtetit çifut Izraelit, ata pohojnë



se kjo ka të bëjë me njërën prej komponentëve themelore të Islamit.

Nga ana tjetër gjejmë pikëpamjen e kundërt, te myslimanët, të cilët nuk dallojnë mes fesë çifute dhe shtetit izraelit dhe si rezultat të urrejtjes për ekzistimin e Izraelit ata e përziejnë me të fenë çifute. Për këtë, ata harrojnë bashkëjetesën me çifutët, e cila përshkruhet si histori e tyre e përbashkët. Çfarë rezultoi me një vizion të gabuar dy dimensional?

Me formimin e shtetit izraelit dhe me luftërat e njëpasnjëshme me botën arabe, të cilat po vazhdojnë edhe sot, shihet sikur myslimanët dhe çifutët duke përfshirë edhe të krishterët e Perëndimit, të cilët u përshkallëzuan nga laicizmi evropian në nacionalizmin amerikan, filluan ta konsiderojnë konfliktin arabo-izraelit si fazë të fundit të një lufte të gjatë mes feve. Ndërkohe që në botën arabe mbretëron botë-kuptimi se myslimanët për një kohë të gjatë iu kundërvunë ekzistimit të hebreizmit dhe ushqyen armiqësi kundër Perëndimit dhe të krishterëve në të njëjtën kohë.

Ndërkohë që në botën arabe ekzistenca e Izraelit u bë simbol i dobësimit të arabëve dhe argument se reformatoret dhe nacionalistët dështuan në realizimin e qëllimit të tyre në ringjalljen e lavdisë arabe.

Kjo analizë serioze e Karabellit, na çon te marrëdhëniet e këqija mes një

numri të madh të vendeve të botës islame dhe Perëndimit, vende islame, që mes tyre dhe Palestinës i ndajnë mijëra mile. Mirëpo, okupimi izraelit dhe për fatin e keq të tij mbeti i paprekur në një tokë të shenjtë të botës islame po ashtu. Kjo është gjendja e myslimanëve të Nigerisë, Indisë, Afganistanit, Pakistanit, Indonezisë, Filipineve etj.

Shkurtimisht, kjo pamje shikohej si një tragjedi që i hoqi një herë e për gjithmonë ëndrrat e reformimit dhe të zhvillimit dhe për shumë myslimanë të botës së afërt apo të largët nuk ishte viti 1948 fillim, por mbarim dhe brenda hirit të premtimeve të dështuara u shfaqen ide të reja të zeza, të errëta, pa shpresë, të cilat shkuan për shekuj të tërë në anën e kundërt të historisë.

### Imazhi negativ i së tashmes

Çka mund të thuhet për të tashmen dhe shpresat e së ardhmes, në veçanti në dritën e komplikimeve të konfliktit palestinez-izraelit, në mënyrë të veçantë dhe rritës së fitoreve të njëpasnjëshme të lëvizjeve politike islame në rajonin e Lindjes së Mesme pas revolucioneve të njohura me pranverën arabe deri më tash? Sipas autorit të librit, ne të gjithë jemi peng të kulturës sonë me shkallë të ndryshme. Andaj, me disa përjashtime mund të thuhet se imazhi aktual i marrëdhënieve mes myslimanëve, të krishterë-

ve dhe hebrenjve është një imazh negativ dhe besimi për ekzistimin e vazhdueshëm të konfliktit mund rrënojset thellë në kujtesën e njerëzve. Atëherë ku qëndron problemi? A qëndron në pikëpamjet tona për të kaluarën, apo në qëndrimet e historisë sonë të dhimbshme apo në tregimet tona të trishtueshme?

Kjo që u tha më lart mund të jetë e vërtetë. Kur brezat e ardhëm të shikojnë pjesën e dytë të shekullit njëzet dhe dhjetë vjetët e para të shekullit njëzet e një do të shohin një mori të dhënash kontradiktore mes vete. Nëse ne nuk bëjmë përpjekje për të gjetur tregime tjera të natyrës pozitive e krijuese. Në mendjet e tyre do të mbetet - kujdestaria e transmetuesi Karabell - se këto vite që janë e tashmja e jonë, janë përshkruar si luftëra mes qytetërimeve, me një armiqësi të shtuar mes myslimanëve, të krishterëve dhe hebrenjve. Ata do të thonë, koha jonë u cilësua me rritën e dhunës, akteve

terroriste, aksioneve vetëvrasëse dhe frikës së depërtimit të armëve për shkatërrim në masë në duar të grupeve terroriste. Shtrohet pyetja: Kush është fajtor? A ekziston me të vërtetë fajtori?

Në fund, autori i librit fajëson myslimanët, të krishterët dhe hebrenjtë për shkak të fokusimit të tyre kokëfortë në aspektin e konflikteve. Vërehet që secili grup tenton ta paraqesë të kaluarën një seri poshtërimesh, viktimë e të cilave kishte nga dy grupet tjera. Rezultat i pashmangshëm i të cilës është, shtimi i intolerancës fetare në tërë botën.

Shkrimtari i madh francez, Viktor Hugo, në një rast kishte thënë: “Reziqet e mëdha kanë një lloj bukurie, sepse ato e përqendrojnë dritën e marrëdhënieve vëllazërore mes të huajve”. A nuk është e denjë për monoteistët, myslimanë, të krishterë dhe hebrenj të hulumtojnë për këtë bukuri tash?

## MERHUMËT TANË

*Sadik Mehmeti*

### KALOI NË AHIRET IXHAZETLIU I FUNDIT NË OPOJË - HAXHI SALIM EF. REXHEPI - 4.05.1921 - 7.05.2012

Haxhi Salim ef. Rexhepi u lind më 4.05.1921 në fshatin Bresanë të Opojës. Është pinjoll i derës së fisme të hoxhallarëve të këtij fshati. Gjyshi i Haxhi Salim efendiut, Mulla Ismaili, i biri i Shaqirit, për një kohë të gjatë kishte shërbyer si imam në fshtain Bellanicë të Malishevës. Kurse i ati i Haxhi Salimit, Haxhi Rexhep efendiut (1871- 1956) ish-studenti i dalluar i medresesë “Mehmet Pasha” të Prizrenit, i laureuar me ixhazet nga myderrizi i njohur, alimi e hoxha i Prizrenit, Hafiz Abdylaziz ef. Kurtishi, ka qenë myderriz dhe drejtues për afro 40 vjet i medresesë së Opojës në Bresanë.

I lindur, i rritur dhe i edukuar në një familje me traditë në arsimim dhe shkollim, Salimi i ri s’kishte se si të



bënte përjashtim. Prandaj, pasi që kishte kryer mektebin, më 1930 qe regjistruar në shkollën fillore publike në vendlindje, e cila kishte zgjatur pesë vjet, përfshirë këtu edhe një klasë përgatitore për mësimin e gjuhës serbe.

Pas mbarimit të shkollës fillore më 1935, Haxhi Salim efendiut, po këtë vit, nisi mësimet në medresenë e Opojës në Bresanë, tek i ati i tij dhe myderrizi Haxhi Rexhep ef. Ismaili, tek i cili më 3 të muajit shaban 1366 h. (22 qershor 1947) do ta merrte edhe ixhazetnamenë-diplomën, pasi kishte përvetësuar shkëlqyeshëm lëndët, së bashku me disiplinat e tyre, që asokohe mësoheshin në medrese: Kur’an, Tefsir (komentimi i Kur’anit), Tradita Islame (ilmi hadith), Apologjetika islame (ilmi kelam), Jurisprudenca islame (ilmi fikih), Bazat e të Drejtës së Sheriatit (ilmi usuli fikih), Filozofi (ilmi hikmet), Gramatika arabe (sarf), Sintaksa arabe (nahv), Logjika (mantik), Stilistika (ilmi meani), Poetika (ilmi bedi) dhe Retorika (ilmi adab).

Haxhi Salim efendiut nuk ishte i vetmi në këtë familje, pas babait dhe gjyshit të tij, që ishte ixhazetli. Edhe vëllai i tij Haxhi Adnan ef. Rexhepi (1925-2001) po në vitin 1947 kishte arritur të merrte ixhazetnamenë, madje ky ishte edhe hafëz i Kur’anit, kurse dy vëllezërit tjerë Bushra efendiut dhe Bejtullah efendiut, për shkak se më 1948 nga ana e pushtetit që po instalohej në atë kohë do të mbylleshin medresetë e Kosovës, pra edhe medreseja e Opojës, nuk do të arrinin deri në ixhazet, veç se do të kryenin detyrën e imamatit e mualimit

në fshatra të ndryshëm të Opojës dhe me gjerë. Dhe jo vetëm kaq, por traditën e kësaj familjeje hoxhallarësh dhe arsimdashës do ta vazhdojnë një varg i tërë i pasardhësve, të cilët do të mbarojnë medrese e fakultete, për të shërbyer në fusha të ndryshme të dijes dhe të fesë.

Pas mbarimit të medresesë, Haxhi Salim efendiut kishte vajtur në shërbimin ushtarak. Pas kthimit nga atje, për një kohë do të qëndronte i papunë deri në vitin 1953, kur filloi si imam në fshatin Grekoc të Suharekës, detyrë kjo të cilën e kreu për 15 vjet me radhë, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në shpjegimin dhe mësimin e fesë islame dhe në edukimin e popullatës së këtyre anëve.

Në vitin 1968 u emërua imam në fshatin e tij të lindjes, në Bresanë, ku shërbeu deri në vitin 2002, kur pas pesë dekadash, la detyrën e imamatit aktiv.

Krahas detyrës së imamatit, Haxhi Salim efendiut kryente edhe detyrën e mualimit në mektebin e fshatit, nga i cili mësuhan leximin e drejtë të Kur’anit dhe shartet e fesë islame një numër i konsiderueshëm i fëmijëve nga fshati Bresanë dhe Kuklibeg. Disa nga nxënësit e mualim Haxhi Salim efendiut, më vonë, do të kryejnë medresenë dhe fakultete drejtimesh të ndryshme dhe shumë nga ata do t’i

gjejmë duke shërbyer në institucione fetare e publike gjithandej Kosovës.

Haxhi Salim efendiu deri në ditët e fundit të jetës së tij, megjithëse i thyer në moshë, nuk iu nda xhamisë dhe angazhimit të tij të herëpashershëm brenda në xhami dhe jashtë saj.

Ai ishte simbol i brezit të vjetër të hoxhallarëve autoritativ, kompetentë e të ditur; i atyre ixhazetlinjve plotë ilm, dituri e urtësi, që ditën t'u bënin ballë dhe të qëndronin stoikë ndaj furtunave dhe rropatjeve të ndryshme që u solli jeta, i atyre personaliteteve të shquara që ditën t'u prinin xhematëve dhe qytetarëve të tyre edhe atëherë kur për një fjalë e për një shkronjë plaste hataja.

Haxhi Salimi, siç qe i popullarizuar me këtë emër - gëzonte një respekt të thellë kudo që paraqitej ndër besimtarët e Bresanës në veçanti dhe të Opojës në përgjithësi. Dallohej për urtësinë dhe maturinë e tij, qoftë në biseda fetare, qoftë në të tjera. Fjalët, këshillat, porosinë, derset, vazet dhe nashihatet e tij në xhami, në mexhlise e oda, ishin me peshë, dëgjoheshin dhe merreshin seriozisht. Pas përgjigjeve të argumentuara, bindëse e të sakta që jepte Haxhi Salimi, nuk mbetej vend për dyshime e diskutime. Shpjegimet e tij në çështje të ndryshme, qetësonin zemrat e interesuara e të trazuara të pyetësve, qofshin edhe nga ata të asaj kohe (mos iu përmendt emri kurrë!)

që provokonin dhe mundoheshin të thumbonin në adresë të hoxhallarëve dhe të fesë. Me zërin e tij të butë, karakteristikë, plot këshillëdhënës e edukativ, Efendiu i nderuar s'kishte se si të mos i përvetësonte dhe t'i bënte për vete xhematlinjtë dhe bashkëbiseduesit...

Haxhi Salim ef. Rexhepin, përveç se imam dhe mualim, për shkak të personalitetit, autoritetit, urtësisë dhe mençurisë - veti që e karakterizuan gjithmonë - e gjejmë të angazhuar dhe në ballë të shumë çështjeve edhe jashtë xhamisë, jo vetëm në fshatin e tij në Bresanë, por edhe në fshatrat e tjerë të Opojës. Aktiviteti i tij shtrihej edhe përtej xhamisë dhe mektebit, si në zgjidhjen e kontesteve të ndryshme, në pajtime, organizime e aktivitetet dhe ngjarje të ndryshme në gëzime e hidhërimet.

Ai ishte shumë i respektuar dhe i nderuar edhe në mesin e kolegëve dhe hoxhallarëve të tjerë. Këtë më së miri e tregon fakti se për tre mandate (1979-1991) Haxhi Salim efendiu ishte edhe kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame të Dragashit-Sharrit. Ndërsa në mesin e hoxhallarëve të rinj, ai kishte vendin e vet të posaçëm, aty ku ishte ai, hoxhallarët tjerë vinin pas tij. Prandaj, për këtë arsye, jemi të bindur se hoxhallarët e rinj të Bresanës dhe të Opojës, do të ndjekin rrugën e Haxhi Salimit, i cili ishte si një

urëlidhëse mes brezit të vjetër dhe brezit të ri të hoxhallarëve të Opojës. Rruga që ndoqi ky brez i hoxhallarëve të kalibrit të Haxhi Salimit dhe pararendësve të tij, duhet të jetë shembull dhe model për gjeneratat e reja të hoxhallarëve jo vetëm në Opojë, sepse rruga e këtij brezi është dëshmuar si më e suksesshme, më e mira, më dobiprurësja, më e zgjedhura, më e sigurt dhe më e pranueshme; është ajo "*rruga e mesit*" apo "*mesatarja*" për të cilën porositi Kur'ani dhe Syneti i Muhamedit a.s.. Haxhi Salimi nuk u shmang nga kjo rrugë, përkundrazi...

Për punën dhe kontributin e tij prej disa dekadash në shërbim të xhamisë dhe arsimimit e edukimit të brezave të rinj, Bashkësia Islame e Kosovës, më 11 gusht 2011, Haxhi Salim ef. Rexhepit i ndau një mirënjohje.

Ditën e hënë më 7.05.2012, Haxhi Salim efendiu në pajtim me urdhrin e Allahut xh.sh. se "çdo i gjallë do të vdesë" dhe se në Ahiret do të shkojnë vetëm ata që erdhën në Dynja, si një shpirt i bindur plotësisht për fundin e misionit të tij, rahat e qetë-qetë iu kthye Zotit të tij. Haxhi Salim efendiu u varros po atë ditë në vendlindjen e tij, pasi iu fal namazi i xhenazës nga qindra qytetarë nga Opoja, Sharri, Prizreni e Suhareka.

Kalimi në Ahiret i hoxhës, imamit, hatibit e mualimit tonë të nderuar Haxhi Salim ef. Rexhepit, i jep fund pe-

riudhës së ndritur e të bereqetshme të ixhazetlinjve, mbase jo vetëm në Opojë. Me të mbyllet perioda afro pesëshekullore e ixhazetlinjve të nisur në hajratet dhe vakëfet e të përkorit dhe të ndriturit Mehmet Kuklibegut të Opojës.

Me vdekjen e Haxhi Salim ef. Rexhepit, Bresana dhe Opoja humbën edhe një hoxhë të ditur e të ngritur, mungesa fizike e të cilit do të vërehet dukshëm, por fjalët dhe këshillat e tij sigurisht që do të gjallojnë brez pas brezi për një kohë të gjatë.

Allahu i Madhëruar shpirtit të bekuar të Haxhi Salim efendi Rexhepit i pastë siguruar një vend të merituar në Xhenet. Amin!

ربنا اغفر لنا ولاسآذننا ولاسآيئنا  
 وشركائنا ومن وصانا بالعقار الخير  
 والمؤمنين والمؤمنات يوم يقوم الحساب  
 لا اله الا الله محمد رسول الله  
 كذا بينا ان شاء الله لا حول ولا قوة  
 الا بالله والمحمد لله تعالى بدأ وكأما  
 وعلى انبياءه تحية وسلاما  
 كنه القصر الرسامة الراجي عفو و  
 عفو القصر المدرس محمد رس برو  
 دوصا محمد المسيسي عم اهد اماري  
 من مصادي الناعة محمد رس بررس  
 صابها الله من الهللا الى يوم الدين  
 وذلك في اليوم الثالث من شعبان المظلم  
 من شهر ربيع سنة ١٢٨٥  
 ماء بعد الالف من الهجرة من الف والاربع  
 رجب مجودي بن اسماعيل

بسم الله الرحمن الرحيم  
 الحمد لله الذي علمنا ما لم نعلم واسعدنا  
 بتعليم العلوم واكرم . والصلوة والسلام  
 على محمد المرشد للامم وعلى آله  
 واصحابه العالمين بشرية النبي المحترم  
 فاعلم وحقك الله وايانا لطاعة اذ السب  
 لنيل الكرامات العلية والمقامات النبوية  
 والمرتبة البرية والعبادة الابدية  
 له العالم الشريف . حيث قال صلى الله  
 عليه وسلم . من سلك طريقا يلتمس  
 فيه الله سهل الله له طريقا الى الجنة  
 وان الملائكة لتضع اجنحتها  
 لطالب العلم رضاه بما يصنع وان العالم  
 يستغفر له من في السموات ومن في الارض  
 حتى الحيتان في الماء . وان فضل العالم  
 على العابد كفضل القمر ليلة البدر على  
 سائر الكواكب وان الزاهد العابد بلا علم  
 كقوس بلا وتر . **وننقل** وان العلماء  
 ورثة الانبياء . وقال عليه الصلاة والسلام

Faksimile i faqes së parë dhe të dytë të ixhazetnamesë  
 së Haxhi Salim ef. Rexhepit

## MERHUMËT TANË

*Olsi Jazexhi*

### RAHMET PASTË ALI BASHA

1.

Më 31 mars 2012, nga postimet e njerëzve në facebook, mësova që në Tiranë kishte ndërruar jetë Ali Basha. Vdekja e Aliut, ashtu si të gjitha vdekjet tjera që dëgjoj të ndodhin në vitet e fundit, me erdhi e papritur. Edhe pse Aliu më ankohej prej vitesh për shëndetin e tij të lig e më thoshte që nuk e kishte të gjatë, sërish vdekja e tij më erdhi si një lajm i papritur e trishtues. Më trishtoi pse me largimin e njerëzve të mirë nga kjo botë, më duket sikur largohet edhe një pjesë e imja. Largohen kujtime të bukura që kam nga koha e rinisë, e në të njëjtën kohë, vdekja e miqve më kujton që edhe unë si të gjithë të gjallët tjerë, vdekjen dhe kthimin te Allahu e kam të afërt.



*Ali Basha  
1932-2012*

2.

Edhe pse kishim diferencë të madhe në moshë, Aliu ka qënë për mua një nga mendjet më të kthjellëta my-

slimane shqiptare që kam njohur ndonjëherë. Aliun e kam njohur si fytyrë në vitet '95 kur punonte në Komunitetin Mysliman. Megjithatë, njohja ime ideore me Aliun, nisi të realizohet në vitin 2000, kur ai botoi librin "Islami në Shqipëri gjatë shekujve". Njohja fizike me të u konkretizua pas vitit 2002, kur u ktheva nga Malajzia. Në kohën kur unë u ktheva në Shqipëri dhe shkruaja në shtypin e Tiranës për problemet e myslimanëve shqiptarë, Aliu që ndiqte shkrimet e mia, më kontaktonte herë pas here dhe më jepte opinionet e tij.

Vitet 2002 deri në 2005, kanë qënë disa nga vitet më të rënda për myslimanët shqiptarë. Regjimi i Fatos Nanos, që ishte në pushtet në atë kohë, duke u bërë aleatë me amerikanët në luftën "kundër terrorit" persekutonte në mënyrë të frikshme myslimanët. Vrasja e sekretarit të përgjithshëm të Komunitetit Mysliman Sali Tivarit, në zyrën e tij në 2003, ishte një nga pretekset që regjimi i Nanos përdori në ato kohë për të arrestuar me dhjetëra hoxhallarë në gjithë vendin dhe lëshuar një fushatë të frikshme islamofobike, përgjimesh, kërcënimesh e vrasjesh nëpërmjet shërbimit sekret të drejtuar nga Fatos Klosi. Aliun unë e njoha në këto kohë të vështira e frike. E takoja në shtëpinë e tij pranë rrugës së Barrikadave, në iftare dhe xhamitë e Tiranës. Si mysliman i ri dhe ene-

rgjik që isha në atë kohë, për mua, Aliu ishte një thesar diturie dhe urtësie. Ai kishte parë e dëgjuar edhe më keq sesa përjetonin në nën sundimin e socialistëve dhe shpjegimet e tij për të kaluarën, për mua, shpesh dukeshin profetike.

3.

Siç e kam përmendur edhe në shkrime të tjera, Ali Basha ishte djali i Musa Bashës, kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, nga viti 1945 deri në 1954. Ishte nip i Haxhi Ali Elbasanit, kryetarit të klubit osmanist të Aksarajit dhe një nga ulematë më të mëdhenj të Shqipërisë Osmane. Ai trashëgonte në familjen e tij dy paraardhës hoxhallarë; njëri kishte qënë besnik i kalifatit, ndërsa tjetri i Shqipërisë, e më pas bashkëvuajtës i kohës së komunizmit dhe luftës së tij ndaj fesë. Aliu ishte një besimtar që kishte përjetuar katër epoka ndryshimesh madhore në historinë e Shqipërisë. Ishte lindur në kohën e Zogut më 1932, kur mbreti në emër të shqiptarisë i mbylli gjyshin në shtëpi, ndërsa oksidentalizoi e laicizoi vendin. Më pas kishte parë kohën e pushtimit fashist dhe nazist kur servilët shqiptarë ia dhanë Shqipërinë Duçes dhe Hitlerit. Më vonë, pas çlirimit kur mbaroi medresenë në vitin 1950-1951 dhe Fakultetin e Histori-Filologjisë në Tiranë, përjetoi epokën e komunizmit. Më

në fund Aliu përjetoi edhe kohën e demokracisë kur Shqipëria u kthye në një koloni euro-amerikane dhe shqiptarët u lëshuan si të tërbuar ndaj Perëndimit, duke shkatërruar çdo vlerë dhe arritje të kaluar të tyre dhe degjeneruar në masë.

Ndryshe nga gjyshi dhe babai i tij që patën fatin të bëhen ulema dhe hafizë me çallma, Aliu u shkollua në shkollat nacional-ateiste të kohës së komunizmit. Ai dha mësim në Kinë, e më pas punoi në shtëpitë botuese “Naim Frashëri” dhe “8 Nëntori”. Edhe pse jetoi në një regjim ateist, nga babai dhe mësimet e medresesë trashëgoi besimin në Zot. Pas rënies së komunizmit ai i'u bashkangjiti Komunitetit Mysliman, ku edhe shërbeu për shumë vite.

Aliu ishte një besimtar i mirë dhe i urtë. Edhe pse nuk ishte ulema si ulematë klasikë, por më shumë letrar dhe historian, ai kishte një brengë të madhe për fenë. Ndërsa brezi i ri i myslimanëve shqiptarë nuk e dinin sesi kishte qënë e kaluara e Islamit në vend, ai me urtësinë e tij, donte që të dokumentonte për besimtarët e rinj dhe naivë të shkuarën e Islamit në vendin tonë. Libri i tij i parë “Islami në Shqipëri gjatë shekujve” që u ndoq nga “Nëpër gjurmët e Islamit” (2005) tregojnë brengën që Aliu mbante në vete. Kur takohesha me të në fillim të viteve 2000, shqetësimi kryesor që ai

kishte - ndërsa shihte dëbimin e misionarëve arabë dhe shkatërrimin e infrastrukturës së Komunitetit Mysliman nga qeveritë socialiste - ishte e ardhmja e Islamit. Më tregonte me pesimizëm që e ardhmja nuk do ishte e mirë. Ankohej që në vitet '90, kur koha ishte e mbarë për Islamin, arabët nuk kishin punuar si duhet, nuk i kishin dëgjuar të vjetrit dhe kishin shpenzuar para kot. Misionarët myslimanë ishin përqëndruar kryesisht nëpër fshatra dhe provinca të thella dhe kishin shkolluar njerëz me pak kulturë, ndërsa Tirana, ku ishte elita intelektuale e vendit ishte lënë jashtë vëmendjes.

Aliu, për mua ka qenë syndritur lidhur me të shkuarën e Islamit në Shqipëri. Ndryshe nga ç'mendoja unë dhe si trajtohet feja në Shqipërinë e pas-komunizmit, ku fajet i hidhen vetëm komunizmit, ai ishte i pari që më tërhoqi vërejtjen të kuptoja se shkatërrimi i fesë në Shqipëri nisi që në kohën e Mbretërisë, gjatë konsolidimit të shtetit shqiptar, kur Zogu shkatërroi strukturat e Islamit në vend, konfiskoi vakëfe, mbylli mejtepet, u hoqi çallmat hoxhallarëve dhe ndaloi shariat. Për atë Enver Hoxha ishte produkt i nacional-laicizmit zogist dhe finalizues i një projekti që nisi më herët.

Në vitet kur unë e njoha Ali Bashën, Islami sulmohej në mediumet e Tiranës nga fundamentalistët e krish-

terë dhe laik, vuante nga mungesa e ndihmës, e shoqërisë civile, injoranca, frika, oportunizmi dhe paorganizimi i myslimanëve të Shqipërisë. Edhe pse me sëmundje të shumta, Aliu i cili nuk e ndryshonte dot këtë situatë dhe që në njëfarë mënyre trembej nga terrori i pushtetit agresiv socialist, energjitë e tij i kishte përqëndruar te shkrimi i së aluarës. Kush ka lexuar librat e tij do të shohë që në çdo gjë që ai shkruante tregohej shumë i kujdesshëm. Regjimi komunist kishte bërë të veten tek ai, dhe për këtë, gjithmonë mendohej të shkruante brenda normave kombëtare - ndryshe nga ç'shperehej në konfidencë me të njohurit. Librat që ai botoi janë dëshmi e punës së tij. Në librin “Islami në Shqipëri gjatë shekujve” ai tregon rrjedhat e Islamit në vendin tonë, duke u përqëndruar më shumë në kohët që nga krijimi i Komunitetit Mysliman e deri në zhdukjen e fesë nga komunistët. Në librin “Nëpër gjurmët e Islamit” ai mundohet që në njëfarë mënyrë të mbledhë citate dhe t'u kundërvihet islamofobëve të sojit të Piro Mishës, Ismail Kadaresë dhe fondamentalistëve të tjerë të krishterë të asaj kohe, të cilët e tregonin Islamin si fenomen të huaj që duhej larguar nga Shqipëria.

Megjithatë, kryevepra e Aliut, për të cilën unë mendoj se ai do të kujtohet për shumë kohë nga ata myslimanë që kuptojnë rëndësinë e shkrimit

dhe të dijes, ishte libri i tij i fundit që botoi në vitin 2011 “Rrugëtimi i fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)”. Aliu nisi të punojë për këtë libër që në mesin e viteve 2000. E mbaj mend si tani kur e takoja në Arkivin e Shtetit, sesi çapitej me bastunin që mbante në dorën e djathtë, me vetullat e mëdha të bardha dhe me trupin e shëndoshë por të sëmurë, sesi rrinte me orë të tëra në arkiv, ku lexonte dokumentet që drejtorja e arkivit ia nxirrte si me sitë. Përndryshe, nga trajtimi që stafi i Nevila Nikës u bënte kaurëve si Kristo Frashëri dhe të tjerë, të cilëve u jepej akses i pa-limit në arkiv dhe në dosjet arkivore, Aliut i duhej të priste me ditë derisa arkivistët t'i nxirrnin dosjet që ai kërkonte. Megjithatë, ai punonte me durim edhe në rastet kur nuk i jepnin materialet që ai kërkonte. Meqë nuk kishte mjete të avancuara kopjimi, ai rrinte me orë të tëra në arkiv dhe merrte shënime me dorë mbi dokumentacionin që lexonte. Kur e shihja sesi mendohej në mes të vapës duke kopjuar dokumentet i thosha: O Ali – shko në shtëpi se u lodhe. Duke marrë frymë me vështirësi më thoshte: Duhet ta bëj këtë punë, pse nuk e di sesa të gjatë do e kem, e duhet ta nxjerr këtë libër medoemos.

Libri “Rrugëtimi i fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)” është një vepër me të cilën Aliu i ka bërë një shërbim të thellë dokumentimit të historisë së

Islamit dhe Shqipërisë. Edhe pse ai nuk e sulmon laicizmin e Zogut dhe të Enver Hoxhës drejtëpërdrejt dhe e mbron procesin e kombëtarizimit, libri i tij është një rrëfyes i trishtë që tregon fatet e islamizmit në përballjen e tij me laicizmin në Shqipëri. Për mendimtarët që duan të kuptojnë, libri që Aliu shkroi për së fundi, tregon qartë që në ato vende ku myslimanët nuk zhvillojnë një Islam politik, por politikën, arsimin dhe ideologjinë ia lënë të pafeve, fati i fesë do të jetë në rrezik dhe feja do të zhduket me kalimin e kohës.

#### 4.

Kur në vitin 2011, mësova nga djali i Aliut, se ai kishte arritur më në fund të botojë librin unë u gëzova pa masë. Rahmetliu Ali kishte arritur më në fund që të shkruante librin, për të cilin u lodh aq shumë në vitet e fundit të jetës. Librin të cilin e sigurova në formë elektronike e kam lexuar me zell në netët e Ramazanit 1432, në brigjet e Liqenit të Ontarios. Ai është një mrekulli, një dokumentim i mrekullueshëm që do t'u shërbejë atyre që do të vijnë pas nesh. Tani që Aliu nuk është më me ne, unë ngushëlloj vetveten pse them, të paktën kemi trashëguar punën e tij. Në librat e tij ne mund të gjejmë akoma mendjen Aliut, që qëndron brenda tyre. Herë pas here, kur më duhet t'i konsultoj ato, para

meje shfaqet edhe imazhi i Aliut, me flokët e tij të bardhë, vetullat e gjata të thinjura, sytë ngulmues, dorën e trashë dhe të folurën e avashtë me zë të ulët. Më kujtohen ditët e nxehta të verës kur i shkoja në shtëpi, pinim pije freskuese dhe bënim muhabet. Më kujtohen edhe netët e dimrit kur e telefonoja nga Italia dhe e pyesja për Haxhi Qamilin, Haxhi Aliun, Musa Qazimin, Esat Pashën, Zogun, Komunitetin Mysliman, fashistët, Enver Hoxhën, vakëfet dhe shumë e shumë hoxhallarë të të shkuarës, që tashmë nuk janë më mes nesh, por ne i përmendim vetëm si histori. Edhe pse Aliu nuk është më në këtë botë, mbresat që ai më ka lënë janë të thella dhe për këtë i jam mirënjohës.

Unë nuk besoj se do të kem mundësi që ta shoh Aliun më në këtë botë, pasi ai tashmë ka kaluar në botën e përtejme. Tani ai ndodhet në berzakh, ku është duke pritur Ditën e Madhe. Megjithatë, unë për një gjë jam i bindur; në Ditën e Qametit, kur Allahu do të ringjallë njerëzit dhe gjithçka që Ai ka krijuar, unë shpresoj që do ta shoh përsëri Aliun. Për këtë edhe i lutem Allahut që ta shoh atë dhe veten time në turmën e njerëzve të mirë të Muhamedit a.s. dhe të më japë mundësi, që të dëshmoj për të për të mirë. Meqë kur ai vdiq unë nuk para mundësi të ndodhesha në Shqipëri e t'i falja xhenazën, këtë shkrim po e

shkruaj si një dua para Allahut, njerëzve dhe melaqeve që regjistrojnë, për të dëshmuar respektin dhe dashurinë time për Aliun. Për këtë edhe i lutem

Allahut, që rahmeti dhe selami – mëshira dhe paqja e Tij të jetë mbi atë dhe ata që e duan dhe i shërbejnë fesë së Tij. Amin!

## MERHUMËT TANË

### NDAHET NGA JETA DR. IBRAHIM Rr. GASHI -Të dhëna biografike- (23 gusht 1935 - 9 maj 2012)

Lindi më 23 gusht 1935, në Krujë. Mbaroi shkollën e mesme në Mitrovicë të Kosovës (1955). Vazhdoi fakultetin e Shkencave të Natyrës, dega matematikë-astronomi, në Universitetin e Beogradit (1955-1959). Para diplomimit, në prill 1959, me disa studentë të tjerë shqiptarë, burgoset nga organet e UDB-së dhe me 15 qershor të atij viti dëbohet familjarisht për në Shqipëri. Diplomohet në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, dega matematikë, në Universitetin e Tiranës. Për vite me radhë, ka qenë mësimdhënës i matematikës në shkollat e mesme të Krujës, kurse në vitet 1984 deri 1990, në Universitetin e Tiranës, profesor i jashtëm. Për punë të mirë në mësimdhënie, është dekoruar me medaljen “Naim Frashëri”.



Dr. Ibrahim Rr. Gashi

Gjatë punës 31-vjeçare të tij në arsim, përveç se në mësimdhënie, është dalluar edhe në veprimtarinë shkencore e pedagogjike me arsimtarët e rethit. Për shumë vjet kreu detyrën e

kryetarit të komisionit të lëndës së matematikës për shkollat e mesme, në rrethin e Krujës. Mori pjesë në diskutimet për hartimin e teksteve të reja për matematikën dhe astronominë, madje, për këtë të fundit përgatiti e botoi përmbledhjen, “Probleme të zgjidhura astronomike”, si dhe “Vrojtimit astronomike”, për vitin e katërt të shkollave të mesme.

Puna e tij e vazhdueshme, në thellimin e studimeve shkencore, u kurorëzua në vitin 1979, me fitimin e gradës shkencore “Kandidat i shkencave”, konvertuar më vonë, “Doktor i shkencave”.

Në vitet 1980-1982, duke qenë zv.drejtor i shkollës së mesme “Shote Galica“, në Fushë Krujë, mori pjesë për krijimin e një dhome muze aty, për Heroinën Shote Galica dhe luftëtarët për çlirimin e Kosovës. Gjithashtu, punoi për organizimin e një simpoziumi shkencor, me tematikën përkatëse. Për këtë qëllim, aktivizoi punonjës shkencorë të Institutit të Historisë në Tiranë, si dhe mësimdhënës të kësaj lënde të shkollave të rrethit të Krujës. Ai e ndoqi ecurinë e këtyre përgatitjeve, grumbulloi materiale dokumentare nëpër muze e arkiva të vendit, zhvilloi biseda me bashkëkohës të Shotës dhe të Azemit, si dhe organizoi një ekspeditë njëjavore në viset veriore të Shqipërisë, ku strehoheshin çetat lu-

ftarake të Kosovës pas aksioneve që zhvillonin kundër serbëve. Falë punës së devotshme të I.Gashit dhe të studiuesve, që përgatiten temat e simpoziumit, puna e nisur u kurorëzua me sukses të plotë. Dhoma Muze u bë qendër e vizitave nga shkolla të ndryshme të vendit, kurse simpoziumi u vlerësua lart për nivelin shkencor të temave të paraqitura.

Dr. Gashi, nga janari 1993 e deri shtator 1996, ka kryer detyrën e diplomatit (sekretar II) në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë, në Slloveni. Atje ndoqi çështjet e marrëdhënieve dypalëshe në fushën e politikës, arsimit, kulturës, e mbrojtjes, si dhe çështjet konsullore. Detyrë të veçantë ka patur Diasporën Shqiptare në Slloveni.

Doli në pension më 1996. Gjatë kësaj kohe, shkroi shumë artikuj shkencorë e metodikë për lëndët matematikë dhe astronomi, po kështu edhe me tematikë sociale e politike. Ka botuar 11 libra, tetë prej tyre me përmbajtje matematiko-astronomike dhe kronologjike. Në vitin 2007, botoi librin “Shqiptarët, Sllovenia dhe Ballkani i trazuar, sipas një diplomati”, që është produkt i vrojtimeve, analizave dhe përfundimeve të nxjerra gjatë punës së tij katër-vjeçare diplomat, pranë Ambasadës Shqiptare në Lubjanë.. Në mars të vitit 2009, botoi monografinë



”Xhemal Pazari, patriot i shquar tiranas”.

Ndër artikujt shkencorë të shkruar nga ky autor, të rëndësishëm janë sidomos ata të fushës së matematikës, që flasin për gjeometritë joeuklidiane, për bazimet e gjeometrive në përgjithësi, për mësimdhënien e matematikës në shkollat e mesme etj. Kurse nga fusha e astronomisë janë ata, ku trajtohen problemet e kronologjisë e kalendarëve, pa anashkaluar edhe çështjet e mësimdhënies në këtë lëndë.

Nga 11 librat e botuara deri tani, 3 janë me përmbajtje astronomike dhe 5 të tjera, me tematikë pak të rrahur në vendin tonë, në të cilat pasqyrohen njohuri për kalendarët dhe kronologjinë si shkencë, të domosdoshme për studiuesit e periudhave të ndryshme historike. Në to përveç bazimeve matematiko-astronomike, për kronologjinë dhe kalendarët, janë dhënë edhe shembuj të shumtë ngjarjesh historike e dukurish natyrore, të kronologjizuara sipas kalendarëve të ndryshëm.

Dr. Ibrahim Gashi, ndonëse në moshë të thyer, deri në fundin e jetës së tij nuk iu nda hulumtimeve dhe shkrimeve, si në fushën e shkencës, ashtu edhe në atë shoqërore-atdhetare. Pasi

botoi librin (me bashkautor Fazli Haxhizinin) ‘Mësuesi Rrahim Gashi, me brezat në trojet Arbërore’ (nëntor 2010), udhëhoqi me atdhetarezëm e aftësi profesionale veprimtarinë e Institutit të Integritetit të Kulturës Shqiptare, me qendër në Tiranë, lidhur me “*Studimin e mundësive të përafrimit, deri në njësim, të programeve e teksteve mësimore, në trojet shqiptare dhe në diasporë*”.

La në dorëshkrim edhe disa libra të tjerë, dy prej të cilëve lidhen me kronologjinë shqiptare.

Me ndarjen përgjithnjë nga jeta të Dr. Ibrahim Gashit, bashkëshortja, fëmijët, motrat e gjithë familjarët e tij, humbën njeriun e tyre shumë të dashur dhe të paharruar. Ndërsa kolegët, miqtë dhe dashamirësit e tij të panumërt, në Shqipëri, Kosovë e trojet tjera shqiptare dhe në Diasporë, u ndanë nga atdhetari i zjarrtë, arsimtari e diplomati, veprimtari i palodhur, studiuesi dhe botuesi i zellshëm në fushën e traditave kombëtare shqiptare.

*I paharruar qoftë kujtimi i tij!*

(Nga: **Murat Gecaj**,  
Tiranë, 9 maj 2012)

## BIBLIOGRAFI

*Ramadan Shkodra*

### BIBLIOGRAFIA E REVISTËS “EDUKATA ISLAME” nr. 1/1971 - 99/2012

#### Parafjalë

Bibliografia e punimeve të revistës "Edukata Islame" është përgatitur me rastin e botimit të numrit 100 të revistës “Edukata Islame”, që shënon një moment të rëndësishëm në historinë e periodikut dhe publicistikës islame në gjuhën shqipe tek ne.

Revista “Edukata Islame”, mbi katër dekada, është bartëse, shtytëse, promovuese dhe tribunë e fjalës së shkruar islame në gjuhën shqipe, jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë.

Ndonëse misionin e saj “Edukata Islame” e nisi në vitet ‘70 të shekullit të shkuar, në kohën e sistemit monist, ajo me sukses arriti që të plasoj tek lexuesit dhe besimtarët mësimet për fenë islame.

Në fillim të misionit të saj, revista “Edukata Islame”, pati fatin të ishte e vetmja revistë islame që botohej në gjuhën shqipe. Kjo për shkakun se në Shqipëri me ligj qe ndaluar feja, ndërsa në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare, nuk kishte traditë të botimit të periodikut islam në gjuhën shqipe.

Megjithëqë në kohë të vështira, “Edukata Islame”, falë drejtuesve të saj, arriti që afër vetës të tubonte një sërë entuziastësh e dashamirës të fjalës së shkruar, dhe në këtë mënyrë kjo revistë u shndërrua në një tribunë-shkollë të publicistikës islame.

Kështu, bashkëpunëtorët e saj, dora-dorës, nga numri në numër, nga tema në temë, mësuan artin e të shkruarit, ndërsa besimtarët dhe lexuesit fituan njohuritë themelore për fenë islame, kurse vetë “Edukata Islame” fitoi fizionominë, formën dhe përmbajtjen e saj, fitoi lexuesit e saj, duke kultivuar kështu dita ditës historinë e kulturës islame tek ne.

“Edukata Islame”, në mënyrë të suksesshme u shndërrua nga ideja dhe projekti në realitet të prekshëm, e cila jo që la gjurmë në historinë më të re të Kosovës, por u bë pjesë e historisë së kulturës, publicistikës dhe qytetërimit islam tek ne.

“Edukata Islame” është histori e gjallë e fjalës së shkruar islame, për këto 40 vjet të veprimtarisë së saj në mënyrë më të mirë, në kushte jo shumë të favorshme, qe zëri i edukimit shpirtëror, qe dera për njohjen e Allahut xh.sh, qe promovuse e veprimeve të Pejgamberit a.s., qe zëri i urtësisë dhe arsyes, qe zëri i besimit -imanit.

Nuk mund të shkruhet historia e kulturës dhe qytetërimit islam dhe rrjedha e fesë në Kosovë dhe viset tjera shqiptare të ish-federatës jugosllave, pa i kushtuar një vëmendje të veçantë dhe pa u konsultuar revista “Edukata Islame”.

“Edukata Islame” në vazhdimësi ka botuar tema të fushave të ndryshme dhe po që se e vështrojmë me kujdes, do shohim që në 20 vjetet e para të daljes së saj, kryesisht ka botuar tema fetare nga fusha e Tefsirit, Akaidit, Fikhut, Historisë Islame, Hadithit, Ahlakut, pastaj aktivitete e informata nga institucionet e Bashkësisë Islame. Ndërsa në 20 vjetshin e dytë, e posaçërisht në dekadën e fundit, “Edukata...” ka marrë karakter më universal e më gjithëpërfshirës, ngase në këtë kohë është hapur edhe ndaj fushave të tjera, ku ka botuar edhe shkri-me e trajtesa nga fusha e historisë, kulturës, qytetërimit, letërsisë, artit etj.

Kjo bibliografi, është dëshmia më e mirë që paraqet rezultatet e revistës “Edukata Islame”. Bibliografia, jemi të bindur se do t’u shërbej e do t’ua lehtësoj punën studiuesve dhe gjurmuesve të këtyre fushave.

Botimi i numrit 100 të “Edukatës Islame”, e bashkë me të edhe botimi i bibliografisë, është kujtim, mirënjohje dhe falënderim për të gjithë ata që e nisën, e rriten, e mbajtën dhe e drejtuan “Edukatën Islame”, që nga fillimi e deri më tash.

Botimi i numrit të 100 të “Edukatës Islame” shënon edhe një të arritur, ngase është pikërisht “Edukata Islame”, revista e parë islame gjithandej ku jetojnë shqiptarët që botohet në vazhdimësi për katër dekada pa ndërprerje, po ashtu “Edukata Islame”, është revista e parë islame që në këtë format arrin numrin 100, me një fjalë, është revista islame më jetëgjatë në trojet shqiptare. Dhe jo vetëm që është më jetëgjata, por, do të thoshim, edhe revista islame që ka pasur dhe ka një shtrirje gjithëkombëtare të temave, të lexuesve dhe të bashkëpunësorëve.

Shih ko incidencën, botimi i numrit Jubilar të revistës “Edukata Islame” korrespondon pikërisht edhe me ngjarjen e rëndësishme për kombin tonë- me shënimin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.

Të thëksojmë faktin se gjatë përgatitjes së së kësaj bibliografie është respektuar renditja kronologjike e temave sipas botimit të tyre për çdo numër veç e veç.

### Edukata Islame, nr. 1/1971

1. HOXHA, Hajrullah, *Me rastin e ditëlindjes së njeriut më të famshëm në botë-Muhamedit a.s.*, Edukata Islame, nr. 1/1971, fq. 3-5.
2. AHMETI, h. Sherif, *Prezentimi i Zotit xh.sh. në natyrë dhe procese*, Edukata Islame, nr. 1/1971, fq. 6-9.
3. *Profeti-pejgamberi Muhamed këshillon*, Edukata Islame, nr. 1/1971, fq. 10-13.
4. AHMETI, Sherif, *Islami është dituri e kulturës*, Edukata Islame, nr. 1/1971, fq. 14-18.
5. HOXHA, Hajrullah, *Muhamedi a.s.. dhe përhapja e fesë islame (III) vazhdim*, Edukata Islame, nr. 1/1971, fq. 19-23.
6. SOKOLLOVIQ, h. hfz. Sinanuddin, *Detyrat e fëmijëve ndaj prindërve*, e përktheu nga “Gllasniku” nr. 1-2/69 Jashar Jashari, Edukata Islame, nr. 1/1971, fq. 24-31.
7. MORINA<sup>1</sup>, Qemajl, *Kushtuar ditëlindjes së Muhamedit a.s (Ditës së mevludit)*, Edukata Islame, nr. 1/1971, fq. 32-34.
8. *Problemi i prapambeturisë së përgjithëshme*, e përktheu nga “Gllasniku” nr.11-12/1970 haxhi Jetish Bajrami, Edukata Islame, nr. 1/1971, fq. 35-42.
9. *Feja dhe jeta në dritën e Kur’anit*, e përktheu nga “Zemzemi” nr. 3-4/1970 Jashar Jashari, Edukata Islame, nr. 1/1971, fq. 43-47.
10. KADRIU, Abdylfetah, *Butësia dhe mëshirësia e Ymerit të Hatabi*, Edukata Islame, nr. 1/1971, fq. 48-50.
11. *Shembëll të cilin duhet ndjek edhe të tjerët*, Edukata Islame, nr. 1/1971, fq. 51-52.
12. *Bëmirësit*, Edukata Islame, nr. 1/1971, fq. 53-54.
13. *Thirrje për bashkëpunim*, Këshilli redaktues, Edukata Islame, nr. 1/1971, f. 56.
14. *I ndjeri Haxhi Mustafë ef. Canhasi*, Redaksia, Edukata Islame, nr. 1/1971, f. 55.

<sup>1</sup> Nxënës i klasës V të Medresesë “Alaudin” të Prishtinës.

**Edukata Islame, nr. 2/1971**

15. AHMETI, h. Sherif, *Komentim i sures "Vel Asri"*, Edukata Islame, nr. 2/1971, fq. 3-9.
16. SOKOLLOVIQ, h. hfz. Sinanuddin, *Detyrat e fëmijëve ndaj prindërve* (vazhdim II), e përktheu nga "Gllasniku" nr. 1-2/69 Jashar Jashari, Edukata Islame, nr. 2/1971, fq. 10-18.
17. AHMETI, h. Sherif, *Profeti Muhamed këshillon*, Edukata Islame, nr. 2, fq. 19-21.
18. HOXHA, Hajrullah, *Muhamedi a.s. dhe përhapja e fesë islame* (vazhdim IV), Edukata Islame, nr. 2/1971, fq. 22-27.
19. DOVOLANI, hfz. Behxhet, *të Falurit e namazit*, Edukata Islame, nr. 2/1971, fq. 28-32.
20. *Problemi i prapambeturisë së përgjithëshme* (vazhdimi II), e përktheu nga "Gllasniku" nr. 11-12/1970, H. Jetish Bajrami, Edukata Islame, nr. 2/1971, fq. 33-41.
21. AHMETI, h. Sherif, *Shkollimi-arsimimi i femrës dhe Islami*, Edukata Islame, nr. 2, fq. 42-45.
22. KADRIU, Abdulfetah, *Lanësimi i edhe një gjenerate maturantësh*, Edukata Islame, nr. 2/1971, fq. 46-48.
23. *Bëmirësit*, Edukata Islame, nr. 2/1971, fq. 49.
24. *Statuti i Bashkësisë Islame për territorin e Kuvendit në Prishtinë*, Edukata Islame, nr. 2/1971, fq. 51-85.

**Edukata Islame, nr. 3/1971**

25. AHMETI, h. Sherif, *Mirë se na vjen muaj i madh i arsimit islam!*, Edukata Islame, nr. 3/1971, fq. 3-7.
26. AHMETI, h. Sherif, *Komentim i sures "el-Fatiha"*, Edukata Islame, nr. 3/1971, fq. 8-16.
27. SOKOLLOVIQ, hfz. Sinanuddin, *Detyrat e fëmijëve ndaj prindërve* (vazhdimi III), e përktheu Jashar Jashari, Edukata Islame, nr. 3/1971, fq. 17-24.
28. SPAHIJA, Ibrahim, *Islamizmi dhe roli i tij në ruajtjen e traditave kombëtare ndër popuj*, Edukata Islame, nr. 3/1971, fq. 25-29.
29. SPAHIU, Rustem, *Zoti*, Edukata Islame, nr. 3/1971, fq. 30.
30. T. Nelaj<sup>2</sup>, *Të Huajt (jomuslimanët) për islamizmin, Kur'anin dhe Muhamedin a.s.*, Edukata Islame, nr. 3/1971, fq. 31-39.
31. BAJRAMI, h. Jetish, *Urtësia e fjalës së fundit*, Edukata Islame, nr. 3/1971, fq. 40-48.
32. HOXHA, Hajrullah, *Muhamedi a.s. dhe përhapja e fesë islame* (V), Edukata Islame, nr. 3/1971, fq. 49-55.
33. SHABANI, Hysen, *Kushtuar profetëve*, Edukata Islame, nr. 3/1971, fq. 56.
34. JASHARI, Jashar, *Reis-ul-Ulema për vizitë Kosovës*, Edukata Islame, nr. 3/1971, fq. 57-59.
35. *Bëmirësit*, Edukata Islame, nr. 3/1971, fq. 60.

---

<sup>2</sup> Pseudonim i Feti Mehdiut (r.sh.).

### Edukata Islame, nr. 4/1972

36. AHMETI, h. Sherif, Koment i ajetit “*Inneddine Indall-llahil Islam*”, Edukata Islame, nr. 4/1972, fq 3-8.
37. SOKOLLOVIQ, h. hfz. Sinanuddin, *Detyrat e fëmijëve ndaj prindërvet*, e përktheu, Jashar Jashari, Edukata Islame, nr. 4/1972, fq. 9-20.
38. T. Nelaj, *Për Muhamedin<sup>3</sup> a.s.*, Edukata Islame, nr. 4/1972, fq. 21-26.
39. *Dyshimet rreth fesë Islame*, Edukata Islame, nr. 4/1972, fq. 27-34.
40. PLLANA, Ahmet, *Për Zotin*, Edukata Islame, nr. 4/1972, fq. 35.
41. *Ali ibni Ebi Talib dhe drejtësia e gjyqit islam*, e përktheu nga arabishtja, Sherif Ahmeti, Edukata Islame, nr. 4/1972, fq. 36-41.
42. AZIZI, Abdurezak, *Bujaria*, Edukata Islame, nr. 4/1972, fq. 42-45.
43. *Ebreja kriminale*, (tregim), Edukata Islame, nr. 4/1972, fq. 46.
44. *Kush nuk e ka qëlluar-është mashtrua* (fjalë të urta), përkthyer nga arabishtja, Edukata Islame, nr. 4/1972, fq. 47.
45. VEZAJ, Ali, *Kush e krijoi gjithsinë?*, Edukata Islame, nr. 4/1972, fq. 48.
46. *Jerusalemi (Kudësi)*, përkthyer nga literatura arabe, Edukata Islame, nr. 4/1972, fq. 49-55.
47. JASHARI, Jashar, *Solemnitet fetar me rastin e duasë së hatmes në Mushnikovë të Prizrenit*, Edukata Islame, nr. 4/1972, fq. 56-57.
48. *Bëmirësit, nga Drejtoria e Medresesë “Alauddin”* Edukata Islame, nr. 4/1972, fq. 58-60.

<sup>3</sup> Mendimet e jomuslimanëve për Muhamedin a.s.

### Edukata Islame, nr. 5/1972

49. AHMETI, h. Sherif, *Komentim i sures “Ihlas”*, Edukata Islame, nr. 5/1972, fq. 3-9.
50. AHMETI, h. Sherif, *Disa fjalë mbi pejgamberin e fesë islame*, Edukata Islame, nr. 5/1972, fq. 10-16.
51. N. N. *Yll i pa shuar*, Edukata Islame, nr. 5/1972, fq. 17-18.
52. *Tërë jetën do të ia kushtoj përhapjes së Islamit<sup>4</sup>*, e përktheu Faik Bashota, Edukata Islame, nr. 5/1972, fq. 19-25.
53. SOKOLLOVIQ h. hfz. Sinanuddin, *Detyrat e fëmijëve ndaj prindërvet*, e përktheu Jashar Jashari, Edukata Islame, nr. 5/1972, fq. 26-34.
54. JASHARI, Jashar, *Vërejtje*, Edukata Islame, nr. 5/1972, fq. 34-35.
55. LEVAKOVIQ, Hasan, *Pendimi i singertë- Tevbeja*, përktheu, Avni Aliu, Edukata Islame, nr. 5/1972, fq. 36-41.
56. HADŽIĆ, Kasim, *Pozita e femrës në islamizëm*, përktheu nga serbokroatishtja, Ibrahim Spahija, Edukata Islame, nr. 5/1972, fq. 42-47.
57. AL-SUBAI, Muhammed, *Djegëja e Mesxhid-ul-Aksas*, nga arabishtja e shqipëroi, Ismail Ahmed, Edukata Islame, nr. 5/1972, fq. 48-49.
58. HABIBI, Admir, *Në vend të komentit pse nuk jemi, si duhet të jemi*, Edukata Islame, nr. 5/1972, fq. 50-55.
59. SAKAR. Abdullbeidë, *Litari i drunjt (tregim)*, e përktheu prej arabishtes, H. Sherif Ahmeti, Edukata Islame, nr. 5/1972, fq. 56-57.
60. *Naimi, dashurinë e tij ndaj Perëndisë dhe gjithësisë e ka shprehur shumë bukur në vjershën “Jeta”*, marr nga “Lulet e Verës”, Edukata Islame, nr. 5/1972, fq. 58.

<sup>4</sup> Intervistë me kampionin e botës në boks, Muhamed Aliun, e huazuar nga “Preporod”-i.

61. JASHARI, Jashar, *Jeta fetare në Lubinë të Epërme*, Edukata Islame, nr. 5/1972, fq. 59-61.
62. *Bëmirësit*, Edukata Islame, nr. 5/1972, fq. 62-63.

**Edukata Islame, nr. 6/1972**

63. AHMETI, h. Sherif, *Koment i ajetit "Rabbenâ atina fiddunja haseneten ve fil ahireti haseneten ve kina adhabennar"*, Edukata Islame, nr. 6/1972, fq. 3-10.
64. XHOZO, h. Husejn, *Islami Besim në një Zot*, përktheu Jetish Bajrami, Edukata Islame, nr. 6/1972, fq. 11-21.
65. SOKOLLOVIQ, h. hfz. Sinanuddin, *Detyrat e fëmijëve ndaj prindërve* (vazhdim), e përktheu Jashar Jashari, Edukata Islame, nr. 6/1972, fq. 22-26.
66. *Femra (gruaja dhe islami)*, përktheu, Ibrahim Spahija, Edukata Islame, nr. 6/1972, fq. 27-36.
67. HOXHA, Hajrullah, *Muhamedi a.s. dhe përhapja e fesë islame* (V-vazhdim nga numri 3/1971), Edukata Islame, nr. 6/1972, fq. 37-41.
68. AHMETI, Sherif, *Gjurmave të artikullit të shkruar nga prof. Fehmi Kelmendi, e të botuar në revistën mujore "Fjala" nr. 29/a*, (reagim), Edukata Islame, nr. 6/1972, fq. 42-47.
69. ZHINIPOTOKU, Mehmet, *Çfrenimi*, Edukata Islame, nr. 6/1972, fq. 48-49.
70. ANAMALI, Shaqir, *Butësija*, Edukata Islame, nr. 6/1972, fq. 50-51.
71. GASHI, Mehmet, *Jeta fetare në Kosovë*, Edukata Islame, nr. 6/1972, fq. 52-54.
72. RATKOCERI, Hajdin, *Jam për atë që të tretet hakmarrja*, Edukata Islame, nr. 6/1972, f. 55.
73. M. G., *Bamirësit*, Edukata Islame, nr. 6/1972, fq. 56-57.
74. VEJSELOVIQI, haxhi Beqir, *Merhum haxhi Sadik efendi Hoxha*, Edukata Islame, nr. 6/1972, fq. 58-61.

### Edukata Islame, nr. 7/1973

75. OSMANI, haxhi Rashid, *Eudhu Bil-lahi Mineshshejtaniirrahim Bismil-lahirrahmanirrahim*<sup>5</sup>, Edukata Islame, nr. 7/1973, fq. 3-5.
